

**Abdurahman bin Muala Al-Luejhik**

قواعد في التعامل مع العلماء

# **Etika e Sjelljes ndaj Dijetarëve**

*Bazuar në thëniet e sahabëve,  
tabi'inëve, tabi-tabi'inëve dhe  
dijetarëve të umetit islam.*

*Pasuruar me këshillat e shejkh  
Abdulaziz bin Abdullah bin Baz,  
Salih El-Feuzan,  
Nasir Abdul Kerim El-Akil etj.*



شبكة  
الألوكة  
www.alukah.net







Abdurahman bin Mualá Al-Luejhik

قواعد في التعامل مع العلماء

## **Etika e sjelljes ndaj dijetarëve**

*Bazuar në thëniet e Sahabëve, Tabi'inëve, Tabi Tabi'inëve  
dhe dijetarëve të umetit islam .*

*Pasuruar me këshillat e shejkh  
Abdul Aziz bin Abdullah Bin Baz, Salih El-Feuzan,  
Nasir Abdul Kerim El-Akil etj...*

Përkthyer nga arabishtja

**Mesazhi**

Tiranë

**Etika e sjelljes ndaj dijetarëve**

Titulli i origjinalit

قواعد في التعامل مع العلماء

Kauidun fij Et-Teamuli mea El-Ulema

Autor:

عبد الرحمن بن معلا اللويحق

Abdurahman bin Muala Al-Luejhik

Përktheu dhe përzgjedhi nga arabishtja:

Eduart Thartori dhe Arsen Muskurti {Hamza}

Recensentë:

Ma, Arsen Muskurti {Hamza}

Radhitja:

Ma, Arsen Muskurti {Hamza}

Korrektor:

Ma, Arsen Muskurti {Hamza}

Redaktor:

Roald A. Hysa

Përpunimi grafik:

Elton Gjeçi

Botuar nga:

**Mesazhi**

Rruga: Islam Alla, Tiranë – ALBANIA

00355 4 2421799

00355 672043863

mesazhi-tirana@hotmail.com



ISBN: 978-9928-4124-0-9

Shënimi CIP i katalogut të këtij librit gjëndet në bibliotekën kombëtare në Tiranë.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e saj nuk lejohet të shumëfishohet [kopjohet], të strehohet [ruhet] diku apo të shpërndahet në çdo lloj forme, qoftë elektronike apo mekanike, përfshirë fotokopjimin pa të drejtën e Botuesit.

Botimi i parë, Tiranë 2012.





درجات في شامخ العلم والعمل والدعوة

# قول محمد

في النكاح من كتب العلماء

تقديم

سماحه لفتح لعلامه

عبد العزيز بن عبد الله بن باز

تأليف

عبد الرحمن بن عبد السلام



## Pasqyra e Lëndës

Pasqyra e Lëndës	5
Parathënie e Dijetarit të nderuar Shejkh Abdul Aziz bin Abdullah Bin Baz	1
Parathënie e autorit	3
<b>PJESA E PARË</b>	<b>11</b>
Kapitulli i parë: Kush quhen Dijetarë?	13
Kapitulli i dytë: Cilësitë e dijetarëve	23
Kapitulli i Tretë: Dallimi i dijetarit me ata që e pretendojnë se janë të tillë.	29
E Para: Dallimi ndërmjet Dijetarit dhe Leximtarit	29
E dyta: Dallimi ndërmjet Dijetarit dhe Mendimtarit	36
E treta: Dallimi ndërmjet dijetarëve dhe ligjëruesve (khatibëve)	39
Kapitulli i Katërt: Pozita e dijetarëve dhe vlerat e tyre	42
Ixhmai (unanimiteti i mendimit të dijetarëve)	70
<b>PJESA E DYTË</b>	<b>75</b>
<i>Parime në sjelljet me dijetarët</i>	<i>75</i>
Kapitulli i parë: Dashuria për Dijetarët.	77
Kapitulli i dytë: Respekti dhe vlerësimi i Dijetarëve.	83
Kapitulli i tretë: Marrja e diturisë nga dijetarët dhe mundimi i nevojshëm për këtë	87
Kapitulli i katërt: Respektimi i hierarkisë së dijetarëve.	93
Kapitulli i pestë: Rrezikshmëria e ofezave ndaj dijetarëve.	101
Kapitulli i gjashtë: Rrezikshmëria e kritikës jo profesionale ndaj dijetarëve.	106



Kapitulli i shtatë: Domosdoshmëria e justifikimit të dijetarëve. _____	112
Kapitulli i tetë: Referimi i dijetarëve në çdo moment, sidomos në kohë të turbullta. _____	116
Kapitulli i nëntë: Askush nga dijetarët nuk ka shpëtuar nga shpifjet _____	120
Kapitulli i dhjetë: Marrja në referencë e mirësive të dijetarëve para gjykitimit ndaj tyre _____	126
Kapitulli i njëmbëdhjetë: Kujdesi në gjykimin e gabimeve të dijetarëve _____	133
Kapitulli i dhjetë: Mospërfillja e kritikave nga bashkëkohësit _____	139
Kapitulli i trembëdhjetë: Dijetarët fillimisht gjykohen si të drejtë _____	145
Kapitulli i katërbëdhjetë: Ndalesa në kundërshtimin e dijetarëve _____	162
Kapitulli i pesëmbëdhjetë: Statusi i besueshmërisë për dijetarin. _____	172
Përfundimi _____	178
Fjalori Terminologjik _____	183
Biografi _____	197
Referenca _____	231



## بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

لَقَدْ مَنَّ اللَّهُ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ إِذْ بَعَثَ فِيهِمْ رَسُولًا مِّنْ أَنفُسِهِمْ يَتْلُوا عَلَيْهِمْ آيَاتِهِ  
وَيُزَكِّيهِمْ وَيُعَلِّمُهُمُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَإِن كَانُوا مِن قَبْلُ لَفِي ضَلَالٍ مُّبِينٍ ﴿١٦٤﴾

Allahu i Madhëruar thotë në Kuran: "Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre, i cili ua lexon Shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin (Kuranin) e urtësinë (diturinë e thellë fetare), edhe pse më parë, me të vërtetë, ata ishin në rrugë krejt të gabuar".

*Kuran: Ali Imran, 164.*

يُؤْتِي الْحِكْمَةَ مَن يَشَاءُ ۚ وَمَن يُؤْتَ الْحِكْمَةَ فَقَدْ أُوتِيَ خَيْرًا كَثِيرًا ۗ وَمَا يَذَّكَّرُ إِلَّا  
أُولُو الْأَلْبَابِ ﴿١٦٩﴾

"Cilitdo që i është dhënë urtësia, vërtet që i është dhënë një mirësi e madhe".

*Kuran: El-Bekare, 269.*

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) ka thënë: "Gjithmonë do të ketë një grup prej umetit tim të përqëndruar në Fenë e Allahut të Madhëruar. Ata nuk do të mposhten nga kundërshtarët e tyre as nga ata që i braktisin. Ata do të qëndrojnë ashtu deri kur të vijë Kijameti (urdhëri i Zotit) Në atë kohë ata do të jenë triumfues ndaj kundërshtarëve të tyre".

*Buhariu: 149, Muslimi: 1524.*

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) thotë: "Dallimi ndërmjet dijetarëve të devotshëm dhe besimtarëve të devotshëm është si dallimi i hënës së plotë me yjet që e rrethojnë. Dijetarët janë trashëgimtarët e Pejgamberëve. Ndërsa Pejgamberët nuk kanë lënë pas tyre pasuri, as dinar e as dirhemë. Ata kanë lënë pas diturinë e tyre. Kush e merr këtë, ka arritur një mirësi të madhe".

*Ebu Daud, 3641, Tirmidhiu: 2823.*

Dituria është trashëgimia e profetëve

Dituria është dritë, padituria është errësirë.

Dituria është jeta e zemrës dhe drita e syve.

Per dijetarin lutet dhe peshku që është në det.

Dituria e shoqeron njeriun si punë dhe pas vdekjes.

Zemra jeton me driten e dijes, sic jeton toka me ujin e qiellit.

Gjeja më e mirë në botë është dija, ndërsa gjeja më e keqe është padija

Sa njerëz i ka ngritur dituria në gratë të larta, e sa të tjerë të cilët kanë pozitë i ka ulur injoranca e tyre.





## Parathënie e Dijetarit të nderuar Shejkh Abdul Aziz bin Abdullah Bin Baz

Me Emrin e Allahut të Madhëruar <sup>(1)</sup>, falënderimet i takojnë Atij. Paqja dhe bekimet qofshin mbi Pejgamberin e fundit, Muhamedin të birin e Allahut. Qoftë paqja dhe bekimet e Allahut të Madhëruar mbi familjen e tij të pastër, mbi shokët e tij të ndershëm dhe mbi të gjithë ata që ndjekin me korrektësi rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit. <sup>(2)</sup>

E lexova këtë libër me vëmendje dhe interes. Duke qenë se më tërhoqi shumë e pashë të arsyeshme që t'i them këto fjalë për dobinë e tij. Autori i librit Shejkh <sup>(3)</sup> Abdurrahman bin Mualaa, ka sjellë në vëmendjen e lexuesit parime të etikës së sjelljes me dijetarët e botës islame. Sjell shembuj shumë të qëlluar nga

---

<sup>(1)</sup> - Allahu, është emri i Zotit, Krijuesit të gjithësisë. Termi 'i Madhëruar' përdoret në shenjë nderimi për Krijuesin e gjithësisë. Vetëm Atij i takon merita për ekzistencën e gjithçkaje në gjithësi. Adhurimi duhet ti dedikohet vetëm Atij dhe askujt tjetër, për faktin se Ai është Sunduesi i vërtetë i gjithçkaje. Emri madhështor "Allah" përmendet edhe në librat e mëparshëm sipas dialektikave të gjuhëve respektive. Në Bibël është përmendur 'Eloha' nga hebraishtja. Në Kuran emri "Allah" përmendet rreth 2153 herë. (sh.p)

<sup>(2)</sup> - Dita e Gjykimit, quhet dita e madhe në të cilën do të vendoset drejtësia absolute hyjnore. Ajo ditë do të jetë pas Kijametit dhe ringjalljes së krijesave. Do të jetë e gjatë sa njëmijë vjet me ato të tokës. Në të njerëzit do të llogariten për çdo veprim të jetës së tyre në këtë botë dhe do të shpërblehen sipas veprave që kanë kryer. Të gjitha veprat e tyre do të vihen në peshore dhe nëse ajo do të anojë nga punët e mira, personi do të shpërblehet me Xhenet. Ndërsa nëse peshorja do të anojë nga veprat e këqija, atëherë personi do të dënohet në zjarrin e Xhehenemit. Aty do të ketë edhe dëshmitarë të cilët do të dëshmojnë për veprat që ka kryer njeriu, prej të cilave do të jenë edhe vetë gjymtyrët dhe shqisat e tij. Prej dëshmitarëve të kësaj dite gjithashtu mund të jenë edhe engjëjt, njerëzit, kafësht dhe sendet. Vetë Kurani do të dëshmojë mbi sjelljen e njeriut në raport me të. (sh.p)

<sup>(3)</sup> - Termi "Shejkh", është në gjuhën arabe dhe përdoret zakonisht për njerëzit e ditur, për njerëzit me reputacion shoqëror dhe për njerëzit e shtyrë në moshë. (sh.p).

jeta e dijetarëve të mëparshëm dhe të sotëm. Na i shërben ato në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme për këdo që e lexon këtë libër.

E porosis çdo kërkues të diturisë, çdo student, çdo person që e di, se me dituri afrohet tek Allahu i Madhëruar ta lexojë këtë libër dhe të kuptojë, se për ta marrë diturinë duhet mund, punë, modesti dhe dashamirësi, dhe se dijetarët janë pikërisht ato llampa që ua ndriçojnë rrugën për tek Krijuesi i Gjithësisë, Allahu i Madhëruar. Prandaj sjellja ndaj tyre duhet të jetë e mbushur me respekt dhe dashuri për ta.

Lus Allahun e Madhëruar që dobia e këtij libri të jetë e shpërndarë në sa më shumë njerëz të Umetit <sup>(4)</sup> tonë dhe t'ia shpërblejë mundin e kësaj pune autorit të librit, në këtë botë dhe në Ahiret.

*Me respekt Abdul-Aziz bin Abdullah Bin Baz*

*Myftiu<sup>(5)</sup> i përgjithshëm i Mbretërisë së Arabisë Saudite. President i komitetit të Dijetarëve të Mbretërisë dhe Institutit të Studimeve Islame dhe Fetvasë<sup>(6)</sup>*

<sup>(4)</sup> - Termi "Umet", në gjuhën arabe përkthehet si Bashkësi dhe përdoret zakonisht për bashkësinë islame. Është nocion më i gjerë sesa termi komb, pasi në bashkësinë islame futen kombe të ndryshme. Umeti musliman, është nocioni i përdorur për kombin apo popullin musliman. Ai nuk është i ndërtuar mbi baza etnike apo raciale, porse baza e tij është përkatësia në Islam. Në fakt në Umetin musliman, futen edhe ato pakica jo muslimane, të cilat janë të mbrojtura me kontratë nga Shteti Islam. (sh.p)

<sup>(5)</sup> - Myfti, edhe ky është term në gjuhën arabe dhe përkthehet si njeriu, i cili nxjerr gjykimin ndaj një çështjeje të caktuar. Sigurisht personi që ka tagrin ta nxjerrë gjykimin dhe ta bëjë atë publik duhet të jetë patjetër i specializuar në fushat përkatëse. Zakonisht ky term përdoret për juristët e Sheriatit Islam. (sh.p).

<sup>(6)</sup> - Fetva, është gjykim për një çështje të caktuar dhe duhet të dalë vetëm nga një person i specializuar në këto çështje dhe që në këtë rast quhet Myfti. (sh.p).



## Parathënie e autorit

Falënderimi i takon Allahut të Madhëruar, që krijoi qiejt dhe tokën. Krijoi errësitrat dhe dritën, edhe pse mosbesimtarët këtë gjë akoma nuk e pranojnë.

Falënderimi i takon Allahut të Madhëruar, që për çdo mirësi që na ka dhënë ne nuk kemi mundësi t'ia kthejmë falënderimin tonë ashtu siç e meriton Ai.

Sado të përpiqen poetët, shkrimtarët, shkencëtarët etj., që ta përshkruajnë Bukurinë e Tij, ata mbeten gjithmonë të dorëzuar para Madhështisë së Tij.

Prej Tij ndihmë kërkoj. Pa Atë fuqi nuk ka, as mbrojtje e as dritë.

Allahut të Madhëruar i lutem që udhën time drejt Tij të ma ndriçojë. Askush nuk humb, nëse prej Tij është i udhëzuar.

Allahut të Madhëruar falje i kërkoj për çdo gabim dhe faj që kam bërë në jetën time. I sigurtë, se askush veç Tij faljen dhe qetësinë nuk mund të ma dhurojë. I Sigurtë, se prej Allahut të Madhëruar, askush pa dashurinë dhe mëshirën e Tij nuk mund të shpëtojë.

Dëshmoj se Nuk ka zot tjetër veç Allahut, i Vetëm, i Pashoq, që e meriton me të drejtë të adhurohet dhe i denjë për adhurim. Dëshmoj gjithashtu se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij.

Allahu i Madhëruar i dhuroi botës mirësinë më të madhe me dërgimin e Muhamedit (paqja qoftë mbi të) si Pejgamber <sup>(7)</sup> dhe me Mesazhin e tij.

لَقَدْ مَنَّ اللَّهُ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ إِذْ بَعَثَ فِيهِمْ رَسُولًا مِّنْ أَنفُسِهِمْ يَتْلُوا عَلَيْهِمْ آيَاتِهِ  
وَيُزَكِّيهِمْ وَيُعَلِّمُهُمُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَإِن كَانُوا مِن قَبْلُ لَفِي ضَلَالٍ مُّبِينٍ ﴿١٢٩﴾

(7) - Termi Pejgamber, përkthehet ndryshe, si i dërguar i Zotit për të përcjellë mesazhet e Tij. Në Kuran përmenden rreth 28 Pejgamberë, por numri i tyre i kalon të 120 mijët. Ata janë dërguar kohë pas kohe tek popuj të ndryshëm për ta përcjellë këtë mesazh. Pejgamberi i fundit dhe vula e mesazhit hyjnor është Muhamedi (paqja qoftë mbi të).



“Allahu u ka dhënë besimtarëve një dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre, i cili ua lexon Shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe iu mëson Librin (Kuranin) e urtësinë (diturinë e thellë fetare), edhe pse më parë ata ishin me të vërtetë në rrugë krejt të gabuar.”

*Kuran: Ali Imran, 164.*

Kjo pra, Muhamedi (*paqja qoftë mbi të*) dhe mesazhi i tij ishte dhurata më e madhe që Allahu i Madhëruar iu ka dhënë besimtarëve (në fakt të gjithë njerëzimit).

Dhurata e Allahut të Madhëruar do të vazhdonte edhe pas largimit të Muhamedit (*paqja qoftë mbi të*) nga kjo botë, duke e trashëguar diturinë dhe mesazhin e tij tek dijetarët. Trashëgimia e mesazhit të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) nga dijetarët do të thotë, se ky mesazh nuk do të mbaronte me jetën e një njeriu (Muhamedit) (*paqja qoftë mbi të*). Përkundrazi ai do të përcillej nga dijetarët, duke e aplikuar atë në jetën e çdo besimtari, duke e sqaruar, hulumtuar në thellësitë e tij dhe duke nxjerrë prej tij ato thesare, që janë të vyer për njerëzimin e çdo race apo kombi, deri në ditën e fundit të kësaj bote.

Duke qenë se dijetarët trashëgojnë dituritë e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) ata njëkohësisht trashëgojnë edhe respektin që iu kushtohet këtyre diturive, ashtu siç u bë e detyrueshme për çdo musliman, që të respektojë diturinë, lodhjen, nderimin dhe vlerësimin e saj. E Njëjta gjë u bë e detyrueshme për ta edhe respekti ndaj dijetarëve, lodhja për ta, nderimi dhe vlerësimi i tyre. Sigurisht deri në momentin kur këta të fundit të jenë të bindur ndaj Allahut të Madhëruar dhe Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*).

Kështu kanë vepruar edhe brezat e parë të kërkuesve të diturisë të këtij Umeti. Dijetarët e atyre kohëve vendoseshin gjithmonë të parët në respekt. Në kuvende të ndryshme vendi i tyre ishte vendi i nderit. Ata merreshin si referencë për problemet e shoqërisë. Njerëzit në ato kohë ia dinin vlerën dhe respektin dijetarëve të tyre.

Më vonë ndryshuan brezat, dituria u pakësua bashkë me të edhe dijetarët. Në mesin e këtyre shoqërive dijetarët e vërtetë ishin të rrallë. Me rrallimin e



dijetarëve të vërtetë edhe respekti ndër njerëz humbi. Filluan të mos njihnin çfarë duhet nderuar. Njerëzit filluan të përçaheshin në klane e në grupime.

1. Disa prej tyre i konsideronin dijetarët si çdo njeri tjetër. Duke menduar se Islami nuk e shenjtëron njeriun ata as që iu kushtonin vëmendjen më të vogël dijetarëve. Këta në fakt u ngajnë shumë Khauarixhëve <sup>(8)</sup>, të cilët treguan mungesë respekti ndaj dijetarëve të parë prej Sahabëve <sup>(9)</sup> të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Mirëpo këta (khavarixhët) u shkatërruan dhe bashkë me veten shkatërruan edhe shumë njerëz. Ata shkaktuan përçarje të madhe, klane dhe gjakderdhje.

2. Disa të tjerë i shenjtëruan dijetarët, aq sa i çuan aty ku ata nuk janë. Si pasojë filluan t'i ndjekin verbërisht. Ata nuk merrnin për bazë argumentet fetare. Për ta mjaftonte që shejhu i tyre ta kishte thënë dhe mjaftoheshin me këtë, duke e vendosur fjalën e tij mbi atë të Kuranit apo Hadithit të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Ky grup njerëzish u ngjan Rafidinjë <sup>(10)</sup>, të cilët i konsideronin udhëheqësit e tyre si të shenjtë. Ata i kthyen në objekte kulti pozita të cilat, as Pejgamberët, as engjët e Zotit nuk i kanë patur. Edhe këta u përçanë në grupe sipas numrit të udhëheqësve, që ata ndiqnin deri në adhurim.

3. Një grup tjetër njerëzish e kuptuan ndryshe figurën e dijetarit. Ata e respektonin atë shumë, madje aq shumë sa filluan të mos i trajtonin si njerëzit e tjerë. Nisur nga kjo ata e shihnin për të madhe që një dijetar të gabojë, madje gabimin e tij i cili mund të ishte si i çdo njeriu tjetër e shihnin shumë herë më të madh dhe e përhapnin ndër njerëz si një kob të rëndë.

Në fakt këta bëjnë një sërë gabimesh:

- I madhërojnë aq shumë dijetarët, aq sa nuk e përfytyrojnë sesi ai mund të gabojë.

---

<sup>(8)</sup> - Khauarixhët, janë një sekt ekstremist i dalë pas trazirash të mëdha, që janë shkaktuar në brezin e parë të Historisë Islame. (sh.p).

<sup>(9)</sup> - Sahabët, janë shokët e Pejgamberit Muhamed (*paqja qoftë mbi të*). Në fakt konsiderohet i tillë çdo bashkëkohës i tij, të cilët e kanë parë, ose jetuar me të duke qenë muslimanë. (sh.p).

<sup>(10)</sup> - Rafidinjë, edhe ky është një sekt ekstrem, i cili është diametralisht i kundërt me sektin e Havarixhëve. (sh.p).

- Abuzimi me figurën e dijetarit në rast gabimi, duke i përhapur fjalët dhe ofendimet ndaj tij.

- Teprimi deri aty, sa edhe shpifin për gjëra që ai në fakt as nuk i ka bërë. Apo gjykimi i tij sipas parametrave të tyre pa marrë parasysh justifikimet, që mund të ketë pasur ky dijetar.

Të gjitha këto grupe njerëzish janë të dukshëm në kohët tona.

Një dëshpërim i tillë nga ky realitet ishte shkak që më shtyu ta bëj këtë studim për të nxjerrë në pah vlerat e tyre dhe vendosjen e disa shinave, në lidhje me etikën, që duhet të tregojmë kundrejt dijetarëve tanë. Edhe pse nga njëra anë dëshpëroheshja me sjelljen e këtyre grupeve bashkëkohore ndaj dijetarëve të sotëm, nga ana tjetër vërehet një sjellje shumë fisnike nga brezat e parë të Umetit Musliman. Nderimi i tyre ishte brenda kufijve të njerëzores, po ashtu ishte edhe mirëkuptimi në rastet kur gabohej.

Pasi i mblodha të gjithë këta shembuj vendosa të ndërtoj disa parime bazë të etikës së sjelljes ndaj dijetarëve të Umetit tonë. Kjo gjë do të jetë e dobishme në tre aspekte:

1. Nxitja e studentëve dhe e kërkuesve të diturisë, që të thellohen edhe më shumë në dituri. Kështu ata ngjiten edhe më lart në vlera, për të arritur gradën e atyre, që Allahu i Madhëruar iu jep urtësi. Kur e arrijmë ta kuptojmë vlerën e dijetarëve, kushdo nxitet që të kërkojë të njëjtat vlera, pastaj përvesh mëngët dhe i futet punës për arritjen e këtyre vlerave të diturisë.

2. Ndhimmon në unitetin e Umetit Musliman dhe është një vaksinë e mirë kundër përçarjes së zemrave, pasi dijetarët janë pikat e referimit për masën e gjerë të Umetit. Nëse do të respektohej vlera e tyre, dhe do t'u referoheshim porosive që na japin, atëherë sigurisht që Umeti do të ecte në rrugën e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) të bashkuar në sfidat e tij. Edhe e kundërta vlen.

3. Në këtë libër përmenden emra dhe shembuj të njerëzve, të cilët janë vërtetë vlera të shoqërive njerëzore. Në kohën kur ne po jetojmë është e mbushur me shembuj dhe emra personash, të cilët janë antivlera të shoqërisë dhe shembuj të këqij për të. Në këtë mënyrë emrat dhe shembujt e këtyre njerëzve me vlerë do të mbaheshin mend dhe do të pasoheshin me dashuri dhe respekt. Është koha për të zgjedhur shembujt, që ne duhet të marrim në jetën tonë.





Duhet që lexuesi i nderuar, i cili do të shfletojë këtë libër të ketë parasysh këto dy shënime prej meje:

**Shënimi i parë:**

Dijetarët për të cilët e kam fjalën në këtë libër janë të gjithë ata të cilët njihen nga Umeti musliman. Nuk e kam fjalën për ata, që e konsiderojnë diturinë islame profesion. As me ata që mundohen ta orientojnë diturinë e tyre drejt interesit material. Ata në fakt nuk kanë lidhje me dijetarët e vërtetë. Ata thjesht u ngjajnë atyre në veshje dhe në të folur. Ata mund të jenë njerëz të ditur, por jo dijetarë.

Gjithashtu pjesë e këtyre që konsiderohen jo dijetarë janë edhe ata njerëz, të cilët e marrin diturinë e tyre si profesion me të cilin paguhen dhe jetojnë, dhe jo si mision për të cilin duhet të lodhen dhe të sakrifikojnë. Një pjesë e madhe e tyre mbështeten vetëm në aparcencën dhe gradat që u jepen dhe jo në thelbin e diturisë dhe misionin e saj.

Këta njerëz duhet të bëhen pjesë e masës së popullit pasi ata janë njerëz të mësuar dhe jo dijetarë.<sup>(11)</sup>

**Shënimi i dytë:**

Ky libër shqyrton etikën e njerëzve ndaj dijetarëve dhe jo etikën e këtyre të fundit ndaj njerëzve, pasi këtu nuk kam çfarë të shtoj, sepse ata që janë dijetarë e kuptojnë fare mirë këtë problem dhe e praktikojnë atë drejt.

Këtë libër e kam ndarë në dy pjesë:

**Pjesa e parë**

Në këtë pjesë e kam shtjelluar në disa kapituj, ku kam përmendur në to:

*Kapitulli i parë:* Personalitetin e dijetarëve dhe rolin e tyre në shoqëri.

*Kapitulli i dytë:* Mënyra e njohjes së një dijetari.

*Kapitulli i tretë:* Dallimi midis dijetarëve të vërtetë dhe atyre që nuk e meritojnë këtë emër.

*Kapitulli i katërt:* Pozita e dijetarëve në Islam dhe vlerësimet që iu jep Allahu i Madhëruar atyre.

---

<sup>(11)</sup> - Mund të përdoret si konsultim për llojet e dijetarëve libri i dijetarit Bekër Ebu Zejd "Të mësuarit dhe rezultatet e tij në ideologji dhe në Krijimtari".

**Pjesa e dytë**

*Kapitulli i parë:* Dashuria ndaj dijetarëve.

*Kapitulli i dytë:* Respekti dhe vlerësimi i dijetarëve.

*Kapitulli i tretë:* Referimi tek dijetarët dhe ndjekja e tyre.

*Kapitulli i katërt:* Respekti i hierarkisë së dijetarëve.

*Paragrafi i pestë:* Rreziku i cënimit të vlerave të dijetarëve.

*Kapitulli i gjashtë:* Rreziku i hedhjes poshtë të argumenteve që ata sjellin, sidomos kur kjo ndodh pa justifikimet përkatëse.

*Kapitulli i shtatë:* Domosdoshmëria e justifikimit të qëndrimeve të dijetarëve.

*Kapitulli i tetë:* Domosdoshmëria e referimit tek dijetarët sidomos në raste krizash.

*Kapitulli i nëntë:* Besueshmëria ndaj dijetarëve.

*Kapitulli i dhjetë:* Mos nxitimi në gjykime ndaj dijetarit, dhe marrja parasyshe e vlerave të tij.

*Kapitulli i njëmbëdhjetë:* Kujdesi nga gabimet e dijetarëve.

*Kapitulli i dymbëdhjetë:* Mos-marrja në konsideratë e bashkëkohësve të tyre dijetarë, në rast se ata flasin negativisht për kolegun e tyre.

*Kapitulli i trembëdhjetë:* Kujdesi ndaj dhënies së gjykimit për fetvanë përkatëse ndaj një dijetari.

*Kapitulli i katërbëdhjetë:* Domosdoshmëria e lënies së debatit me dijetarët.

*Kapitulli i pesëmbëdhjetë:* Pozita e besueshmërisë tek Dijetarët

Konkluzionet e kësaj pjese.

Gjithashtu dëshiroj këtu të falënderoj Allahun e Madhëruar, që ma mundësoi arritjen me sukses në këtë studim. Pastaj falënderoj të gjithë ata që dhanë ndihmesën e tyre në suksesin e këtij libri. Duke filluar me dijetarin e njohur Shejkh Abdul Aziz bin Abdullah Bin Baz, Myftiu i përgjithshëm i Mbretërisë së Arabisë Saudite dhe president i Komitetit të Dijetarëve të Mbretërisë dhe Institutit të Studimeve Islame dhe Fetvasë, i cili pati mirësinë ta lexonte këtë



libër dhe të jepte mendimin e tij për të (Allahu e mëshiroftë)<sup>(12)</sup>. Ai më dha sugjerimet e nevojshme, të cilat unë me kënaqësi i bëra pjesë të librit tim.

Gjithashtu dua të falënderoj një grup dijetarësh, të cilët me këshillat dhe sugjerimet e tyre, disa edhe nëpërmjet ligjëratëve dhe shkrimeve hapën dritare të reja për mua në horizontin e diturisë. Veçanërisht prej tyre: Dr. Salih El-Feuzan, Dr. Bekr bin Abdullah Ebu Zejd, Dr. Nasir Abdul Kerim El-Akil.

Një falënderim i veçantë edhe për Shejhun e nderuar Salih bin Muhamed El-Hakemi, i cili ia lexonte<sup>(13)</sup> Shejkh Bin Bazit këtë libër. E falënderoj për mundimin e tij deri në maksimum, që të caktonte takimet e herëpashershme me këtë dijetar të umetit musliman, për lodhjen e tij në leximin me zë.

Të gjithë këtyre miqve të mi nuk gjej mundësi që t'ua shpërblej në nivelin e duhur për mundimet e tyre, përveç faktit që e lus Allahun e Madhëruar, që t'ua dhurojë këtë shpërblim në këtë botë duke i ngritur vlerat e tyre dhe në botën tjetër në Xhenetet e Tij të larta.

\*\*\*

Nëse kam qenë i saktë në përpjekjen timen, e gjitha kjo është sepse Allahu i Madhëruar më ka ndihmuar. Por nëse në të diku mund të kem gabuar, atëherë kjo ka ardhur prej dobësisë time dhe shejtanit të mallkuar.

O Allah i Madhëruar, për hatrin Tënd i dua dijetarët. Duke respektuar ata të respektoj Ty. O Allah i Madhëruar, më ringjall me grupin e tyre në Ditën e Llogarisë, me Pejgamberët, (*paqja qoftë mbi ta*), dëshmorët<sup>(14)</sup> dhe të gjithë besimdrejtët.

---

(12) - *Dijetari i njohur*, Shejkh Abdul Aziz bin Abdullah bin Baz ka ndërruar jetë në vitin 1999. (sh.p).

(14) - *Dijetari i njohur*, Shejkh Abdullah bin Baz që në moshë të vogël ka humbur shikimin për këtë arsye ai kishte dikënd që i'a lexonte atij literaturën për të cilën do të mësonte ose do ta publikonte. Edhe ky rast bën pjesë në praktikën e tij të vazhdueshme. (sh.p).

(14) - *Dëshmor*, në Islam konsiderohet çdo musliman që lufton dhe jep jetën e tij në beteja kundër mosbesimtarëve, ose në mbrojtje të nderit, pasurisë dhe jetës së tij, apo familjes së tij, madje i tillë konsiderohet edhe ai që mbron atdheun e tij duke qenë besimtar dhe me nijetin që këtë sakrificë t'ia dedikojë vetëm Allahut të Madhëruar. (sh.p).

Më ndero o Allahu im, me vlerat e tyre. O Allah pastroji qëllimet e mia, më dhuro gjykim të drejtë dhe fjalë të drejtë. M'i fal gjynahet, ato që unë i di dhe ato që nuk i di. Ty t'i dedikoj të gjitha mirësitë që kam. Vetes time ia njoh të metat e saj! Të lutem Allahu im më mëshiro.

*Vëllai juaj në fe*

*Abdurrahman bin Muala El-Luejhik El-Mutairi*

*Dhul Hixha 1414 Hixhri<sup>(15)</sup>*

---

<sup>(15)</sup> - *Hixhri*, është mënyra e llogaritjes së kohës sipas historisë Islame. Kalendari që bazohet në llogaritjet hënore dhe fillon me kohën kur Pejgamberi (*Paqja qoftë mbi të*) emigroi nga Meka në Medine (më 24 shtator të vitit 622 e.s.), dhe i pari që e caktoi këtë Kalendar ishte Omer Ibn Hatabi, Halifi i dytë i shtetit Islam. Viti hixhri ka 12 muaj me nga 29 deri në 30 ditë. Dita e parë fillon më dt: 16 Qershor të vitit 622 e.s. Aktualisht ndër shtetet që e aplikojnë zyrtarisht këtë Kalendar është Arabia Saudite. (sh.p).





# PJESA E PARË



## Kapitulli i parë: Kush quhen Dijetarë?

Dijetarët janë ata që njohin ligjin e Allahut të Madhëruar, ata të cilët janë të thelluar në dituri. Janë ata që diturinë e tyre e vejnë në zbatim me urtësi dhe mençuri. Janë ata të cilët Allahu i Madhëruar iu ka dhuruar urtësi:

يُؤْتِي الْحِكْمَةَ مَنْ يَشَاءُ وَمَنْ يُؤْتَ الْحِكْمَةَ فَقَدْ أُوتِيَ خَيْرًا كَثِيرًا وَمَا يَذَّكَّرُ إِلَّا  
أُولُو الْأَلْبَابِ ﴿٢٦٩﴾

"Kujtudo që i është dhënë urtësia, vërtet që i është dhënë një mirësi e madhe".

*Kuran: El-Bekare, 269.*

Allahu i Madhëruar i ka bërë dijetarët shtylla të shoqërisë, që mbartin hallet e tyre. Ata japin zgjidhje për problemet e shoqërisë, qofshin ato në çështje fetare apo në çështje të kësaj bote.<sup>(16)</sup>

Dijetarët janë juristët e Islamit<sup>(17)</sup>. Janë ata të cilëve iu referohemi në çështjet e fetvasë.<sup>(18)</sup> Janë ata të cilët analizojnë dhe nxjerrin argumentat përkatëse nga

<sup>(16)</sup> - Imam Et-Taberi, "Xhamiu el-Bejan", vëllimi: 3, faqa: 327.

<sup>(17)</sup> - *Islami*, është i vetmi religjion dhe besim i pranuar tek Allahu i Madhëruar. Ai është i vërteti. Të gjitha religjionet e tjera kanë dalë si shkak i devijimit nga religjioni i vërtetë që është Islami. Në fakt Islami është shumë më tepër se religjion, ai është program jete për njeriun në misionin e tij si mëkëmbës i Allahut të Madhëruar në Tokë dhe i krijesave që ka në të. Përkthehet në shqip (paqe, harmoni) në këtë rast në harmoni me Allahun e Madhëruar dhe me krijesat e Tij. Islami është besimi i të gjithë Pejgamberëve (paqja goftë mbi ta). (sh.p).

<sup>(18)</sup> - Imam Ibën Kajim, "Ialam el-Muekin", vëllimi: 1, faqja: 7.

burimet e Islamit Kurani<sup>(19)</sup> dhe Suneti<sup>(20)</sup>. Janë ata që vendosin parimet e Hallallit<sup>(21)</sup> dhe Haramit<sup>(22)</sup>.

Dijetarët janë udhëheqësit e Islamit. Ata e arrijnë këtë gradë të lartë duke u thelluar në dituri, me durim në të vërtetën dhe me besim të plotë tek Allahu i Madhëruar.

وَجَعَلْنَا مِنْهُمْ أُمَّةً يَهْتَدُونَ بِأَمْرِنَا لَمَّا صَبَرُوا وَكَانُوا بِعَايَتِنَا يُوقِنُونَ ﴿٢٤﴾

“Ne zgjodhëm prej tyre prijës, të cilët udhëzonin me urdhrat Tanë, për sa kohë që ishin të durueshëm dhe besonin bindshëm.”

*Kuran: Es-Sexhde, 24.*

Dijetarët janë trashëgimtarët e Pejgamberëve. Ata kanë trashëguar prej tyre diturinë. Ata pasi e mësojnë atë me zemër dhe mendje, e reflektojnë atë me punën e tyre dhe i ftojnë njerëzit në atë dituri.

Dijetarët janë ai grup njerëzish që u zgjodhën për ta kërkuar diturinë. Lanë çdo gjë pas vetëm që të mësonin Islamin, këtë fe të Allahut të Madhëruar. Pastaj janë ata që marrin përsipër misionin e përhapjes së diturisë dhe edukimin e popullit të tyre kur të kthehen.

<sup>(19)</sup> - *Kurani*, është mesazhi i fundit hyjnor i zbritur nga Allahu i Madhëruar. Ai i zbriti Pejgamberit Muhamed (*paqja qoftë mbi të*). Përbëhet nga 114 kapituj (sure), i ndarë në 30 pjesë (xhuze). Ai konsiderohet mrekulli, për faktin se në të ka vazhdimisht argumente të rigjenerueshme për të gjitha kohët dhe vëndet. Është i mbrojtur nga çdo deformim nga vetë Allahu i Madhëruar, i cili thotë: “Sigurisht, Ne e kemi shpallur Kurandin dhe sigurisht Ne do ta ruajmë atë.” Sure: El-Hixhr, ajeti: 9. Kurani konsiderohet si shtylla e parë e Legjislacionit Islam. (sh.p).

<sup>(20)</sup> - *Sunet*, quhet e tërë vepra, porosinë, pohimet, ndalesat dhe heshtjet e Pejgamberit Muhamed (*paqja qoftë mbi të*). Suneti është shtylla e dytë e Legjislacionit Islam. (sh.p).

<sup>(21)</sup> - *Hallall*, përkthehet në shqip, e lejuar. Në fakt në Islam në origjinë të gjitha gjërat janë hallall, përveç disave prej tyre për të cilat kanë ardhur ndalesat përkatëse, nga Kurani dhe Suneti. (sh.p).

<sup>(22)</sup> - *Haram*, është e kundërta e Hallallit. Natyrisht edhe përkthimi do të ishte, të ndaluara. Në Islam të gjitha adhurimet konsiderohen të ndaluara (d.m.th, nuk mund të shpiken vetvetiu) derisa të kemi një argument për urdhërimin dhe mënyrat e praktikimit të tyre, nga Kurani dhe Suneti. (sh.p).



﴿ وَمَا كَانَ الْمُؤْمِنُونَ لِيَنْفِرُوا كَافَّةً فَلَوْلَا نَفَرَ مِنْ كُلِّ فِرْقَةٍ مِّنْهُمْ طَائِفَةٌ لِّيَتَفَقَّهُوا فِي الدِّينِ وَلِيُنذِرُوا قَوْمَهُمْ إِذَا رَجَعُوا إِلَيْهِمْ لَعَلَّهُمْ يَحْذَرُونَ ﴾

“Nuk është mirë që besimtarët të shkojnë në luftë të gjithë njëherësh, por prej çdo bashkësie, një grup të mbetet mbrapa, që të thellohet në mësimin e fesë dhe kështu të këshillojë popullin e vet, mbasi të kthehet nga lufta, që t'i frikësohet Allahut.”

*Kuran: Et-Teube, 122.*

Dijetarët janë udhëzues të njerëzimit. Kurrë ndonjë shoqëri e mirë nuk mund të bëjë pa ata. Ata do të jenë në krye të grupit të njerëzve të ndihmuar nga Zoti, deri në Ditën e Kijametit.<sup>(23)</sup> Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) ka thënë: “{Gjithmonë do të ketë një grup prej umetit tim të përqendruar në Fenë e Allahut të Madhëruar. Ata nuk do të mposhten nga kundërshtarët e tyre, as nga ata që i braktisin. Ata do të qëndrojnë ashtu deri kur të vijë Kijameti (urdhri i Zotit). Në atë kohë ata do të jenë triumfues ndaj kundërshtarëve të tyre}.”<sup>(24)</sup>

Imam Neueui<sup>(25)</sup> [Allahu e mëshiroftë] na rrëfen: Për këtë grup njerëzish Bukhariu<sup>(26)</sup> ka thënë: Ata janë dijetarët. Imam Ahmed Ibën Hambeli<sup>(27)</sup> Nëse

<sup>(23)</sup> - Dita e Kijametit, është dita në të cilën do të mbarojë kjo botë dhe jeta në të dhe do të shkatërrohet. Ajo do të ndodhë vetëm me një të fryrë të bririt të cilit do t'i fryjë engjëlli Israfil. Paskësaj gjithçka do të shkatërrohet. Sipas dëshmimeve të shkencëtarëve i gjithë kozmosi ka qenë i ngjeshur në një masë shumë të vogël dhe ka shpërthyer nga ajo përmes atij që quhet “Big Beng-Shpërthimi i Madh”. Sipas tyre, shkatërrimi i gjithësisë do të ndodhë kur e gjithë kjo masë të mblidhet sërish në preludin fillestar ku ishte. Pikërisht mbi këtë fakt shkencor Allahu i Madhëruar thotë në Kuranin fisnik: “Ashtu si e nisëm fillimin e krijimit ashtu edhe do e rikthejmë atë” {Kurani: El Enbija, ajeti: 104}. Pas Kijametit gjithçka do të asgjësohet, përveç Allahut të Madhëruar. Pastaj kur Allahu i Madhëruar të japë leje, me fryrjen e dytë të bririt nga ana e engjëllit Israfil, do të fillojë Ringjallja e Madhe, për të vazhduar me të Dita e Gjykimit. (sh.p)

<sup>(24)</sup> - Sahih el-Bukhari, vëllimi: 8, faqja: 149. Sahih Muslim, numri i hadithit: 1920.

<sup>(25)</sup> - Imam En-Neueui, lindi në vitin 631 Hixhri (1234 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 676 Hixhri (1278 Diellor).

Ka lindur dhe vdekur në Neue, një fshat të Hauranit në Siri. Ka qenë një imam novator, hafëz (memorizues) urdhërues në të mirë dhe ndalues nga e keqja, braktisës i pasioneve, vendos të mos martohet. Përsoset në shkenca të ndryshme dhe merr kryesinë e Komunitetit të Hadithit. Biografia e tij shfaqet unike në një sërë kumtesash. Ibën El-



ky grup nuk do të jetë prej dijetarëve të Hadithit<sup>(28)</sup>, nuk e di se prej kujt tjetër do të jenë.

A'tari, një prej nxënësve të tij i ka renditur dhe nxënë përpilimet e tij. Prej tyre përmendim: "Tehdhibu el-Esmei uel Lugati", "El-Minhaxhu fi Sherhi Muslim", "Et-Tekribu ue Tejsir fi Mustalahi el-Hadith", "El-Edhkar", "Rijadu es Salihin" i cili është një libër koleksionues shumë i shquar, "El-Mexhmu'u Sherhi el-Muhedheb", "El-Arbeain en Neueuie", "Mukhtesar Esed el-Gabe fi Mearifeti es-Sahabe", etj. (sh.p)

<sup>(26)</sup> - *Imam El-Bukhari*, Lindi në vitin 194 Hixhri (810 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 256 Hixhri (870 Diellor).

Ai ishte pena e Islamit, hafëz (memorizues) i hadithit të të Dërguarit të Allahut [paqja qoftë mbi të!]. Ai është autori i "El-Xhemiu es-Sahih", i cili njihet me titullin "Sahihu el-Bukhari". Gjithashtu ai është autor i një sërë veprash sikurse "Et-Tarikh" që është një vepër voluminoze, "Ed-Dua'feu" që shtjellon autoritetin e transmetuesve të hadithit, "Khalku Efa'li el-I'bad" dhe "El-Edeb el-Mufrad". Ai është lindur në Bukhara dhe është rritur jetim. Bëri një udhëtim të gjatë (në vitin 210 hixhri) në gjurmim të hadithit, duke vizituar Khurasenin, Irakun, Egjiptin dhe Shamin. Ai ka dëgjuar prej rreth njëmijë dijetarëve si dhe ka koleksionuar rreth 600 000 hadithe, prej të cilave në "Sahihun" e tij përzgjedhi transmetuesit me autorësi të besueshme. Ai është autori i parë që bëri në Islam një përpilim të këtij konteksti. Rezidencën ai e pati në Bukhara. Një grupazh, për shkak të fanatizmit, e akuzuan atë me akuza të paqena, kështu ai doli në Khartenka (një fshat prej fshatrave të Semerkandit) ku edhe ndërroi jetë. Përpilimi i tij në hadith është përpilimi më autentik ndër gjashtë përpilimet e famshme të hadithit që janë: "Sahihu el-Bukhari" (i autorit biografik e të cilit po bëjmë), "Sahihu el-Muslim" (lindi 201 – ndërroi jetë në vitin 262 hixhri), "Sunen Ebi Daudi" ((lindi 202 – ndërroi jetë në vitin 275 hixhri), "Sunen et-Tirmidhi" (lindi 209 – ndërroi jetë në vitin 279 hixhri), "Sunen Ibën Maxhe" (lindi 209 – ndërroi jetë në vitin 273 hixhri) dhe "Sunen en-Nesaiu" (lindi 215 – dhe ndërroi jetë në vitin 303 hixhri). Për zgjerim në biografikë e imam Bukhariut mund të lexoni librin "Hajatu El-Bukhari" të dijetarit Xhemaludin El-Kasimiu. (sh.p).

<sup>(27)</sup> - *Imam Ahmed Ibën Hanbel*, lindi në vitin 164 Hixhri (780 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 241 Hixhri (855 Diellor). themeloi një shkollë juridike shumë të rëndësishme, e cila quhet Medhhebi Hambeli. Ai njihet gjithashtu edhe për rezistencën që i bëri Khalifit [prijësit] Me'mun, në lidhje me çështjen e përkufizimit të Kuranit, nëse ai është Fjala e Zotit apo krijesa e Zotit. Imam Ahmedi mbrojti mendimin që Kurani është Fjala e Zotit, që është edhe e vërteta. Vuajti për 18 muaj tortura dhe disa vite internim, por më në fund u lirua nga Khalifi [prijësi] Muteuekil.(sh.p)

<sup>(28)</sup> - *Hadith*, është ekuivalente edhe me fjalën Sunet. Bëhet fjalë për porositë e Pejgamberit (paqja qoftë mbi të), qofshin ato pohime, ndalesa, dhe heshtje të tij. Shkenca e mbledhjes së Hadithit është një ndër shkencat e rralla të diturisë njerëzore. Për t'u kujdesur për autenticitetin e përcjelljes së Hadithit, dijetarët e Islamit kanë krijuar shkencën e biografisë së transmetuesve të Hadithit. Në bazë të transmetuesve mund të vlerësohet edhe vetë autenticiteti i Hadithit. Përmbledhjet më autentike janë Sahihu i Buhariut dhe Sahihu i Muslimit, këto për faktin se standartet e vendosura nga këta dy



Kadij Ajadi <sup>(29)</sup> [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Imam Ahmedi ka patur si qëllim të gjithë dijetarët e Ehli Sunetit dhe Xhematit dhe të gjithë ata që merren me hadithin.

Neueuiu vazhdon: Ky grup njerëzish në fakt përfshin shumë lloje besimtarësh. Aty përfshihen luftëtarët muslimanë, që mbrojnë Islamin, futen dijetarët e Hadithit, asketët <sup>(30)</sup>, ata që ftojnë në të mirë dhe ndalojnë nga e keqja. Ka prej tyre që merren me lloje të ndryshme bamirësish. Nuk është e thënë se patjetër ata që futen në këtë grup të shpëtuar t'i kenë të gjitha këto cilësi të mbledhura

---

dijetarë të hadithit janë shumë të rrepta dhe shumë korrekte në përcjelljen e një Hadithi të transmetuar nga Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*). (sh.p).

<sup>(29)</sup> - Kadij Ajad, lindi në vitin 476 Hixhri (1083 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 544 Hixhri (1149 Diellor).

Dijetar i Marokut, hafëzi unik, i atribuar me titullin dijetari i Islamit, imam (lider) i hadithit në kohën e tij. Ai ishte prej njerëzve më të ditur mbi artikulimet e gjuhës arabe, gjenealogjinë dhe kronikën e tyre. Ai nuk është se filloi të mësonte që në vegjëlinë e tij, por filloi të mësonte pas të njëzetedytave të moshës së tij, në duart e dijetarëve më me zë numri i të cilëve ka qenë rreth njëqind, derisa u thëllua në dituri, koleksionoi dhe përpiloi, për t'i bërë përpilimet e tij kapitëqë synonin dhe bartnin karvanët e nxënësve të dijes dhe për të marrë përfitimet dhe dijen e tij. Ai lindi në Sebte dhe pikërisht në të atij iu besua për një kohë relativisht të gjatë kryesia e gjykatës. Pas kësaj atij iu besua kryesia e gjykatës së Granadës ku nuk qëndroi gjatë dhe u nis për në Kurtube (Kordobë). Kadij Ajadi arriti në vendin e tij një pozitë dhe emërim që askush nga banorët e vendit të tij nuk e pati arritur më parë, porse kjo nuk i shtoi atij përveçse modesti dhe frikë ndaj Allahut të Madhëruar. Ai ndërroi jetë në Marakish i helmuar, teksa thuhet se helmimin ia bëri një hebre. Prej përpilimeve të tij përmendim "Esh-Shifa bi Tearifi Hukuki el Mustafa" që është një ndër përpilimet e tij më të çmuara ku problemi i vetëm është se ai nuk i ka mënjanuar apo identifikuar hadithet e trilluara, paçka se qëllimi i tij ka qenë lavdërimi i Pejgamberit [*paqja qoftë mbi të!*], teksa hadithet autentik të pasura në këtë zhanër janë të shumta. Prej përpilimeve të tij të tjera është gjithashtu edhe "El-Gunje" ku përmend dijetarët nga të cilët ai e kishte marrë diturinë, "Tertibu el-Mederiki ue Tekribu el-Meseliki fi Mearifeti Ealemi Medhhebi el-Imam Maliki" që është disa vëllimesh, "Et-Tarikhu" një përpilim që dominoi në lëmin e vet, ku ai tuboi informatat mbi mbretërit e Andaluzisë dhe Marokut dhe përfshiu të dhënat e Sebtës dhe dijetarëve të saj. Gjithashtu prej librave të tij janë edhe "El-Ilmea ile Mearifeti Usuli er-Rauije ue Tekjidi es-Semai" që është një përpilim në terminologjinë e hadithit. (sh.p).

<sup>(30)</sup> - Asketizmi, është animi i njeriut në një jetesë shpirtërore, duke lënë pas dore anën materiale të kësaj bote. Në Islam duhet të ketë patjetër një balancim ndërmjet anës shpirtërore dhe asaj materiale. Gjithsesi në kontekst bëhet fjalë për ata njerëz dijetarë që e njohin mirë këtë balancë të Islamit. Këtu është përdorur për të vënë në pah refuzimin e tyre në kompromentimin material të fjalës. (sh.p)

tek një idivid. Ata mund të jenë secili në anë të ndryshme të botës dhe mund të kenë nga këto cilësi të përmendura më lart. <sup>(31)</sup>

Sidoqoftë dijetarët janë në krye të këtij grupi të shpëtuar dhe të mbrojtur nga Allahu i Madhëruar. Ndërsa pjesa tjetër e njerëzve janë ndjekës të tyre në mirësi.

Dijetarët edhe nëse mungojnë fizikisht, gjurmët e tyre janë përherë të pranishme. Imam Ali Ibën Ebi Talib <sup>(32)</sup> (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) thotë: Dijetarët mbesin aq sa të jetë koha. Edhe pse jo fizikisht, gjurmët e tyre janë në zemra. <sup>(33)</sup>

Dijetarët janë udhëheqësit e Bashkësisë (xhematit), për të cilët jemi urdhëruar t'i bashkohemi dhe kurrë të mos e braktisim.

Abdullah Ibën Mesudi <sup>(34)</sup> (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) ka transmetuar prej Pejgamberit (paqja qoftë mbi të), se ai ka thënë: "{Nuk lejohet vrasja e

<sup>(31)</sup> - Komenti i Sahih Muslim, vëllimi: 13, faqja: 67.

<sup>(32)</sup> - *Ali Ibën Ebi Talib*, lindi në vitin 23 para Hixhretit dhe ndërroi jetë në vitin 40 Hixhri. Ishte Khalifi [prijës] i katërt i drejtë, djëi xhaxhait të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*), fëmija i parë, që pranoi Islamin dhe jetoi me të deri në momentin kur e vranë, në një atentat në vitin 40 Hixhri. Konsiderohet gjithashtu edhe si dëshmor në rrugën e Allahut të Madhëruar. (sh.p).

<sup>(33)</sup> - Transmeton, Imam Ibën Abd el-Berr: "Xhemiu Bejani el- Ilmi ue Fadlihi", vëllimi: 1, faqja: 68.

<sup>(34)</sup> - *Abdullah Ibën Mesudi*, lindi në vitin 28 para Hixhretit (593 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 32 Hixhri (653 Diellor). Ebu Abdurahmani: pena e diturisë, fakihu i kombi islam, pjesëmarrës në Betejën e Bedrit, emigroi në të dy rastet, prej më të sojshmëve të njerëzve, prej sahabëve më të mëdhenj, në meritë, inteligjencë si dhe në afrimin që gëzonte tek i Dërguari i Allahut [*paqja qoftë mbi të!*]. Ai është prej banorëve të Mekës, prej të parëve që pranuan Islamin, para se Pejgamberi të strehohej në Shtëpinë e Erkamit, si dhe i pari që e lexoi haptazi Kuranin në Mekë. Gradët dhe meritat e tij janë të bollshme. Ai ishte asistent i të Dërguarit të Allahut [*paqja qoftë mbi të!*], besniku dhe mbajtësi i sekretit të tij, shoqëruesi i tij në qëndrim, udhëtim dhe beteja, i pandashëm nga ai. Një ditë Umari [Allahu qoftë i kënaqur me të!] e pa atë dhe tha: "Një enë e mbushur përplot dituri". Pas vdekjes së Pejgamberit [*paqja qoftë mbi të!*] ai e emërua në krye të Thesarit Publik të Kufes. Pastaj në kohën e Khalifatit (qeverisjes) së Uthmanit [Allahu qoftë i kënaqur me të!] ai erdhi në Medinë, ku edhe ndërroi jetë rreth moshës gjashtëdhjetë vjeçare. Ai ishte shumë i shkurtër sa që thujse mund të mbulohej edhe prej një njeriu të ulur. Ai pëlqente shumë të parfumohej, sa që kur dilte nga shtëpia, fqinjët për shkak të erës së parfumit të tij, e kuptonin se ai ka kaluar. Ai ka transmetuar 848 hadithe. El-Xhahidhu në "El-Bejanu ue et-Tibjenu" ka sjellë ligjërime dhe pjesë të zgjedhur të Ibën Mes'udit [Shih: "El Ea'lem" me autor Ez-Zirikliu (i cili ndërroi jetë në



muslimanit, i cili dëshmon La ilahe Il Allah, Muhamedun Resul Allah<sup>(35)</sup>. Vetëm nëse ai vepron njërën nga këto tre (krime). Imorëi martuar. Vrasësi pa të drejtë. Mohuesi i fesë së tij dhe i larguari prej bashkësisë (sidomos kur ai bëhet armik i saj).<sup>(36)</sup>

Ebu Dherri sahab [shok] i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) i cili (ndërroi jetë në vitin 32 Hixhri) (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) gjithashtu ka transmetuar nga Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) një thënie të ngjashme: "{Kush del nga Bashkësia qoftë edhe një pëllëmbë ai e ka hequr besën e Islamit nga vetja e tij}."<sup>(37)</sup>

Umer Ibën Khatabi<sup>(38)</sup> (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) ka thënë: Duhet t'i përmbaheni bashkësisë patjetër dhe të bëni shumë kujdes nga përçarja, sepse

---

vitin 1396 Hixhri) dhe "Sijaru Ealemi en Nuebelei" me autor Edh-Dhehebi (i cili ndërroi jetë në vitin 748 Hixhri) (sh.p.).

<sup>(35)</sup>- *La ilahe il Allah Muhamed Resulullah*, Kjo është fjala e dëshmisë, me të cilën njihet zyrtarisht kushdo që do ta deklarojë, si besimtar musliman. Sipas një hadithi të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) është edhe çelësi për t'u futur në Xhenet. Kjo përkthehet në shqip: Nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut të Madhëruar, i Cili është i denjë për adhurim dhe se Muhamedi është i Dërguar i Tij. Allahu Krijuesi dhe Poseduesi i gjithçkaje që ekziston është i Vetmi, që meriton të adhurohet dhe i denjë për adhurim. Madje kjo është arsyeja e vetme për të cilën Allahu i Madhëruar e ka krijuar racën njerëzore dhe racën e xhindeve. Ndërsa Muhamedi (*paqja qoftë mbi të*) ishte dhe është i Dërguari i Tij i fundit. (sh.p).

<sup>(36)</sup> - Sahih el-Bukhari, vëllimi: 9, faqja: 6, kapitulli i Dëmshpërblimeve. Sahih Muslim, vëllimi: 3, faqja: 1302, Musned Imam Ahmedi, vëllimi: 1 faqja: 382, Sunen Ebi Daudi, numri i hadithit: 4352, Sunen en-Nesaiu, vëllimi: 7, faqja: 90.

<sup>(37)</sup> - Musned Imam Ahmed, vëllimi: 4, faqja: 130 dhe faqja 202, po ashtu vëllimi: 5, faqja: 344, Sunen Ebi Daud, numri i hadithit: 4758, Sunen et-Tirmidhi, vëllimi: 3, faqja: 2863, Hakimi, vëllimi: 1, faqja: 117, Ibn Hibani, numri i hadithit: 1550.

<sup>(38)</sup> - *Umer Ibën Khatabi*, lindi në vitin 40 para Hixhretit (584 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 23 Hixhri (644 Diellor).

Khalifi [prijësi] i dytë i drejtë, i pari që u emërtua me titullin Prijësi i Besimtarëve, guximtari, i paepuri, autori i çlirimeve të mëdha, drejtësia e të cilit shërben si model. Në injorancën paraislame ai ishte prej kreshnikëve të Kurejshëve mekas dhe krerëve të tyre, saqë atij i qe besuar roli i ambasadorit. Ai ishte besnik i tyre, urrente dhe kërcënonte sipas politikës së tyre. Ai është një nga dy Umarët për të cilët Pejgamberi [*paqja qoftë mbi të!*] e luste Allahun e Madhëruar që me njërin prej tyre ta përforconte Islamit. Ai e pranoi Islamit pesë vjet para hixhretit (emigrimit në Medine) dhe ishte dëshmitar i të gjitha betejave. Ibën Mesu'di ka thënë: "Nuk mundeshim të faleshim tek Qabja, derisa u bë musliman Umeri". Ikrima ka thënë: "Islami mbeti i fshehur derisa pranoi Islamit Umeri". Umeri [Allahu qoftë i kënaqur me të!] merrej me tregtinë që bëhej në Sham, në Jemen dhe në Hixhaz (Meke dhe Medine). Atij iu dha besëlidhja për kryetar shteti në



Shejtani <sup>(39)</sup> është me atë që rri vetëm. Është më larg me atë që rri vetë i dytë. Ai që i dëshiron begatitë e Xhenetit <sup>(40)</sup>, le t'i përmbahet Bashkësisë. Ai që

po atë ditë që vdiq Ebu Bekri [Allahu qoftë i kënaqur me të!] (në vitin 13 hixhri) falë marrëveshjes të implementuar nga Ebu Bekri. Në kohën e qeverisjes së Umerit (e cila zgjati dhjetë vjet) u çlirua Shami. Iraku, Kudsi, Medeini, Egjipti dhe Gadishulli Arabik, saqë është thënë se: Në periudhën e tij janë ngrehur dymbëdhjetëmijë podiume pro Islamit. Ai është i pari që u vendosi arabëve Kalendarin hixhri, para të cilit ata referoheshin tek betejat dhe ngjarjet e mëdha të ndodhura. Ai bëri Shtëpinë e Ndihmës Financiare (Bankën Bamirëse) për muslimanët si dhe urdhëroi ndërtimin e Basras dhe Kufës, (qytete në Irak) ndërtim i cili u bë realitet. Ai është i pari që implementoi arshivat në Islam, të cilat i vendosi sipas modelit persian, me qëllim që të bënte bilancin e asistentëve dhe shpërndarjen e rrogave për ta. Ai vërtitej i vetëm nëpër tregje dhe gjykonte në kohë rekord konfliktet midis njerëzve. Ai u shkroi punonjësve të tij: "Nëse më shkruani filloni me shqetësimet tuaja personale". Zuhriu transmeton: "Kur Umerit i binte të gjykonte për një çështje komplekse, ai thërriste dy të rinj dhe konsultohej me ta, për të shfrytëzuar mprehtësinë e intelektit të tyre". Umeri [Allahu qoftë i kënaqur me të!] është autor i citateve, ligjëratave dhe kumtimeve jashtëzakonisht të arrira. Thuaje gjithmonë kur i ekspozohet ndonjë çështje, ai recitonte në lidhje me të ndonjë varg poetik. Gjëja e parë që ai bëri kur mori qeverisjen ishte kthimi në familjet e tyre, të robëreshave të zëna në luftën kundër dezertorëve, duke thënë: "Urreva që robëreshat të shndërrohen në turp për arabët". Monedhat në kohën e tij ishin të shtypura sipas shtypjes persiane dhe ai u shtoi disave prej tyre "El-Hamdu li Lah, Falënderuar qoftë Allahu", disave "La ilahe il Allah Uahdehu, Nuk ka të adhurar tjetër me të drejtë veç Allahut, Një të Vetmit" dhe disave "Muhamed Resulullah, Muhamedi është i Dërguari i Allahut". Në librat e hadithit vijnë prej tij 537 hadithe. Gdhendja e unazës së tij lexonte: "O Umer, vdekja të mjafton për këshilluesë". Në një hadith profetik vjen: "Frikësojuni zemërimit të Umerit, pasi Allahu zemërohet për shkak të zemërimit të tij." I Dërguari i Allahut [paqja qoftë mbi të!] e titulloi atë Faruk, Diferencuesi, si dhe i vendosi atij nofkën Ebu Hafs (babai i luanit). Ai bënte gjykatësin teksa Pejgamberi [paqja qoftë mbi të!] ishte ende gjallë. Ai u vra nga atentati me hanxhar, që i bëri Ebu Lulue Fejruz persiani (skllavi i Mugira ibën Shu'bes), atentat në të cilin ai u qëllua në bel, teksa po falte sabahun dhe jetoi vetëm tre netë pas këtij qëllimi. Autori i "Eshher Meshahiri Islam", Rafik el-Adham, i ka dedikuar Umerit [Allahu qoftë i kënaqur me të!] më se treqind faqe në biografinë që i bën. Ibnul Xheuzi [Allahu e mëshiroftë!] i ka kushtuar atij përpilimin e tij "Umer ibn El-Khatib". (sh,p)

<sup>(39)</sup> - Shejtani, d.m.th i mallkuar dhe i përzënë. Ky epitete i është vendosur xhindit me emrin Iblis, i cili u mallkuar nga Allahu i Madhëruar si pasojë e mosbindjes së tij kryeneçe ndaj urdhërit të Allahut të Madhëruar. (sh,p).

<sup>(40)</sup> - Xheneti, apo Parajsa, antonim i Xhehenemit apo Ferrit: Kuptimi gjuhësor është kopsht apo lulishte. Xheneti është vendi i shpërblimit për besimtarët e devotshëm ndaj Allahut të Madhëruar. Aty do të jenë pa kufi në të gjitha kënaqësitë e mundshme. Aty nuk ka vdekje, pleqëri, skamje, mjerim dhe as sëmundje. Banori i Xhenetit jeton përjetësisht në rini dhe lumturi. Sigurisht kënaqësia më e madhë që do t'u jepet





gëzohet me sukseset e saj dhe pikëllohet nga problemet e saj, ai në fakt është besimtar i sinqertë.<sup>(41)</sup>

Ajo që dijetarët kanë thënë për Bashkësinë janë këto dy mendime:

*I Pari:* Ajo është bashkësia e muslimanëve <sup>(42)</sup>, nëse ata mblidhen rreth një lideri të ligjshëm.

*I Dyti:* Bashkësia është një program i caktuar nga Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) dhe Sahabët e tij dhe të gjithë pasuesit e tyre dijetarë, dhe kushdo që i përmbahet këtij programi ai është anëtar i Bashkësisë Islame.

Sidoqoftë në krye të kësaj Bashkësie janë dijetarët. Janë ata që marrin besën e Liderit të muslimanëve. Bindja e popullit shkon në bazë të bindjes së tyre ndaj këtij lideri musliman. Dijetarët janë udhëzuesit në programin e saktë, pasi ata janë të ditur dhe të specializuar për Mesazhin hyjnor të Muhamedit (*paqja qoftë mbi të*).

Për këtë arsye Imam El-Exhiri (280-360 Hixhri), [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Shenja e dashurisë së Allahut të Madhëruar për një njeri është që ky i fundit t'i përmbahet Librit të Allahut të Madhëruar, Kuranit, Sunetit të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*), traditës së sahabëve (Allahu qoftë i kënaqur prej tyre) dhe të gjithë atyre dijetarëve (Allahu i mëshiroftë), që ndoqën dhe ndjekin rrugën e tyre.<sup>(43)</sup>

Kur e kanë pyetur Abdullah Ibën Mubarekun (118-181 Hixhri), [Allahu e meshiroftë]: Cila është bashkësia që duhet të ndjekim?- Ai tha: Ebu Bekri <sup>(44)</sup>

---

besimtarëve në Xhenet është pamja e Allahut të Madhëruar, të Cilin ata e besojnë dhe adhurojnë në këtë botë paçka se nuk e kanë parë, por kanë parë gjurmët e Tij të pamohueshme kudo në ekzistencë. (sh.p)

<sup>(41)</sup> - Musned Imam Ahmed, vëllimi: 1 faqja: 18, Tirmidhiu, numri i hadhithit: 2254. E bëri të saktë (sahih) këtë hadith Shejkh, Albani.

<sup>(42)</sup> - *Musliman*, ky term përkthehet si njeri i nënshtruar dhe në paqe. Kështu i quan Allahu i Madhëruar të gjithë besimtarët, që i nënshtrohen Vullnetit dhe ligjit të Tij. (sh.p).

<sup>(43)</sup> - Shejkh El-Islam Ibën Tejmije, në librin e tij Sheriati, faqja: 14.

<sup>(44)</sup> - *Ebu Bekri*, lindi në vitin 51 para Hixhretit (573 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin e 13 Hixhri (634 Diellor).

Ebu Bekër es-Sidiku, Khalifi (prijësi) i parë i drejtë dhe i pari prej burrave që besuan tek i Dërguari i Allahut [*paqja qoftë mbi të!*]. Ai ishte një prej njerëzve të mëdhenj ndër arabët. U lind në Mekë dhe u rrit aty si një prej krerëve të Kurejshëve, të kamurve të tyre, dijetar sa i përket gjenealogjisë së fiseve, rrëfimeve dhe politikave të arabëve. Arabët e quanin atë dijetari i Kurejshëve. Ebu Bekri [Allahu qoftë i kënaqur me të!] ia kish

[Allahu qoftë i kënaqur me të] dhe Umeri...- dhe vazhdoi të numëronte sahabet dhe tabiinët <sup>(45)</sup> derisa arriti në brezat e dijetarëve, siç ishin Muhamed Ibën Thabiti ( i cili ndërroi jetë në vitin 63 hixhri), Husejn Ibën Uakidiu (ndërroi jetë në vitin 157 Hixhri) [Allahu e mëshiroftë]. - Pyetësi i tha: - Por këta kanë vdekur të gjithë! Po nga këta që janë gjallë? Ai tha: Ndiq Ebu Hamza Es-Sekeri ( i cili ndërroi jetë në vitin 167 Hixhri).<sup>(46)</sup> Kështu Abdullah Ibën Mubareku në krye të bashkësisë konsideronte dijetarët e kohëve të tij dhe ata të kohëve më të hershme.

[Të pasosh Bashkësinë Islame do të thotë të ndjekësh mendimet që dijetarët e kësaj bashkësie janë pajtuar me to. Këtë ka si qëllim Buhariu kur thotë: Dijetarët janë Bashkësia Islame].<sup>(47)</sup>

ndaluar vetes alkoolin që në kohën paraislame dhe nuk e kishte pirë atë. Në epokën e Pejgamberit Muhamed [paqja qoftë mbi të!], Ebu Bekri [Allahu qoftë i kënaqur me të!] njihet për qëndrime të mëdha. Ai i dëshmoi betejat e bëra, duroi vështirësitë dhe kontribuoi me pasurinë e tij. Besëlidhja e tij si halif (qeveritar i muslimanëve) u bë në ditën e vdekjes së Pejgamberit [Paqja qoftë mbi të!], në vitin 11 hixhri. Ai i luftoi dezertorët dhe këdo që refuzoi të jepte zekatin. Në ditët e tij u çliruan territoret e Shamit [Siria, Jordania, Libani dhe Palestina] dhe një pjesë e madhe e Irakut. Ai gjeti konsensusin e komandantëve të mëdhenj sikurse Khalid ibën Uelidit, Amër ibën el-A'sit, Ebu Ubejde ibën el Xherahut, El-A'le ibën el-Hadramiut, Jezid ibën Ebi Sufjanit dhe El-Muthene ibën Harithes [Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë ata!]. Ebu Bekri [Allahu qoftë i kënaqur me të!] atribuohet me maturi dhe butësi kundrejt masës së gjerë të popullit. Ai ishte ligjërues elokuent dhe guximtar heroik. Koha e qeverisjes së tij zgjati dy vjet e tre muaj e gjysmë. Ai ndërroi jetë në Medine. Ebu Bekrit [Allahu qoftë i kënaqur me të!] në librat e hadithit i takon përcimi i 142 haditheve. Thuhet se pseudonim i tij ka qenë "Es-Sidiku, "I sinqerti" që në kohën paraislame, por thuhet edhe se këtë pseudonim ai e fitoi në Islam, nisur nga vërtetimi që i bëri lajmit të Israsë dhe Mia'raxhit, që i ndodhi Pejgamberit Muhamed [Paqja qoftë mbi të!]. Dosja e ngjarjeve të Ebu Bekër es-Sidikut [Allahu qoftë i kënaqur me të!] është e dendur dhe autori i veprës "Eshher Meshehiri el-Islam" i ka dedikuar ai rreth njëqindëpesëdhjetë faqe material. Gjithashtu për personalitetin unik të Ebu Bekrit [Allahu qoftë i kënaqur me të!] janë shkruar edhe shumë vepra të tjera, ndër të cilat përmendim librin "Ebu Bekër es-Sidiku" me autor dijetarin Ali et-Tantaui [Shih: "El Ea'lem" me autor Ez-Zirikliu (i cili ndërroi jetë në vitin 1396 Hixhri). (sh.p)

<sup>(45)</sup>- Tabiinët, ishin nxënësit e Sahabëve, ata që lindën pas largimit të Pejgamberit (paqja qoftë mbi të) nga kjo jetë. Konsiderohen të tillë të gjithë ata që kanë takuar së paku një herë, njërin prej sahabeve [shokë] të Pejgamberit (paqja qoftë mbi të). (sh.p).

<sup>(46)</sup> - Imam Esh-Shatibi, "El- 'Atisam", vëllimi: 1, faqja: 771.

<sup>(47)</sup> - Imam Ibën Batal, transmetim nga Ibën Haxheri në "Fet'h el-Bari": vëllimi: 13, faqja: 316.



## Kapitulli i dytë: Cilësitë e dijetarëve

Cilësia kryesore e dijetarëve është dituria e tyre. Është ajo e cila i dallon prej njerëzve të tjerë. Ata e trashëgojnë atë nga Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) dhe ia mësojnë atë njerëzimit.

Dijetarët njihen gjithashtu edhe për qëndrueshmërinë e tyre në momente të vështira, apo në momente të paqarta, kur shumë njerëz nuk arrijnë dot të japin gjykimin e drejtë. Këtu në këto momente janë dijetarët ata të cilët arrijnë të depërtojnë në thelbin e problemit dhe të japin gjykimin e drejtë, për ato gjëra që shumica e njerëzve janë në konfuzion. Dijetarët pra janë shtylla të qëndrueshme aty ku shoqëria mbështetet. Kjo vjen prej bindjes së tyre të fuqishme, si rezultat i diturisë që ata kanë përfituar.

Imam Ibën Kajim El-Xheuzije<sup>(48)</sup> [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Njeriu i thelluar në dituri, sikur t'i vijë çështje të vështira aq sa dallgët e detit, ai përsëri i bën ballë atyre dhe nuk luhetet në besimin e tij. Ato nuk ia cenojnë

---

<sup>(48)</sup> - *Ibën Kajim El-Xheuzje*, lindi në vitin 691 Hixhri (1292 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 751 Hixhri (1350 Diellor).

Ai është prej famozëve të reformës fetare islame të shekullit 8 hixhri. U lind në Damask dhe procesin e nxënies së tij e kreu në duart e Ibën Tejmijes [Allahu e mëshiroftë!], prej të cilit u ndikua vërtet shumë. Ishte pikërisht Ibën Kajimi [Allahu e mëshiroftë!] ai që i përpunoi librat e tij dhe e publikoi diturinë e tij. Ai u burgos dhe u ndëshkua disa herë, për tu liruar më pas nga burgimi në Kalanë e Damaskut ku qe burgosur, vetëm pas vdekjes të Ibën Tejmijes [Allahu e mëshiroftë!]. Prej librave më të shquar të Ibën Kajim el-Xheuzijes [Allahu e mëshiroftë!] në lëmin e politikës ishte libri i tij i famshëm "Et-Turuk el-Hukmije fi es-Sijaseti esh-Sher'ije". Gjithashtu atij i takojnë një sërë përpilimesh në tjera në Sheriat, tefsir dhe fikh, prej të cilave përmendim: "Talemu el-Mueki'in", "Zedu el-Mead", "Mederixhu es-Salikin", "El-Uebil es-Sajib min el-Kelam et-Tajib" dhe "Et-Tibjan fi Eksami el-Kurani". Muhamed Uejs e- Nedeui ka përpiluar një libër me titull "Tefsiru el-Kajim lil Imam Ibn el-Kajim", të cilin e ka përfutuar prej përpilimeve të tij. Ibën el-Kajimi [Allahu e mëshiroftë!] ka dhënë një rol të shquar në ideologjinë islame bashkëkohore. (sh.p)

bindjet atyre. Argumentet dhe qartësia e tyre arrijnë ta shpërbëjnë mjegullën dhe konfuzionin<sup>(49)</sup>.

Cilësi tjetër e dijetarëve është edhe përpjekja dhe sakrificat e tyre, që bëjnë në rrugë të Zotit, duke përhapur diturinë. Ata jetën dhe mundin e tyre ia kushtojnë Rrugës së Allahut të Madhëruar. Dijetarët njihen edhe për devotshmërinë e tyre me Allahun e Madhëruar, sepse ata janë njerëzit më të ditur me vërtetësinë e Krijuesit dhe janë më afër Tij.

وَمِنَ النَّاسِ وَالْأَنْعَامِ مُخْتَلِفٌ أَلْوَانُهُ كَذَلِكَ ۗ إِنَّمَا يَخْشَى اللَّهَ مِنْ عِبَادِهِ  
الْعُلَمَاءُ ۗ إِنَّ اللَّهَ عَزِيزٌ غَفُورٌ ﴿١٦﴾

“Në të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët, (që e dinë se) Allahu është vërtet i Plotfuqishëm dhe Falës.”

*Kuran: Fatir, 28.*

Dijetarët njihen gjithashtu edhe për vetëpërmbytjen e tyre ndaj luksit të kësaj bote.

Të tillë dijetarë me këto cilësi, njerëzit i njohin shumë mirë. Për këtë arsye nëse do të shikosh dikë me këto cilësi dhe shoqëria e respekton atë, dhe i caktojnë atij lidërshtipin e saj për shkak të këtyre cilësive, atëherë dije se ai është Dijetar.

Imam Ibën Tejmije<sup>(50)</sup> [Allahu e mëshiroftë] thotë: Nëse dikush në shoqërinë tonë njihet për besueshmëri, respektohet për shërbimet e tij ndaj saj me

<sup>(49)</sup> - Imam Ibën Kajim, "Miftah Daru es-Seadeh", vëllimi: 1, faqja: 140.

<sup>(50)</sup> - Ibën Tejmije, lindi në vitin 661 Hixhri (1263 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 728 Hixhri (1328 Diellor).

U lind në Haran, prej qyteteve të gadishullit arabik, mes Digjlës dhe Euftratit, në vitin 661 Hixhri. Atë, bashkë me familjen, e solli në Damask i jati, në kohën kur zbarkuan ushtritë mongole dhe tatarë që zaptuan shumë prej viseve arabe muslimane, në sulmin e tyre barbar të njohur historikisht. Moshë e tij në ditët e emigrimit si kalonte të gjashtë vitet. Në Damask, që asokohe ishte vatra e diturisë dhe fesë, e mori diturinë nga kompetentët e saj. Ai dha fetua (opinione fetare) ende pa mbushur të njëzetat. U preokupua në Kuran, Hadith dhe Fikh. Ishte mbrojtës solid i besimit të drejtë, i famshëm për asketizmin, fetarinë, përdëllimin, krahas guximit dhe trimërisë së tij. Ishte mbrojtës i vendit me shpatën e tij ashtu siç ishte edhe mbrojtës i bindjeve të Umetit me



diturinë që ka, dije se ky është nga udhëheqësit e shoqërisë në rrugë të drejtë. Ata janë pishtarët ndriçues të rrugës së saj. <sup>(51)</sup>

Kjo është e vërteta dhe umeti musliman është dëshmuesi më i mirë për këtë, para Zotit.

Enes Ibën Malik El-Ensarij<sup>(52)</sup> [Allahu qoftë i kënaqur prej tij] na përcjell nga Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) një ngjarje. Kur ishim duke përcjellur një

gjuhën dhe dorën e tij. Kur tatarët bënë ofensivë kundër Damaskut, në luftën e Shekhabit, ai u ngrit të mbronte Damaskun Jugor, luftë në të cilën Allahu shkroi dhe humbjen e tatarëve. Qe kjo luftë ajo që u bë shkak për shpëtimin e viseve të Shamit (Sirisë dhe Jordanisë), Palestinës, Egjiptit dhe Hixhazit (Gadishullit Arabik) nga ofensiva e dytë barbare e tatarëve. Kërkoj nga pushtetarët vazhdimësinë e xhihadit për shfarosjen e armiqve të kombit islam dhe përkrahësve e bashibozukëve të tyre. Kjo gjë ndolli urrejtjen e pushtetarëve e rivalëve të tij dhe stimuloi intrigat e dyfytirëshve dhe të prishurve, gjë që solli keqtrajtimin, burgimin, përzënieën dhe internimin e tij; porse ai nuk u dobësua dhe as u nënshtrua. Fjala e tij e famshme ishte: "E çfarë të më punojnë mua armiqtë e mi?! Unë parajsën dhe bahçen time e kam në gjoksin tim, kudo që të shkoj është me mua e nuk më ndahet. Për mua burgu është vetmi me Zotin tim, vrasja martirizim, ndërsa përzënia nga vatani është eksplorim." Gjatë burgimit të tij, që ishte vërtetë i gjatë, ai thoshte: "I burgosur i vërtetë është ai të cilit i është burgosur zemra larg Zotit të tij, e i robëruar është ai të cilin e ka robëruar epshi i tij." Veprat e tij në lëmenj të ndryshëm të diturisë i kaluan treqind dhe disa prej tyre janë disa vëllimshe. Vdekja e gjeti atë në burgun e Kalasë së Damaskut, natën e hënë, ditën e njëzetë të Dhul Kides, të vitit 728 hixhri [Allahut e mëshiroftë me një mëshirë të gjerë!] [Shih biografinë e Ibn Tejmijes, në fillimin e librit "Kitabu el-Iman" me autor Ibën Tejmije]. (sh.p).

<sup>(51)</sup> - Shejkh El-Islam Ibën Tejmije, "Mexhmuatu el-Fetaua", vëllimi: 11, faqja: 43.

<sup>(52)</sup> - Enes Ibën Malik El-Ensarij, lindi në vitin 10 para Hixhretit (612 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 93 Hixhri (712 Diellor), në Basra (qytet në Irak). Njihet dhe me nofkën Ebu Hamza. Ai është sahabi [shok] i të Dërguarit të Allahut [*paqja qoftë mbi të!*] dhe asistenti i tij. Transmetuesit e hadithit kanë transmetuar nga ai 2286 hadithe. Është i lindur në Medinë, e pranoi Islamit në vegjëli dhe i shërbeu të Dërguarit të Allahut [*paqja qoftë mbi të!*] derisa ai [*paqja qoftë mbi të!*] ndërroi jetë. Pastaj udhëtoi për në Damask dhe prej aty për në Basra, ku edhe vdiq. Ai është sahabiu [shoku] i fundit që vdiq në Basra [Shiko: "El-Ea'lem" me autor Ez-Zirikliu (i cili ndërroi jetë në vitin 1396 Hixhri)]. Ai është imami i madh, myfriu, kënduesi i Kuranit, muhadithi, transmetuesi i Islamit, i afërm i Pejgamberit (nga ana e nënës së Pejgamberit [*paqja qoftë mbi të!*]), nxënës i tij dhe pasues i tij. Ai mori pjesë në betejat e Pejgamberit [*paqja qoftë mbi të!*] më se një herë, si dhe ishte prej atyre që ia dhanë Pejgamberit [*paqja qoftë mbi të!*] besën nën pemë. Ebu Hurejra [Allahu qoftë i kënaqur me të!] ka thënë: "Nuk kam parë asnjë të falë namaz më të përngjashëm me namazin e të Dërguarit të Allahut [*paqja qoftë mbi të!*], sesa i biri i Umu Sulejmit (Enesi [Allahu qoftë i kënaqur me të!])" [Shih: "Sijaru Ealemi en-Nubala" me autor Imam Edh-Dhehebi (i cili ndërroi jetë në vitin 748 Hixhri)]. Enesi thotë për veten e tij: "Kur erdhi i Dërguari i Allahut [*paqja qoftë mbi të!*]



xhenaze të gjithë njerëzit filluan ta lavdëronin të vdekurin. Në atë kohë Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) tha: *E fitoi*. Kur na ndodhi e njëjta gjë me një xhenaze tjetër, të gjithë njerëzit filluan të flisnin keq për të. Në këtë rast Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) tha: *E fitoi!*- Omer Ibn Hatabi e pyeti Pejgamberin çfarë është ajo që fitoi? Pejgamberi iu përgjigj: "*{Ai i pari, mori shumë lavdërime prej jush. Ato ishin dëshmi që ai të fitojë Xhenetin. Ndërsa i vdekuri i dytë mori nga ju shumë mëri. Ato ishin dëshmia para Zotit me të cilën ai mori Zjarrin, sepse ju jeni dëshmitarët e Allahut të Madhëruar në tokë}*".<sup>(53)</sup>

Në një transmetim tjetër: "*{Besimtarët janë dëshmitarët e Allahut të Madhëruar në Tokë}*".<sup>(54)</sup>

Edhe dëshmia e mësuesve të tij për diturinë është një arsye më shumë, që ky njeri të konsiderohet dijetar. Ka qenë traditë e vazhdueshme që dijetarët e parë të këtij Umeti ta përcillnin diturinë tek nxënësit e tyre. Ishin nxënësit ata që do të merrnin më pas në dorë stafetën e lënë nga mësuesit e tyre. Ata do të bëheshin liderët e shoqërisë. Mirpo këta nxënës nuk e hidhnin këtë hap, derisa të merrnin nga mësuesit e tyre dëshminë e aftësisë së njohurive të tyre. Ata merrnin leje prej tyre në dhënien e fetvasë (gjkimit të çështjeve).

Imam Maliku [Allahu e mëshiroftë]<sup>(55)</sup> ka thënë: Nuk i takon dikujt të japë fetvanë e tij për një çështje, derisa të pyesë dikë, që është më i ditur se ai. Unë personalisht nuk kam dhënë fetva derisa kam pyetur Rabian<sup>(56)</sup> dhe Jahja Ibën

---

në Medine unë isha dhjetë vjeç dhe kur ai ndërroi jetë isha njëzet dhe nëna më nxiste t'i shërbeja të Dërguarit të Allahut [*paqja qoftë mbi të!*]. Umu Sulejmi, nëna e tij, ia solli atë Pejgamberit [*paqja qoftë mbi të!*] kur erdhi në Medine, duke i thënë: "Ky është Enesi, një djalosh që të të shërbejë ty", gjë të cilën Pejgamberi [*paqja qoftë mbi të!*] e pranoi. Ai i shërbeu Pejgamberit [*paqja qoftë mbi të!*] dhjetë vjet dhe Pejgamberi [*paqja qoftë mbi të!*] u lut për të [Shih: "El-Isabe fi Temjizi es-Sahabe" me autor Ibn Haxher el-A'skalani (i cili ndërroi jetë në vitin 852 Hixhri). (sh.p).

<sup>(53)</sup> - Transemton Bukhariu vëllimi: 3, faqja: 181 Muslimi vëllimi: 2, faqja: 655 Ahmedi vëllimi: 3, faqja: 179. Tirmidhiu: numri i hadithit: 1058, Nesai: vëllimi: 4, faqja: 49 - 50. Hakimi: vëllimi: 1, faqja: 377.

<sup>(54)</sup> - Transmeton Bukhariu vëllimi: 5, faqja: 185 Ibn Maxhe: numri i hadithit: 1491.

<sup>(55)</sup> - Imam Maliku, themeluesi i medhhebit (shkollës juridike) maliki. Lindi në Medine në vitin 93 hixhri dhe ndërroi jetë po aty në vitin 179 hixhri. Autori i librit të famshëm 'El-Muveta'. (sh.p).

<sup>(56)</sup> - Rabia, ishte prej Tabiinëve. Bëri një jetë të pasur me dituri, edhe pse ishte i verbër. Shquhej në Medine si ndër dijetarët më të mëdhenj të kohës së tij. Prej tij mësoi edhe imam Maliku. (sh.p).



Seidin <sup>(57)</sup>, të cilët më dhanë leje për këtë. Nëse do të ma ndalonin, unë do të ndaloja. <sup>(58)</sup>

Ai gjithashtu thotë: Në kohën tonë jo çdokush mund të ulej në mexhliet <sup>(59)</sup> e diturisë në xhami. Secili duhej të merrte një referencë nga njerëzit e ditur, që ai është i aftë për të marrë dituri. Edhe unë nuk munda të ulem në një mexhli të tillë, derisa dëshmuam për aftësinë time të të mësuarit shtatëdhjetë dijetarë. <sup>(60)</sup>

Për diturinë e një njeriu dëshmojnë fetvatë dhe gjykimet e tij, si dhe mësimet që ai i mban dhe shkrimet që ai ka punuar.

Imam Ebu Tahir Es-Selefi (478 – 576 hixhri) tregon për Imam Khatabiun <sup>(61)</sup>: Ai (Imam Hatabiu) është komentuesi i librit të Ebu Daudit <sup>(62)</sup>, dhe ishte me

---

<sup>(57)</sup> - *Jahja Ibën Seid*, dy nga Mësuesit e Imam Malikut. [Sh.p].

<sup>(58)</sup> - Imam Ibën Hamdan, "Sifetu el-Fetua ue el-Mustefti", faqja: 7.

<sup>(59)</sup> - *Mexhliet*, Në ato kohë nuk kishte klasa të rregullta me banka, por nxënësit uleshin në formë rrethi dhe mësonin nga dijetari që u ligjëronte. Kjo ulje quhej Mexhli. (sh.p).

<sup>(60)</sup> - Imam Ibën Farhun, "Ed-Dijbaxh", faqja: 21.

<sup>(61)</sup> - *Khatabiu*, indi në vitin 319 Hixhri (931 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 388 Hixhri (998 Diellor).

Khatabiu, ishte prej krerëve të dijetarëve të arabishtes, pedagogjisë, fikhut dhe hadithit. Ai ishte prej banorëve të Bustes (prej viseve të Kabulit), prej pasardhësve të Zejd ibën el-Hatabit (vëllait të Omar ibën el-Hatabit). Jetoj një farë kohe në Nejsibur, pastaj u bart në Buste, ku edhe ndërroi jetë. Atij i takojnë një sërë përpilimesh të çmuara, prej të cilëve "Mealimu es-Suneni", "Garibu el-Hadithi", "Bejenu Ia'xhezi el-Kuran", "Islahu Galati el-Muhadithine", "Tefsir Ehadithi el-Xhami' Es-Sahih lil Bukhariu" etj. Ai ishte shok i Eth-Thealebiut, i cili ka sjellë një pjesë të mirë të poezisë së tij në përpilimin e vet "El-Jetime" [Shih: "El-Ea'lem" me autor Ez-Zirikliu ( i cili ndërroi jetë në vitin 1396 Hixhri). (sh.p).

<sup>(62)</sup> - *Ebu Daudi*, lindi në vitin 202 Hixhri (817 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin e 275 Hixhri (889 Diellor).

Ebu Daudi, nga Sixhistani: hadithologu i Basrës [qytet në Irak], imami (lideri), dijetari i madh, lideri i liderëve në hadith, një prej gjashtë autorëve të famshëm të përpilimeve të hadithit. Ai ka transmetuar nga El-Kanabiu, Ahmedi, Jahja, Ibën El-Mediniu dhe shumë të tjerë veç tyre [Allahu i mëshiroftë që të gjithë!]. Kurse prej tij kanë transmetuar: Et-Tirmidhi dhe djali i tij Ebu Bekri, Ebu Auane dhe një grup transmetuesish të tjerë [Allahu i mëshiroftë që të gjithë!]. Ibrahim el-Harbiu [Allahu e mëshiroftë!] ka thënë për të: "Hadithi iu ujdin Ebu Daudit, ashtu siç iu ujdin hekuri Daudit [paqja qoftë mbi të!]". Ibën Hibani [Allahu e mëshiroftë!] ka thënë: "Ebu Daudi është një nga liderët e botës në fikh, dituri, memorizim, rit, devocion dhe perfeksionim." Ebu Daudi [Allahu e mëshiroftë!] e koleksionoi, përpiloi dhe mbrojte Sunetin. Atij i takojnë një sërë përpilimesh, prej të cilave përpilimi më i shquari është padyshim "Es-Sunen", që përbën një prej gjashtëshes së përpilimeve më të shquara ndër përpilimet e hadithit, ku Ebu Daudi [Allahu e mëshiroftë!] ka koleksionuar 4800 hadithe, të cilat i

të vërtetë i ditur dhe i besueshëm. Nëse dikush do të hulumtonte në shkrimet e tij do të vinte re, se ai ishte një dijetar i mirëfilltë dhe një lider për shoqërinë e kohës. Ai ishte një fetar i mirë dhe një transmetues i besueshëm. Imam Hatibiu ishte një njohës i mirë i Hadithit dhe shkencave të ndryshme. Atij i atribuohen një numër i madh librash në shkenca të ndryshme.<sup>(63)</sup>

Këto janë disa cilësi të dijetarit të vërtetë dhe vlerat e tij. Ndërsa pushteti dhe pozita jo gjithmonë janë argument për diturinë e njeriut, i cili qëndron mbi to. Dijetarët nuk e marrin këtë titull me anë të përzgjedhjeve apo votimeve. Ata nuk mund ta marrin këtë titull, as me anë të pozitës profesionale. Sa e sa dijetarë të shquar të Umetit tonë, as nuk e kanë ditur çfarë është pushteti dhe pozita. Në fakt as që iu ka interesuar kjo gjë.

Imam Ibën Tejmije tregon në lidhje me pushtetin dhe diturinë: Pushteti apo pozita nuk mund ta bëjë njeriun dijetar. Nëse do të ishte kështu atëherë Sulltani<sup>(64)</sup> duhej të ishte njeriu më i ditur dhe njeriu që duhej të thoshte fjalën përfundimtare në çështjet e jurisprudencës. Mirëpo kjo nuk ndodh kështu. Madje as Sulltani nuk e pretendon dot këtë gjë. E nëse mbretërit apo sulltanët nuk mund ta pretendojnë dot, atëherë ata që janë më poshtë tyre, as që duhet ta hapin gojën, duke pretenduar titullin dijetar thjesht prej postit që ka ...<sup>(65)</sup>

---

ka përzgjedhur nga mesit i 500000 haditheve. Gjithashtu Ebu Daudit [Allahu e mëshiroftë!] i takojnë përpilimet: "El- Merasil", "Ez Zuhd", "El-Beathu" etj [Marrë nga: "El-Meusuatu el-Arabie el-Alemie"]. Në "Ruetu et-Tehdhijbejni: ("Tehdhibu el-Kemali fi Esmat er-Rixhali", me autor El-Mezziun (i cili ndërroi jetë në vitin 742 hixhri) dhe "Tehdhibu et-Tehdhib", me autor Ibën Haxher el-Askalani (i cili vdiq në vitin 852 hixhri) vjen: "Ai është shtresa e njëmbëdhjetë, që i takon gjeneratës së mesit të atyre që kanë nxënë prej "tebi-tebi'inëve-gjeneratës pas gjeneratës së sahabëve". (sh.p).

<sup>(63)</sup> - Imam Edh-Dhehebi, "Sijer Alam en-Nubela", vëllimi: 17, faqja: 25.

<sup>(64)</sup> - Sulltani, bën fjalë për kreun e shtetit musliman. Sipas sistemeve të ndryshme është quajtur Halif [prijës], Sulltan ose Emir. (sh.p).

<sup>(65)</sup> - Shejh El-Islam Ibën Tejmije, "Mexhmuatu el-Fetaua", vëllimi: 27, faqja: 296-297.



## Kapitulli i Tretë: Dallimi i dijetarit me ata që e pretendojnë se janë të tillë.

Që të formojmë një panoramë të plotë për figurën e dijetarit të vërtetë na duhet të përmendim disa dallime ndërmjet tij dhe atyre që e pretendojnë se janë të tillë, ose duke u nisur nga disa njohuri të kufizuara i llogarisin ata prej dijetarëve.

### E Para: Dallimi ndërmjet Dijetarit dhe Leximtarit

Leximtaria është një fenomen shumë i përhapur në botën islame në kohën tonë. Shohim se shumë njerëz arrijnë të lexojnë bukur, sidomos ata që lexojnë Kuranin. Kjo ka bërë që shumë njerëz t'i shikojnë këta me nder dhe respekt të madh. Po kështu janë përhapur një mori e madhe librash, të cilët flasin për shkenca të ndryshme të Islamit, për Hadithin e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*), për jurisprudencën Islame etj.

Kjo çështje edhe pse shumë e dobishme mund të bëhet shkak, që edhe të devijohet rruga e drejtë. Kjo ndodh për arsyen se masa e gjerë e njerëzve fillojnë të lexojnë tekstet e argumenteve: pa marrë parasysh komentet e dijetarëve rreth tyre, pa marrë parasysh parimet dhe shinat që ata i kanë vënë në gjykimin ndaj argumentit tekstual, qoftë ai kuranor apo i hadithit, pa marrë parasysh krahasimet e argumenteve dhe metodat e përdorimit të tyre.

Ibën Abasi [Allahu qoftë i kënaqur me të]<sup>(66)</sup> ka thënë: Një herë erdhi dikush para Prijësit të Besimtarëve, Umer Ibën Khatabit. Ai i tregoi, se njerëzit po e

---

<sup>(66)</sup> - *Ibën Abasi*, lindi në vitin 3 para Hixhretit (68 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 68 Hixhri (687 Diellor).

Ai ishte (djali i xhaxhait të Pejgamberit [*paqja qoftë mbi të!*]), pena e kombit islam, dijetari i madh i fikhut, interpretuesi i Kuranit. Lindi në Mekë dhe u rrit në fillimin e

mësonin Kuranin me shumë shpejtësi dhe zell. Po i thoshte se një numër i madh njerëzish po arrinin ta mësonin Kuranin përmendësh. Unë i thashë Ibën Abasi: Jo pasha Zotin, kjo shpejtësi nuk është e mirë. Umeri m'u drejtua duke më kritikuar: Mjaft Ibn Abas! - Unë dola nga kuvendi i Umerit dhe u nisa për në shtëpi tepër i mërëzitur. Me vete thoja: Nuk paska më vlerë tek Umeri fjala ime. U shtriva në shtrat, nuk doja të më fliste askush. Mirëpo pas pak dikush më tha, se Prijësi i Besimtarëve po më kërkon. Shkova dhe pashë se ai po më priste në derën e shtëpisë së tij. Më mori brenda dhe më pyeti: Pse nuk të pëlqeu fjala e atij njeriu?- I thashë: O Prijës i Besimtarëve, nëse kam gabuar, atëherë i kërktoj falje Allahut të Madhëruar, e nëse kam gabuar ndaj teje, atëherë edhe ty të kërktoj falje. Umeri tha: Më trego, pse nuk të erdhi mirë nga fjalët e tij? Atëherë i thashë: Nëse njerëzit nxitohen kaq shumë vetëm duke e mësuar Kuranin përmendësh, do t'u rritet mendja e do të fillojnë të vetëquhen dijetarë. Pastaj do të fillojnë të ndërhyjnë në çështjet e fesë me mendimin e

---

epokës profetike. E shoqëroi hap pas hapi të Dërguarin e Allahut [paqja qoftë mbi të!] dhe i transmetoi prej tij hadithet e tij të sakta. Në dy autentikët ("Sahih el-Bukhari" dhe "Sahihu el-Muslim") dhe jashtë tyre, vijnë prej tij 1660 hadithe. Ibën Mesu'di [Allahu qoftë i kënaqur me të!] ka thënë: "Abasi (Ebu el-Abasi) është më i miri interpretues (i Kuranit)". Amër Ibën Dinari ka thënë: "Nuk kam parë kuvend në të cilin të tubohej tërë mirësia, sikurse ai i Ibën Abasit, (në kuvendin e të cilit koleksionohej) hallalli, harami, arabishtja, gjenealogjia dhe poezia". A'tau ka thënë: "Kishte prej individëve që e frekuentonin Ibën Abasin për poezinë dhe gjenealogjinë, kishte që e frekuentonin për ditarin e arabëve dhe ngjarjet e tyre dhe kishte që e frekuentonin për fikhun dhe diturinë. Secilës kategori ai i qasej me atë që deshte. Në të shumtën e rasteve ai i ndante ditët e tij, një ditë për fikhun, një për interpretimin, një për betejat, një për poezinë dhe një për ngjarjet e arabëve". Umeri [Allahu qoftë i kënaqur me të!] kur kishte për të zgjidhur ndonjë çështje të ndërlikuar, thërriste Ibën Abasin dhe i thoshte: "Ti je për këtë dhe për gjëra të sojtit të saj. Pastaj ai e merrte në konsideratë fjalën e tij dhe nuk thërriste kënd tjetër veç tij". Ai ishte argument në memorizim. Ai e mësoi me një të dëgjuar një poezi prej tetëdhjetë vargësh që e recitoi Ibën Ebi Rabi'a'. Kur dëgjonte këndimet lavdëruese që gratë bënin për të vdekurin, ai i mbyllte veshët me gishtat e tij, nga frika se mos i memorizonte fjalët e tyre. Vepra "Tefsiru el-Kuran" i është atribuar pikërisht Ibën Abasit [Allahu qoftë i kënaqur me të!]. Kjo vepër përbën atë që disa nga dijetarët kanë koleksionuar prej transmetimit që komentuesit e Kuranit kanë përcjellë në adresë të tij, për çdo thënie Kuranore që ai ka komentuar. Dosja e të dhënave që flasin për Ibën Abasin është vërtetë shumë e ngjeshur. Ai i dëshmoi në krahun e Aliut [Allahu qoftë i kënaqur me të!] dy betejat, "Sifin" dhe "El-Xhemel". Në fundin e moshës së tij ai u prek nga verbimi, jetoi në Taif dhe aty ndërroi jetë [Shih: "El-Ea'lem" me autor Ez-Zirikliu (i cili ndërroi jetë në vitin 1396 hixhri). (sh.p).





tyre. Nëse e bëjnë këtë, atëherë do të debatojnë me padituri dhe do të përçahen, e nëse përçahen do të vriten me njëri-tjetrin. Umeri tha: Pasha Zotin, ti je i mençur o Ibën Abas. Sikur të mos ma kishe sqaruar ti këtë mënyrë, kurrë nuk do të më shkonte në mendje kjo gjë.<sup>(67)</sup>

Ibën Abasi frikësohej për njerëzit, se ata do të mësonin shumë përmendësh, pa u thelluar në dituri dhe në kuptimin e ajeteve të Kuranit. Kjo gjë do të thoshte devijim i sigurtë nga rruga e drejtë. Kjo gjë ndodhi edhe me khavarixhët, të cilët ishin lexues shumë të mirë të Kuranit, por ata nuk i kushtuan rëndësi kuptimit të tij. Pejgamberi ka thënë për këta njerëz: "*{Ata (Khavarixhët) e lexojnë Kuranin, por ky lexim nuk kalon as deri në gurmazin e tyr}*".<sup>(68)</sup>

Ata jepeshin shumë pas leximit të Kuranit dhe mësimin përmendësh, duke lënë pas dore të kuptuarit e tij dhe kështu duke mos u marrë me thelbin dhe synimet e këtyre ajeteve.<sup>(69)</sup>

Imam Neueuiu thotë: Në këtë hadith të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) kuptojmë se leximi i tyre i Kuranit nuk arrin të shkojë deri në gurmazin e tyre e jo më t'u arrijë në zemër dhe në mendje. Ai mbetet thjesht në gjuhët e tyre.<sup>(70)</sup>

Ky fenomen (shpërndarja literaturës) nxori si produkt atë kategori njerëzish që quhen leximtarë, që janë të pathelluar në botën e diturisë dhe nuk mund të futen në grupin e të diturve.

Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) ka treguar se: "*{Do të vijë një kohë kur njerëzit do të lexojnë shumë, por do të kuptojnë pak. Dituria do të zhduket ndërsa kotësitë do të përhapen}*".<sup>(71)</sup>

Dijetari i njohur Hamud Et-Tuexhrij (1334-1413 Hixhri), [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Kjo profeci tashmë është plotësuar. Sot ne shohim shumë lexues të kotësive, por shumë pak ka njerëz që kuptojnë dhe janë të thelluar në dituri. Sot njerëzit janë të shkolluar, por ka shumë pak dijetarë të mirëfilltë, që e meritojnë këtë titull.<sup>(72)</sup>

(67) - "Musnedi i Imam Abdu Rezakut", numri i hadithit: 20368, Imam Edh-Dhehebi 'Sijer Alam en-Nubela', vëllimi: 3, faqja: 349.

(68) - Transmeton Bukhariu, vëllimi: 8, faqja: 53, Muslimi, numri i hadithit: 1064.

(69) - Imam Esh-Shatibi, 'El-I'atisam', vëllimi: 2, faqja: 226.

(70) - Imam Ibën Haxher El-Askalani, "Fet'h el-Bari" vëllimi: 12, faqja: 293.

(71) - Imam Hakimi në librin e tij "El-Mustedrek", vëllimi: 4, faqja: 457.

(72) - Imam Et-Tuexhrij "Itihaf el-Xhemah", vëllimi: 1, faqja: 418.



Sot është krijuar një hendek i madh ndërmjet lexuesve të librave fetarë dhe atyre që i kuptojnë ato dhe thellohen në dituri.

Lexuesi i sotëm i ka mundësitë të ketë disa broshura apo libra të vegjël, në të cilët përmenden disa çështje fetare dhe mendon se kjo është e gjithë feja islame. Mirëpo ai nuk e ka shijuar aspak diturinë, nuk ka vuajtur për të, nuk është lodhur në kërkim të saj. Lexuesi i sotëm nuk ka hedhur, as hapin më të vogël, që të ndjekë dijetarët e të mësojë prej tyre. Edhe nëse shikon, se ai flet me “kompetencë” për një çështje të caktuar, meqenëse ka lexuar një libër, ose ka dëgjuar ndonjë ligjëratë në internet nga dijetarë të caktuar, ky lexues përsëri do të stononte në argumentimin e çështjes, pasi ai as nuk ia ka haberin diturisë dhe metodave të analizës së çështjeve të ndryshme.

Që në kohën e tij Khatib El-Bagdadi (392-463 Hixhri), [Allahu e mëshiroftë] i përshkruante këta njerëz, duke thënë: Kam parë shumë njerëz në këtë kohë që pretendojnë se janë dijetarë të hadithit, se dijnë shumë prej haditheve dhe mundohen edhe të flasin me kompetenca për to. Mirëpo në fakt ata janë njerëzit më pak të ditur me këtë shkencë. Mashtrojnë veten me ato pak kohë që kanë mësuar në hadith dhe më e keqja është se krekosen edhe pretendojnë për respekt e nder pasi ia kanë ngjitur këtë epitete vetes (Dijetar i Hadithit). Këta as nuk duan t`ia dinë fare për diturinë dhe dijetarët. Hedhin poshtë fjalët e dijetarëve pa asnjë problem, fundja edhe ata janë “dijetarë”. Ata, as nuk i njohin detajet e shkencës së Hadithit, as nuk ua ndjen fare për saktësimin e argumenteve dhe as për analizën e tyre.<sup>(73)</sup>

Edhe Imam Edh-Dhehebi <sup>(74)</sup> shprehet për këtë çështje duke thënë: Disa njerëz pretendojnë se janë dijetarë. Në fakt ata thjesht kanë lexuar disa rreshta

<sup>(73)</sup> - Imam Ibën Haxher El-Askalani, “El Xhamiu fi Ehlak er-Raui ue Edab es-Semia”, vëlimi: 1, faqja: 75-77.

<sup>(74)</sup> - Imam Edh Dhehebi, lindi në vitin 673 Hixhri (1275 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 748 Hixhri (1347 Diellor).

Ai është rrëfyes, lektor, lider hafëz (memorizues), muhadith (shkencëtar i hadithit) i kohës dhe vulë e hafëzëve (memorizuesve). Ai është kronist islam dhe gjurmues i hadithit përgjatë tetëmbëdhjetë viteve. Ai ka nxënë prej shumë dijetarëve, ka udhëtuar, është preokupuar me këtë çështje, është përpjekur dhe i ka shërbyer asaj derisa u afirmua në të. Es-Sekhauiu në lidhje me të ka thënë: “Muhadithët e tanishëm, në lidhje me transmetuesit dhe profilet e tjera të arteve të hadithit, janë të nevojshëm për katër (personalitete): (Ebu el-Haxhaxh) El-Miziu, Edh Dhehebiu, El-I'rakiu dhe Ibën Haxher El-Askalani”. Atij i iku shikimi në vitin 741 Hixhri. Përpilimet e tij janë të



nga librat. Ata nuk e dinë se dituria ka moralin e saj dhe sjelljet përkatëse, sepse ata në fakt nuk i kanë shkuar pas një dijetari dhe të shohin sjelljet e tij.<sup>(75)</sup> Ata thjesht kanë lexuar në mënyrë të vazhdueshme. Kështu ata nuk e kuptojnë, se dituria ka edhe moral, ka devotshmëri edhe kulturë.<sup>(76)</sup>

Ndërsa dijetari i vërtetë është shumë lart tyre. Ai ka një botëkuptim të gjerë të Islamit. Ai i ka hulumtuar të gjitha në jurisprudencën islame. Ai nuk ka lexuar thjesht disa broshura, por është marrë me volume librash. Ka studiuar çështje të mëdha, ka studiuar bazat juridike. Ai ka arritur ta kuptojë thelbin e teksteve, ka arritur të kuptojë qëllimet e jurisprudencës dhe ku synojnë ato.

Dituria e tij nuk ka ardhur nga leximi i një nate, por nga netë të tëra pa gjumë dhe ditë të tëra të lodhshme në kërkim të diturisë. Dijetarët në fakt nuk qëndrojnë në një nivel të caktuar diturie, ata janë gjithmonë në kërkim të saj, gjithmonë në përhapjen e saj.

Kur e kanë pyetur Ibën Mubarekun deri kur do të vazhdosh të kërkosh dituri?- Akoma nuk kam arritur tek kufiri i saj,- është përgjigjur ai.<sup>(77)</sup>

Kur i kanë bërë të njëjtën pyetje Imam Ahmedit ai ka thënë: Deri kur të vdes! Deri kur të futem në varr.<sup>(78)</sup>

Tërë udhëtimet e dijetarëve për ta kërkuar diturinë tregojnë se ata e kanë dashur atë më shumë se veten e tyre. Tregon se ata nuk janë mjaftuar vetëm me disa fjalë dëgjuar aty këtu prej njerëzve.

Imam Ahmedi [Allahu e mëshiroftë] tregon për Imam Abdullah Ibën Mubarekun: Nuk ka patur në kohën e tij dikë që të lodhej aq shumë në kërkimin e diturisë më shumë se sa Ibn Mubareku. Ai udhëtoi në Jemen, pastaj

---

shumta dhe përafërsisht shkojnë në njëqind vepra, prej të cilave përmendim: "Tarikhu el Islam", "Sijaru Ealemi en-Nubela", "Tabakatu el-Hufadh", "Tabakatu el-Kura", "Mukhtesar Tehdhibi el-Kemali", "El Keshefu" "Et-Texhridu fi Esmat es-Sahabe", "El-Mizan fid Duafe", "El-Mugni fid Duafe", "Telkhisu el-Mustedrak lil Hakim", "Mukhtesar Suneni el-Bejhaki", etj. Ai është lindur në Damask. (sh.p).

(75) - Imam Edh-Dhehebi, "Sijer El-alam en-Nubela", vëllimi: 7, faqja: 153.

(76) - Këta janë njerëzit e librave, kultura e tyre është brenda atyre faqeve dhe devotshmëria e tyre është thjesht ndaj librit. Kënaqen duke mbledhur libra dhe për debat janë të parët. (sh.p).

(77) - Transmeton Imam Khatib El-Bagdadi, "Sheref As`hab el-Hadith", faqja: 68.

(78) - Po aty.

në Egjipt, pastaj në Siri, pastaj shkoi në Basra e më vonë në Kufa [qytete në Irak]. Ai ishte me të vërtetë dijetar i madh. <sup>(79)</sup>

Dijetarët gjithmonë iu kanë sugjeruar nxënësve të tyre të marrin dituri nga njerëzit që kanë sakrifikuar dhe derdhur mund në kërkimin e saj. Ky është argument, se ata ishin të thelluar në dituri dhe e donin atë më shumë se edhe veten e tyre.

Ibrahim Ibën Eshaethi [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Nëse doni të merrni për bazë fjalët e dikujt në dituri, shikoni sa mund ka derdhur ai për ta marrë atë dituri. <sup>(80)</sup>

Dituria e arritur dhe thellimi në dituri, nuk iu erdhi atyre brenda një nate apo një ëndrre të bukur vere. Ishte munda dhe sakrifica e tyre ajo që i bëri ata dijetarë ta meritojnë atë titull. Njerëzit e thjeshtë mashtrohen me leximtarët pasi këta të fundit kanë mësuar nja dy gjëra, të cilat janë temë e ditës në kuvendet e njerëzve. Sapo të hapet tema ky lloj njerëzish shkrep menjëherë ato pak argumente që ka lexuar, aq sa dikush që nuk di të bëjë dallimin e mësipërm, mendon se këta me të vërtetë janë dijetarë.

Këta leximtarë janë të aftë t'i degdisin njerëzit e thjeshtë nëpër degëzime të ndryshme të temave fetare, aq sa njerëzit nuk e bëjnë dot dallimin e tyre me dijetarët e vërtetë.

Dituria dhe urtësia janë dritë me të cilën Allahu i Madhëruar udhëzon kë të dojë, ajo nuk është me llomotitjet e shpeshta <sup>(81)</sup>. Në ambjentet e dijetarëve leximtarët kanë qenë të përbuzur, ata gjithmonë demaskoheshin prej tyre.

Ahmed Ibën Ali El-Ebari (425-507 Hixhri), [Allahu e mëshiroftë] thotë: Kam njohur një njeri, i cili i kishte shkurtuar mustaqet e tij dhe kishte lënë mjekrrën. Ai kishte blerë libra të shumtë dhe bazuar në to jepte fetva. Kur i përmendeshin atij Dijetarët e Hadithit, ai pa hezitim thoshte: Ata nuk janë asgjë, nuk vlejné. Një ditë i thashë (Ahmed Ibën Ali El-Ebari) atij: Ti nuk di të falesh! Ai më tha: Mua më drejtohesh kështu? I thashë: Po! Sepse ti nuk di asnjë argument nga Pejgamberi për mënyrat e Namazit. Ti në fakt nuk di asgjë nga hadithet e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Ty të thuhet Sabahu ka dy

<sup>(79)</sup> - Transmeton Imam Khatib El-Bagdadi "Er-Rihletu fi Talebi el-Hadith", faqja: 91.

<sup>(80)</sup> - Transmeton, Imam Ibën Hiban "Kitab el-Mexhruhin", vëllimi: 1, faqja: 24.

<sup>(81)</sup> - Përmendur nga Imam Ibën Abdul Berri, "Xhamiu Bejan el-Ilm ue Fadlihi", vëllimi: 1, faqja: 18.



rekate dhe aq i fal. Të thuhet fëkatër rekate të drekës dhe ti atë bën. Fëvaktet, se kjo është më e mira për ty sesa të flasësh me fjalë që nuk të shkojnë për shtat.<sup>(82)</sup>

Në komentin e tij Khatib El-Bagdadi [Allahu e mëshiroftë] thotë se: Ky është një shembull, që përmendet nga dijetarët, si i njeriut të pavend për çështjet diturisë. Ndërsa dijetarët e vërtetë ata që janë hulumtues dhe shkencëtarë të mirëfilltë të shkencave islame, ata janë njerëzit e vlerave dhe gradave të larta. Janë ata të cilët e kanë ruajtur për umetin musliman të gjithë jurisprudencën e ardhur nga Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*). Janë ata që sqaruan argumentet kuranore, vlerësuan abrogimet e cilësuar të këtyre argumenteve. Ata sqaruan dallimet në argumentet e drejtpërdrejta dhe ato të tërthorta (Muteshabih). Ata i përmblodhën të gjitha hadithet e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) dhe veprimet e tij. Gjithçka që ka folur apo vepruar Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) deri në detaje, gjumin e tij, qëndrimet ulur, veshjen, ushqimin madje edhe ëndrrat e tij. Qëndrimet e tij për ngjarje dhe ndodhi të ndryshme, duke shprehur kështu madhështinë e këtij njeriu (*paqja qoftë mbi të*) Janë ata të cilët e hulumtuan hadithin, analizuan transmetuesit e tij etj.

Dijetarët gjithashtu mblodhën edhe jetëshkrimin e sahabëve (Allahu qoftë i kënaqur me ta) dhe vlerat e tyre. Shkruajtën gjithçka për familjen e nderuar të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Madje dijetarët ishin ata që u morën edhe me historitë e pejgamberëve të tjerë të mëparshëm. Po ashtu edhe me qëndrimet e besimtarëve të devotshëm dhe debatet ndërmjet dijetarëve për çështje të ndryshme juridike.

Sikur të mos ishte impenjimi rigoroz i shkencëtarëve të Hadithit në radhitjen e tij, sqarimin e vërtetësisë së tij etj., sot nuk do të kishim një jurisprudencë kaq madhështore. Tashmë argumentimi me Hadithet e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) është një çështje e thjeshtë dhe të jep siguri, për faktin se na është bërë i njohur, madje është analizuar shumë mirë zinxhiri i transmetuesve të hadithit deri tek burimi i tij, Pejgamberi. Prandaj ai që e njeh vërtetësinë e Islamit dhe mbron vlerat e tij, ai sigurisht është i nderuar nga Allahu i Madhëruar dhe nuk mund të zhvlerësohet nga askush.<sup>(83)</sup>

<sup>(82)</sup> - Imam Khatib El-Bagdadi, "El- Kifaje fi Ulumi er-Riuaje", faqja: 4-5.

<sup>(83)</sup> - Imam Khatib El-Bagdadi, "El Kifaje fi Ulumi er-Riuaje", faqja: 5.

## E dyta: Dallimi ndërmjet Dijetarit dhe Mendimtarit

Si rezultat i përballjes së dy civilizimeve<sup>(84)</sup> atij Islam me atë Perëndimor dhe konfliktit ndërmjet tyre me hapjen e fronteve të reja të debatit, në shoqëritë islame ka lindur një grup i elitës intelektuale, të cilët e njohin Islamin në mënyrë të përgjithëshme. Ata e konceptojnë Njëshmërinë e Allahut të Madhëruar sipas Islamit, gjithashtu ata njohin edhe vizionin e Islamit për gjithësinë, njeriun dhe jetën në përgjithësi. Ata njohin edhe shumë çështje, të cilat konsiderohen si pika ndryshimi ndërmjet Islamit dhe religjionet apo besimet e tjera. Çështje të tilla si Materializmi<sup>(85)</sup>, Laicizmi<sup>(86)</sup>, Sistemi financiar, Sistemi shoqëror çështje të studimit të historisë, janë objekt i studimeve të tyre.

Më këtë formim ata gjithësesi mbartin mbi supet e tyre përgjegjësinë e përhapjes së Islamit. Ata kanë një sensibilizim të plotë për çështjet bashkëkohore. E njohin civilizimin perëndimor dhe problemet e tij. Ndër më të njohurit në mesin e tyre është Malik Ibën Nebij (1323 -1393 Hixhri) (Allahu e mëshiroftë).

Këta nuk janë dijetarë të Sheriatit<sup>(87)</sup> (Jurisprudencës islame). Ata janë Mendimtarë, njerëz të mençur, të cilët mund të jenë orientues me mendimet e tyre në shoqëri.

Nuk duhet t'i përziejme Mendimtarët me Dijetarët. Është e vërtetë se Mendimtarët kanë vendin e tyre të respektuar në Shoqëri për kontributet që kanë dhënë. Madje disave prej tyre Allahu i Madhëruar iu ka dhënë mundësi të ndikojnë në masa të gjera njerëzish, duke i sensibilizuar ata për Islamin dhe të

<sup>(84)</sup> - Civilizimet, janë mënyra jetese të shoqërisë njerëzore. Aty përfshihen kulturat, traditat mënyrat e jetesës dhe religjionet e shoqërisë njerëzore. (sh.p).

<sup>(85)</sup> - Materializmi, është filozofia që bazohet në mënyrën e jetesës vetëm në anën materiale. (sh.p).

<sup>(86)</sup> - Laicizmi, është një rrymë mendimi e fuqishme për të cilët mënyra e qeverisjes është duke mos i pranuar legjislacionet fetare, por edhe duke mos i mohuar fetë dhe besimet në ushtrimin e funksionit të tyre shpirtëror. (sh.p).

<sup>(87)</sup> - Sheriati, kështu quhet sistemi i ligjeve të Islamit i njohur ndryshe si Jurisprudenca Islame. (sh.p).





vërtetat e tij. E megjithatë ata nuk mund të bëjnë dot pa dijetarët dhe diturinë që buron nga ata.

Ekziston gjithashtu edhe një grup tjetër mendimtarësh, që mund të quhen shkencëtarë. Shumë prej tyre janë njerëz të devotshëm dhe të besueshëm në shoqëri. Por ata janë të specializuar në shkencë të tjera, qofshin ato natyrore, të aplikuar apo shkencë sociale. Pa ua humbur vlerat atyre në fushat përkatëse, shkencëtarët nuk mund të kenë fjalën e tyre në çështjet islame, pasi ata nuk janë në fushat që i njohin më mirë. Kështu, në lidhje me çështjet e Islamit dhe jurisprudencës së tij, ata konsiderohen si pjesa tjetër e Umetit musliman dhe nuk mund të futen në rradhët e dijetarëve muslimanë. Në çështjet e Islamit ata janë ndjekës si kushdo tjetër në umetin musliman.

Ndryshe nga pjesa tjetër e Umetit mendimtarët ose shkencëtarët kanë për detyrë të ndihmojnë dijetarët e Islamit për sqarimin e specifikave përkatëse të shkencave ku janë specializuar. Kjo ndihmë është shumë e nevojshme për të dhënë një gjykim efikas me baza të Islamit për çështje që kanë të bëjnë me këto shkencë. Mjeku sqaron veçoritë e çështjeve të mjekësisë, po ashtu edhe ekonomisti sqaron veçoritë e çështjeve ekonomike, të cilat pasi të qartësohen mund të jepet një gjykim i saktë nga jurisprudenca islame. Kështu me radhë edhe për çështje të shkencave të tjera.

Fjala e këtyre shkencëtarëve mund të merret për bazë nëse flitet për çështje të specialitetit të tyre, por ata nuk mund të llogariten nëse japin gjykime rreth çështjeve të jurisprudencës islame. Nëse kjo do të ndodhte, atëherë ato thjesht do të ishin mendime të tyre, që kurrsesi nuk mund të merren për bazë pa argumentimet e Jurisprudencës Islame. Nëse dikush do të jepte mendimin e tij për çështje fetare të paargumentuar nga Jurisprudenca Islame, atëherë ai mendim do të cilësohej si risi në fe dhe risia në fe është rreptësisht e ndaluar. Dijetarët që mund të flasin rreth çështjeve Islame janë ata që janë marrë me Jurisprudencën e Islamit dhe të shkencave të tjera të këtij lloji. Por jo vetëm kaq, ata duhet të jenë njohës dhe kuptues të mirë të argumenteve fetare.<sup>(88)</sup>

Filozofia nuk mund të futet në shkencat e Islamit, për këtë arsye njerëzit që mundohen t'i japin shpjegime filozofike çështjeve fetare janë të përbuzur në

---

<sup>(88)</sup> - Imam Ibën Abdul Berr, "Xhemi bejan el-Ilm," vëllimi: 2, faqja: 96.



mesin e dijetarëve. Kjo për faktin se Islami është fe e argumentit hyjnor dhe jo e logjikës njerëzore.

Të gjithë dijetarët e njohur, si të hershmit prej tyre, po ashtu edhe të mëvonshmit kanë pasur si angazhim të vetëm hulumtimin e Kuranit dhe të Sunetit të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) për të dhënë përgjigje për çështje të ndryshme të kohës.<sup>(89)</sup>

Imam Ahmed Ibën Hambeli [Allahu e mëshiroftë thotë] thotë për një dijetar të kohës së vet: “E kam zili filanin. Ndërroi jetë duke ditur vetëm Hadith. Ai nuk e përfillte fare filozofinë”.<sup>(90)</sup>

Imam Edh-Dhehebi [Allahu e mëshiroftë] thoshte: Kështu ishin dijetarët e hershëm (selefët). Ata nuk e shihnin me vend të merreshin me debate dhe llafologji. Të gjithë mundin e tyre ata e shpenzonin duke mësuar Kuranin, Sunetin dhe Jurisprudencën e Islamit. Ishin ndjekës korrektë dhe nuk ishin devijues.<sup>(91)</sup>

Shumë njerëz sot, edhe pse janë intelektualë në fushat e tyre mundohen t'i japin rëndësi shpjegimit filozofik të çështjeve të Fesë Islame. Nga kjo gjë njerëzit e paformuar me Islamin mashtrohen dhe mendojnë se mjafton të bësh debate filozofike për t'u quajtur dijetar.

Ibën Rexheb El-Hanbeliu (736-795 Hixhri), [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Shumë në kohët tona janë mashtruar me këta njerëz (filozofët), duke menduar se ai që debaton më shumë me filozofi për çështje fetare është edhe më i ditur për to. Por ky është një gabim trashanik. Në fakt sahabët kanë qenë njerëzit më të ditur të Islamit, por ata kanë qenë edhe njerëzit më fjalëpakë dhe për ta filozofia ishte e përbuzur. Tabi'inët gjithashtu kishin të njëjtat cilësi të Sahabëve, në lidhje me diturinë dhe rigorozitetin ndaj saj. Duke qenë njerëzit më afër argumentit Sahabet e përbuznin metodologjinë e shpjegimit filozofik të fesë. Në një kontekst të ngjashëm Ali Ibën Ebi Talibi thotë: Nëse feja (Islami) do të bazohej në shpjegime logjike, atëherë dhënia Mes`h<sup>(92)</sup> do të bëhej në shputat e këmbëve dhe jo në kurrizin e tyre.

(89)- Imam Edh-Dhehebi, “Sijer Ealam en-Nubela”, vëllimi: 10, faqja: 547.

(90)- Po aty, vëllimi: 2, faqja: 335.

(91)- Po aty, vëllimi: 12, faqja: 120.

(92)- Mes`h, është mënyrë pastrimi, e cila përdoret në vend të larjes së këmbëve. Në këtë rast bëhet fjalë për fërkimin e këmbës mbi çorape me dorë të lagur. (sh.p).



Në të vërtetë dituria është dritë që Allahu i Madhëruar e mbjell në zemrën e atij që përpiket me devotshmëri për të. Me diturinë zbulohet e vërteta. Me dituri largohet errësira dhe injoranca. <sup>(93)</sup>

### E treta: Dallimi ndërmjet dijetarëve dhe ligjëruesve (khatibëve)

Qysh në kohët e hershme të historisë islame ka pasur një kategori njerëzish që quheshin ligjërues dhe tregimtarë. Në fillim njerëzit që u flisnin masave ishin dijetarët nëpër mexhliset e tyre. Madje edhe në hytbe nuk mund të ligjëronte kushdo nëse nuk kishte njohuri të thella diturie. Mirëpo pak nga pak minberët u pushtuan edhe nga njerëz më pak të ditur, madje kishte prej tyre që as nuk ia kishin haberin diturisë.

Imam Ibën Xheuziu (519-579 Hixhri) (Allahu e mëshiroftë) ka thënë: Vaizët (ligjëruesit) në fillim kanë qenë prej dijetarëve dhe juristëve. Abdullah Ibën Amru Ibën El-A's <sup>(94)</sup> merrte pjesë në ligjëratat e Ubejd Ibën Umerit (i cili

<sup>(93)</sup>- Imam Ibën Rexheb, "Bejanu Fadli Ilmu Selef ala Ilm el-Khalef", faqja: 57 – 58.

<sup>(94)</sup>- *Abdullah Ibën Amru El-A's*, lindi në vitin 7 para Hixhretit (616 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 65 Hixhri (684 Diellor). Ishte prej Kurejshëve, prej banorëve të Mekes, sahabi, imami, pena e diturisë, adhuruesi i madh, e lexonte Kuranin në tre ditë dhe agjëronte një ditë po dhe një jo. Ai ishte aq i përkushtuar në adhurim saqë Pejgamberi [paqja qoftë mbi të!] i tha: "Në të vërtetë ti i detyrohesh trupit tënd, i detyrohesh bashkëshortes tënde dhe i detyrohesh syrit tënd". Ai ka shumë grada, merita dhe një pozitë solide në dituri, duke qenë se ai barti një dituri të madhe nga Pejgamberi [paqja qoftë mbi të!]. Ai ka transmetuar gjithashtu nga Ebu Bekri, Umeri, Muadhi, Suraka Ibën Maliku, i ati i tij Amri, nga Abdurahman ibën Aufi, Ebu Ed-Darda dhe shumë të tjerë [Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë ata!]. Ai pati marrë pjesë nëpër betejat e luftime dhe godiste me dy shpata njëkohësisht. Në ditën e Betejës së Jermukut, ai e barti flamurin e të atit. Gjithashtu ai qe prezent edhe në ndodhinë e Sifinit, në kampin e Muauijes [Allahu qoftë i kënaqur me të!], i cili e emëroi atë guvernator në Kufa për një periudhë të shkurtër kohore. Kur qeverisja i kaloi Jezidit, Abullahu nuk ia dha atij besëlidhjen dhe u mbyll në një qoshe në anën e Askalanit, duke iu përkushtuar adhurimit. Ai ka transmetuar edhe nga Ehlu Kitabi, i ka pasur vazhdimisht nën mbikëqyrje librat e tyre dhe është preokupuar me to. Ai në kohën paraislame ishte prej atyre që shkruanin dhe e njihje shumë mirë Sirjanishten. Ai i kërkoi leje të Dërguarit të Allahut [paqja qoftë mbi të!] që të shkruante atë që dëgjonte prej tij dhe Pejgamberi [paqja qoftë mbi të!] ia dha lejen për këtë. Ai përcolli nga i Dërguari i Allahut [paqja qoftë mbi të!] 700 hadithe. Për fizionominë e tij është thënë se ai ishte i gjatë dhe i shëndoshë.

ndërroi jetë në vitin 74 Hixhri). Umer Ibën AbdulAzizi <sup>(95)</sup> gjithashtu merrte pjesë në ligjëratat e dijetarëve në xhami. Aty mblidhej i tërë populli pasi niveli i diturisë së tyre ishte shumë i lartë. Umeri i ngrinte duart për dua si gjithë të tjerët sa herë që dijetari ligjërues i ngrinte. Mirëpo më vonë këta ligjërues ranë për nga niveli i tyre, dhe për këtë arsye elita e shoqërisë filloi të mos merrte më pjesë dhe ata frekuentohshin vetëm nga fëmijët dhe gratë. <sup>(96)</sup>

Nuk është e thënë të jesh ligjërues dhe domosdoshmërisht duhet të jesh edhe dijetar. Ka shumë oratorë, që arrijnë t'i bëjnë për vete masat e gjera, megjithatë kjo nuk i bën ata dijetarë. Pasi dituria në fakt nuk shihet te fjalët e oratorëve apo nga emocionaliteti, që ata i përcjellin ligjërimin të tyre.

Ibën Mesudi <sup>(97)</sup> (Allahu qoftë i kënaqur me të) ka thënë: Jetojmë në një kohë, kur dijetarët i kemi të shumtë dhe janë të paktë oratorët. Por pas nesh do të

Në fundin e jetës së tij ai u prek nga verbimi. Thuhet se ai ndërroi jetë në Taif (qytet në Arabinë Saudite). [Shih: "El-Ea'lem" me autor Ez-Zirikliu (i cili ndërroi jetë në vitin 1396 Hixhri) dhe "Sijaru Ealemi en-Nubela" me autor Edh-Dhehebi (i cili ndërroi jetë në vitin 748 hixhri)]. (sh.p).

<sup>(95)</sup> - Umer Ibën Abdulazizi, Khalifi [prijësi] i tetë i dinastisë Emeuite nga viti 717 deri në vitin 720 Gregorian, dhe konsiderohet si i pesti i Khalifëve [prijësve] të Drejtë. (sh.p).

<sup>(96)</sup> - Imam Ibën Kajim, "Telbis Iblis", faqja: 127.

<sup>(97)</sup> - Ibën Mesu'di, lindi në vitin 28 para Hixhretit (593 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 32 Hixhri (653 Diellor).

Ai ishte pena e diturisë, fakihu i kombit islam, pjesëmarrës në Betejën e Bedrit, emigroi në të dy rastet, prej më të sojshmëve të njerëzve, prej sahabëve më të mëdhenj, në meritë, inteligjencë si dhe në afrimin që gëzonte tek i Dërguari i Allahut [paqja qoftë mbi të!]. Ai është prej banorëve të Mekës, prej të parëve që pranuan Islamin, para se Pejgamberi të strehohej në Shtëpinë e Erkamit, si dhe i pari që e lexoi haptazi Kuranin në Mekë. Gradët dhe meritat e tij janë të bollshme. Ai ishte asistent i të Dërguarit të Allahut [paqja qoftë mbi të!], besniku dhe mbajtësi i sekretit të tij, shoqëruesi i tij në qëndrim, udhëtim dhe beteja, i pandashëm nga ai. Një ditë Umeri [Allahu qoftë i kënaqur me të!] e pa atë dhe tha: "Një enë e mbushur përplot dituri". Pas vdekjes së Pejgamberit [paqja qoftë mbi të!] ai e emërua në krye të Thesarit Publik të Kufas. Pastaj në kohën e Khalifatit (qeverisjes) së Uthmanit [Allahu qoftë i kënaqur me të!] ai erdhi në Medinë, ku edhe vdiq rreth moshës gjashtëdhjetë vjeçare. Ai ishte shumë i shkurtër sa që thua jse mund të mbulohej edhe prej një njeriu të ulur. Ai pëlqente shumë të parfumohej, sa që kur dilte nga shtëpia, fqinjët për shkak të erës së parfumit të tij, e kuptonin se ai ka kaluar. Ai ka transmetuar 848 hadithe. El-Xhahidhu në "El-Bejanu ue et-Tibjanu" ka sjellë ligjërimi dhe pjesë të zgjedhur të Ibën Mes'udit [Shih: "El-Ea'lem" me autor Ez-Zirikliu (i cili ndërroi jetë në vitin 1396 hixhri) dhe "Sijaru Ealem en-Nubala" me autor Edh Dhehebi, (i cili ndërroi jetë në vitin 748 hixhri)]. (sh.p).



vijë një kohë, kur dijetarët do të jenë shumë të pakët dhe bota do të jetë e mbushur me oratorë të pavlerë.<sup>(98)</sup>

Dijetari mund të mos jetë shumë orator, ndoshta nuk di të shprehet me artin e fjalës, madje ka prej tyre që nuk munden ta mbajnë as edhe një hytbe (ligjëratë). Nga ana tjetër mund të ketë prej njerëzve të rëndomtë të tillë që ta shkulin zemrën prej vendit, ngaqë janë artistë të fjalës.

Dijetarët janë të pakët, por oratorët janë të shumtë. Muxhahidi (i cili ndërroi jetë në vitin 540 Hixhri) [Allahu e mëshiroftë] thotë: Tashmë nuk ka më dijetarë, kanë mbetur vetëm oratorët. Ata që sot konsiderohen dijetarë, të tillë njerëz konsideroheshin të rëndomtë në kohët e mëparshme.<sup>(99)</sup>

Gjithsesi kjo nuk do të thotë se ligjëruesit (Khatibët) dhe vaizët nuk janë dijetarë. Ka prej tyre që janë dijetarë të mirëfilltë. Madje ka prej tyre që janë dijetarë shumë të njohur të botës islame. Mund të përmendim prej ligjëruesve, dijetarin e njohur Imam Ibën Xheuzin, [Allahu e mëshiroftë], i cili krahas ligjërimeve të ditës së Xhuma, ka qenë edhe autor i shumë librave me vlerë në shkenca të ndryshme islame.

---

<sup>(98)</sup> - Imam Bukhari, "Edeb el-Mufred", faqja: 346 numri i hadithit: 789. Imam Et-Tabarani, numri i hadithit: 18566. Imam Ebu Hejtheme "Kitab el-Ilm" faqja: 109.

<sup>(99)</sup> - I përcjellë nga Imam Ebu Hejthemeh "Kitab el-Ilm", faqja: 69.

## Kapitulli i Katërt: Pozita e dijetarëve dhe vlerat e tyre

Islami i ka dhënë një pozitë dhe vlerësim të veçantë dijetarëve, ndryshe nga pjesa tjetër e njerëzve. Ata konsiderohen sipas Islamit, si orientues të shoqërisë drejt rrugës së drejtë. Kjo konsideratë e lartë për dijetarët ngre përpara nesh edhe dy çështje të rëndësishme:

**E Para:** Bindja ndaj tyre është bindje ndaj Allahut të Madhëruar dhe Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Kështu ndjekja e tyre është detyrim (Vaxhib).

**E Dyta:** Bindja ndaj tyre nuk do të thotë bindje thjesht ndaj personit të tyre, por ajo më shumë është bindje ndaj Allahut të Madhëruar dhe Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*).

Argumentet për këtë vlerësim të dijetarëve janë të shumta nga Kurani dhe Hadithet e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*).

*Argumenti i Parë:* Allahu i Madhëruar thotë:

يٰۤاَيُّهَا الَّذِيْنَ ءَامَنُوْا اطِيعُوْا اللّٰهَ وَاَطِيعُوْا الرَّسُوْلَ وَاُوْلٰى الْاَمْرِ مِنْكُمْ ۗ فَاِنْ تَنَزَعْتُمْ فِيْ شَيْءٍ فَرُدُّوْهُ اِلَى اللّٰهِ وَالرَّسُوْلِ ۗ اِنْ كُنْتُمْ تُؤْمِنُوْنَ بِاللّٰهِ وَالْيَوْمِ الْاٰخِرِ ۗ ذٰلِكَ خَيْرٌ وَّاَحْسَنُ تَاْوِيْلًا ﴿٥٩﴾

“O besimtarë! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja.”

*Kuran: En-Nisa, 59.*

Ibën Abasi [Allahu qoftë i kënaqur prej tij] në komentimin e këtij Ajeti thotë: Me fjalën ‘Të parët tuaj’ është si qëllim për dijetarët dhe juristët e Islamit. Ata të cilët i binden Allahut të Madhëruar dhe iu mësojnë njerëzve kuptimet e fesë së



tyre. Ata që i urdhërojnë në mirë dhe i ndalojnë nga e keqja. Këta janë ata që Allahu e ka bërë detyrim t' i ndjekim dhe t' iu bindemi.<sup>(100)</sup>

Xhesasi (ndërroi jetë në vitin 315 Hixhri), [Allahu e mëshiroftë] e komenton këtë ajet duke thënë: Personat që quhen 'Të parët tuaj' mund të jenë sundimtarët, prijësit dhe dijetarët. Prijësit janë ata që merren me punët e shtetit, administrojnë ushtrinë dhe janë në mbrojtje të civilëve. Nga ana tjetër dijetarët kanë rolin e tyre të lidërshiptit pasi janë ata që e edukojnë shoqërinë me Islamin. Janë ata që mbrojnë jurisprudencën islame...<sup>(101)</sup>

Ibën Tejmije për të njëjtin ajet do të shprehej: Të parët tuaj, bëhet fjalë për për dy kategori të elitës së shoqërisë. Shtetarët dhe Dijetarët. Nëse ata janë të drejtë, edhe në shoqëri do të ketë drejtësi. E nëse ata do të korruptohen e gjithë shoqëria do të shkatërrohet<sup>(102)</sup>. Në një tjetër citim të tij ai thotë: Pa dyshim, Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) bashkë me Khalifët<sup>(103)</sup> e drejtë ndiqnin një politikë të drejtë me shoqërinë. Mirëpo më pas ndryshuan brezat dhe prijësat luftarakë ishin ata që merreshin me politikën, ndërsa me fenë filluan të specializoheshin njerëz, të cilët pasi u thelluan në fe morën përsipër t' iu mësonin njerëzve fenë dhe bazat e jurisprudencës. Këta mund të konsiderohen si 'Të parët tuaj', të cilëve duhet me të vërtetë t' iu bindeni, pasi ata janë që i binden Allahut të Madhëruar më shumë.<sup>(104)</sup>

Bindja ndaj prijësve vjen vetëm pas sugjerimeve të dijetarëve. Ndërsa bindja ndaj dijetarëve konsiderohet si bindje ndaj Allahut të Madhëruar dhe Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) të Tij.

Ibën Kajim El-Xheuzije [Allahu e mëshiroftë] për bindjen ndaj prijësve thotë: Bindja ndaj prijësve varet nga korrektësia e tyre në referimin tek dituria për direktivat që ata japin. Kështu bindja ndaj tyre vjen me kusht që ata të

---

<sup>(100)</sup> - 'Tefsiri i Taberiut', vëllimi: 5, faqja: 149. Imam Es-Sujuti "Ed-Durar el-Menthur, vëllimi: 2, faqja: 176. Imam Hakim "El-Mustedrek", vëllimi: 1, faqja: 123. Imam El-Lalakaj "Sherhu Usuli l'atikadi Ehli es-Suneti ue el-Xhemah", vëllimi: 1, faqja: 73.

<sup>(101)</sup> - Imam Ibën Arabij Selefî, "Ehkam el-Kuran", vëllimi: 3, faqja: 170.

<sup>(102)</sup> - Shejkh El-Islam Ibën Tejmije, "Mexhmua el-Fetaua", vëllimi: 28, faqja: 170.

<sup>(103)</sup> - *Khalif*, quhet mëkëmbësi i Allahut të Madhëruar në tokë. Kështu është quajtur njeriu, për shkak të misionit të tij në kujdestarinë e tokës. Khalif quhet edhe kryetari i shtetit Islam. Prej tyre katër të parët quhen Khalifët e drejtë, për shkak të drejtësisë dhe korrektësisë që patën në ndjekjen e porosive të Kuranit dhe Sunetit të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). (sh.p).

<sup>(104)</sup> - Shejkh El-Islam Ibn Tejmije, "Mexhmua el-Fetaua", vëllimi: 11, faqja: 551.



ndjekin dijetarët, pasi bindja duhet të jetë në mirësi dhe në ato që sugjeron dituria. Kështu rrjedhimisht sikurse t'i bindesh dijetarëve kushtëzohet me bindshmërinë e tyre ndaj Pejgamberit (paqja qoftë mbi të), po ashtu bindja ndaj prijësve kushtëzohet me bindjen e këtyre të fundit ndaj dijetarëve. Për aq kohë sa këto dy pjesë të Elitës në shoqëri të jenë bashkëpunuese me njëra-tjetrën, edhe njerëzit do t'u binden atyre, po aq edhe shoqëria do të jetë në rrugë të drejtë.<sup>(105)</sup>

*Argumenti i dytë:* Allahu i Madhëruar na ka urdhëruar, që ne t'u referohemi dijetarëve në të gjitha çështjet tona.

وَمَا أَرْسَلْنَا قَبْلَكَ إِلَّا رِجَالًا نُوْحِي إِلَيْهِمْ فَسْأَلُوا أَهْلَ الذِّكْرِ إِنْ كُنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ

"... Pyetni njerëzit e shkrimeve (të mëparshme), nëse ju nuk dini!"

*Kuran: El-Enbija, 7.*

Njeriu duhet të drejtohet tek dijetarët për çështje të cilat i ka të paqarta. Kjo vlen për çdo lloj çështjeje, por më shumë vlen për çështjet fetare. Duhet të bëjmë kujdes ndaj njerëzve që pyesim të jenë të njohur për diturinë e tyre. Pasi nuk lejohet që t'u jepet zgjidhje çështjeve problematike thjesht me mendimin e njerëzve të papërshtatshëm dhe jo të ditur.<sup>(106)</sup>

Shejh Abdurrahman Es-Seadij [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Në këtë ajet ngrihet vlera e dijetarëve dhe sidomos e atyre që flasin në Emrin e Allahut të Madhëruar. Sidomos për çështje që kanë të bëjnë më njohjen e Allahut të Madhëruar është shumë e rëndësishme pyetja e dijetarëve. Aty e kuptojmë se Allahu i Madhëruar i ka vlerësuar duke urdhëruar që ata të jenë personat e referencës sidomos në çështjet e fesë dhe të besimit.<sup>(107)</sup>

Mirëpo kjo nuk do të thotë, se obligohet ndjekja e dijetarëve në lejjimin e të ndaluarave dhe ndalimin e të lejuarave. Kështu atëherë do të të futeshin njerëzit në grupin e atyre për të cilët Allahu i Madhëruar thotë në Kuran:

<sup>(105)</sup> - Imam Ibën Kajim, "T'alam El-Muekine", vëllimi: 1, faqja: 10.

<sup>(106)</sup> - Imam Esh-Shatibi, "El-Muefekat", vëllimi: 4, faqja: 262.

<sup>(107)</sup> - Imam Abdurrahman Es-Sadi, "Tefsir El Kerim Al Rrahman", vëllimi: 4, faqja: 206.



اتَّخَذُوا أَحْبَارَهُمْ وَرُهَبَانَهُمْ أَرْبَابًا مِنْ دُونِ اللَّهِ وَالْمَسِيحِ ابْنِ مَرْيَمَ وَمَا أُمِرُوا إِلَّا لِيَعْبُدُوا إِلَهًا وَاحِدًا ۗ لَّا إِلَهَ إِلَّا هُوَ ۚ سُبْحٰنَهُ عَمَّا يُشْرِكُونَ ﴿٣١﴾

“Në vend të Allahut, ata kanë zgjedhur për zot rabinët dhe murgjit e tyre.”

*Kuran: Et-Teube, 31.*

Pasi pyetja e dijetarëve është për të gjetur gjykimin e Allahut të Madhëruar në këtë çështje dhe nuk është për qëllim bindja e tyre e verbër. Për këtë arsye dijetarët unanimisht bien dakord, se në çështjet e fesë duhet patjetër të rikthehemi për gjykim tek dijetarët... Ashtu sikurse unanimisht bien dakord, se nuk lejohet të japë gjykim për çështje të tilla dikush, i cili nuk është i specializuar në të, pasi përgjegjësia e dhënies së gjykimit është shumë e rëndë.<sup>(108)</sup>

Imam Esh-Shatibi (538-590 Hixhri) (Allahu e mëshiroftë) ka thënë: Fetvaja (gjykimi) i dijetarëve në lidhje me njerëzit e zakonshëm është tamam si argumenti burimor në lidhje me dijetarët. Për njerëzit e zakonshëm argumentimi është diçka e panjohur për ta. Kështu është më e mirë, që ata të mos merren me çështjen e gjetjes së argumenteve dhe të mjaftohen si argument me gjykimin që japin dijetarët.<sup>(109)</sup>

Dijetarët janë udhëzuesit për në rrugën e Allahut të Madhëruar. Nëpërmjet kuptueshmërisë së tyre arrijmë në thelbin dhe qëllimet e argumentave të Allahut të Madhëruar. Imam Ibën Kajim [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Nga këtu kuptojmë dallimin ndërmjet ndjekjes së verbër të dijetarit dhe ndihmesës së tij në të kuptuarit më mirë të urdhëresave me anë të dritës së diturisë, që Allahu i Madhëruar ia ka dhënë. Ndjekësi i verbër mjaftohet thjesht me thënien e dijetarit madje ai është mospërfillës i mendimit ndryshe që bie në kundërshtim me dijetarin e tij. E vërteta është që dijetarët luajnë rolin e ndihmuesit në arritjen e kuptimit të çështjeve bazuar në argumenta. Ai (dijetari) me anë të horizontit të tij të gjerë në dituri na hap rrugën për ta parë

<sup>(108)</sup> - Imam Ibën Abd El-Berr, "Xhemiu el-Bejan ue Fadlihi", vëllimi: 2, faqja: 114.

<sup>(109)</sup> - Imam Esh-Shatibi, "El-Muefekat", vëllimi: 4, faqja: 293.

çështjen edhe nga këndvështrime të tjera. Është ai i cili na afron edhe më shumë me Pejgamberin (paqja qoftë mbi të).<sup>(110)</sup>

Dituria siç kemi thënë më lart është trashëgimi e Pejgamberit (paqja qoftë mbi të) për brezat pasardhës. Ndërsa dijetarët e Islamit [Allahu i mëshiroftë] janë ata që e kanë trashëguar atë. Kështu janë ata që arrijnë të na afrojnë më shumë me jetën e Pejgamberit (paqja qoftë mbi të). Të parët ua transmetojnë atë nxënësve të tyre e kështu brez pas brezi dituria peygamberike vjen deri në ditët tona.

*Argumenti i tretë:* Allahu i Madhëruar i ka ngritur ata në një nivel shumë të lartë nderi, duke i bërë dëshmitarë të çështjes më të rëndësishme në këtë gjithësi, Ekzistencës së Allahut të Madhëruar. Allahu i Madhëruar thotë në Kuran:

شَهِدَ اللَّهُ أَنَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ وَالْمَلَائِكَةُ وَأُولُوا الْعِلْمِ قَائِمًا بِالْقِسْطِ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْعَزِيزُ

الْحَكِيمُ

“Allahu dëshmon, e po ashtu engjëjt dhe njerëzit e dijes, se nuk ka zot tjetër (që meriton të adhurohet), përveç Tij, duke mbajtur drejtësinë. S’ka zot tjetër (që meriton të adhurohet), përveç Tij, të Plotfuqishmit, të Urtit.”

*Kuran: Ali Imran, 18.*

Në këtë ajet Allahu i Madhëruar i ngre dijetarët në pozitën e dëshmuesit për një çështje kaq të rëndësishme, Njehsimin e Tij. Për këtë arsye mund të themi se dijetarët në përgjithësi janë të drejtë, pasi dëshmitarët që Allahu i Madhëruar zgjedh për të dëshmuar për Të janë të drejtë. Të gjithë njerëzit e tjerë janë ndjekës të tyre në këtë dëshmi. Kjo edhe një herë vërteton, se ata në Islam kanë një vend nderi që nuk e kanë të tjerët.

Imam Ibën Kajim El-Xheuzije [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Në këtë dëshmi të Allahut të Madhëruar për dijetarët përfshihet edhe pastrimi i personalitetit të tyre dhe vlerësimi për ta.<sup>(111)</sup>

<sup>(110)</sup> - Imam Ibën Kajim, "Kitab er-Rruh", faqja: 356.

<sup>(111)</sup> - Imam Ibën Kajim, "Et-Tefsir el-Kajim", faqja: 199



Imam El-Kurtubi <sup>(112)</sup> [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Sikur të ishte dikush tjetër në një pozitë të ngjashme nderi si dijetarët, edhe ai do të përmendej në këtë ajet. Mirëpo në fakt nuk ekziston një kategori tjetër njerëzore kaq e nderuar, sa të marrë pjesë në këtë dëshmi të madhe. <sup>(113)</sup>

Shejh Abdurrahman Ibën Seadi (1307- 1376 Hixhri) [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Duke qenë kjo pozitë kaq e nderuar për dijetarët, që të gjithë njerëzit e tjerë duhet t' i ndjekin ata në këtë dëshmi. Këtu vërejmë urdhëresë nga Allahu i Madhëruar në ndjekjen e tyre dhe se ata duhet të jenë liderat e shoqërisë. Kjo është një pozitë, e cila në të vërtetë nuk mund të vlerësohet me asnjë lloj çmimi. <sup>(114)</sup>

*Argumenti i katërt:* Allahu i Madhëruar nuk i barazon dijetarët me pjesën tjetër të njerëzve. Allahu i Madhëruar thotë në Kuran:

قُلْ هَلْ يَسْتَوِي الَّذِينَ يَعْمَلُونَ وَالَّذِينَ لَا يَعْلَمُونَ ۗ إِنَّمَا يَتَذَكَّرُ أُولُو الْأَلْبَابِ ﴿٩﴾

“Thuaj: “A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?!...”

Kuran: Ez-Zumer, 9.

<sup>(112)</sup> - Imam El-Kurtubi, lindi në vitin 600 Hixhri (1204 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 671 Hixhri (1273 Diellor). Ai është nga Andaluzia, Ebu Abdullahu, prej Ensarëve të fisit Khazreth: dijetar i madh i tefsirit, fikhut dhe gjuhës arabe. Ai ishte një njeri i denjë, adhuruës i flaktë, i devotshëm, e kishte lënë mënjane ekzagjerimin, vishte një rrobë të vetme dhe mbi kokë mbante një takije. Ai u lind në qytetin e Kurtubes (Kordobës), pas rënies së saj udhëtoi për në Aleksandri dhe më pas për në Said të Egjiptit ku edhe banoi. Imam El-Kurtubi [Allahu e mëshiroftë!] ishte një dijetar i madh që i ishte përkushtuar diturisë dhe e kishte lënë mënjane dynjanë. Ai la pas vetes një thesar diturie që vlerësohet me trembëdhjetë libra, prej të cilave padyshim që më i shquari është tefsirit i tij i madh dhe tubues i dispozitave të Kuranit fisnik, i cili është një tefsir (komentim) i kompletuar dhe i pasur, që krahas shkencave të tjera bart në të edhe studimin e çështjeve fetare. Ky tefsir titullohet “El-Xhemiu’ li Ehkami el-Kurani”, i njohur ndryshe me “Tefsiru el-Kurtubi” dhe është i përbërë nga njëzet vëllime. Krahas tij, prej veprave më të njohura të El Kurtubiut [Allahu e mëshiroftë!] mund të përmendim “Et-Tedhkira bi Ehuali el-Meuta”, “Ehualu el-Akhira”, “Et Tedhekir fi Efdali el-Edhkar” dhe “Et-Takrib li Kitabi et-Temhid” që ka dy vëllime të mëdha. Imam El-Kurtubi u ndërroi jetë në një moshë rreth shtatëdhjetë vjeçare dhe u varros në Said të Egjiptit [Shih: “El-Ea’lem” me autor Ez Zirikliu (i cili ndërroi jetë në vitin 1396 Hixhri). (sh.p).

<sup>(113)</sup> - Imam El-Kurtubi, “El-Xhemiu Li el-Ehkam el-Kuran”, vëllimi: 4, faqja: 41.

<sup>(114)</sup> - Imam Abdurrahman Es-Sadi, “Tefsir el-Kerim er-Rrahman”, vëllimi: 1, faqja: 365.

Allahu i Madhëruar në këtë ajet bën dallimin ndërmjet atyre që janë dijetarë dhe atyre që nuk janë të tillë. Edhe këtu vihet re pozita e tyre mbi njerëzit e tjerë me diturinë që ua ka dhuruar Allahu i Madhëruar. Ata janë ngritur në pozitë më të larta mbi të gjithë besimtarët e tjerë, por edhe besimtarët sigurisht janë më të lartësuar në pozitë se sa jobesimtarët.

Allahu i Madhëruar thotë në Kuran:

يَتَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا إِذَا قِيلَ لَكُمْ تَفَسَّحُوا فِي الْمَجَالِسِ فَافْسَحُوا يَفْسَحِ اللَّهُ لَكُمْ وَإِذَا قِيلَ أُنشُرُوا فَاذْشُرُوا يَرْفَعِ اللَّهُ الَّذِينَ ءَامَنُوا مِنْكُمْ وَالَّذِينَ أُوتُوا الْعِلْمَ دَرَجَاتٍ وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرٌ ﴿١١﴾

“Allahu do t’i ngrejë në shkallë të lartë ata midis jush që besojnë dhe që iu është dhënë dija.”

*Kuran: El-Muxhadele, 11.*

Imam Et-Taberi<sup>(115)</sup> [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Allahu i Madhëruar ngre në pozita të larta dijetarët mbi besimtarët e tjerë të Tij, por edhe besimtarët kanë pozitë më të lartë se pjesa tjetër e njerëzve, të cilët nuk janë besimtarë.<sup>(116)</sup>

<sup>(115)</sup> - *Imam Et-Tabari*,: lindi në vitin 224 Hixhri (839 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 310 Hixhri (923 Diellor).

Ai ishte lideri i komentuesve të Kuranit fisnik. Është lindur në Tabaristan, ku ka filluar nxënien e diturisë në moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare. Pastaj udhëtoi për në Bagdad ku u vendos pasi vizitoi një sërë visesh. Dijetarët i kanë bërë lëvdata të shumta Et-Tabariut, duke thënë: Ai është i besueshëm, dijetar i madh, një nga liderët e mëdhenj të Ehlu (Ndjekësve të) Sunetit. Fjala e tij merret në konsideratë dhe ai është referencë falë diturisë së tij të gjerë dhe metodologjisë së tij të saktë. Ai ka lënë pas një sërë përpilimesh me vlerë ku më e shquara është vepra e tij e madhe e tefsirit “Xhemi’u el-Bejeni an Teuili Eji el-Kurani”, i cili në masën e gjerë njihet me titullin “Tefsiri i Et-Tabariut”, që është komentimi i parë i plotë i Kuranit që ka arritur tek ne. Prej tij kanë përfituar të gjithë studiuesit e mëpasshëm, prandaj dhe dijetarët e kanë konsideruar Et-Tabariun baba të tefsirit. Gjithashtu ata e kanë konsideruar atë babanë e historisë, pasi ai në lëmin e historisë është autor i përpilimit të një libri të madh të cilit nuk i gjendet shoku, por duhet thënë se ai në këtë vepër nuk është treguar konsekuent në lidhje me dokumentimin. Këtë libër ai e ka quajtur “Tarikhu el-Umemi uel Muluk”. Prej veprave të tij të shquara është gjithashtu edhe “Tehdhibu el-Etheri” etj. Imam Et-Tabariu ndërroi jetë në Bagdad. (sh,p).



*Argumenti i pestë:* Allahu i Madhëruar iu drejtohet dijetarëve dhe kuptueshmërisë së tyre kur paraqet argumentet e Tij. Allahu i Madhëruar thotë në Kuran:

وَتِلْكَ الْأَمْثَلُ نَضْرِبُهَا لِلنَّاسِ وَمَا يَعْقِلُهَا إِلَّا الْعَالِمُونَ ﴿١٣٧﴾

“Këta shembuj Ne ua paraqesim njerëzve, por ata nuk i kupton kush, përveç dijetarëve.”

*Kuran: El-Ankebut, 43.*

Argumentet e Allahut të Madhëruar në fakt për të gjithë njerëzit janë të qarta. Mirëpo ata që arrijnë t’i kuptojnë ato janë vetëm dijetarët e thelluar në dituri. “Mund të jesh i thelluar në dituri, mirëpo argumentet e Allahut të Madhëruar nuk i kupton vetëm se ai që dituria e tij është e ngulitur thellë në zemër dhe në veprim.”<sup>(117)</sup>

Imam Ibën Kethiri <sup>(118)</sup> [Allahu e mëshiroftë] ka thënë në komentin e këtij ajeti të Kuranit: Askush nuk mund t’i hulumtojë dhe t’i kuptojë argumentet e

<sup>(116)</sup> - Imam Ibën Abd El-Berr, "Xhemiu el-Bejan", vëllimi: 28, faqja: 19.

<sup>(117)</sup> - Imam Esh-Shatibi, "El-Muvefekat", vëllimi: 1, faqja: 71.

<sup>(118)</sup> - *Imam Ibën Kethiri*, lindi në vitin 701 Hixhri (1302 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 774 Hixhri (1373 Diellor).

Jetoi në Basra, pastaj në Damask. Hafëz (memorizues), kronist, jurist, lindi në Sham në një fshat të Basras dhe më pas me një vëllain e tij u transferua në Damask në vitin 706 hixhri, nga ku udhëtoi në kërkim të diturisë. Njerëzit i bartën përpilimet e tij teksa ai ishte ende gjallë. Prej librave të tij përmendim "El-Bidaja ue En-Nihaje" me 14 vëllime në lëmin e historisë, i cili vjen në modelin e Ibn el-Ethirit, "Sherhu Sahihi el-Bukhari" të cilin nuk arriti ta përfundonte, "Tabakatu el-Fukahei esh-Shafi'in", "Tefsiru el-Kurani el-Kerim" me dhjetë vëllime, "Xhemiu el Mesenid" më tetë vëllime, "Ikhtisar Ulumi el-Hadith" një kumtim në shkencën e terminologjisë së hadithit, "Ikhtisar es-Sirati en-Nebeuia", "Et-Tekmil fi Mearifeti eth-Thikati ued Duafei ue el-Mexhehil" me pesë vëllime [Shiko: "El-Ea'lem" me autor Ez-Zirikliu (i cili ka ndëruar jetë në vitin 1396 hixhri)]. Nxënien e diturisë ai e bazoi tek dijetarët e Damaskut sikurse El-Emediu dhe Ibn Tejmija me të cilin kishte një komunikim privat, për shak të të cilit Ibn Kethiri iu ekspozua një persekutimi. Ai i takonte një shtëpie diturie dhe disipline. Ai ishte nxënës i dijetarëve të mëdhenj të kohës së tij. Progrosoi si dijetar, ekzaminues, i besueshëm, i përpiktë, det në dituri, hulumtues i arrirë dhe lider në tefsir, hadith dhe histori, duke



Allahut të Madhëruar. Askush përveç dijetarëve të thelluar në dituri dhe të kalitur prej saj.<sup>(119)</sup>

*Argumenti i gjashtë:* Dijetarët janë njerëzit më të devotshëm me Allahun e Madhëruar

Allahu i Madhëruar thotë në Kuran:

وَمِنَ النَّاسِ وَالْأَنْعَامِ وَالْأَنْعَامِ مُخْتَلِفٌ أَلْوَانُهُ، كَذَلِكَ إِنَّمَا يَخْشَى اللَّهَ مِنْ عِبَادِهِ  
الْعُلَمَاءُ إِنَّ اللَّهَ عَزِيزٌ غَفُورٌ ﴿٢٨﴾

"Në të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët".

*Kuran: Fatir, 28.*

Ata përcaktohen si njerëzit më të devotshëm ndër të gjithë njerëzit e tjerë të Allahut të Madhëruar. Imam Ibën Kajim El-Xheuzije [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Në këtë ajet theksohet devotshmëria që kanë dijetarët. Shpërblimi i tyre tek Allahu i Madhëruar është shumë i lartë, si rezultat i devotshmërisë së tyre. Ajeti në vijim e përcakton këtë:

جَزَاءُ هُمْ عِنْدَ رَبِّهِمْ جَنَّاتُ عَدْنٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا أَبَدًا رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمْ  
وَرَضُوا عَنْهُ ذَلِكَ لِمَنْ خَشِيَ رَبَّهُ ﴿٨﴾

"Shpërblimi për ta është te Zoti i tyre: Kopshtet e Adnit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj e ku do të banojnë përherë. Allahu është i kënaqur me ta, por dhe ata janë të kënaqur me Atë. Kjo është (dhurata) për ata që e kanë frikë Zotin e vet."

*Kuran: El-Bejine, 8.*

lënë pas një sërë përpilimesh të çmuara... Para se të vdiste atij ai u verbua. Ndërroi jetë dhe u varros në Damask. (sh.p).

<sup>(119)</sup> - Imam Ibën Kethir, "Tefsiru el-Kurani el-Adhim", vëllimi: 3, faqja: 414.



Kështu të dyja ajetet i përcaktojnë dijetarët si personat që do ta përfitojnë më shumë këtë shpërblim të madh të Allahut të Madhëruar dhe kjo për shkak të devotshmërisë së tyre.<sup>(120)</sup>

Sa më shumë që njeriu të njihet me Allahun e Madhëruar, aq më shumë bëhet i devotshëm me Të, aq më tepër ai e dashuron Atë, aq më shumë i shtohet frika ndaj zemërimit të Tij, aq më shumë i shtohet shpresa ndaj Mëshirës së Tij. E kështu pra dijetari, sa më i ditur të jetë me Allahun e Madhëruar, aq më shumë do të jetë i devotshëm me të.

Sa më pak dituri të kesh për Allahun e Madhëruar, aq më pak e njeh zemërimin e Tij, e fuqinë e Tij; aq më pak ia njeh mëshirën Allahut të Madhëruar; aq më pak e di vlerën e fjalëve dhe porosive të Tij; aq më pak je afër Tij. Sa më larg Allahut të Madhëruar, aq më afër shkatërrimit e sa më afër Allahut të Madhëruar, aq më afër sigurisë dhe prosperitetit të njeriut.

Imam Ibën Kethiri [Allahu e mëshiroftë] thotë për këtë ajet: Me të vërtetë ata që janë më shumë të devotshëm me Allahun e Madhëruar janë dijetarët. Pasi ata janë, që e njohin më shumë Allahun e Madhëruar. Sepse sa më shumë të kesh dijeni për Allahun, të Plotfuqishmin, të Mëshirshmin, të Gjithëditurin, që i ka cilësitë më madhështore, sa më shumë të kesh dituri për Të, aq më shumë rritet devotshmëria ndaj Tij.<sup>(121)</sup>

Imam Ibën Rexhebi [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Dituria e dobishme është ajo që të afron me Allahun e Madhëruar dhe të rrit dashurinë për të vepruar dy gjëra:

*E Para:* Duke njohur Allahun e Madhëruar njihesh me cilësitë e Tij. Njihesh me madhështinë e Tij. Dashurohesh me Të. I frikësohesh Atij. Kështu devocioni juaj shtohet edhe më shumë.

*E dyta:* Dashuria dhe Frika ndaj Allahut të Madhëruar të bën t'i përmbahesh ndalesave, që të ka urdhëruar. Të bën të nxitosh në zbatimin e urdhëresave, që të ka kërkuar.

Kjo ndodh pra, nëse njeriu që mëson dituria e nxit atë në këto dy çështje, atëherë kjo është dituria e dobishme.<sup>(122)</sup>

(120) - Imam Ibën Kajim, "Miftah Dar es-Seadeh", vëllimi: 1, faqja: 51. Mund të shikohet edhe nga Imam Ibën Xhem'ah në librin "Tedhkiretu es-Samij uel- Mutekelim", faqja: 6.

(121) - Imam Ibën Kethir, "Tefsiru el-Kurani el-Adhim", vëllimi: 3, faqja: 553.

(122) - Imam Ibën Rexhebi, "Bejan Fadli Ilm es-Selef ala Ilmi el-Khalef, faqja: 72-73.

Shejkh Abdurrahman Es-Seadij [Allahu e mëshiroftë] thotë: Devotshmria me Allahun e Madhëruar të nxit që të largohesh nga gjërat e dëmshme dhe jo të pëlqyeshme. Të nxit në përgatitjen me takimin e Allahut të Madhëruar. Kështu pra dituria bëhet shkak për ngritjen e vlerave të njeriut përpara Allahut të Madhëruar.<sup>(123)</sup>

Njëkohësisht sa më shumë që njeriu largohet nga të ndaluarat dhe afrohet me devotshmëri me Allahun e Madhëruar, aq më shumë ai do të jetë i vlerësuar edhe tek njerëzit.

*Argumenti i shtatë:* Dijetarët janë njerëzit më të kujdesshëm ndaj problemeve dhe më largpamësit.

Allahu i Madhëruar thotë në Kuran:

وَقَالَ الَّذِينَ أُوتُوا الْعِلْمَ وَيَلَكُمْ ثَوَابُ اللَّهِ خَيْرٌ لِمَنْ ءَامَنَ وَعَمِلَ صَالِحًا وَلَا يُلَقِّهَا إِلَّا الصَّابِرُونَ ﴿٨٠﴾

“Ndërsa njerëzit e dijshtëm thoshin: “Të mjerët ju! Shpërblimi i Allahut është më i mirë.”

*Kuran: El-Kasas, 80.*

Në komentin e këtij ajeti dijetari Abdurrahman Es-Seadij [Allahu e mëshiroftë] thotë: Vërtetë në këtë ajet vërehet vlera e madhe e dijetarëve. Theksohet se ata janë njerëzit që u merret dëshmia në këtë botë dhe në botën tjetër, kur të fillojë llogaria e madhe për njerëzimin. Theksohet se fjala e tyre merret në konsideratë nga Allahu i Madhëruar, por edhe nga shoqëria njerëzore.<sup>(124)</sup>

Kjo tregon largpamësinë e dijetarëve për rezultatet e mosbesimit të atyre që nuk besojnë dhe mashtrohen me të mirat e kësaj bote. Kjo tregon se ata i dinë pasojat e punëve të këqija. Ata gjithashtu dinë thelbin dhe arsyet pse njerëzit sprovohen me të mirat e kësaj bote. Si shembull kemi Karunin, i cili u

<sup>(123)</sup> - Abdurrahman Es-Sadi "Tejsir el-Kerimi er-Rrahman, vëllimi: 6, faqja: 317.

<sup>(124)</sup> - Shejkh Abdurrahman Es-Sadi, "Tejsir el-Kerimi er-Rrahman, vëllimi: 4, faqja: 196.



mashtroa me mirësitë e kësaj bote, të cilat ia kishte dhuruar Allahu i Madhëruar. Të gjithë njerëzit që e shihnin lakmonin në të mirat e tij. Mirëpo dijetarët i këshillonin duke thënë:

وَأَصْحَابُ الَّذِينَ تَمَنَّوْا مَكَانَهُ بِالْأَمْسِ يَقُولُونَ وَيَكَابُ اللَّهُ يَبْسُطُ الرِّزْقَ لِمَنْ يَشَاءُ  
مِنْ عِبَادِهِ وَيَقْدِرُ لَوْلَا أَنْ مَنَّ اللَّهُ عَلَيْنَا لَخَسَفَ بِنَا وَيَكَانَهُ لَا يُفْلِحُ الْكَافِرُونَ ﴿٨٢﴾

“Të nesërmen, ata që më parë dëshironin të kishin qenë në vend të tij, thoshin: “Është shumë e qartë, se Allahu është Ai që i jep bollëk dhe ia pakëson kujt të dojë prej robërve të Tij. Sikur Allahu të mos kishte mëshirë për ne, me të vërtetë, që do të na kishte bërë të na gëlltiste toka. Ububu! Është shumë e qartë, se mohuesit nuk kanë shpëtim!”

*Kuran: El-Kasas, 82.*

Dijetarët e dinin më mirë prapavijën e mendjemadhësisë së Karunit, për këtë arsye i këshillonin njerëzit që të mos nxitoheshin në lakminë e të mirave të tij, sepse ajo që me të vërtetë duhet të vlerësohet është shpërblimi i Allahut të Madhëruar për njerëzit besimdrejtë dhe të devotshëm. Ishte detyrë e dijetarëve që t’i këshillonin njerëzit. Por edhe detyrë e njerëzve, që të dëgjonin këshillat e dijetarëve, në mënyrë që të shpëtonin nga e keqja që i priste.

Allahu i Madhëruar i Madhëruar thotë:

لَوْلَا يَنْهَاهُمُ الرَّبَّانِيُّونَ وَالْأَحْبَارُ عَنْ قَوْلِهِمُ الْإِثْمَ وَأَكْلِهِمُ السُّحْتَ لَبِئْسَ مَا كَانُوا  
يَصْنَعُونَ ﴿٨٣﴾

“Përse rabinët dhe dijetarët nuk i ndalojnë ata të thonë fjalë të ulëta (për Zotin) dhe të hanë fitimet e paligjshme? Sa keq veprojnë ata!”

*Kuran: El-Maide, 63.*

Janë dijetarët ata që e njohin të mirën dhe të keqen dhe janë ata që e paralajmërojnë masën për rreziqet që mund t’iu vijnë.

*Argumenti i tetë:* Dijetarët janë trashëgimtarët e Pejgamberëve (*paqja qoftë mbi ta*). Ata janë gjithashtu edhe më të nderuarit ndër njerëzit, pas Pejgamberëve (*paqja qoftë mbi ta*).

Nga Ebu Darda <sup>(125)</sup> [Allahu qoftë i kënaqur prej tij] na përcillet, se Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) thotë: “{Dallimi ndërmjet dijetarëve të devotshëm dhe besimtarëve të devotshëm është si dallimi i hënës së plotë me yjet që e rrethojnë. Dijetarët janë trashëgimtarët e Pejgamberëve. Ndërsa Pejgamberët nuk kanë lënë pas tyre pasuri, as dinar e as dirhemë. Ata kanë lënë pas diturinë e tyre. Kush e merr këtë ka arritur një mirësi të madhe}.”<sup>(126)</sup>

Imam Ibën Rexhebi [Allahu e mëshiroftë] ka thënë në komentin e këtij Hadithi: Dijetarët trashëgojnë diturinë e Pejgamberëve, njëkohësisht ata janë edhe udhëheqës të bashkësive të tyre ashtu siç ishin Pejgamberët. Ata i ftojnë njerëzit në rrugën e Allahut të Madhëruar dhe në bindjen ndaj Tij. I këshillojnë, madje edhe e pengojnë shoqërinë të marrë rrugë të keqe dhe të shkatërrohet.<sup>(127)</sup>

Dijetarët kanë trashëguar prej Pejgamberëve krahas diturisë, edhe vlerat dhe kompetencat për ta sqaruar këtë dituri në popull. Pejgamberët janë përcjellësit e diturisë nga Allahu i Madhëruar, ndërsa dijetarët janë përcjellësit e diturisë nga Pejgamberët (*paqja qoftë mbi ta*). Kjo do të sqarohet edhe në argumentin e mëposhtëm.

*Argumenti i nëntë:* Dijetarët janë përcjellësit e mesazhit të Pejgamberëve (*paqja qoftë mbi ta*).

<sup>(125)</sup>- Ebu Darda, Sahab [shok] i Pejgamberit (*Paqja qoftë mbi të*), Gjykatës i Damaskut në kohën e Osman ibn Afanit (Allahu qoftë i kënaqur me ta) ndërroi jetë në vitin 32 Hixhri. (sh.p).

<sup>(126)</sup>- Transmetuar nga Imam Ahmedi në Musned, vëlimi: 5, faqja: 196. Darimiu, "Es-Sunen" numri i hadithit: 349. Ebu Daud "Es-Sunen", numri i hadithit: 3641. Tirmidhiu "Es-Sunen", numri i hadithit: 2823. Ibën Maxhe "Es-Sunen", numri i hadithit: 223. E bëri të saktë [sahih] këtë hadith Imam El-Bukhari.

<sup>(127)</sup>- Imam Ibën Rexheb El-Hanbeli, "Sherh Hadith Ebi Derda`a "Fi Talebi el-Ilm", faqja: 46.



Pejgamberi Muhamed (paqja qoftë mbi të) ka thënë: “{Ju duhet të mësoni, sepse edhe prej jush të tjerë duhet të mësojnë, por edhe prej tyre një brez tjetër do të mësojë}.”<sup>(128)</sup>

Në një hadith tjetër Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) ka thënë: “{Allahu e ndriçoftë një njeri, i cili e dëgjon thënien time dhe e mëson atë përmendësh, por edhe duke e kuptuar. Pasi mund të ketë disa nga ata, që do ta transmetojnë dhe nuk do ta arrijnë ta kuptojnë atë. Por ka edhe prej tyre, që e përcjellin diturinë tek dikush, që mund ta kuptojë atë më thellë}.”<sup>(129)</sup>

Dijetarët kanë thënë, se është e mundur që transmetuesit e diturisë të hulumtojnë aty në ato argumente. Madje duke qenë se argumentet janë për të gjitha kohët këta dijetarë e kanë për detyrë të gjejnë kuptime të reja, brenda këtyre argumenteve, për çështje të cilat nuk kanë qenë tek përcjellësit e diturisë së tyre, më parë.

Imam Esh-Shatibi [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Dijetari është në vetvete edhe hartues i Sheriatit (Jurisprudencës islame). Pasi ai jo vetëm që përcjell argumentet nga burimi i tyre, por edhe na përcjell hulumtimet dhe gjykimet e tij, që i ka nxjerrë prej këtyre argumenteve. Kështu përcjellësi mundet edhe të jetë hartues i një ligji, i cili ka bazën e tij në argumentin që është përcjellur, por që nuk ka qenë prezent në kohën kur argumenti ka ardhur. Është e vërtetë, se Hartuesi i ligjeve është vetëm Allahu i Madhëruar, por kjo nuk i ndalon që dijetarët hulumtues në ligjet e Allahut të Madhëruar të nxjerrin prej tij të tjera zgjidhje dhe ligje për çështje që kanë të bëjnë me kohën kur këta jetojnë. Pasi argumentat e Allahut të Madhëruar janë gjithpërfshirëse në kuptimet e tyre, duke qenë kështu të përshtatshme për kohët në vazhdim e deri në fund të kohëve. Në këtë mënyrë mund ta kuptojmë më drejtë, pse dijetarët janë trashëgimtarët e Pejgamberëve (*paqja qoftë mbi ta*).<sup>(130)</sup>

---

<sup>(128)</sup> - I përcjellur nga Imam Ahmedi në Musned, numri i hadithit: 2947. Ebu Daudi, numri hadithit: 3659, Ibën Hibani, numri i hadithit: 61. dhe Hakimi, vëllimi: 1, faqja: 95. Imam Edh-Dhehebi e ka bërë të saktë (sahih) këtë hadith.

<sup>(129)</sup> - Transmetuar nga Imam Shafiu, vëllimi: 1, faqja: 14. Ebu Daud, numri i hadithit: 3660, Tirmidhiu, numri i hadithit: 2794, Ibën Maxhe, numri i hadithit: 230, Imam Ibën Haxher El-Askalani e bëri të saktë [sahih] këtë hadith.

<sup>(130)</sup> - Imam Esh-Shatibi, "El Muuefekat" vëllimi : 4, faqja: 245.



*Argumenti i dhjetë:* Dituria është argument për dashurinë e Allahut të Madhëruar ndaj njeriut

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) ka thënë: “{Atij që Allahu ia do të mirën, i jep dituri në fe}.”<sup>(131)</sup>

Imam El-Exhiri (280-360 Hixhri) [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Atyre që Allahu i Madhëruar ua do të mirën u jep dituri të Kuranit dhe të Sunetit të Pejgamberit (paqja qoftë mbi të). Kështu ata bëhen pishtarë të njerëzimit për të ndriçuar rrugën e tyre.<sup>(132)</sup>

Shejkh El-Islam Ibën Tejmije [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Çdo popull para Islamit ka patur dijetarët e vet. Mirëpo ata kanë qenë të prishur duke i shkatërruar ata. Ndërsa dijetarët e Islamit marrin prej tij tjetër edukim, aq sa ta ruajnë amanetin dhe të jenë njerëz të drejtë ndaj Umetit musliman.<sup>(133)</sup>

Nëse ky është vlerësimi i Allahut të Madhëruar për ta, duke ua mësuar Islamit dhe shkencat e tij, atëherë ata e meritojnë prej shoqërisë që t’u binden udhëzimeve të tyre.

*Argumenti i njëmbëdhjetë:* Suksesi dhe zhvillimi i shoqërisë është atëherë kur në mesin e tyre ka dijetarë. Nëse ata mungojnë ose i nxjerrin prej saj (me persekutime), atëherë ajo shoqëri do të jetë e humbur.

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) ka thënë: “{Allahu i Madhëruar nuk e heq diturinë duke e ngritur atë nga mendja e njerëzve. Por e merr këtë dituri kur merr dijetarët (kur ata vdesin). Deri kur të mos mbetet më asnjë dijetar, liderët e shoqërisë caktohen njerëz injorantë. Ata japin udhëzime pa dituri dhe pa përvojë. E nëse e bëjnë këtë humbin veten dhe të gjithë ata që i kanë në varësi}.”<sup>(134)</sup>

Ata (injanantët) japin udhëzime pa e ditur fare se si funksionon shoqëria. Pa e kuptuar thelbin e ekzistencës së gjithçkaje në këtë botë. Kështu ata i degdisin masat në koncepte boshe dhe shkatërruese. Është pikërisht kjo që na serviret

<sup>(131)</sup> - Transmetuar nga Imam El-Bukhari në shumë kapituj të Sahihut, vëllimi: 4, faqja: 49, vëllimi: 8, faqja: 149. Muslimi, numri i hadithit: 1037, Imam Ahmedi në "Musned", vëllimi: 4, faqja: 92. Tirmidhiu, "Es-Sunen", vëllimi: 4, faqja: 137.

<sup>(132)</sup> - Imam Ebu Bekr El-Exherij, "Ahlak el-Ulema", faqja: 94.

<sup>(133)</sup> - Shejkh El-Islam Ibën Tejmije, "Refau el-Melam", faqja: 11.

<sup>(134)</sup> - Transmetuar nga Bukhariu. vëllimi: 1, faqja: 174-175, vëllimi: 8, faqja: 148, Muslimi, numri i hadithit: 2673.



sot në shumë media. Është pikërisht kjo arma me të cilën po shkatërrojnë shoqëritë moderne.

Në fakt sot nuk mungon leximi, madje literatura është shumë e madhe, madje edhe në lidhje me librat hyjnorë. Mirëpo çështja nuk qëndron tek sasia e madhe e librave, por tek jetësimi i mesazheve të tyre. Historia tregon plot shembuj nga popujt e mëparshëm, se si ata kanë dështuar me teoritë nga literatura. Ata kishin boll literaturë, por në fakt nuk jetësuan asgjë nga mesazhet hyjnore, që mbartnin ato libra. Kështu ata u shkatërruan si civilizime.

- Kishte prej tyre që e adhuronin Allahun e Madhëruar pa dituri, por kjo i çoi në devijime të errëta, aq sa sot nuk e gjejnë dot rrugën e vërtetë. Këta janë të krishterët.

- Ka pasur prej tyre, që me vetëdije i manipuluan udhëzimet e Allahut të Madhëruar dhe u kthyen në një klasë të korruptuar që përfaqësonte fenë. Ata morën mallkimet e Allahut të Madhëruar dhe këta janë hebrenjtë.

Në fakt të gjithë këta popuj kanë patur udhëzime hyjnore prej Allahut të Madhëruar, por ata i keqpërdorën këto udhëzime. Të Krishterët kishin Ungjillin [Biblën], por e manipuluan atë. Përpara tyre hebrenjtë kishin Teuratin, por edhe ata e manipuluan atë. Kështu të dyja palët e humbën rrugën.

Po kështu edhe umeti musliman nuk ka për t'i bërë dobi prania e Kuranit, nëse ai nuk jetësohet me vepra të sinqerta prej muslimanëve.

Nga Ebu Umame <sup>(135)</sup> [Allahu qoftë i kënaqur prej tij] na ka transmetuar nga Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*), i cili ka thënë: “{Mbajeni diturinë para se ajo

---

<sup>(135)</sup> - Ebu Umame, Ndërroi jetë në vitin 86 Hixhri (706 Diellor). Ai është prej sahabëve të shquar dhe një prej atyre që i dhanë besën Pejgamberit [*paqja qoftë mbi të!*] në Marrëveshjen e Hudejbijes, që ndodhi në vendin me të njëjtin emër. Në Betejën e Sifinit ai ishte në krahun e Aliut [Allahu qoftë i kënaqur me të!]. Ai banoi në Egjipt dhe pastaj në Hums të Shamit, [Siri] ku edhe ndërroi jetë në moshën nëntëdhjetenjë vjeçare. Ai është sahabiu i fundit që vdiq në tokën e Shamit, në kohën e Khalifatit të Abdulmalik Ibën Maruanit. Në dy autentikët e haditheve (“Sahihu el-Bukhari” dhe “Sahihu Muslim”) prej tij janë përcjellë 250 hadithe. Ai shquhej për devotshmërinë e tij, sidomos për agjërimin e dëndur të tij, gjë për të cilën thuhej: “Nuk është parë Ebu Umame, as e shoqja dhe as asistenti i tyre, veçse agjërueshëm”. Nëse në shtëpinë e tij shihje zjarr ose tym gjatë ditës, dihej se atyre u kishin shkuar miq [Shih: “El Ea’lem” me autor Ez Zirikliu (i cili ndërroi jetë në vitin 1396 Hixhri). (sh.p.)].

t'ju ikë". O i Dërguari i Allahut, e si mund të ikë dituria, kur ne e kemi Kuranin,- e pyetën shokët e tij? Ai u mërzi nga kjo pyetje dhe tha: -"A nuk e kishin edhe Hebrenjtë e të Krishterët Teuratin dhe Inxhilin? Por ato nuk i bënë dobi. Dituria ikën kur nuk ka kush që ta mbartë atë me sinqeritet}".<sup>(136)</sup>

Në një transmetim tjetër nga Ebu Darda, na thuhet se Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) hodhi shikimin e tij drejt qiellit pastaj tha: "{Kjo është koha kur dituria do të shpërbëhet nga njerëzit. Aq sa nuk do kenë mundësi fare ta mbajnë}." Zijad Ibën Lebidi<sup>(137)</sup> [Allahu qoftë i kënaqur prej tij] e pyeti: -Si do të shpërbëhet nga ne, o i Dërguar i Allahut, kur ne e kemi mësuar Kuranin. Pasha Zotin kemi për ta mbajtur në mendjen dhe zemrën tonë. Por edhe do t'ua mësojmë atë fëmijëve dhe grave tona. Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) tha: "Eh Zijad, unë të kam llogaritur si njerëzit e ditur të Medines. Po pse, a nuk e kishin Teuratin dhe Inxhilin, Hebrenjtë dhe të Krishterët? E çfarë dobie u solli mbartja e tyre?"<sup>(138)</sup>

Pra, zhdukja e diturisë vjen me zhdukjen e dijetarëve të sinqertë dhe punëtorëve me këtë dituri. Ikja nga kjo botë e dijetarëve sjell si rezultat shkatërrimin e shoqërisë.

Ibën Abasi [Allahu qoftë i kënaqur prej tij] na përcjell një hadith nga Pejgamberi (paqja qoftë mbi të), i cili ka thënë: "{A e dini se si do të ikë dituria?}- I thamë: Jo! - Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) tha: "Me ikjen e dijetarëve}."<sup>(139)</sup>

Seid Ibën Xhubejri [Allahu e mëshiroftë]<sup>(140)</sup> e konsideronte shkatërrim për njerëzit dhe shoqërinë vdekjen e dijetarëve.

Umer Ibën Khatabi [Allahu qoftë i kënaqur prej tij] ka thënë: Ai popull që zgjedh liderët e vet prej diturisë dhe devotshmërisë së tyre ka për të patur sukses, ndërsa ai lider që nuk zgjidhet për shkak të diturisë do të jetë i

<sup>(136)</sup> - E përcjell Imam Ahmed i në "Musned", vëllimi: 5, faqja: 266. Imam Darimiu, numri i hadithit: 245.

<sup>(137)</sup> - Zijad Ibn Lebidi, Sahab [shok] i Pejgamberit (paqja qoftë mbi të), i cili ka marrë pjesë në Betejën e Bedrit. Nderroi jetë në vitin 41 Hixhri. (sh.p).

<sup>(138)</sup> - E përcjellur nga Darimiu, vëllimi: 1, faqja: 75. Tirmidhiu vëllimi: 4, faqja: 140. Hadithi është i mirë (hasen garib).

<sup>(139)</sup> - E përcjellur nga Darimiu në "Sunen", vëllimi: 1, faqja: 68, nr. i hadithit: 249. Në parathënie edhe tek kapitulli "Zhdukja e Diturisë".

<sup>(140)</sup> - Seid Ibën Xhubejri, Është prej Tabiinëve të famshëm, i cili qëndroi trimërisht përballë diktatorit Haxhaxh Ibën Jusuf Eth-Thekafiut. Në qëndrimin e tij ai tregoi vendosmëri për të mbrojtur të vërtetën, që në atë kohë nuk i shkonte shumë për shtat Haxhaxhit. Ai u vra nga Haxhaxhi në vitin 95 Hixhri. (sh.p).



shkatërruar dhe bashkë me veten do të tërheqë dhe popullin e tij në shkatërrim.<sup>(141)</sup>

Ibën Abasi [Allahu qoftë i kënaqur për tij] ka thënë: Sa herë që vdes një dijetar një pjesë e diturisë largohet, një pjesë e injorancës shtohet. Kur injoranca do të arrijë përhapje të gjerë, atëherë njerëzit do të shturen.<sup>(142)</sup>

*Argumenti i dymbëdhjetë:* Nevoja për dijetarët në shoqërinë njerëzore është jetike.

Imam Ahmed Ibën Hambeli [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Njerëzit kanë nevojë për dijetarët, më shumë se sa për ushqimin e tyre. Pasi ushqimi i tyre është i nevojshëm dy ose tre herë në ditë, ndërsa dituria duhet çdo moment.<sup>(143)</sup>

Imam El-Exhiri [Allahu e mëshiroftë] thotë: Si mendoni për një rrugë të mbushur plot pengesa dhe papastërti, në të cilën njerëzit do të duhej të kalojnë në një natë me errësirë? Si do të bënin ata po të mos kishin dritë? Për këtë arsye Allahu i Madhëruar i ka caktuar dijetarët si pishtarë, që njerëzit të jenë të kujdesshëm në pengesat e rrugës. Mirëpo pas këtyre njerëzve në një natë tjetër disa të tjerë janë duke kaluar në këtë rrugë, por befas pishtarët shuhën. Si mendoni? Çfarë do të ndodhte me këta njerëz? Kështu është edhe shembulli i dijetarëve në shoqëri. Shumica nuk e dinë cilat janë detyrimet e tyre? Detyrimet e njeriut ndaj Krijuesit, ndaj shoqërisë apo edhe ndaj individëve në të. Nëse nuk do të ishin dijetarët shoqëria do të shpërbëhej.<sup>(144)</sup>

Umer Ibën Abdul Azizi [Allahu e mëshiroftë] prijësi i drejtë thotë: Kush punon pa dituri, sjell dëm më shumë se sa dobi.<sup>(145)</sup>

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) i krahason dijetarët me yjet në qiell: Na përcjell Enesi [Allahu qoftë i kënaqur më të], se Pejgamberi [paqja qoftë mbi të] thotë: “{Shembulli i dijetarëve në tokë është si shembulli i yjeve në qiell.

(141) - Transmetuar nga Darimiu “Sunen”, vëllimi: 1, faqja: 69, numri i hadithit: 257, dhe Ibën Abdul Berr, në “Xhemiu Bejan el-Ilm ue Fadlihi”, vëllimi: 1, faqja: 62.

(142) - Imam Ibën Abdul Berr, “Xhemiu Bejan el -Ilm ue Fadlihi”, vëllimi: 1, faqja: 155.

(143) - Imam Ibën Kajim, “Talam el Muvekiin”, vëllimi: 2, faqja: 256.

(144) - Imam Ebu Bekr El-Exherij, “Ahlak el-Ulema”, faqaj: 96.

(145) - Imam Ibën Abdul Berr, “Xhemiu Bejan elilm ue Fadlihi”, vëllimi: 1, faqja: 27.

Njerëzit me ta orientohen në errësirat e natës në tokë apo në det. Nëse yjet zhduken njerëzit mbesin të humbur}”<sup>(146)</sup>

Dobitë e yjeve:

Allahu i Madhëruar i përmend disa prej këtyre dobive:

1. Yjet janë udhëzues:

وَعَلَّمَتِ وَالنَّجْمِ هُمْ يَهْتَدُونَ ﴿١٦﴾

“Si dhe yjet, nëpërmjet të cilave njerëzit orientohen.”

Kuran: En-Nahl, 16.

2. Yjet janë zbukurues të qiellit:

وَلَقَدْ زَيَّنَّا السَّمَاءَ الدُّنْيَا بِمَصْبِيحٍ وَجَعَلْنَاهَا رُجُومًا لِلشَّيَاطِينِ وَأَعْتَدْنَا لَهُمْ عَذَابَ السَّعِيرِ ﴿٥﴾

“Ne jua kemi zbukuruar qiellin më të afërt me yje të shkëlqyeshme.”

Kuran: El-Mulk, 5.

3. Yjet janë gjuajtës ndaj djajve.

وَلَقَدْ زَيَّنَّا السَّمَاءَ الدُّنْيَا بِمَصْبِيحٍ وَجَعَلْنَاهَا رُجُومًا لِلشَّيَاطِينِ وَأَعْتَدْنَا لَهُمْ عَذَابَ السَّعِيرِ ﴿٥﴾

“... dhe i kemi bërë ato si predha për të larguar djajtë.”

Kuran: El-Mulk, 5.

(146) - Transmetuar nga Imam Ahmed i në "Musned", vëllimi: 3 faqja: 157, Hejthemi thotë në lidhje me këtë hadith, vëllimi: 1, faqja: 121 në librin e tij, hadith i saktë [sahih] nga ana kuptimore.



Edhe dijetarët mund të jenë të krahasueshëm me yjet, duke marrë parasysh këto dobi të tyre, pasi dijetarët ashtu si yjet janë:

- Ata janë udhëzues për shoqërinë në problemet e saj.
- Ata janë krenaria e shoqërisë dhe thesari i saj i vërtetë.
- Ata janë sulmues të djajve, të cilët e dëmtojnë vazhdimisht shoqërinë.

Roli i dijetarëve është pengimi i tyre në shkatërrimet që bëjnë.<sup>(147)</sup>

Shembulli i dijetarit është si shembulli i ujit të shiut në kohë thatësire. Dobia e tyre për njerëzit është e njëjtë. Dijetari Mejmun Ibën Mehran (40-117 Hixhri), [Allahu qoftë i kënaqur prej tij] do t'i krahasonte dijetarët me burimet e ujit, kur thoshte: Dijetarët janë si burimi i ujit të pastër në një qytet të banuar. Të gjithë e preferojnë ujin e tij.<sup>(148)</sup>

Një fjalë e urtë thotë: Dijetarët janë si shiu, kudo që bie është i dobishëm.<sup>(149)</sup>

Njerëzit nëse do të donin të jetonin pa dijetarët që iu tregojnë rrugën, janë si ata që duan të jetojnë pa diellin.

Djali tij Abdullahu (113-290 Hixhri) [Allahu e mëshiroftë] e ka pyetur të atin, Ahmed Ibën Hambelin: Çfarë njeriu ka qenë ky Shafiu? (Imam Shafiu) Shoh që ti lutesh shumë për të dhe e lavdëron punën e tij. Imam Ahmedi [Allahu e mëshiroftë] tha: Ai ka qenë si dielli për botën. Si shëndeti për njerëzimin. A mendon se njerëzimi do të mund t'i zëvendësonte këto dy elementë për ekzistencën e tij?<sup>(150)</sup>

Kështu dijetarët janë persona shumë të rëndësishëm në Jurisprudencën Islame. Ata kanë një pozitë që askush tjetër në umetin musliman nuk e ka. E megjithatë duhet të kemi kujdes nga disa gjëra:

#### *E Para: Shenjtërimi i njeriut.*

Edhe pse konsiderata për dijetarët e Islamit është shumë e lartë ajo përsëri nuk mund të na çojë drejt shenjtërimin të tyre. Kjo do të ishte një rrëshqitje në ekstremizëm, ashtu sikurse bënë më parë hebrenjtë dhe të krishterët.

(147) - Imam Ibën Rexheb El-Hanbeli, "Sherh Hadith Ebi Derda`a fi Talebi el-Ilm", faqja: 16.

(148) - Imam Ibën Abdul Berr, "Xhemiu Bejan el-Ilm ue fadlihi", vëllimi: 1, faqja: 54.

(149) - Imam Ibën Abdul Berr, "Xhemiu Bejan el-Ilm ue fadlihi", vëllimi: 1, faqja: 60.

(150) - Imam Ed-Dhehebi, "Sijer ealam eN-Nubela", vëllimi: 10, faqja: 45.



أَتَّخَذُوا أَحْبَارَهُمْ وَرُهَبَانَهُمْ أَرْبَابًا مِّن دُونِ اللَّهِ وَالْمَسِيحَ ابْنَ مَرْيَمَ وَمَا أُمِرُوا إِلَّا لِيَعْبُدُوا إِلَهًا وَاحِدًا ۗ إِلَّا إِلَهَ إِلَّا هُوَ سُبْحٰنَهُ عَمَّا يُشْرِكُونَ ﴿٣١﴾

“Në vend të Allahut, ata kanë zgjedhur për zot rabinët dhe murgjit e tyre, si dhe Mesinë, të birin e Merjemes, ndërkohë që janë urdhëruar të adhurojnë vetëm një Zot, përveç të Cilit nuk ka tjetër që meriton të adhurohet. I lartësuar qoftë Ai mbi gjithçka që ia shoqërojnë (në adhurim).”

Kuran: Et-Teube, 31.

Udej Ibën Hatim<sup>(151)</sup> [Allahu qoftë i kënaqur prej tij] na tregon historinë e tij për këtë ajet. -Shkova tek Pejgamberi (paqja qoftë mbi të), ndërsa në qafë mbaja një kryq të artë. Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) më tha: “{Hiqe atë idhull që ke në qafë!” Pastaj lexoi ajetin e lartpërmendur. E pasi e mbaroi më tha: “Ata nuk i adhuronin këta njerëz, por kur këta priftërinj dhe murgj i gjykonin gjërat si Hallall (të lejuara) ata i ndiqnin verbtazi. Po ashtu bënë kur i gjykonin si haram (të ndaluara). Megjithëse këto vinin thjesht si teka dhe mendime personale të tyre aspak në lidhje me ligjin e Allahut të Madhëruar}”<sup>(152)</sup>

E kanë pyetur dijetarin Ebu Alije (ndërroi jetë në vitin 93 Hixhri), [Allahu e mëshiroftë]: Si funksiononte shenjtërimi i njerëzve tek hebrenjtë? Ai i tha: Populli kur shihte në librin e Zotit, ndalesat dhe urdhërimet, stepeshin dhe thoshin, se ne do të marrim mendimin e priftërinjve tanë. Mirëpo klasa e priftërinjve dhe farisenjve<sup>(153)</sup> ishin të korrptuar. Kjo bënte që populli tashmë të linte pas dore librin e Zotit (Teuratin) dhe të merrte për bazë mendimet dhe tekat e priftërinjve, që herë pas here u shkonin sipas interesave të elitës

<sup>(151)</sup> - Udej Ibën Hatim, Sahab [shok] i Pejgamberit (Paqja qoftë mbi të). Ndërroi jetë në moshën 120 vjeçare në vitin 66 Hixhri. (sh.p).

<sup>(152)</sup> - Transmeton, Tirmidhiu në “Sunen”, numri i hadithit: 3095, Bejhakiu në “Tabakat el-Kubra” vëllimi: 10, faqja: 116.

<sup>(153)</sup> - Farisenjtë, janë klerikë në religjionin hebraik. (sh.p).



politike dhe shtresave të pasura të vendit, pa harruar përkujdesin e veçantë që i kushtonin shenjtërimin të elitës fetare.<sup>(154)</sup>

Ndërsa në Islam dijetarët konsiderohen si njerëz të vlerësuar, por jo edhe të shenjtë. Bindja ndaj tyre shkon deri në kufirin që ata i përmbahen Kuranit dhe Sunetit të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Nëse dikush i pyet ata, në fakt i pyet jo për mendimin e tyre, por për pajtueshmërinë e këtij mendimi në lidhje me bazat e Islamit (Kurani dhe Suneti). Nëse njeriu bazohet me këtë gjykim të dijetarit, atëherë ai është i justifikuar përpara Allahut të Madhëruar, edhe nëse gjykimi i këtij dijetari është i gabuar. Ndryshe nga hebrenjtë muslimanët nuk pyesin se si është gjykimi i njeriut, por si është gjykimi i Zotit. Për këtë arsye ky njeri është i justifikuar nga Allahu i Madhëruar për mundin e tij dhe veprimin që vjen si pasojë e gjykimit të marrë nga dijetari. Por edhe dijetari nga ana e tij është i justifikuar para Allahut të Madhëruar, nëse në gjykimin e tij është përpjekur të gjejë të vërtetën, edhe pse nuk ia ka arritur asaj në rastin më të keq, në ndryshim nga njerëzit tekanjozë dhe të dhënë pas interesave dhe pasioneve.

إِنَّ هِيَ إِلَّا أَسْمَاءٌ سَمَّيْتُمُوهَا أَنْتُمْ وَءَابَاؤُكُمْ مَا أَنْزَلَ اللَّهُ بِهَا مِنْ سُلْطَانٍ إِنْ يَتَّبِعُونَ إِلَّا الظَّنَّ  
وَمَا تَهْوَى الْأَنْفُسُ وَلَقَدْ جَاءَهُمْ مِنْ رَبِّهِمْ الْهُدَى ﴿١٣﴾

"Ata ndjekin vetëm hamendjet dhe atë që ua ka qejfi, ..."

Kuran: En-Nexhm, 23

Dijetarët e korruptuar e bëjnë fakt të kryer gjykimin e tyre dhe nuk pranojnë që ai të jetë i gabueshëm. Kështu ata japin gjykime në kundërshtim me të drejtën, në kundërshtim me ligjin e Allahut të Madhëruar. Të tillët janë të shkatërruar për veten e tyre, por edhe shkatërrues të shoqërisë. Dënimi i tyre nga Allahu i Madhëruar është i tmerrshëm.<sup>(155)</sup>

Njerëzit ndahen në tre kategori në raport me konsideratën e tyre ndaj dijetarëve

<sup>(154)</sup> - Imam Ibën Xherir, "Xhemiu el-Bejan", vëllimi: 10, faqja: 115. Shejkh El-Islam Ibën Tejmije në "Fetaua", vëllimi: 7, faqja: 67.

<sup>(155)</sup> - Shejkh El-Islam Ibën Tejmije, "Fetaua", vëllimi: 29, faqja: 43.

1. Një kategori e tillë nuk e njohin vlerën e dijetaëve. Nën justifikimin se “Islami nuk i shenjtëron njerëzit” apo “Islami nuk është besim priftërinjsh” ata tentojnë të mos përfillin fjalët dhe gjykimet e dijetarëve. Të tillët janë Hauarixhët, të cilët nuk njohën asnjë vlerë të Sahabeve dhe të dijetarëve. Edhe sot ka shumë ndjekës të tyre.

2. Kjo kategori ka devijuar në ekstremin tjetër. Ata janë ndjekës të verbër të dijetarëve deri në shenjtërimin e tyre. Ata ngjajnë shumë me hebrenjtë dhe të krishterët, të cilët adhurojnë “shenjtorët” e tyre. Njësoj si këta janë edhe Rafidinjtë, të cilët liderët e tyre i ngrejnë në pozita shumë më të larta se Pejgamberët apo engjëjt.

3. Kjo është kategoria më e ekuilibruar e njerëzve. Në këtë grup futen ata njerëz, të cilët në mënyrë të ekuilibruar nuk e hedhin poshtë vlerën e madhe të dijetarëve, por as nuk kalojnë kufirin e tyre duke i shenjtëruar njerëzit. Ata e dinë se çdo njeri është i gabueshëm dhe ndjekja pa kushte e tyre është e padrejtë dhe e ndaluar nga Islami.

Kështu dijetarët e hershëm e kishin vënë si njësi matëse të tyre ‘të vërtetën’ për të peshuar vlerat e njerëzve. Ndërsa injorantët apo ndjekësit e verbër kanë vendosur si njësi matëse të tyre ‘njerëzit’ për të peshuar ‘të vërtetën’.

Imam Esh-Shatibi [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Në çfarëdo lloj rasti, askush nuk mund të ndiqet pa kushte. Dijetarët ndiqen në varësi të përqendrimit të tyre në Islam, në varësi të thellueshmërisë së tyre në shkencat islame dhe në praktikimin e tyre. Nëse dikush nuk i përmbahet këtyre kushteve bazë të Islamit, atëherë ai nuk duhet të ndiqet dhe nëse bëhet, ajo nuk është argument para Allahut të Madhëruar dhe njeriu nuk mund të jetë i justifikuar në veprimet e tij, bazuar në gjykimet e një njeriu, i cili nuk i përmbahet burimeve të Islamit (Kuranit dhe Sunetit).<sup>(156)</sup>

Kështu kanë vepruar dijetarët e Umetit musliman, qofshin nga brezi i hershëm, po ashtu edhe nga ata të mëvonshmit. E nëse dijetari tejkaloonte kufirin e tij ndaj Sheriatit Islam, atëherë askush nuk i bindej atij.<sup>(157)</sup>

Imam Ebu Hanife<sup>(158)</sup> [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Nëse Hadithi është i saktë, atëherë ai është edhe mendimi im.<sup>(159)</sup>

<sup>(156)</sup> - Imam Esh-Shatibi, “El iatisam” vëllimi.: 2, faqja: 860.

<sup>(157)</sup> - Imam Esh-Shatibi, “El iatisam” vëllimi: 2, faqa: 862.



Imam Maliku [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Unë jam vetëm një njeri dhe mund të gaboj, ose mund t'ia qëlloj në gjykimin tim, prandaj shqyrtojeni gjykimin tim. Nëse ai është në përputhje me Kuranin dhe Sunetin, atëherë merreni atë. Nëse gjykimi im bie ndesh me to atëherë lëreni.<sup>(160)</sup>

Imam Shafiu<sup>(161)</sup> [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Çdokujt mund t'i ndodhë që t'i shpëtojë ndonjë hadith pa e gjetur ose pa e kuptuar si duhet. Nëse ju ndodh që të gjeni në gjykimet e mia diçka që bie ndesh me hadithin e Pejgamberit (paqja qoftë mbi të), atëherë gjykimi im është ashtu si ka gjykuar edhe Pejgamberi (paqja qoftë mbi të).<sup>(162)</sup> Përsëri Imam Shafiu [Allahu e mëshiroftë] thotë: Nëse hadithi është i saktë ajo është rruga ime.<sup>(163)</sup>

Imam Ahmed Ibën Hambeli<sup>(164)</sup> [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Mendimi i Euzaiut (88 -157 Hixhri), Mendimi i Malikut, Mendimi i Ebu Hanifes, është i

---

<sup>(158)</sup> - Imam Ebu Hanife, është themeluesi i Medhhebit (Shkollës Juridike) Hanefi. Ai konsiderohet ndër dijetarët më të njohur të shkollës së Mendimit. Imam Shafiu do të thoshte për Ebu Hanifen: Njerëzit janë fëmijë përpara Ebu Hanifes kur bëhet fjalë për Jurisprudencën Islame (lindi në vitin 80 Hixhri dhe ndërroi jetë në vitin 150 Hixhri).

<sup>(159)</sup> - Imam Ibën Abdul Berr, "El-Intika min Fadail eth-Thelethe el-Eime el-Fukaha", faqja: 145. Imam Ibën Kajim, "Talam El-Muuekiin", vëllimi: 2, faqja: 309. Imam Ibën Abedin, "El-Hashija", vëllimi: 6, faqja: 293. Imam Albani në "Sifetu es-Salah", faqja: 46. Me këtë Ebu Hanife kuptonte se ai i përmbahej në gjykimet e tij vetëm hadithit të saktë. Nëse hadithi i saktë do të vinte në kundërshtim me gjykimin e tij, atëherë hadithi i saktë kishte përparësi dhe hidhej poshtë gjykimi i tij. (sh.p.)

<sup>(160)</sup> - E përcjell nga Imam Ibën Abd El-Berr, "Xhemiue Bejani el-Ilmi ue Fadlihi" vëllimi: 2, faqja: 32.

<sup>(161)</sup> - Imam Shafiu, edhe ky konsiderohet ndër eruditët e Islamit. Ai është themeluesi i Medhhebit Shafii. Lindi në Gaza të Palestinës, por në moshën dy vjeçare familja u transferua për në Mekë, ku edhe jetoi për një kohë të gjatë. (lindi në vitin 150 Hixhri dhe ndërroi jetë në vitin 204 Hixhri). (sh.p.)

<sup>(162)</sup> - Imam Ibën Kajim, "Talam el Muvekiin", vëllimi: 2, faqja: 363-364.

<sup>(163)</sup> - Imam En-Neveuij "El-Mexhmu", vëllimi: 1, faqja: 63. Imam Esh-Sharanij "El-Mijzan", vëllimi: 1, faqja: 57. Imam Albani në "Sifetu es-Salah", faqja: 50.

<sup>(164)</sup> - Imam Ahmed Ibën Hambeli, ashtu si edhe Imam Ebu Hanife, Imam Shafiu, Imam Maliku, themeloi një shkollë juridike shumë të rëndësishme, e cila quhet Medhhebi Hambeli. Ai njihet gjithashtu edhe për rezistencën që i bëri Khalifit Me'mun, në lidhje me çështjen e përkufizimit të Kuranit, nëse ai është Fjala e Zotit apo krijesa e Zotit. Imam Ahmed mbrojt mendimin që Kurani është Fjala e Zotit, që është edhe e vërteta. Vuajti për 18 muaj tortura dhe disa vite internim, por më në fund u lirua nga Khalifi [prijësi] Muteuekil. (lindi në vitin 164 Hixhri dhe ndërroi jetë në vitin 241 Hixhri). (sh.p.)

njëjtë me mendimin tim se: baza është nga argumentet e Kuranit dhe Sunetit dhe është përparësia mbi çdo mendim.<sup>(165)</sup>

Kjo do të thotë se të gjithë dijetarët e Islamit janë bazuar në mendimet e tyre në Sheriatin Islam (Kurani dhe Suneti). Atë kanë si referencë të të gjitha gjykimeve që japin. E nëse këto gjykime janë të referuara dhe të mbështetura nga Kurani dhe Suneti, atëherë ai merret për bazë. Në të kundërt të gjithë këta dijetarë kanë rënë dakord, se mendimet dhe gjykimet e tyre duhet të hidhen poshtë, nëse ato bien ndesh me një argument kuranor apo nga Suneti i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*).<sup>(166)</sup>

Imam Ibën Kajim El-Xheuzije [Allahu e mëshiroftë] na e ka sqaruar konsideratën, që duhet të kemi në raport me gjykimin e dijetarëve pas analizave që ato bëjnë. Ai do të shprehej: Gjykimi i dijetarëve, të cilët arrijnë në këtë përfundim si rezultat i kërkimeve të tyre në Jurisprudencën Islame, mund të lihet ose të merret për bazë, pasi ai nuk është drejtpërdrejtë gjykimi i Allahut të Madhëruar. Zakonisht kjo ndodh në rast se kemi gjykime të ndryshme për të njëjtën çështje nga dijetarë të ndryshëm. Ai i cili nuk dëshiron të zgjedhë gjykimin e një dijetari, nuk do të thotë se është mëkatar dhe nuk konsiderohet si lënës i besimit, pasi ky nuk është gjykimi i Allahut të Madhëruar dhe njeriu mund të zgjedhë ndërmjet cilido gjykim që ndjehet më i qetë.

Ebu Hanife [Allahu e mëshiroftë] thoshte: Ky është mendimi im, nëse dikush tjetër vjen me një tjetër mendim më të mirë se i imi, do ta pranoja atë. Nëse mendimet e tij do të ishin drejtpërdrejt gjykimi i Allahut të Madhëruar, atëherë ai nuk do t'i lejonte nxënësit e tij të kishin mendime të ndryshme nga mendimi i tij.

Edhe Maliku pasi u autorizua nga Khalifi Harun Er-Rrashid<sup>(167)</sup>, që ta bënte librin e tij "El Muveta" si bazë të kushtetutës së të gjithë shtetit islam, kundërshtoi duke thënë: Sahabët e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) janë

(165) - Imam Ibën Abdul Berr, "Xhemiu Bejan el-Ilm ue fadlihi", vëllimi: 2, faqja: 149.

(166) - Imam Esh-Shatibi në librin e tij "El-I'atizam", vëllimi: 2, faqja: 862.

(167) - *Harun Er-Rashid*, është një personalitet për të cilin është folur shumë në Perëndim si njeri i dhënë pas pasioneve. Mirëpo e vërteta e tij është se ai ishte një njeri i ditur dhe e nderonte diturinë. Në kohën e tij çdo libër që botohej për herë të parë e drejta e autorit blihej në flori me peshën e librit. (lindi në vitin 147 Hixhri dhe ndërroi jetë në vitin 193 Hixhri). (sh.p).





shpërndarë nëpër zona të ndryshme të shtetit Islam, për këtë arsye ata patën gjykime të ndryshme duke marrë në konsideratë natyrën e popujve ku ata ishin.

Shafiu gjithashtu i ndalonte nxënësit e tij të përqendroheshin vetëm në gjykimet e tij, sidomos kur gjenin një argument nga Kurani apo Suneti, që e hidhte poshtë atë gjykim.

Imam Amedi [Allahu e mëshiroftë] ua ndalonte nxënësve të tij, që t'i përmbaheshin vetëm mendimeve të tij. Ai thoshte se: Mos më kopjoni mua, as filanin mos e kopjoni. Merrni dhe ju prej burimeve në të cilat ne morëm. Sikur dijetarët e mëhershëm të mendonin se gjykimet e tyre janë drejtpërdrejt gjykimi i Allahut të Madhëruar, atëherë ata nuk do të lejonin asnjë nga nxënësit e tyre të kishin mendime të ndryshme nga ata. Nuk do të kishin as vetë gjykime të ndryshme herë pas here për të njëjtën çështje. Kjo vinte në varësi të vendit dhe kohës, madje edhe mentalitetit të popullit ku jetonin.<sup>(168)</sup>

Si konkluzion i mendimit të mësipërm dalim në përfundim, se i vetmi gjykim i cili meriton të ndiqet pa mëdyshje është gjykimi i Allahut të Madhëruar dhe gjykimi i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*), ndërsa për çdo gjykim tjetër krahasohet përputhshmëria e tij me këto dy baza të Islamit. Nëse janë në përputhje me to, atëherë merret në konsideratë e nëse jo atëherë ai hidhet poshtë, pavarësisht kur ka qenë njeriu që e ka dhënë atë mendim, apo pozita e tij.<sup>(169)</sup>

#### *E dyta: Konsiderata e pjesshme.*

Disa njerëz, madje shumë prej tyre besimtarë të devotshëm mendojnë se dijetarët e Islamit duhet të merren vetëm me çështjet që kanë të bëjnë me besimin dhe adhurimet. Sipas tyre ka disa çështje të tjera të jetës, në të cilat nuk është e domosdoshme të merren këta dijetarë, si referenca në gjykimin e tyre. Për të tilla çështje mjafton të pyesim specialistët e fushave përkatëse dhe do të ishte kjo e drejta.

Mirëpo duke qenë se Islami përfshin çdo aspekt të jetës dhe se gjykimet e tij duhet të merren parasysh jo vetëm në çështje që kanë të bëjnë me adhurimet,

---

<sup>(168)</sup> - Imam Ibën Kajim, "Er-Rruh", faqja: 276-277.

<sup>(169)</sup> - Imam Esh-Shatibi, "El I'atizam", vëllimi: 2, faqja: 355.



por me të gjitha çështjet e jetës. Atëherë edhe mendimi i dijetarëve të Islamit në këto fusha duhet të jetë po aq i konsiderueshëm sa edhe vetë gjykimet e Islamit.

Por që të arrihet kjo gjë duhet patjetër një bashkëpunim i ngushtë ndërmjet specialistëve shkencorë apo socialë me dijetarët e Islamit, në mënyrë që të qartësohet gjykimi i tij për këto çështje.

Pa dashur shumë prej njerëzve bijnë pre e laikëve, të cilët duan ta mbajnë Islamin larg nga sferat e tjera të jetës. Për këtë ata ndikohen nga pasojat negative, që pati shoqëria nga ndikimi i kishës kur kishte pushtetin. Në fakt ka edhe prej tyre që janë të vetëdijshëm, se Islami nuk është aspak në nivelin e kishës. Madje ata e dinë shumë mirë se Islami jep zgjidhjet më të drejta për çdo aspekt të jetës. Mirëpo kjo gjë bie ndesh me interesat e tyre afatshkurtra apo afatgjata në sundimin padrejtësisht dhe përfitimin prej abuzimit të tyre me popullin. Këtë gjë Islami e ndalon rreptësisht.

*E treta: Konsiderata për dijetarët.*

Kjo konsideratë duhet të vijë si pasojë e përmbajtjes së tyre ndaj Islamit dhe Jurisprudencës së tij, por jo vetëm kaq. Ajo duhet të vijë edhe në bazë të devotshmërisë së këtij dijetari. Mirëpo disa njerëz marrin ose jo për bazë një dijetar të caktuar vetëm nga gjykimet e një dijetari tjetër ndaj tij. Kjo në fakt është e ndaluar. Shembull për këtë kemi dijetarët e mëdhenj të Islamit si: Imam Ahmed Ibën Hambeli, Ibën Tejmije, Muhamed Ibën Abdul Uehab,<sup>(170)</sup> [Allahu i mëshiroftë] etj, të cilët në kohën e tyre nuk arritën të triumfonin me mendimet e tyre për shkak të pushtetit, apo presioneve që iu bëheshin. Më në fund Allahu i Madhëruar i dha vlerë diturisë së tyre, duke i bërë ato mendime të nderuara nga muslimanët në të gjitha kohët.

<sup>(170)</sup> - Muhamed Ibën Abdul Uehab, ky dijetar jetoi dhe veproi në zonën që sot njihet si Arabia Saudite. Ai konsiderohet themeluesi i lëvizjes vehabite (edhe pse këtë emër ia vendosën më vonë studiuesit perëndimorë). Gjithsesi si meritë e punës së tij ishte që e pastroi zonën e Arabisë nga idhujtaria, që kishte mbuluar shoqërinë muslimane të kohës. Kryesisht kjo lëvizje pati si qëllim purifikimin e besimit të muslimanëve në besimin në një Zot të vetëm (Allahu i Madhëruar), duke mos bërë ndaj Tij idhujtari të asnjëlloj forme. ( lindi në vitin 1115 Hixhri dhe ndërroi jetë në vitin 1206 Hixhri). (sh.p).



*E katërta: Konsiderata e pjeshme.*

Disa njerëz mendojnë se tashmë ka ikur koha kur merreshin për bazë mendimet e dijetarëve për të gjitha çështjet. Tani shumë më e përshtatshme do të ishte marrja e mendimit nga ftuesit islamë, të cilët janë në terren. Ose mund të jenë të përshtatshëm mendimet e liderëve të sotëm apo të elitës së pasur të vendit. Mirëpo kjo do të sillte një abuzim me të drejtat e Islamit ndaj shoqërisë. Pasi ngushtohet fusha në të cilën Islami jep zgjidhjet e duhura. E siç kemi thënë më lart Islami është feja e Allahut të Madhëruar dhe është gjithëpërfshirëse për çdo aspekt të jetës.

*E pesta: Marrja e diturisë teorike.*

Dijetarët në fakt nuk duhet të merren në konsideratë vetëm për diturinë e tyre teorike. Të ndjekësh një dijetar do të thotë të marrësh shembull prej tij në mënyrën e tij të jetesës. Të marrësh për bazë jo vetëm fjalët dhe mendimet e tij, por edhe sjelljen e tij.

Ibën Sirini<sup>(171)</sup>, [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Njerëzit në kohën e dijetarëve të hershëm të Islamit mësonin prej dijetarëve edhe sjelljen ashtu siç mësonin diturinë e tyre.<sup>(172)</sup>

---

<sup>(171)</sup> - *Ibën Sirini*, lindi në vitin 33 Hixhri (653 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 110 Hixhri (729 Diellor).

Ishte lider i kohës së vet në shkencat e fesë në Basra. I ati i tij pati qenë skllav i Enesit [Allahu qoftë i kënaqur me të!] që e kishte liruar atë me kontratë pagese. Ai është nga Tabi'inët dhe nga autorët më të nderuar të përpilimeve fetare, bartës i titullit dijetar i Islamit. Ai lindi në Basra, në kohën e qeverisjes së Umarit [Allahu qoftë i kënaqur me të!], jetoj rreth tetëdhjetë vite dhe ndërroi jetë po në Basra. Për fizionominë e tij kanë thënë se ai ka qenë me probleme në të dëgjuar, i shkurtër, barkmadh, i ndante flokët, bujar dhe bënte shaka e qeshte shumë në bisedat me njerëzit, por kur fliste për fenë ai vrenjtej dhe rrudhej. Ai përshkruhet se ka qenë unik, mendjemprehtë, i devotshëm dhe i përmbajtur. Pati pësuar disa probleme, ndër të cilat edhe në mallin që tregtonte, gjë e cila e zhyti në borxh dhe bëri që të bjerë dhe në burg. Gjithashtu thuhet se ai merrte gusël për çdo ditë dhe kishte shumë vesvese në abdes. Tregohet se kur në prani të tij përmendej vdekja, çdo gjymtyrë e tij bëhej si e vdekur. Njerëzit e donin shumë atë dhe pamja e tij i kujtonte ata me fenë e Allahut të Madhëruar. Ai vlerësohet se kishte njohuri të gjera në diturinë e trashëgimisë (El-Faraid) dhe në çështjet penale. Ai jetoj me tridhjetë prej sahabëve. Ai u bë dijetar në fikh dhe në transmetimin e hadithit. Ai ishte i shquar për devocionin e tij, agjëronte një ditë po dhe një ditë jo. Gjithashtu ai ishte i shquar edhe për interpretimin e tij të ëndrrave. Atij i përkatësohet libri "Teabiru er Ru'je" sikurse e përmend këtë fakt Ibën Nedimi dhe ky libër nuk ka të bëjë me botimin

## Ixhmai (unanimiteti i mendimit të dijetarëve)

Nëse për një çështje të caktuar do të kishte unanimitet në mendimin e dijetarëve, edhe pse gjykimi për atë çështje nuk është përmendur në Kuran apo Sunet, kjo konsiderohet e vlefshme në Islam, madje është një prej burimeve kyësore të Islamit, i cili quhet Ixhmai (Unanimiteti).

Dijetarët e kanë cilësuar Unanimitetin e tyre si: Dakordësia e të gjithë dijetarëve, ose e pjesës dërrmuese të tyre për një çështje të caktuar, në një kohë të caktuar.<sup>(173)</sup>

Për vlefshmërinë e Ixhmit ka argumente, edhe nga Kurani, edhe nga Suneti i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*): Nga Kurani:

- Ixhmai, Rruga e besimtarëve

وَمَنْ يُشَاقِقِ الرَّسُولَ مِنْ بَعْدِ مَا تَبَيَّنَ لَهُ الْهُدَىٰ وَيَتَّبِعْ غَيْرَ سَبِيلِ الْمُؤْمِنِينَ نُوَلِّهِ مَا تَوَلَّىٰ  
وَنُصَلِّهِمْ جَهَنَّمَ وَسَاءَتْ مَصِيرًا ﴿٥٧﴾

me titull "Muntekhabu el Kelam fi Tefsiri el Ehlam", që ia kanë përkatësuar Ibën Sirinit, por që s'është i tij [Shih: "El Ea'lem" me autor Ez Zirikliu (i cili ndërroi jetë në vitin 1396 Hixhri) dhe "Sijaru Ealemi en Nuebelei" me autor Edh-Dhehebiu (i cili ndërroi jetë në vitin 748 Hixhri)]. Në "Ruetu et-Tehdhijbejni: ("Tehdhibul Kemali fi Esmei er Rixhali", me autor El-Mezziun (ndërroi jetë në vitin 742 Hixhri) dhe "Tehdhibu et-Tehdhib", me autor Ibën Haxher el-Askalanin (ndërroi jetë në vitin 852 Hixhri) vjen: "Ai është shtresa e tretë, që i takon gjeneratës së mesit të "Tab'i'ineve - gjeneratës pas sahabëve". Ibën Haxheri në lidhjen me gradën e autoritetit të tij në hadith thotë: Ai është i besueshëm, me shumë vlera dhe nuk ishte pro transmetimit të hadithit me kuptim. Ndërsa Edh-Dhehebiu thotë për të: Ai ishte i besueshëm, argument, një prej krerëve të diturisë, me dituri të madhe. (sh.p.).

<sup>(172)</sup> - Imam Ibën Khatib El-Bagdadi, "Xhemiu Ehlak er-Raui ue Edab es-Semiu", faqja: 79.

<sup>(173)</sup> - Imam El- Emedij, "Ihkam el-Ehkam", vëllimi: 1, faqja: 196.



“Këdo që e kundërshton të Dërguarin, pasi i është dhënë udhëzimi dhe ndjek rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve, Ne e lëmë të ecë andej nga është nisur dhe do ta përcëllojmë në zjarrin e Xhehenemit; eh, sa vendbanim i keq që është ai!”  
*Kuran: En-Nisa, 115*

Ky ajet Kurani është argumentimi më i qartë që i referohen dijetarët, në lidhje me argumentimin e Ixhma-it (Unanimitetit). Argumentimi këtu është në termin ‘Ruga e besimtarëve, e cila vjen menjëherë pas rrugës së Pejgamberit (paqja qoftë mbi të). Sikur kjo të mos ishte detyrim për të gjithë njerëzit, atëherë nuk do të jepej një dënim i tillë.

- Parametri matës i shoqërisë njerëzore.

وَكَذَلِكَ جَعَلْنَاكُمْ أُمَّةً وَسَطًا لِتَكُونُوا شُهَدَاءَ عَلَى النَّاسِ وَيَكُونَ الرَّسُولُ عَلَيْكُمْ  
شَهِيدًا ... ﴿١١٣﴾

“Kështu, Ne ju kemi bërë një bashkësi të drejtë, që të bëheni dëshmitarë përmbi njerëzit dhe që i Dërguari të jetë dëshmitar përmbi ju.”  
*Kuran: El-Bekare, 143*

Ky ajet argumenton faktin se Umeti musliman është parametri matës i zhvillimit të shoqërisë njerëzore. Sa më afër të jetë njerëzimi ndaj vlerave të Umetit musliman aq më afër perfeksionimit janë.

- Umeti musliman është kulmi i zhvillimit të shoqërisë njerëzore

كُنْتُمْ خَيْرَ أُمَّةٍ أُخْرِجَتْ لِلنَّاسِ تَأْمُرُونَ بِالْمَعْرُوفِ وَتَنْهَوْنَ عَنِ الْمُنْكَرِ وَتُؤْمِنُونَ  
بِاللَّهِ ۗ وَلَوْ أَمَنَ أَهْلُ الْكِتَابِ لَكَانَ خَيْرًا لَهُمْ ۚ مِنْهُمْ الْمُؤْمِنُونَ وَأَكْثَرُهُمُ  
الْفَاسِقُونَ ﴿١١٤﴾

“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun.”

*Kuran: Ali Imran, 110.*

Këtu Allahu i Madhëruar e cilëson Umetin Musliman, si populli më i mirë që ka dalë ndonjëherë për njerëzimin. Këtë vlerë ata e arrijnë atëherë kur urdhërojnë në punë të mira dhe ndalojnë nga e keqja. Mirëpo vetëm këto dy faktorë nuk mjaftojnë për të qenë më të mirët e njerëzimit. Patjetër këta reformatorë të shoqërisë duhet të kenë edhe besimin e drejtë tek Allahu i Madhëruar.

Sigurisht që ka edhe të tjerë faktorë që Umeti musliman duhet të plotësojë për të qenë në lidhshpirtin e botës. Ndër këta faktorë është edhe Unanimiteti i Umetit Musliman. Ndër argumentet që referohen nga Kurani janë edhe këto ajete:

وَأَعْتَصِمُوا بِحَبْلِ اللَّهِ جَمِيعًا وَلَا تَفَرَّقُوا ... ﴿١١٣﴾

“Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani!”

*Kuran: Ali Imran, 103.*

Gjithashtu edhe ajeti:

وَمِمَّنْ خَلَقْنَا أُمَّةً يَهْتَدُونَ بِالْحَقِّ وَبِهِ يَعْدِلُونَ ﴿١٨١﴾

“Ndërmjet atyre që kemi krijuar, ka njerëz që i udhëzojnë të tjerët në rrugën e vërtetë dhe gjykojnë drejt.”

*Kuran: El-E'araf, 181.*

Gjithsesi më shumë e përkufizojnë çështjen e Unanimitetit të Umetit musliman edhe këto hadithe të Pejgamberit (paqja qoftë mbi të): “{Allahu



nuk lejon që Umeti im të unifikohet në padrejtësi. Dora e Allahut është mbi bashkësinë. Ai që veçohet nga uniteti do të jetë i veçuar në zjarr}”.<sup>(174)</sup>

“{Kush ndahet një pëllëmbë prej unitetit të bashkësisë, vdes si xhahil (inJORANT)}”.<sup>(175)</sup>

“{Kush do të shijojë aromën e Xhenetit le të përqendrohet me unitetin e bashkësisë}”.<sup>(176)</sup>

Nga këto argumenta vërtetohet se uniteti i Umetit musliman është i mbrojtur nga Allahu i Madhëruar dhe nuk mundet të jetë në rrugë të gabuar në tërësinë e tij. Gjykimi i dalë si rezultat i hulumtimeve nga një numër i madh dijetarësh është shumë më i fortë, se gjykimi i dhënë për të njëjtën çështje nga një dijetar i vetëm. Në kohët tona ka institucione kërkimore, të cilat merren me hulumtimet shkencore në fusha të ndryshme dhe gjykimet e Islamit mbi to.

---

<sup>(174)</sup> - E përcjell Tirmidhiu, numri i hadithit: 2255, Imm Ibën Ebi Asimi, numri i hadithit: 80, Imam El-Lalakai në librin e tij “Sherh Usul el-Itikad”, vëllimi: 1, faqja: 106. Hakimi, vëllimi: 1, faqja: 115-116. Tabarani, Dhilal el-Xheneh fi tehrixh es-Suneh”, vëllimi: 1, faqja: 40. Imam Albani thotë që ky hadith është i saktë [sahih].

<sup>(175)</sup> - Po aty.

<sup>(176)</sup> - Po aty.





## **PJESA E DYTË**

**Parime në sjelljet me dijetarët**



## Kapitulli i parë: Dashuria për Dijetarët.

Dashuria dhe urrejtja janë prej bazave të Islamit. Është ndër kushtet e Dëshmisë së madhe: La, Ilahe Il Allah, Muhamedun Resul Allah (*Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut, i Cili e meriton me të drejtë, që të adhurohet dhe i denjë për adhurim dhe se Pejgamberi Muhamed është i dërguari i Tij.*

Për këtë bazë të Islamit janë të shumta argumentet që e vërtetojnë. Aq sa Dijetari Hamd bin Atik (1227-1301 Hixhri), [Allahu e mëshiroftë] do të thoshte: Pas argumenteve të Njehsimit të Allahut të Madhëruar dhe rrezikut të mohimit të këtij Njehsimi, argumentet më të qarta dhe më të shumta janë për çështjen e dashurisë dhe urrejtjes.<sup>(177)</sup>

Është e natyrshme se Dashuria kryesore i takon Allahut të Madhëruar, pas Tij i takon Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) dhe pas tij të gjithë Pejgamberëve të tjerë të Allahut të Madhëruar. Por menjëherë pas tyre dashuria i takon dijetarëve, që siç e cituam më lart janë trashëgimtarët e diturisë së Pejgamberëve (*paqja qoftë mbi ta*).

Është detyrim për çdo besimtar, që të dojë Allahun e Madhëruar, pastaj Pejgamberin Muhamed (*paqja qoftë mbi të*), pastaj të dojë besimtarët. Në mënyrë të veçantë prej besimtarëve duhet të dojë më të mirët e tyre, të cilët janë dijetarët. Ata, të cilët Allahu i Madhëruar i ka bërë si yjet në qiell, udhëzues për njerëzimin.<sup>(178)</sup>

Dijetarët e hershëm e konsideronin dashurinë dhe respektin ndaj dijetarëve si një vlerë me të cilën masnin devotshmërinë e njerëzve.

Ibën El-Medeni (ndërroi jetë në vitin 178 Hixhri) [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Nëse do të gjykosh ndaj një njeriu nga Basra, atëherë shiko se sa e nderon dhe i respekton Ejub Al Sahtijanin (68-131 Hixhri), Ibën Auen (66 -

<sup>(177)</sup> - Imam Ibën Atijk El-Hanbeli, "Sebil Nexhah ue el-Fekak", faqja: 31.

<sup>(178)</sup> - Shejkh El-Islam Ibën Tejmije, "Refau el-Melam an-Eimet el-E'alam", faqja: 11.

151 Hixhri), Junusin dhe Tejmin <sup>(179)</sup>. Nëse ndjek ata dhe i nderon, atëherë prej këtij njeriu pritet mirësi. Njësoj është edhe me njerëzit e Kufas. Nëse sheh dikë që e nderon dhe është ndjekës i Talha bin Musrifit (ndërroi jetë në vitin 112 Hixhri), Ibën Ebxherit, (101-196 Hixhri), Ebi Hajan Tejmit (113-194 Hixhri), Malik Ibën Mogolin (ndërroi jetë në vitin 195 Hixhri), Sufjan Eth-Theuriu (97-161 Hixhri), atëherë edhe prej këtij pritet mirësia.<sup>(180)</sup>

Imam Et-Tahaui<sup>(181)</sup> [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Dijetarët e hershëm, por edhe të mëvonshëm duhet të përmenden vetëm për mirë. Ai që nuk vepron kështu është jashtë rrugës së drejtë.<sup>(182)</sup>

Dashuria ndaj dijetarëve nuk duhet ta çojë njeriun deri në ekstrem, duke u armiqësuar me këdo që kundërshton filan dijetar, apo fjalët e tij. Kjo lejohet vetëm në rastin e Allahut të Madhëruar dhe Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) të Tij. Për këtë arsye çdo fanatizëm në lidhje me dijetarët pavarësisht kush janë ata është rreptësisht e ndaluar.

Ibën Tejmije [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Ai që bëhet ndjekës i verbër ndaj dikujt, e do dikë, apo e urren dikë tjetër vetëm prej hatrit të dikujt, atëherë ky

<sup>(179)</sup> - Junusi dhe Tejmini, Dijetarë të Basras bashkëkohës të Ibën El-Medenit, Junus bin Abid (ndërroi jetë në vitin 140 Hixhri), Sulejman Et-Tejmi (ndërroi jetë në vitin 143 Hixhri). (Sh.p).

<sup>(180)</sup> - Transmetuar nga Imam El-Lalakai, "Sherhu Usuli Itikadi ehli Suneh uel Xhemaah", vëllimi: 1, faqja: 171.

<sup>(181)</sup> - Et-Tahaui, lindi në vitin 238 Hixhri (852 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin e 321 Hixhri (933 Diellor). Dijetar i madh i hadithit, dijetar i shquar i fikhut, i njohur përmes përpilimit të tij "El-Akide et-Tahauie". Studioi fikhun Shafi'i përmes dajës së tij El-Muzeniut, kolegut të imam Shafi'ut. Pastaj u kthye në medhhebin e Ebu Hanifes, duke marrë mësimet e fikhut nga dijetar i madh i fikhut hanefi Ahmed ibën Ebi Imran. Ai udhëtoi në Sham dhe mori leksione hadithi në Bejtul Makdes, Gazë, Askalan dhe Damask, ku e studioi fikhun përmes Ebi Hazmit Abdulhamid Ibën Abdulazizi. Pastaj u kthye në Egjipt, ku kryesoi kolegjiun e Ebu Hanifes në Egjipt. Ai ka transmetuar nga Junus ibën Abdu El-Eale, Harun Ibën Seaid El-Ejliu, Muhamed Ibën Abdullah Ibën Abdulhakimi, Ibrahim Ibën Ebi Daudi Ed-Darisiu dhe të tjerë veç tyre. Prej tij ka transmetuar djali i tij Aliu, Sulejman Ibën Ahmed Et-Tabaraniu etj. Përpilimet e tij janë të shumta, prej të cilave përmendim: "Sherhu Meani El-Etheri", "Mushkilu el Etheri", "Ikhtilafu El-Fukahei", "El-Mukhtesar fi el-Fikhi", "El-Akide et-Tahauie", "Ehkemu el-Kurani", "El-Usaja" "El Muhadir ue es-Sexhelet", etj. Ai u varros në Egjipt". (sh.p.).

<sup>(182)</sup> - Imam Ibën Ebij Iz, "Sherh el-Akide et- Tahavije", vëllimi: 2, faqja: 740.



do të jetë prej atyre të cilët Allahu i Madhëruar i ka cituar në Kuran, si: "Përçarës të fesë."<sup>(183)</sup>

Nëse dikush respekton diturinë e bashkë me të edhe nderimin ndaj mësuesve të tij, kjo nuk duhet ta bëjë atë që fjalën e mësuesve të tij ta ketë si njësi matëse ndaj njerëzve të tjerë. Patjetër që njeriu duhet të mësojë diturinë dhe bashkë me të edhe mençurinë dhe të jetë i thellë në gjykimet e tij.

Në fakt dobësitë e zemrës dalin në pah në kohë trazirash dhe problemesh. Në këto momente njeriu i ditur nuk duhet të gjykojë në bazë të qëndrimeve të shokëve apo mësuesve të tij. Por duhet të ketë si parim në gjykim sinqeritetin me Allahun e Madhëruar dhe përmbajtjen ndaj urdhëresave të Tij, pasi kjo është devotshmëria e vërtetë.<sup>(184)</sup>

Kështu nuk duhet që asnjë besimtar i sinqertë ta teprojë në dashurinë e tij me mësuesit e vet. Mësuesi apo dijetari respektohen për thellimin e tyre në dituri, për devotshmërinë dhe vënien në jetë të kësaj diturie dhe sigurisht edhe për mësimdhënien e tij dhe edukimin që jep tek nxënësit e vet.

Përsëri Ibën Tejmije [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Çdokush duhet t'i dojë dijetarët, por askush nuk duhet t'i japë dikujt përparësi ndaj dikujt tjetër. Kjo lejohet vetëm sipas devotshmërisë së tyre dhe shërbimit të tyre në shoqëri. Pikërisht këto dy parametra janë ato të përdorura nga Allahu i Madhëruar dhe i Dërguari i Tij (paqja qoftë mbi të) në vlerësimin e njerëzve.<sup>(185)</sup>

Ndjekja dhe fanatizmi i verbër ndaj dijetarëve është shkak për përçarjen e umetit musliman. Ky ka qenë shkak në fakt që shumë prej sekteve kanë devijuar nga Islami. Është kjo që shumë dijetarë nuk arrijnë ta vërejnë edhe në ditët tona. Kënaqen me ndjekësit e tyre dhe e bëjnë këtë qëllim të punës së tyre.

Muslimani nuk mund ta vendosë dashurinë dhe urrejtjen në peshore, nëse në krahun tjetër të saj nuk është Kurani dhe Suneti.

Ibën Tejmije [Allahu e mëshiroftë] në një tjetër vend në shkrimet e tij ka thënë: Nuk i takon askujt të thërrasë në rrugën e filan dijetari apo dikujt tjetri. Rruga e vetme në të cilën duhet të ftojme është rruga e Allahut të Madhëruar dhe e Pejgamberit të Tij. Nuk duhet të gjykojë në bazë të fjalëve apo

---

(183) - Kuran: En`amë, 159.

(184) - Shejkh El-Islam Ibën Tejmije, "El Fetaua", vëllimi: 20, faqja: 8-9.

(185) - Po aty, vëllimi: 11, faqja: 512.



shembullit të dikujt, vetëm nëse këto fjalë janë të Allahut të Madhëruar apo Pejgamberit Muhamed (*paqja qoftë mbi të*) në fjalët dhe veprat e tij, ose të unanimitetit (Ikhma-it) të dijetarëve të Umetit Musliman. Nga ana tjetër, ata që e bëjnë këtë gjykim jashtë këtyre parametrave janë njerëz të grupeve të devijuara. Janë ata që kanë qenë shkaktarë që Umeti Musliman të përçahet dhe të mos gjejë shpeshherë paqe.<sup>(186)</sup>

Atëherë kur dashuria e dikujt ndaj dijetarit të tij të arrijë e të teprohet ajo shndërrohet në shenjtërim. Atëherë njeriu e ngre njeriun aty ku ky i fundit nuk e meriton dhe kjo gjë bëhet shkak, që të gjitha veprat e mira t'i shndërrohen në asgjë.

Por nëse kjo dashuri do të jetë në mënyrë të përmbajtur dhe brenda kufijve të njerëzores, atëherë të tilla fenomene nuk do të ndodhnin. Nuk do të vihej në plan të parë dashuria ndaj njeriut, më shumë se sa dashuria ndaj diturisë së tij dhe metodologjisë me të cilën ai punon. Këtu çështja shkon aq sa jo të gjithë mund të arrijnë ta bëjnë dallimin. Gjithsesi vetëm Allahu i Madhëruar mund t'i ruajë të devotshmit ndaj këtyre problemeve me dashurinë apo urrejtjen.<sup>(187)</sup>

Në porosinë e tij ndaj nxënësve të Udej Ibën Musafirrit (ndërroi jetë në vitin 555 Hixhri), Ibën Tejmije [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Është obligim që t'i japim përparësi, vetëm atij që Allahu i Madhëruar i ka dhënë përparësi dhe i dërguari i Tij Muhamedi [*paqja qoftë mbi të*]. Njeriu duhet të dojë atë që Allahu i Madhëruar e dëshiron dhe i Dërguari i Tij (*paqja qoftë mbi të*) dhe të urrejë atë që e urren Allahu i Madhëruar dhe i Dërguari i Tij (*paqja qoftë mbi të*). Kështu muslimanët do të jenë të bashkuar si një dorë e vetme në gjykimin e tyre ndaj të mirës dhe të keqes.<sup>(188)</sup>

Kështu, dashuria, urrejtja, pëlqimi apo mospëlqimi, dhënia përparësi apo mosdhënia duhet të bëhen vetëm për hir të Allahut të Madhëruar.

Ka ndodhur që dikush nuk i është përmbajtur hatrit të Allahut të Madhëruar, apo ka dashur dikë, duke e vlerësuar me parametra të tjerë. Mirëpo ka patur edhe prej tyre të devotshëm ndaj Allahut të Madhëruar dhe kanë zgjedhur të kënaqin Allahun e Madhëruar dhe kjo jo përherë ka qenë në interesin e ndjekësve të tyre. Kështu këta të fundit kanë filluar t'i urrejnë këta dijetarë.

(186) - Po aty, vëllimi: 20, faqja: 164.

(187) - Imam Sulejman El-Gisn "Itibau el-Heua", faqja: 40-43.

(188) - Shejkh El-Islam Ibën Tejmije, "El-Uasijetu el-Kubra", faqja: 117.



Rast për këtë kemi historinë e Abdullah Ibën Abdu Selamit, dijetarit hebre, i cili zgjodhi të konvertohej në Islam. Ai e dinte se populli i tij (hebrenjtë) janë popull i keq dhe mosmirënjohës. Ai i thoshte Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*): Nëse ata do ta marrin vesh se unë jam bërë musliman do të më keqtrajtojnë dhe do të më mohojnë. Prandaj dërgo fillimisht njerëz tek ata dhe le të pyesin për mua. Kështu bëri edhe Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*), i cili çoi fjalë të pyesnin për Abdullah Ibn Selamin<sup>(189)</sup>. Përgjigjet ishin shumë mbresëlënëse. "Ai është dijetari jonë dhe bir i dijetarëve tanë. Më i dituri në mesin tonë ashtu siç ka qenë më parë edhe babai i tij." I pyetën: - Si mendoni, nëse ai do të pranojë Islamin, a do të bëni edhe ju njëjtën gjë?- Hebrenjtë thanë: Zoti e ruajtë Allahun nga kjo gjë. Atëherë Abdullahu doli para tyre në prezencën e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) dhe dëshmoi se: - Nuk ka zot tjetër veç Allahut, i Cili e meriton me të drejtë që të adhurohet dhe i denjë për adhurim, dhe se Muhamedi është Pejgamber i Tij. Hebrenjtë atëherë thanë: Ky është më i keqi mes nesh. Biri i më të keqit. I padituri, biri i të paditurit. Aty Abdullahu i tha Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*): O i Dërguari i Allahut, a nuk të thashë, që këta janë popull i keq?<sup>(190)</sup> - Hebrenjtë menjëherë patën reagim të kundërt ndaj Abdullah ibn Selamit, sepse ata në fakt nuk kishin si referencë në qëndrimet e tyre sinqeritetin me Allahun e Madhëruar dhe as hatrin e Tij. Ata i vlerësonin njerëzit me standartet e interesave të tyre.

Kështu ka ndodhur edhe me një njeri nga Bagdadi, i cili quhej Bishr el Murijsi (ndërroi jetë në vitin 218 Hixhri). Ky pasi bëri Haxhin u ndikua shumë nga dijetari i njohur Imam Shafiiu [Allahu e mëshiroftë] dhe kur u kthye në vendin e tij i lajmëroi njerëzit për çfarë kishte parë me sytë e tij nga dituria e thellë e Imam Shafiiut. Kur dijetari i nderuar vizitoi Bagdadin dhe sipas vendit ku ishte dha edhe gjykimet e tij të famshme, Bishri i inatosur ngaqë kjo nuk i vinte për shtat atij dhe interesave të tij, tha: - Jo, ky nuk është Shafiiu për të cilin ju kam

---

(189) - *Abdullah Ibën Selam*, Sahab [shok] i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Ishte ndër dijetarët e njohur të izraelitëve që jetonin në Medine dhe më i respektuari prej tyre. Në historinë më sipër bëhet fjalë për reagimin e izraelitëve ndaj konvertimit të tij në Islam. Ndërroj jetë në vitin 43 Hixhri. (sh.p).

(190) - Imam El-Bukhari, vëllimi: 4, faqja: 102, dhe vëllimi: 4, faqja: 268. Ahmed, vëllimi: 3, faqja: 108 dhe faqja: 211.

folur. - Në fakt historia e tij merret si paralele me historinë e Abdullah Ibën Selamit me popullin e tij.<sup>(191)</sup>

---

<sup>(191)</sup>- Imam Ebu Bekr Khatib El-Bagdadi, "Tarikhu Bagdad", vëllimi: 2, faqja: 65; Imam Ibën Asakir në librin e tij, "Tarikhu", vëllimi: 14, faqja: 412, e ka përmendur këtë histori, gjithashtu edhe Imam Edh-Dhehebi në Sijar Ealam en-Nubela, vëllimi: 1, faqja: 44-45.



## Kapitulli i dytë: Respekti dhe vlerësimi i Dijetarëve.

Është porosi e Allahut të Madhëruar, që njerëzit t' i respektojnë dhe vlerësojnë dijetarët e tyre. Pejgamberi Muhamed [Paqja qoftë mbi të] thotë: “{Nuk është prej nesh, ai që nuk e mëshiron të voglin tonë, apo që nuk respekton të madhin, apo që nuk nxit në të mirë e nuk ndalon nga e keqja, ose që nuk e respekton dijetarin tonë}”.<sup>(192)</sup>

Dijetari i njohur Tavus bin Kejsani (ndërroi jetë në vitin 106 Hixhri) [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Është prej Sunetit të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*), të nderohen katër kategori njerëzish. Dijetarët, të moshuarit, prijësat dhe prindërit.<sup>(193)</sup>

Nderimi i dijetarëve duhet më shumë për shkak të diturisë që kanë, Njohjes së Librit të Allahut të Madhëruar dhe devocionit që kanë ndaj Tij.

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) ka thënë: “{Nderimi i Allahut është edhe duke e nderuar të moshuarin musliman, Njohësin e Kuranit që i jep hakun atij, gjithashtu edhe nderimi i prijësit të drejtë}”.<sup>(194)</sup>

Sahabët [shokët] e Pejgamberit na tregojnë shembuj të lartë të nderimit të tyre që i bënin dijetarëve. Kështu Abdullah Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij), edhe pse vetë ishte një det me dituri ai e respektonte aq shumë Zejd Ibn Thabit El-Ensariun<sup>(195)</sup> (Allahu qoftë i kënaqur prej tij), sa i mbante frerët

---

<sup>(192)</sup> - Transmetuar nga Imam Ahmedî në “Musned” vëllimi: 1, faqja: 257. Tirmidhiu në “Sunen” vëllimi: 3, faqja: 215-216, ky hadith është cilësuar si i saktë [sahih] nga Imam Ibën Hibani.

<sup>(193)</sup> - Cituar nga Imam El-Begaiiu në “Sherh es-Suneh”, vëllimi: 13, faqja: 43.

<sup>(194)</sup> - Transmetuar nga Ebu Daudi në “Sunen” numri i hadithit: 4843. Imam Neuevuii, Dhehebi, Ibën Haxher El-Askelani dhe El-Iraki e kanë cilësuar si hadith hasen [të mirë]. Referohu edhe tek Begaiiu në “Sherh es-Suneh”, vëllimi: 13, faqja: 42.

<sup>(195)</sup> - Zejd Ibën Thabit El-Ensarij, Sahab [shok] i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Lindi 11 vjet parë Hixhretit të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Ndërroi jetë në vitin 45 Hixhri. (sh.p).

e kalit të tij, duke i thënë: “Kështu jemi urdhëruar të bëjmë me dijetarët tanë dhe njerëzit tanë të rëndësishëm.”<sup>(196)</sup>

Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) gjithashtu na tregon sesi një ditë kishte qenë duke hulumtuar në një çështje dhe për këtë kishte pyetur shumë nga sahabet e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Ai thotë: Sa herë që dëgjoja se dikush nga Sahabet kishte dëgjuar një hadith prej Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*), i shkoja në shtëpi, ulesha në verandën e tij dhe rrobat e mia bëheshin me pluhur para derës së tij duke pritur derisa të dilte. Kur dilte më thoshte: O Biri i xhaxhait të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) çfarë po pret këtu?!...- Dhe unë i thosha: -Kam marrë vesh, se ti ke dëgjuar një hadith nga Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*), për këtë arsye jam këtu, që të ma transmetosh këtë.- Ai më thoshte: -Po pse nuk dërgove dikë, që të më lajmëronte për këtë dhe vija unë tek ti!- Ndërsa unë i thosha: Jo, më takon mua të vij tek ti.<sup>(197)</sup>

Imam Ahmed Ibën Hambeli [Allahu e mëshiroftë] i ka thënë Khalef El-Ehmerit (i cili ndërroi jetë në vitin 180 Hixhri): Do të qëndroj i ulur përpara teje, sepse jemi urdhëruar t`i nderojmë ata që na mësojnë.<sup>(198)</sup>

Kur Imam Muslimi<sup>(199)</sup> shkoi të takojë Imam Buhariun, e puthi në ballë dhe i tha: Lërmë të të puth këmbët o mësues i mësuesve, o zotëria i muhadithinëve...<sup>(200)</sup>, o korrektues i transmetimit të referencave tona...<sup>(201)</sup>

<sup>(196)</sup> - Transmetuar nga Hakimi, vëllimi: 3, faqja: 423, i cilësuar si transmetim i saktë [sahih] nga Imam Edh-Dhehebi. Po ashtu e ka transmetuar edhe Ibën Abdul Berr në “Xhemiu Bejan El-Ilm”, vëllimi: 1, faqja: 228. Khatib El-Bagdadi “El-Xhamiu li Ehlak er-Rauij ue Edeb es-Sami”, vëllimi: 1, faqja: 189. Ibën Haxher El-Askalani, “El-Isaba”, vëllimi: 4, faqja: 42. Hajthemi “El-Mexhma”, vëllimi: 9, faqja: 345.

<sup>(197)</sup> - Imam Ibën Abdul Berr në “Xhemiu Bejan el-Ilm”, vëllimi: 1, faqja: 86.

<sup>(198)</sup> - Imam Ibën El-Xhemah, “Tedhkiretu es-Semia uel Mutekelim”, faqja: 88.

<sup>(199)</sup> - *Muslimi*, lindi në vitin 194 Hixhri (810 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 256 Hixhri (870 Diellor).

Është imami hafëz (memorizues), argument, përpilues i shquar në hadith dhe shkencat e tij, autor i “El-Xhemi es-Sahih”. Ka lindur dhe ka vdekur në Nejsibur. Ka përfutur shumë prej imam Ahmed Ibën Hanbelit dhe El-Buhariut. Ka udhëtuar në Hixhaz (Arabi), Egjipt, Sham dhe Irak. Është takuar me një sërë dijetarësh prej të cilëve Is’hak Ibën Rahuejhin, Zuhejr Ibën Harbin, Ebu Bekër Ibën Shejben, Ali El-Mediniun dhe Muhamed Ibën Jahja El-Kutaiu. Veç këtyre, Edh-Dhehebiu ka përmendur dhjetëra të tjerë kur ka folur për imam Muslimin në përpilimin e tij “Sijeru Ealemi en Nubelei”. Sa i përket atyre që kanë transmetuar prej tij, numri i tyre është vërtetë i shumtë, prej të cilëve përmendim Et-Tirmidhi, Ibrahim Ibën Sufjanin, Ebu Bekër Ibën Khuzejmen, Muhamed Ibën Makhled El-Atarin, etj.



Dijetarët e hershëm të Islamit tregonin një nderim të madh ndaj diturisë dhe të diturve.

Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) tregon se: Kishte hezituuar për dy vjet me radhë, që të pyeste Umerin për kuptimin e një hadithi. Kjo ngaqë i vinte zor prej personalitetit të tij).

Dijetarët kanë folur shumë jo vetëm për diturinë, por edhe për mënyrat e marrjes së saj dhe respektit që duhet treguar ndaj mësuesve. Ata kanë transmetuar shumë porosi, por ndër më të veçantat është kjo porosi e Ali Ibën Ebi Talibit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij), i cili thotë:

- Nuk i takon pyetësit, që ta mërzhitë mësuesin e tij më shumë pyetje.
- As ta ndihmojë atë në përgjigje.
- Nuk i takon as ta bezdisë mësuesin në pushimin e tij.
- Nuk duhet as ta tërheqë nga rrobat, nëse mësuesi ngrihet.
- Nuk duhet të përhapë të fshehtat e tij.
- As të përgojë dikë në praninë e mësuesit të vet.
- Nëse gabon, duhet ta justifikojë mësuesin e vet.
- Duhet ta nderojë dhe ta vlerësojë për hatër të Allahut të Madhëruar.
- Nuk duhet të ulet përballë tij.

---

Ai ishte prej hafëzëve (memorizuesve) më të shquar, aq sa është thënë se memorizuesit në rang bote janë katër: Ebu Zer'a në Raj, Muslimi në Nejsibur, Abdullah Ed-Derimiu në Semarkand dhe Muhamed Ibën Ismaili në Bukhara.

Ai ka shumë përpilime, më i shquari i të cilave është "El-Xhemí es-Sahih", të cilin e ka përpiluar nga 300 000 hadithe të dëgjuar, të tillë që përmban 12 000 hadithe. Ai e shkruajti atë në 15 vjet. Muslimi mbi këtë vepër thotë: "Nuk kam vendosur dhe marrë për bazë në këtë libër timin diçka përveçse me argument dhe nuk kam rrëzuar diçka prej tij përveçse me argument". Ky përpilim është një prej dy autentikëve që janë që të dy ajkë në lëmin e hadithit profetik. Këtë përpilim e kanë shtjelluar shumë autorë. Hafëzi Ebu Ali En-Nejsiburi ka thënë për të: "Nuk ka nën rripin e qiellit libër më të saktë sesa libri i Muslimit". Prej përpilimeve të tij është gjithashtu edhe "El-Musned el Kebir ale er-Rixhal", "Et-Temjiz", "El-Ilel uel Esme-e", "Et-Tabakat", "Euhemu el-Muhadithin", "etj...(sh.p.).

<sup>(200)</sup> - Imam Ibën Kethir në "El-Bidaje ue en-Nihaje", vëllimi; 11, faqja: 340.

<sup>(201)</sup> - Imam Ibën Abdul Berr në "Xhemiu Bejan el-Ilm", vëllimi: 1, faqja: 112.

<sup>(201)</sup> - Po aty: vëllimi: 1, faqja: 129.

<sup>(201)</sup> - Po aty: vëllimi: 1, faqja: 146.



etika e sjelljes ndaj dijetarëve

- Nëse ka nevojë le të jetë i pari që ta ndihmojë mësuesin e vet.
- Ta përshëndesë në mënyrë të veçantë mësuesin e vet.
- Të ulesh me respekt përpara tij.
- Të mos i drejtohesh atij me duar.
- Dhe as të mos bësh shenja të papërshtatshme me sy.
- Të mos i thuash se filani ka thënë ndryshe nga mendimi jot.
- Mos e bezdis pasi ai është si Hurma e butë, prej së cilës ti gjithmonë mund të fitosh nga frytet e saj.



## Kapitulli i tretë: Marrja e diturisë nga dijetarët dhe mundimi i nevojshëm për këtë

Dijetarët janë trashëgimtarët e diturisë së Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*). Nëse dikush don të fitojë diçka nga kjo trashëgimi, atëherë duhet të ulet me dijetarët. Duhet të mësojë prej tyre. Ai që ka këtë qëllim, atëherë Allahu i Madhëruar do t'ia lehtësojë atij rrugën për në Xhenet. Na përcillet nga Ebu Hurejra<sup>(202)</sup>, se Pejgamberi [*paqja qoftë mbi të*] ka thënë: “{Kush zgjedh një rrugë për të marrë dituri, Allahu do t'ia lehtësojë atij rrugën për në Xhenet}”.<sup>(203)</sup>

---

<sup>(202)</sup> - Ebu Hurejra, lindi në vitin 21 para Hixhretit (602 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin e 59 Hixhri (679 Diellor).

Emri i tij është Abdurrahman Ibën Sakhri nga Deusi, me pseudonimin Ebu Hurejra. Ai ishte prej sahabëve që kishin memorizuar dhe transmetuar hadithet më të shumta. Në kohën paraislame ai u rrit i dobët dhe jetim. Kur ai erdhi në Medinë, Pejgamberi [*paqja qoftë mbi të*] ishte në Khajber [qytet në Arabinë Saudite]. Ai e pranoi Islamin në vitin 7 Hixhri. Ai e ndoqi Pejgamberit [*paqja qoftë mbi të!*] dhe transmetoi prej tij 5374 hadithe, të cilat më pas i transmetuan prej tij më se 800 transmetues prej sahabëve dhe tebi'inëve. Ebu Hurejra [Allahu qoftë i kënaqur me të!] i ka mësuar përmendsh më shumë se 1600 hadithe të Pejgamberit [*paqja qoftë mbi të!*] dhe i ka ruajtur ato për popullin islam. Ai gëzonte autoritetin e myftiut dhe dijetar i Islamit Tekiju ed-Din es-Sebki ka koleksionuar një përpilim të cilin e ka titulluar “Fetuat Ebi Hurjera”. Në kohën e injorancës, ai thirrej “Abdu Shems-rob i diellit. Kur atë e udhëzoi Allahu në Islam ai u takua me Pejgamberin [*paqja qoftë mbi të!*], i cili e pyeti: “Si quhesh?” Ai iu përgjigj: - *Quhem Abdu Shems (rob i diellit)*. Pejgamberi i tha: - *Le të quhesh “Abdurrahman-rob i të Gjithëmëshirshmit”*. Shkaku pse është quajtur “Ebu Hurejra-baba i koteles” është sepse ai në fëmijëri kishte një macë të vogël me të cilën luante dhe qysh atëherë moshatarët e tij e thirrën kështu. Pejgamberi i Zotit [*paqja qoftë mbi të!*] shpeshherë e thërriste “Ebu Hirr-baba i maçokut”, ndaj dhe ai e pëlqeu më shumë të quhej “Ebu Hir”. Ebu Hurejra [Allahu qoftë i kënaqur me të!] e pranoi Islamin nëpërmjet Tufejl Ibnu Amrit Ed-Dejlemiut dhe mbeti në tokën e fisit të tij “Deus” edhe gjashtë vjet pas Hixhretit, kur shkoi në Medinë me një grup nga fisi i tij te Pejgamberii [*paqja qoftë mbi të!*]. Djaloshi nga Deusi u vu në shërbim dhe shoqërim të Pejgamberit [*paqja qoftë mbi të!*]. Xhamia ishte vendqëndrimi i tij kurse Pejgamberi [*paqja qoftë mbi të!*] ishte mësuesi dhe imami i tij.

Mësimi nga dijetarët është rruga për të marrë dituri, por edhe për t'u bërë dijetar. Sa më shumë të lodhesh, aq më shumë dijetar do të bëhesh.

Selman El-Faresi <sup>(204)</sup> (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) ka thënë: Njerëzit do të jenë mirë, nëse i madhi do të mësojë dhe pastaj do t'ia përcjellë atë brezit tjetër. Por njerëzit do të prishen nëse të mëdhenjtë shkojnë pa mësuar diçka për vete dhe si rrjedhim pa u lënë asnjë dituri fëmijëve". <sup>(205)</sup>

Ebu Derda (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) i thoshte popullit të tij: Çfarë po ndodh me ju kështu? Shoh se si dijetarët shkojnë ditë pas dite, ndërsa ju mbetët injorantë. Mësoni tani sa ju kanë mbetur gjallë këta dijetarë, se më vonë dituria do të zhduket prej jush me vdekjen e tyre. <sup>(206)</sup>

Abdullah Ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) thoshte: Askush nuk lind i ditur, por dituria vjen me të nxënë. <sup>(207)</sup>

Imam Abdurrahman Ibën Mehdiu (135-198 Hixhri) [Allahu e mëshiroftë] thoshte: Kur dikush prej dijetarëve takohet me një më të ditur se ai, e

Ebu Hurejra [Allahu qoftë i kënaqur me të!] sa ishte gjallë Muhamedi [paqja qoftë mbi të!] nuk pati as grua dhe as fëmijë (nuk vendosi të martohet që t'i përkushtohet shërbimit të Pejgamberit [paqja qoftë mbi të!] dhe mesazhit të tij). Pas një kohe jo të gjatë të mirat vërshuan tek muslimanët dhe Ebu Hurejra [Allahu qoftë i kënaqur me të!] bëri pasuri, shtëpi, katandi, u martua dhe lindi një djalë... Ai të shumtën e jetës së tij e kaloi në Medinë, ku u emërua për një periudhë kohore guvernator, por ky post nuk ndikoi asnjëherë në shpirtbutësinë dhe zemërgjerësinë e tij. Ai agjëronte gjatë ditës dhe falej gjatë një të tretës së natës. Umari [Allahu qoftë i kënaqur me të!] e pati emëruar Ebu Hurejrën [paqja qoftë mbi të!] guvernator të Bahrejnit, por kur pa se ai ishte me karakter të brishtë dhe i preokupuar me adhurim, e hoqi prej kësaj përgjegjësie. Ai ndërroi jetë në fundin e Khalifatit (qeverisjes) së Muauijes [Allahu qoftë i kënaqur me të!] [Shih: "El Ea'lem" me autor Ez-Zirikliu (ndërroi jetë në vitin 1396 Hixhri) dhe "Sueru min Hajati es-Sahabe" me autor Abdurrahman Rafet El-Basha. (sh.p.).

<sup>(203)</sup> - Transmetuar nga Ahmedi në "Musned", vëllimi: 2, faqja: 325. Darimiu në "Sunen" vëllimi: 1, faqja: 83. Ebu Daudi në "Sunen" vëllimi: 3, faqja: 317, Tirmidhiu, "Es-Sunen", numri i hadithit: 2684. Ibën Maxhe, "Es-Sunen", numri i hadithit: 223. El-Begauj "Sherh es-Suneh" vëllimi: 13, faqja: 282. Bukhariu në "Fet'h el-Bari vëllimi: 1, faqja: 169.

<sup>(204)</sup> - Selman El-Faresi, Sahab [shok] i Pejgamberit (Paqja qoftë mbi të). Pranoi Islamit në Medinë në kohën kur muslimanët ishin të rrethuar në luftën e Hendekut. Ishte ai ideatori i teknikës së hapjes së hendekëve. Ndërroi jetë në Medain [qytet në Iran] në vitin 36 Hixhri. (sh.p).

<sup>(205)</sup> - Imam Darimi në librin e tij, "El-Ilm" vëllimi: 1, faqja: 78.

<sup>(206)</sup> - Po aty, vëllimi: 1, faqja: 78.

<sup>(207)</sup> - Transmetuar prej Hafidh Ebu Hejthme në "Kitab el-Ilm", faqja: 28.



konsideronte këtë ditë të suksesshme, pasi do të mësonte prej tij më shumë. Nëse takonte dikë me dituri më pak se vetja e quante atë ditë, si ditë pune, sepse do ta mësonte atë. Nëse takonte dikë, që ishte i barabartë me diturinë e tij e quante ditë shqyrtimi, sepse së bashku arrinin t'i diskutonin dhe shqyrtonin çështjet që dinin duke debatuar.<sup>(208)</sup>

Imam Mejmun Ibën Mehrani (40-117 Hixhri) (Allahu e mëshiroftë) thoshte: Dijetarët janë thesari që kërkoj në çdo vend. Ata janë qëllimi i udhëtimeve të mia. Me praninë e tyre edhe zemra ime përmirësohet.<sup>(209)</sup>

Sahabët dhe Tabiinët qëndronin shumë me të diturit e tyre. Ebu Xhuhejfe (i cili ndërroi jetë në vitin 120 Hixhri) thoshte [Allahu e mëshiroftë]: Ulu me të mëdhenjtë, bëhu mik me dijetarët dhe shoqërohu me njerëzit e mençur.<sup>(210)</sup>

Ebu Derda (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) thoshte: Zgjuarsia e njeriut qëndron në faktin, se sa ai shoqërohet me të diturit.<sup>(211)</sup>

Nxënësi i diturisë duhet të jetë i durueshëm në marrjen e saj. Duhet të durojë dhe të lodhet me mësuesit e tij.

Lukmani<sup>(212)</sup> (Paqja qoftë me të) e këshillonte një herë birin e tij duke i thënë: Bëhu i durueshëm ndaj atyre që janë sipër teje me dituri, por të jesh i durueshëm edhe ndaj atyre që dijnë më pak se ti. Ata që shoqërojnë dijetarët, në fakt duhet të jenë shumë të durueshëm ndaj tyre. Mundohu të mësosh duke treguar shumë modesti dhe respekt ndaj tyre.<sup>(213)</sup>

Imam Ibën Maxhe El-Kazuini (209-273 H) [Allahu e mëshiroftë] tregon: Një herë Jahja Ibën Mein [Allahu e mëshiroftë] shkoi për të vizituar Imam Ahmed Ibën Hambelin [Allahu e mëshiroftë], ndërkohë që ishin bashkë atypari kalon Imam Shafiuu hipur në një mushkë. Imam Ahmedi menjëherë sapo e pa doli ta përshëndeste, ndërsa Jahja nuk lëvizti prej vendi. Pasi u kthye Jahja e pyeti: Pse e gjithë kjo, o Imam Ahmed? Ai u përgjigj: - Nëse dëshiron të marrësh dituri,

<sup>(208)</sup> - Transmetuar nga Imam Ramehramzi në "El-Muhadith el-Fasil", faqja: 206.

<sup>(209)</sup> - Imam Ibën Abd El-Berr, "Xhemiu Bejan el-Ilm", vëllimi: 1, faqja: 49.

<sup>(210)</sup> - Po aty, vëllimi: 1, faqja: 126.

<sup>(211)</sup> - Po aty, vëllimi: 1, faqja: 127.

<sup>(212)</sup> - Lukmani, Ishte një njeri i urtë nga Abisinia. Thuhet se ka qenë pejgamber, por shumica mendojnë se ai nuk ishte i tillë. Ka jetuar në kohën e Pejgamberit Daud (paqja qoftë mbi të). (sh.p).

<sup>(213)</sup> - Po aty, vëllimi: 1, faqja: 107.

atëherë ndiqe mushkën, edhe duke u kapur pas bishtit të saj.<sup>(214)</sup> Khatib El-Bagdadi na përcjell një histori të habitshme për zellin e dijetarëve të hershëm në rrugëtimet e tyre në kërkim të diturisë. Ata menjëherë sapo dëgjonin se dikush dinte ndonjë hadith të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) merrnin rrugë të gjata për të shkuar tek ata dijetarë që i dinin. Tërë këto sakrifica i bënë vetëm në kërkim të diturisë. Abdullah Ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) thoshte: Nëse do të njihja dikë, që do të dinte diçka më shumë se unë do të bëja gati devetë dhe do të nisesha drejt tij për ta mësuar.<sup>(215)</sup>

Dituria e Islamit merret me të mësuar nga dijetarët, ajo nuk merret thjesht nga librat. Madje do të thoshim se dituria e marrë nga librat do të ishte shumë e cunguar. Kjo për faktin se në libra nuk gjen edukim. Ndërsa dituria e Islamit merret me edukim.

Imam Shafiu [Allahu e mëshiroftë] thoshte: Kush e merr diturinë nga librat, atij i ka humbur shpirti i diturisë.<sup>(216)</sup>

Disa dijetarë diturinë e marrë nga librat e quanin si sprovë të madhe. Pasi ajo nxirrte dijetarë teorikë dhe aspak të edukuar me dituri.

Imam Ebu Hanifes [Allahu e mëshiroftë] i thanë dikur, se në një xhami disa nxënës po studionin rreth çështjeve të jurisprudencës. Ai i pyeti: A kanë ndonjë dijetar mes tyre, që po jua shpjegon? Jo,- i thanë, -ata thjesht po debatojnë me njëri-tjetrin.- Atëherë Ebu Hanife u thotë atyre: Ata nuk po mësojnë, ata thjesht mendojnë se po mësojnë!<sup>(217)</sup>

Ajo që kërkuesi i diturisë duhet të dijë domosdoshmërisht është se për të nxënë dituri duhet të mundohet dhe të lodhet për të, duke ndjekur dijetarët. Nuk është dituria që del para njerëzve dhe duke pretenduar veten si dijetar. Por duhet që njerëzit të vrapojnë pas diturisë dhe dijetarëve dhe nëse i kanë ata në mesin e tyre, le t'i respektojnë dhe të ulen për në nxënë prej tyre. Në fakt dijetarët e vërtetë të Islamit nuk dilnin me flamur, duke e pretenduar diturinë. Madje kishte prej tyre që i shmangeshin fort dhënies së fetvave (gjykimit) pasi e shihnin atë si një përgjegjësi të madhe për supet e tyre. Të

(214) - Transmetuar nga Imam El-Bejhaki në "Menakibu Es-Shafii", vëllimi: 2, faqja: 252. Imam Edh-Dhehebi "Sijer E'lam en-Nubela", vëllimi: 10, faqja: 86 - 87.

(215) - Transmeton Imam El-Bukhariu, vëllimi: 6, faqja: 102.

(216) - Imam Ibën Xhemah, "Tedhkiretu es- semia", faqja: 87.

(217) - Imam Ibën Abd El Berr, "Xhemiu Bejan el-Ilm", vëllimi: 1, faqja: 139.



gjithë këta në fakt nuk i ftonin njerëzit në ndjekjen e tyre dhe as nuk ftonin në mendimet e tyre. Gjithçka që ata bënin ishte ftesa e njerëzve dhe udhëzimi i tyre në rrugën e Allahut të Madhëruar.<sup>(218)</sup>

Imam Ibën Ebi Lejla (74-148 Hixhri) [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Kam arritur të shoh 120 nga sahabët e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*), që ishin prej ensarëve. Ata kur pyeteshin për një çështje të caktuar mundoheshin ta largonin përgjigjen nga vetja, duke ia dhënë shokut të vet lejen. Edhe ky bënte të njëjtën gjë dhe kështu me radhë derisa çështja kthehej përsëri tek i pari.<sup>(219)</sup>

Dijetarët e parë në fakt ishin shumë fjalëpakët. Ata kur uleshin në mexhlise të ndryshme nuk flisnin shumë. Njerëzit mezi prisnin të dëgjonin prej tyre diçka që vërtetë do t'ia vlente në ato mexhlise.

Me sa folëm më sipër kuptojmë se dituria është e vështirë të merret dhe se ajo nuk merret thjesht me shfletimin e disa librave. Por ajo kërkon punë dhe lodhje, dhe ndjekje të dijetarëve për të marrë prej tyre krahas diturisë teorike edhe edukimin e nevojshëm praktik. Është kjo e vetmja mënyrë për të ecur në rrugën e dijetarëve, sepse rruga e dijetarëve është e lodhshme, ngaqë barra e tyre është e lodhshme, por edhe shpërblimi i tyre është i madh, sepse janë përcjellës të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*).

Imam Eameshi [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: U munduam shumë që ta bindim Ibrahim Ibën Ed'hemin të ulet në fronin e mësuesit, por ai gjithsesi refuzonte.<sup>(220)</sup>

Dijetarët e hershëm e kishin fjalën me shumë peshë. Të uleshe pranë tyre nuk i dëgjoje ata të flisnin shumë. Edhe sot nëse dëshiron të përfitosh diturinë, ulu me dijetarët fjalëpakët, sepse ke për të përfituar. Llafazanët edhe pse të shurdhojnë veshët, nuk kanë asgjë për të thënë.

Hasan El-Basriu [Allahu e mëshiroftë] thoshte: Disa njerëz kur ulen në mexhlise rrijnë të heshtur, aq sa të tjerët mendojnë se ky është memec. Mirëpo në fakt nuk janë memecë, ata janë dijetarë dhe fjalët i kanë me peshë.<sup>(221)</sup>

---

(218) - Referohu në librin e Shejkh Nasir ibn Abdurrahman El-Akl me titull: "El-Ulemau humu ed-Duat", faqja: 12.

(219) - Transmeton El-Hafidh Ibn Hajthema në "Kitab el-Ilm", faqja: 21. Darimi, vëllimi: 1, faqja: 49.

(220) - Darimi, vëllimi: 1, faqja: 109.

(221) - Transmeton El-Hafidh Ibn Hajthema në "Kitab el-Ilm", faqja: 20.



Për këtë arsye njerëzit duhet të ndjekin vazhdimisht dijetarët, për të përfituar nga vlerat e tyre. Sigurisht duhet jo vetëm të mësojnë me librat e tyre, por edhe të ndjekin edukimin prej tyre. Sepse kjo dituri (Fetare) është Islami dhe ai nuk është teorik, por është dituri me edukim.



## Kapitulli i katërt: Respektimi i hierarkisë së dijetarëve.

Dituria është me shkallë, dhe dijetarët po ashtu janë me grada të ndryshme sipas diturisë që kanë. Vetë Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) është urdhëruar ta kërkojë sa më shumë diturinë. Allahu i Madhëruar e ka porositur të thotë:

... وَقُلْ رَبِّ زِدْنِي عِلْمًا

“Thuaj: “O Zoti im, shtoma dijeninë!”

*Kuran: TaHa, 114.*

Imam Et-Taberi [Allahu e mëshiroftë] do të thoshte për këtë ajet: Në këtë ajet i thuhet Pejgamberit Muhamed (*paqja qoftë mbi të*), që të kërkojë diturinë prej Zotit. Të kërkojë nga dituria jo thjesht teorinë e saj, por edhe edukimin e saj.<sup>(222)</sup>

Me këtë porosi kuranore kuptojmë se dituria është gjithmonë e hapur dhe prej saj ka gjithmonë se çfarë të shtojmë. Allahu i Madhëruar i ka treguar Musait (*paqja qoftë mbi të*) se ai, edhe pse ishte Pejgamber përsëri nuk ishte plotësuar me diturinë e tij. Në historinë e Ubej Ibën Keab<sup>(223)</sup>, i cili e transmeton këtë ndodhi të Musait<sup>(224)</sup> (*paqja qoftë mbi të*) thuhet se Musain e kishte pyetur dikush nga populli i tij, nëse ai ishte më i dituri. Ndërsa Musai natyrshëm i është përgjigjur se ai ishte personi më i ditur. Në fakt kjo nuk ishte e vërtetë

<sup>(222)</sup> - Imam Et-Taberi, "Xhemiu el-Bejan", vëllimi: 16, faqja: 220.

<sup>(223)</sup> - Ubej Ibën Keab, Sahab [shok] i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Ka qenë njëri ndër gjashtë mbledhësit kryesorë të Kuranit në kohën e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Ndërroi jetë në Medine në vitin 22 Hixhri. (sh.p).

<sup>(224)</sup> - Musai (*paqja qoftë mbi të*), është një nga Pejgamberët më të njohur që ka dërguar Allahu i Madhëruar. Ai u dërgua tek izraelitët për t'i nxjerrë ata nga zgjedha e faraonit të Egjiptit. Atij i zbriti nga Allahu i Madhëruar libri i Teuratit. (sh.p).

edhe pse Musai mendonte kështu. Për këtë arsye Allahu i Madhëruar i tha Musait që të shkonte në vendbashkimin e dy deteve. Aty do të gjente dikë, që do të kishte dituri, të cilat Musai nuk i kishte dhe për këtë Musai duhej të vihej në rolin e nxënësit në raport me të. Ky mësues ishte një njeri që quhej Hidri<sup>(225)</sup>. Ai do të mësonte prej këtij njeriu të mençur dituri që nuk mendonte se ishin. Me këtë histori Allahu i Madhëruar i tregon Musait (Paqja qoftë mbi të), se askush nuk mund të pretendojë kulmin e diturisë, por duhet gjithmonë të jetë në kërkim të saj dhe se mbi çdo të ditur ka edhe një më të Ditur se ai.<sup>(226)</sup> Me këtë histori kuptojmë gjithashtu, se mund të ketë dijetarë, që kanë njohuri në disa fusha të caktuara, por disa të tjerë mund të jenë më të ditur në fusha të tjera.

Imam El-Kurtubi [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Dijetarët tanë na kanë mësuar, se dituria është në lloje të ndryshme. Mund të jetë dikush më i ditur se ti në një fushë të caktuar dhe ty të takon të jesh nxënësi i tij për atë dituri. Argument për këtë është fjala e Hidrit, që i tha Musait (*paqja qoftë mbi të*) se: Ti Musa, ke dituri që Allahu t' i ka mësuar, e që unë nuk i kam. Por edhe unë kam disa njohuri të tjera, të cilat m' i ka mësuar Allahu dhe t' i nuk i ke ato. Me këtë kuptojmë se secili prej të dyve është më i ditur se tjetri në fushën e tij.<sup>(227)</sup> Nëse dituria është e ndarë në grada dhe është e larmishme, po ashtu janë edhe dijetarët që e zotërojnë këtë dituri. Për këtë arsye edhe nxënësit e diturisë duhet të respektojnë hierarkinë e diturisë dhe dijetarëve. Nivelet e hierarkisë

<sup>(225)</sup> - Hidri, konsiderohet si Pejgamber, por ka mendime se ai ka qenë thjesht një njeri besimtar i devotshëm dhe shumë i ditur. Historia e tij me Musain është e përmendur edhe në Kuran në suren Kehf. Rreth tij ekzistojnë gojëdhëna se është akoma gjallë. Por e vërteta e tij është se ai duhet të ketë vdekur brenda shekullit kur jetoi edhe Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*), sepse në një hadith të tij përmendet se askush nga njerëzit që jetonin në atë kohë nuk do të ishin gjallë pas njëqind vjetësh nga ai moment. Ky është edhe mendimi i Ibën Tejmijes. [sh.p].

<sup>(226)</sup> - Transmetuar nga El-Bukhariu, në disa kapituj të librit të tij "Sahihu El-Buhari", vëllimi: 1, faqja: 26-27 në kapitullin e diturisë. Paragrafi që bën fjalë për historinë e Musait me Hidrin. Gjithashtu e transmeton edhe Muslimi në "Sahihu Muslim", vëllimi: 4, nr i hadithit: 1853 dhe 2380. Në kapitullin e mirësive, paragrafi i mirësive të Hidrit. Po ashtu është përmendur edhe nga Imam Ahmedi në 'Musnedin' e tij, vëllimi: 5, faqja: 116 - 117.

<sup>(227)</sup> - Imam El-Kurtubi, "Xhemiu Ehkam El-Kuran", vëllimi: 11, faqja: 10.



në fakt nuk caktohen nga njerëz të zakonshëm. Ajo caktohet nga vetë dituria që zotërojnë këta dijetarë dhe këtë e vlerësojnë vetëm dijetarët e nivelit të tyre. Ibën Akili (431-513 Hixhri), [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Është e çuditshme se si disa injorantë flasin lart e poshtë duke thënë se Imam Ahmedi [Allahu e mëshiroftë] ishte vetëm një dijetar i hadithit. Ai ka qenë edhe jurist. Mirëpo në fakt kjo ka të bëjë thjesht me gjykimin e tyre të shkurtër dhe aspak me dijetarin e përfolur.<sup>(228)</sup>

Imam Ed-Dhehebi [Allahu e mëshiroftë] do ta komentonte këtë citat duke thënë: Këta mendonin se ai ishte vetëm një dijetar i haditheve dhe kaq. Por ai në fakt ka qenë një jurist i thelluar në shkencat e jurisprudencës islame. Vetëm në këtë fushë ai mund të kishte arritur nivelin e Imam Shafiut, Malikut, Ebu Jusufit (113-182 Hixhri). Ndërsa në asketizëm dhe spiritualitet ai ishte si Fudejl Ibën Ajadi (107-187 Hixhri), Ibrahim Ibën Ed'hemi (ndërroi jetë në vitin 162 Hixhri). Në njohjen e teksteve ai barazohej me Shuaben (82-160 Hixhri), Jahja El-Katanin (120-198 Hixhri), Ibën Medeniun (161-234 Hixhri). Mirëpo injoranti nuk i di vlerat e tij pasi ai në fakt nuk di as nivelin e vetes së tij.<sup>(229)</sup>

Kështu, dijetarët janë në fakt në nivele të ndryshme dhe duhet që njerëzit t'i respektojnë këto nivele të tyre.

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) ka thënë: “{Më i mëshirshëm me Umetin tim është Ebu Bekri. Më strikt me ta për fenë e Allahut është Umeri. Më i turpshmi ndër ta është Uthmani. Më i dituri me urdhëresat dhe ndalesat është Muadhi. Më i dituri me trashëgiminë është Zejdi. Për çdo Umet ka nga një të besueshëm. I besueshmi i Umetit tim është Ebu Ubejde}”.<sup>(230)</sup>

Umer Ibën Khatabi [Allahu qoftë i kënaqur prej tij] ka thënë<sup>(231)</sup>: O njerëz! Kush do të pyesë për çështje rreth Kuranit, le të shkojë tek Ubej Ibën Keabi. Kush do të pyesë rreth çështjeve të trashëgimisë, le të shkojë tek Zejd Ibën

---

<sup>(228)</sup> - Imam Edh-Dhehebi, "Sijer Ealam el-Nubela", vëllimi: 11, faqja: 321.

<sup>(229)</sup> - Po aty.

<sup>(230)</sup> - Transmeton Imam Ahmedi, vëllimi: 3, faqja: 181. Tirmidhiu, vëllimi: 5, faqja: 330. Ibën Maxhe numri i hadithit: 154.

<sup>(231)</sup> - Transmetuar nga Imam Et-Taberani në "Muaxhem El-Eusat", nga Hejthemiu në "Mexhmea ez-Zeuaid", vëllimi: 1, faqja: 135.

Thabiti. Ndërsa kush don të pyesë rreth jurisprudencës, le të shkojë tek Muadh Ibën Xhebeli).<sup>(232)</sup>

Imam Shafiiu [Allahu e mëshiroftë] e respektonte gjithmonë Imam Ahmedin në çështje që kishin të bënin me Hadithin. Ai i thoshte Imam Ahmedit: Ju jeni më i ditur për Hadithin, prandaj nëse do të gjeni tranmetime të sakta të tij, atëherë më lajmëroni që të vij t'i shënoj nga ju.<sup>(233)</sup>

Abdurrahman Ibën Mehdi (135-198 Hixhri), [Allahu e mëshiroftë] na tregon për dallimet ndërmjet dijetarëve dhe specialiteteve të tyre, ai thotë: (Nuk kam parë më të njohur me Sunetin e Pejgamerit (*paqja qoftë mbi të*), sesa Hamad bin Zejdi (98-179 Hixhri). Ndërsa për shpjegimet dhe komentet e tij, askush nuk ishte para Shihab bin Harashit (ndërroi jetë në vitin 180 Hixhri). Prej tij mësonte edhe Sufjan Eth-Theuri. Ndërsa për oratori Ibën Mubareku ka qenë më i miri.<sup>(234)</sup>

Imam Edh-Dhehebi [Allahu e mëshiroftë] thoshte: Më i dituri i këtij Umeti, në lidhje me Kuranin ka qenë Ubej Ibën Keabi, më i gjykueshmi ka qenë Aliu, më specialisti në çështjet e trashëgimisë ka qenë Zejdi dhe më i mprehti në komentimin e Kuranit ka qenë Ibën Abasi (Allahu i Madhëruar qoftë i kënaqur me të gjithë këta sahabe).<sup>(235)</sup>

Ndër mënyrat e respektit të dijetarëve është edhe respekti ndaj moshës së tyre. Pasi dituria merret me përvojë. Kështu sa më shumë kohë dhe përvojë të ketë dikush me diturinë e tij, aq më e thellë bëhet ajo. Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) i ka cilësuar si shenja të Kijametit, mungesën e respektit tek brezat e

<sup>(232)</sup> - Muadh Ibën Xhebel, Sahab [shok] i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Ishte ndër të parët që pranoi Islamit dhe është ndër dhjetë të përgëzuarit me Xhenet. Ndërroi jetë në Damask në vitin 18 Hixhri. (sh.p).

<sup>(233)</sup> - Transmetuar nga Imam Ebu Hatim në "Edeb Shafii", faqja: 93-95. Ebu Naim në "El-Hulje", vëllimi: 9, faqja: 106. Ibën Abd El-Berr në "El-Intika", faqja: 75. Ibën Xheuzi në "Menakib el-Imam Ahmed", faqja: 449. Ibën El-Xhemah në "Tedhkiretu es-semia uel Mutekelim", faqja: 29. Ibën Kajimi në "Talam el-Muvekiin", vëllimi: 2, faqja: 325.

<sup>(234)</sup> - E përcjellur nga Lalakai "Sherhu Usuli el-Iatikadi ehli suneh", vëllimi: 1, faqja: 63.

<sup>(235)</sup> - Imam Edh-Dhehebi, "Sijer Ealam en-Nubela", vëllimi: 17, faqja: 319



mëvonshëm ndaj dijetarëve të tyre. Ai ka thënë: “{Do të jetë nga shenjat e Kijametit kur dituria do të merret nga fëmijët e vegjël}”.<sup>(236)</sup>

Dijetarët e hershëm të Islamit nuk e shihnin të drejtë të konsideronin dikë si dijetar, nëse ai nuk do të kishte kalur një përvojë të gjatë në marrjen dhe dhënien e diturisë.

Umer Ibën Khatabi [Allahu qoftë i kënaqur prej tij] ka thënë: Do të shkatërrohet feja, atëherë kur dituria do të vijë nga të vegjlit dhe të mëdhenjtë të mos i ndjekin ata. Por do të ishte më e drejtë kur të mëdhenjtë ta merrnin diturinë dhe më të vegjëlit t' i ndjekin ata.<sup>(237)</sup>

Në një transmetim tjetër të Umerit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) thuhet: Njerëzit do të jenë mirë, nëse do ta marrin diturinë nga të mëdhenjtë dhe të mos ngrihen të vegjëlit para të mëdhenjve. Nëse i vogli del para të madhit, atëherë njerëzit do të shkatërrohen.<sup>(238)</sup>

Abdullah Ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) thoshte: Ju do të jeni mirë deri atëherë kur dituria të merret prej të mëdhenjve në moshë. Sepse nëse dituria do të merrej nga të vegjlit në moshë, nga papjekuria ata do t' i përbuznin dijetarët e mëdhenj.<sup>(239)</sup>

E si do mundej etja të largohet?

A thua deti me rrëke do të ngopet?

Si munden fëmijët të nderohen?

E të lihen pleqtë diku në qoshe?

Ordinerët të ngrihen në piedestale

E të diturit të lihen në sandale.

Nëse të ndershmit, me të ultët barazon?

---

<sup>(236)</sup> - Imam Ibën Mubarek, “Ez-Zuhd”, faqa: 61. Lalakai, në ‘Sherhu Iatikadu ehli suneh’ vëllimi: 1, faqa: 85. Taberani në “El Muaxhem el-Kebir”, vëllimi: 22, faqa: 361 dhe 908. Hejthemi e përmend këtë hadith në “El-Mexhmea”, vëllimi: 1, faqa: 135.

<sup>(237)</sup> - E përcjellur nga Kasimi në “Musnef”, dhe nga Ibn Rexhebi në “Fet’h el-Bari”, vëllimi: 1, faqa: 301-302.

<sup>(238)</sup> - E përcjellë nga Imam Ibën Abd El-Berr, “Xhemi u Bejani el-Ilmi ue Fadlihi”, vëllimi: 1, faqa: 158, nga Imam El-Lalakai “Sherhu Usuil Iatikadi ehli suneh”, vëllimi: 1, faqa: 84.

<sup>(239)</sup> - E përcjellë nga Imam Ibën Abd El-Berr, “Xhemi u Bejani el-Ilmi ue Fadlihi”, vëllimi: 1, faqa: 159.



Vdekja është më e mira, o ti që mendon.<sup>(240)</sup>

Nëse mexhliset mbrapsht do të kthehen

Jo ashtu si dikur dijetarët e parë.

Do ishin një turmë të gjithë pa vlerë

Atëherë vdekja do ishte me nder.<sup>(241)</sup>

Të vegjëlit në hadithin e sipërpërmendur janë komentuar në disa mendime.

**I pari:** Imam Abdullah ibn Mubareku [Allahu e mëshiroftë] i ka quajtur të vegjël ata që nuk ndjekin dijetarët, por bazohen në ëndrrat e tyre. Ai kështu i llogariste njerëzit. Për të vegjël nuk ishin ata me moshë të re, por ata që ishin kokëfortë ndaj mendimit të dijetarëve dhe ndjekin qejfet dhe pretendimet e veta. Ai thoshte: Të vegjël nuk janë ata me moshë të vogël. Por janë ata që i mbështeten kokës së tyre dhe nuk ndjekin paraardhësit e tyre në dituritë e Islamit. Ndërsa të mëdhenjtë janë ata që bazohen në dituritë e paraardhësve të tyre, pavarësisht moshës që kanë.<sup>(242)</sup>

**I Dyti:** Mendohet se janë ata që nuk përfillin Sahabët dhe mendimet e tyre dhe marrin për bazë mendimet e veta para tyre.

**I treti:** Të vegjël konsiderohen ata që nuk kanë dituri dhe flasin në emër të saj. Ndërsa të mëdhenjtë janë ata që me dituri njihen dhe e kanë treguar veten për zellin e tyre në shërbim të diturisë.

**I katërti:** Mendimi i Ibën Muatemiriut [Allahu e mëshiroftë] (i cili ndërroi jetë në vitin 133 Hixhri), i cili thotë: I vogël mund të jesh, me moshë, me dituri ose me vlera.<sup>(243)</sup>

Dituria në fakt siç e përmendëm edhe më lart nuk është thjesht mësimi teorik i saj. Të kesh dituri dhe të njihesh si dijetar duhet ta konsolidosh atë që ke mësuar me përvojë në mësimdhënien e saj. Nuk mund të llogaritet si dijetar dikush që është akoma në moshën e rinisë dhe adoleshencës. Përkundrazi dituria kërkon pjekuri dhe qëndrueshmëri. E megjithatë historia ka treguar, se ka patur dijetarë që në moshë të vogël, siç ishte Abdullah Ibën Abasi (Allahu

<sup>(240)</sup> - Imam Ibën Besam, "Ad-Dhehira", vëllimi: 1, faqja: 304. Ibën Halkani "Uefejat el-Eajan", vëllimi: 1, faqja: 304.

<sup>(241)</sup> - Shiko tek libri i Historisë të Imam Ibën Ethirit, vëllimi: 8, faqja: 89, kapitulli që ka të bëjë me vitin 448 Hixhri.

<sup>(242)</sup> - E përcjellë nga Imam Ibën Abd El-Berr, "Xhemi u Bejani el -lmi ue Fadlihi", vëllimi: 1, faqja: 158 – 159.

<sup>(243)</sup> - Dr. Nasir El-Akl, "El-ulemau humu ed-Duat", faqja: 23.



qoftë i kënaqur prej tij), i cili edhe pse në moshë të vogël i mësonte njerëzit dhe u jepte atyre gjykimet e tij për çështje të ndryshme. Po kështu ka qenë edhe Muadh Ibën Xhebeli apo Utab Ibën Esidi <sup>(244)</sup>. Edhe këta kanë qenë në moshë të vogël, kur u mësonin njerëzve dhe jepnin gjykimet e tyre. Madje Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) i ka përdorur ata edhe si guvernatorë të zonave të ndryshme të Shtetit Islam.

Në lidhje me respektin e të moshuarve ka një mori argumentash, që na e këshillojnë këtë. Malik Ibën Huvejrihi (ndërroi jetë në vitin 74 Hixhri), [Allahu e mëshiroftë] thotë: Ishim një grup pleqsh, që e vizituam Pejgamberin (*paqja qoftë mbi të*) në Medine. Atje qëndruam për njëzet netë me radhë. Pamë prej tij butësi dhe respekt. Ai na pyeste vazhdimisht për shëndetin dhe për familjet tona. Kur do të largoheshim ai na tha: “{Kur të shkoni tek familjarët tuaj qëndroni me ta. Mësojini, dhe faluni me ta, ashtu siç më keni parë mua të falem. Por kur të bëheni gati për namaz, njëri prej jush ta thërrasë Ezanin dhe le të dalë më i moshuari prej jush si imam}” <sup>(245)</sup>

Në këtë hadith kuptojmë, se Imami duhet ndër të tjera të jetë edhe më i madhi në moshë, krahas kushteve të tjera që duhet të plotësojë.

Ndërsa për të vegjlit në moshë është obligim, që t’i përkushtohen mësimi të diturisë. Pasi mosha e tyre e vogël e favorizon këtë. Kjo moshë është mosha e marrjes, ndërsa mosha e madhe është faza kur duhet të jepet.

Hasan El-Basriu [Alahu e mëshiroftë] thoshte: Na i sillni fëmijët që t’i mësojmë ata. Pasi në këtë moshë zemrat e tyre janë të pastra, dhe mendjet i kanë të kthjellëta. Pastaj atë që Allahu i Madhëruar dëshiron ta bëjë dijetar, ai do të bëhet. <sup>(246)</sup>

Të jesh i kujdesshëm ndaj respektit të dijetarëve është që t’i nderosh të gjithë ata, por duke filluar nga dijetari i vendit ku ju jetoni, më parë.

---

<sup>(244)</sup> - Utab Ibën Esidi, Sahab [shok] i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). E pranoi Islamit në moshë të re dhe Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) e caktoi si guvernator në Mekë. Ndërroi jetë në vitin 23 Hixhri. (sh.p).

<sup>(245)</sup> - Imam El-Bukhariu, vëllimi: 1, faqja: 155, kapitulli i Ezanit. Muslimi, vëllimi: 1, faqja: 465, kapitulli i ezanit. Paragrafi i Parësisë për Imam. Darimiu, vëllimi: 1, faqja: 286. Ahmedi, vëllimi: 3, faqja: 436 dhe vëllimi: 5, faqja: 53. Nesaiu vëllimi: 2, faqja: 9. kapitulli i ezanit.

<sup>(246)</sup> - E përcjell Imam Ramehramzi “El-Muhadith el-fasil”, faqja: 192.

Imam Ibën Rahavejhi [Allahu e mëshiroftë] (161-238 Hixhri), ka thënë: Në Irak shoqërohesha shumë me Ahmed Ibën Hambelin, Jahja Ibën Meinin dhe të tjerë. Kur diskutonim për ndonjë transmetim hadithi dhe përmendnim transmetuesit e tij të gjithë kishim se çfarë të thoshim, duke shpjeguar transmetuesit e tij. Mirëpo kur vinte puna tek komenti i këtij hadithi, qëllimet ku ai synonte ne të gjithë heshtnim, sepse ai që fliste ishte Ahmed Ibën Hambeli.<sup>(247)</sup>

Imam Edh-Dhehebi [Allahu e mëshiroftë] tregon për Hakim Ibn El-Bejian (321-403 Hixhri) [Allahu e mëshiroftë]: Dijetarët tanë na tregonin, se Hakimi ka qenë shumë i nderuar në kohën e tij. Madje të gjithë dijetarët e kohës së tij asnjëherë nuk dilnin para tij në diskutime, sepse kishin një respekt të veçantë për të.<sup>(248)</sup>

Ata që kërkohet të jenë të respektueshëm ndaj dijetarëve dhe diturisë së tyre janë dy kategori njerëzish:

**E Para:** Vetë dijetarët, kolegët e tyre. Duhet të respektojnë tek njëri-tjetri, diturinë, moshën, dhe vlerat e tyre.

**E dyta:** Njerëzit e tjerë. Duhet të kujdesen që të mos neglizojnë në respektin ndaj dijetarëve dhe diturisë së tyre. Kjo vjen duke mësuar prej tyre. Duke zbatuar porositë e tyre, dhe duke mos abuzuar ndaj të drejtave të tyre, të cilat i përmendëm më sipër.

Sot ka shumë njerëz që nxitojnë të marrin mendimin e ndonjë nxënësi të thjeshtë dhe të hedhin poshtë mendimet e dijetarëve të mëdhenj të botës islame. Madje disa prej tyre i nderojnë më shumë këta vocërrakë ndaj gjigandëve të diturisë islame.

Imam Ed-Dhehebi vazhdon duke thënë: Më ka ndodhur që një ditë të merrja pjesë në një Konferencë. Aty me ne ishte edhe një dijetar i njohur. Pas pak erdhi dikush i moshuar dhe të gjithë filluan ta respektojnë atë, duke mos e përfillur aspak dijetarin që kishim pranë. Këtë gjë e vërejti edhe i moshuari, i cili edhe pse e respektonin u ndje keq, pasi ai e kuptonte, se nuk mund të barazohej me dijetarin në vlera.

<sup>(247)</sup> - Imam Ibën Ebi Hatimi, "El-Xherhu ue et-Teadi", vëllimi: 1, faqja: 375.

<sup>(248)</sup> - Imam Edh-Dhehebi, "Sijer Ealam en-Nubela", vëllimi: 17, faqja: 170.



## Kapitulli i pestë: Rrezikshmëria e ofezave ndaj dijetarëve.

Të ofendosh dijetarët do të thotë të marrësh rrugën drejt humbjes. Pasi ofeza ndaj tyre nuk është thjesht prej personit të tyre, por ndaj diturisë që ata mbartin. Sigurisht ofeza ndaj tyre do të thotë ofezë edhe ndaj Islamit, pasi ata janë mbartës të tij. Kjo gjë është kategorikisht e ndaluar pasi ata janë trashëgimtarët e diturisë peygamberike dhe përcjellës të saj.

Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) e ka ndaluar në fakt të ofendohet, qoftë edhe muslimani më i thjeshtë e jo më dijetarët e tyre. Ai ka thënë gjatë qëndrimit të tij të fundit në Haxhin e Lamtumirës: “{Gjaku juaj, Pasuria juaj, Nderi juaj janë të ndaluara (të shenjtë). Ashtu sikurse është kjo ditë (e Arafatit) në këtë muaj (të shenjtë, muaji DhulHixhe) që jemi, në këtë vend (të shenjtë, zona e Arafatit në Mekë) ku jemi}.”<sup>(249)</sup>

Ofendimi i dijetarëve bëhet zakonisht për qëllime të tjera. Jo thjesht ofendimin e tyre apo të punës së tyre. Me ofendimin e tyre synohet ofendimi i vetë Islamit, duke ditur që ata janë përfaqësuesit e tij. Zakonisht shohim se ofenduesit e dijetarëve janë armiq të vetë Islamit dhe muslimanëve.

Imam Ibën Kajim El-Xheuzije [Allahu e mëshiroftë] thotë: Mjetet jo haram, që të ndihmojnë në arritjen e qëllimit marrin gjykimin e vetë qëllimit. Nëse kemi të bëjmë me qëllime të ndaluara edhe mjetet e tilla (jo Haram) që të ndihmojnë në arritjen e tyre janë të ndaluara (bëhen Haram). Nëse kemi të bëjmë me qëllime arritje adhurimesh, çdo mjet (jo Haram) që të ndihmon në arritjen e tyre bëhet i detyruar. E kështu me radhë. Kështu Islami pasi i analizon qëllimin dhe mjetin u jep atyre gjykimet përkatëse. Islami nuk neglizhon në analizën dhe gjykimin e ndarë, të qëllimit apo të mjetit. Pasi Islami nuk e lejon, që qëllime të mira të arrihen me mjete të ndaluara dhe anasjelltas. Gjithsesi parimi është më i përgjithshëm. Kështu nëse Allahu i

<sup>(249)</sup> - Imam El-Bukhariu, vëllimi: 2, faqja: 191. Muslimi, vëllimi: 2, faqja: 889.

Madhëruar ka ndaluar diçka, mjetet që të çojnë në konsumimin e saj janë të ndaluara, edhe nëse ato në vetvete mund të jenë të lejuara.<sup>(250)</sup>

Duke u bazuar në këtë parim dijetarët e hershëm e ndaluan ofendimin ndaj sahabeve dhe i konsideruan si renegatë të gjithë ata që cenojnë nderin e tyre. Pasi ofendimi i tyre do të thotë ofendim ndaj Islamit dhe vetë Allahut të Madhëruar.

Abdullah Ibën Musab Ez-Zubejri (ndërroi jetë në vitin 236 Hixhri) [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Më pyeti Prijësi i Besimtarëve El-Mehdi (127-169 Hixhri), [Allahu e mëshiroftë]: O Ebu Bekr, si mendon për ata njerëz që ofendojnë sahabët e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*)?- I thashë: -Ata janë (Zindikë) renegatë (njerëz të dalë prej feje dhe të prishur).- Më tha: Hera e parë që e dëgjoj këtë! Unë vazhdova t'ia sqaroj: -Ata janë njerëz, që duan të ofendojnë vetë edukimin që Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) u ka dhënë atyre njerëzve. Atëherë prijësi i besimtarëve më dha të drejtë.<sup>(251)</sup>

Ebu Zuraa (ndërroi jetë në vitin 264 H) [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Nëse shikon dikë, që i ofendon sahabët e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) dije se ai është zindik, sepse Kurani është i vërtetë, Pejgamberi gjithashtu është i vërtetë dhe mesazhi i tij është i vërtetë. Me ofendimin ndaj Sahabëve ata duan të cenojnë dëshminë e tyre ndaj këtyre të vërtetave të mëdha. Mirëpo nuk mund të pranohet dëshmia e tyre kundër një brezi njerëzish, që i ka lavdëruar vetë Allahu i Madhëruar dhe Pejgamberi i Tij. Për këtë arsye ofeza e tyre konsiderohet si cenim i vetë personalitetit të tyre.<sup>(252)</sup>

Imam Ahmedi [Allahu e mëshiroftë] thoshte: Nëse shikon dikë, që flet keq për Hamad bin Selemen [Allahu e mëshiroftë], atëherë duhet të dyshoni në besimin e tij (akuzuesit), sepse ai (Hamad bin Seleme) ishte i ashpër me devijuesit e fesë.<sup>(253)</sup>

Dijetarët e hershëm në të njëjtën peshore i kanë vendosur edhe ata që ofendojnë Tabiinët dhe dijetarët që vijnë pas tyre.

Jahja Ibën Mein(158-233 Hixhri) [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Nëse shikon dikë, që do të flasë keq për Hamad Ibn Seleme (ndërroi jetë në vitin

<sup>(250)</sup> - Imam Ibën Kajim, "Ialam el-Muvekiin", vëlimi: 3, faqja: 147.

<sup>(251)</sup> - Imam Khatib El-Bagdadi "Tarikhu Bagdad", vëlimi: 10, faqja: 174.

<sup>(252)</sup> - Imam Khatib El-Bagdadi. "El-Kifaje fi ilmi er-Riuaje", faqja: 49.

<sup>(253)</sup> - Imam Edh-Dhehebi, "Sijer Ealam en-Nubela", vëlimi: 7, faqja: 450.





167 Hixhri) apo Ikrima Meula Ibën Abasin (ndërroi jetë në vitin 105 Hixhri), atëherë mundesh ta akuzosh atë (akuzuesin) për besimin e tij.<sup>(254)</sup>

Imam Ahmedi [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Nëse dikush ofendon Hamad Ibën Seleme mundesh ta akuzosh atë njeri për besimin e tij, pasi Hamad Ibën Seleme i luftonte fort bidatçinjtë.<sup>(255)</sup>

Kjo nëse bëhet fjalë për ofeza dhe akuza të pabaza. Ndërsa kur kemi të bëjmë me kritikën, sidomos ajo që vjen nga vetë dijetarët, atëherë kjo është e dobishme, pasi kritika e ndihmon njeriun në arritjen e më të mirës.

Imam Edh-Dhehebi [Allahu e mëshiroftë], kur flet për Hamad Ibën Selemen apo Ikrimen e ka fjalën, që nuk lejohet ofendimi i tyre. Por gjithsesi ai thotë se defektet e tyre profesionale në transmetimin e haditheve duhet të vihen në pah, pasi kjo ndihmon në vlerësimin ndaj transmetimeve që ato kanë sjellë.<sup>(256)</sup> Dijetarët e hershëm të Islamit nuk kanë ndaluar vetëm ofezat ndaj personaliteteve të Islamit, ata gjithashtu e konsideruar për ofendim edhe çdo veprim që tregon mungesë respekti ndaj tyre.

Imam Ibën Mubareku (118-181 Hixhri) [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Njeriu me mend në kokë nuk duhet të tregojë mungesë respekti ndaj tre njerëzve: dijetarëve, qeveritarëve e miqve. Mungesa e respektit ndaj dijetarëve ta shkatërron Ahiretin. Mungesa e respektit ndaj qeveritarëve ta shkatërron dynjanë, ndërsa mungesa e respektit ndaj miqve ta shkatërron karakterin.<sup>(257)</sup>

Ofendimi i dijetarëve shkakton lëndimin e tyre, ndërkohë që dijetarët janë të dashurit e Allahut të Madhëruar. Kështu nëse lëndohet një i dashur i Allahut, ky njeri i ka shpallur luftë Allahut të Madhëruar. Në një hadith kudsij, Allahu i Madhëruar ka thënë: “{Kush armiqësohet me një të dashurin Tim, atij njeriu i kam shpallur luftë!}.”<sup>(258)</sup>

Tallja me dijetarët dhe diturinë e tyre cenon vetë besimin e personit, që e bën këtë veprim. Në Medine njëri nga munafikët (hipokritët) kishte thënë me

---

(254) - Imam El-Lalakai në “Sherhu Usuli Iatikadi ehli suneh uel xhemah”, vëllimi: 3, faqja: 514.

(255) - Imam Edh-Dhehebi, “Sijer Ealam en-Nubela”, vëllimi: 7, faqja: 447.

(256) - Po aty, vëllimi: 5, faqja: 31.

(257) - Po aty, vëllimi: 17, faqja: 251.

(258) - Imam El-Bukhariu, vëllimi: 7, faqja: 190, kapitulli i spiritualitetit. Ibën Maxhe në “Sunen”, vëllimi: 2, faqja: 1321, numri i hadithi 3989, kapitulli i Sprovave.



përbuzje: - Këta muslimanët janë të pangopur, gënjeshtarë dhe frikacakë. Në këto momente Allahu i Madhëruar zbriti ajetin e Kuranit:

وَلَيْن سَأَلْتَهُمْ لَيَقُولُنَّ إِنَّمَا كُنَّا نَخُوضُ وَنَلْعَبُ ۗ قُلْ أَيْلَلَهُ وَءَايَاتِهِ وَرَسُولِهِ كُنْتُمْ  
تَسْتَهْزِئُونَ ﴿٦٥﴾ لَا تَعْتَذِرُوا قَدْ كَفَرْتُمْ بَعْدَ إِيمَانِكُمْ ۗ إِنَّ نَعْفَ عَنْ طَآئِفَةٍ مِّنْكُمْ نُعَذِّبُ  
طَآئِفَةً بِأَنَّهُمْ كَانُوا مُجْرِمِينَ ﴿٦٦﴾

“Nëse i pyet, ata do të të përgjigjen: “Ne vetëm po bënim shaka dhe po luanim”. Thuaj: “A mos vallë me Allahun, me Shpalljet dhe me të Dërguarin e Tij po talleshit?” Mos u shfajësoni! Ju e mohuat fenë, pasi patët besuar. Nëse Ne i falim disa prej jush (për shkak se u penduan), do t’i ndëshkojmë të tjerët, ngase janë fajtorë (nuk u penduan për talljen që bënë”.

Kuran: Et-Teube, 65-66.

Në këtë ajet Allahu i Madhëruar e konsideron ofendimin apo talljen e Pejgamberit (paqja qoftë mbi të) dhe besimtarëve si ofendim ndaj vetë Atij. Për këtë arsye ky konsiderohet një krim i madh i personit, që e konsumon këtë vepër. Duhet të bëjmë kujdes në përgojimin e dijetarëve, në fakt të çdo njeriu pasi Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) ka thënë: “{A e dini se çfarë është Gibeti (Përgojimi)? - Shokët e tij iu përgjigjën: Allahu dhe Pejgamberi i Tij e dinë më mirë! - Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) tha: -Ta përmendësh vëllanë tend për gjëra që ai urren.”- I thanë: Edhe sikur ato që i përmendim për të, të jenë të vërteta?- Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) tha: -Nëse janë të vërteta, atëherë e ke përgojuar. Nëse ato nuk janë të vërteta, atëherë kë shpifur për të}”.<sup>(259)</sup>

Përgojimi i dijetarëve është më i rëndë, se sa përgojimi i njerëzve të tjerë.

Imam Ibën Asakir Ed-Dimeshkiu (550-620 Hixhri) [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Dije pra i dashur vëlla, se mishi<sup>(260)</sup> i dijetarëve është i helmuar. Ndërsa

<sup>(259)</sup> - Muslimi, vëllimi: 4 faqja: 2001, numri i hadithit 2589, kapitulli i respektit, paragrafi i gibeitit. Ahmedi në “Musned”, vëllimi: 3, faqja: 386 dhe 458. Darimiu në “Sunen”, vëllimi: 2, faqja: 209 - 210, kapitulli i spiritualitetit, paragrafi i gibeitit.

<sup>(260)</sup> - Në një ajet Kurani në suren El-Huxhuratë, Allahu i Madhëruar e konsideron përgojimin e tjetrit sikur të hash mishin e tij pasi të ketë vdekur.



Allahu i Madhëruar zakonisht i ka demaskuar dhe turpëruar ata që mundohen të përgojnë dijetarët. Sidomos ndaj atyre që shpifin ndaj dijetarëve. Pasi ata janë njerëzit që Allahu i Madhëruar i ka zgjedhur të jenë përcjellësit e fesë së Tij në tokë. <sup>(261)</sup>

Problemi fillon menjëherë kur disa nxënës pretendojnë se janë të ditur dhe shprehin paturpësisht gjykimin e tyre ndaj dijetarëve të caktuar. Kjo shkakton tek njerëzit një abuzim me respektin ndaj këtyre dijetarëve.

Mundet që një dijetar të ketë rezervat e veta ndaj një tjetër dijetari. Por kur këto i shpreh tek nxënësit e vet, ata me papjekurinë e tyre e përhapin këtë ndër njerëzit e tjerë. Për këtë arsye duhet të rezervohen dijetarët në thëniet e tyre, që me to të mos abuzohet në rangjet e poshtme.

---

<sup>(261)</sup>- Imam Ibën Asakir Ed-Dimashkij, "Tebjînu Kedhibi el-Mufteri", faqja: 28.

## Kapitulli i gjashtë: Rrezikshmëria e kritikës jo profesionale ndaj dijetarëve.

Është e vërtetë se dijetarët janë njerëz dhe gabojnë. Por gjykimi i gabimeve të tyre mbart në vetvete dy rreziqe.

**I pari:** Mund të jetë një gjykim i gabuar, pasi çështja për të cilën ky dijetar kritikohet mund të mos jetë me të vërtetë gabim, ashtu siç mendojnë kritikuesit. Ndoshta dijetari është i vërtetë në mendimin e tij dhe gjykimi ndaj tij do të dilte i pavend. Zakonisht këta kritikë nxitojnë në gjykimin e dijetarëve, ndoshta për shkak të paragjyqimeve të mëparshme.

Me sy të mirë gjërat kur i shikojmë

E meta duket, por është lehtë për ta mbuluar

Me sy të keq gjërat kur shikon

E vogla zmadhohet dhe gabim njeriu ka gjykuar...

Ndodh që kritikët e dijetarit mund të mos e njohin realitetin e tij, të mos njohin mënyrat e analizave që ka përdorur në analizën e çështjes për të cilën kritikohet. Këta "kritikë" të nxituar, nuk durojnë që të pyesin vetë dijetarin apo të thellohen në çështjen, të cilën e shohin të gabuar.

Ndonjëherë paragjykimi na errëson gjykimin dhe mund të gabojmë në kuptimin e çështjeve. Për këtë arsye është e domosdoshme që të pastrojmë fillimisht zemrën dhe mendjen dhe të jemi të urtë sidomos në botëkuptimin për diturinë dhe dijetarët.

Imam Edh-Dhehebi, [Allahu e mëshiroftë] na tregon një shembull me këtë rast: Ai thotë: Ishim ulur në mësim tek një mësues i yni. Pasi foli për jetën e tre Khalifëve të drejtë (Ebu Bekrit, Umerit, Othmanit) foli edhe për jetën e të katërtit prej tyre, Ali Ibën Ebi Talibit. [Allahu qoftë i kënaqur me ta], por aty nga mesi i njerëzve u ngrit dikush dhe me zë të lartë përgënjeshtroi mësuesin tonë. Ai edhe pse kishte dëgjuar në heshtje gjithçka për biografinë e tre



Khalifëve të parë, inati për të katërtin bëri që ai të rrëmbehej dhe të fliste padrejtësisht për të.<sup>(262)</sup>

Dijetari i nderuar Abdul Aziz bin Baz [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Është detyrim për çdo musliman, që të ruajë gjuhën dhe gjykimin e tij. Sidomos kur bëhet fjalë për dijetarët. Edhe në rastin më të keq, kur nuk bën ndryshe vetëm se të gjykohet qëndrimi i filan dijetari, atëherë këtë duhet ta bëjë një njeri, që është në nivelin e tij ose më lart se ai. Ndryshe nëse kushdo do të fliste për dijetarët, atëherë ky do të ishte një abuzim i madh me diturinë dhe dijetarët.<sup>(263)</sup>

Njësoj është edhe diskutimi dhe akuzat ndaj njerëzve si hipokritë. Ndërkohë që askush nuk mund të zbulojë çfarë ka brenda zemrës së tjetrit. Madje as vetë Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) nuk e ka ditur, që rreth tij kishte nga ata që e shoqëronin, por që nuk ishin me zemër me të. Allahu i Madhëruar për këtë arsye edhe ka zbritur këto ajete nga Kurani:

وَمِمَّنْ حَوْلَكُم مِّنَ الْأَعْرَابِ مُنَافِقُونَ وَمِنْ أَهْلِ الْمَدِينَةِ مَرَدُوا عَلَى النِّفَاقِ لَا تَعْلَمُهُمْ  
 خُنُّنُ تَعْلَمُهُمْ سَنُعَذِّبُهُمْ مَّرَّتَيْنِ ثُمَّ يُرَدُّونَ إِلَىٰ عَذَابٍ عَظِيمٍ ﴿١٠١﴾

“Ka beduinë në mjedisin tuaj, që janë hipokritë, por ka edhe ndër banorët e Medinës të atillë që janë këmbëngulës në hipokrizi. Ti nuk i di ata. Ne i dimë. Ne do t’i dënojmë dy herë e pastaj, do të kthehen në dënimin e madh (në Xhehenem)”.

Kuran: Et-Teube, 101

Për këtë arsye nëse Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) nuk kishte mundësi të gjykonte njerëzit për çfarë kishin në zemrat e tyre, kjo gjë bëhet më e pamundur dhe më e ndaluar për secilin prej nesh në kohët tona, kur shpallja prej Allahut të madhëruar mungon.<sup>(264)</sup>

Umer Ibën Khatabi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) thoshte: Në kohën e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) njerëzit i gjykonte shpallja hyjnore. Mirëpo

(262) - Imam Edh-Dhehebi, “Sijer Ealam en-Nubela”, vëllimi: 15, faqja: 524.

(263) - Revista “Rabitat el-Alem el-Islami”, numri: 313.

(264) - Imam Edh-Dhehebi, “Sijer Ealam en-Nubela”, vëllimi: 14, faqja: 343.

tani që shpallja është ndërprerë ne i gjykojmë njerëzit sipas punëve të tyre dhe jo sipas qëllimeve. Nëse dikush bën një të mirë ndaj muslimanëve, ne e vlerësojmë atë dhe ia shpërblejmë për punën e tij. Ama qëllimet e zemrës së tij janë në dorë të Allahut të Madhëruar. Nëse dikush bën diçka të keqe ndaj muslimanëve, ai nuk do të jetë më i besueshëm ndaj nesh, edhe pse ai mund të na shfajësojë qëllimet e tij.<sup>(265)</sup>

Njerëzit në gjykimet e tyre duhet të bazohen në mendimet e dijetarëve dhe jo në çfarë dëgjojnë lart e poshtë. Vlerësimi i tyre nuk bëhet nga njerëzit e rëndomtë, as nga gojët e një ose dy dijetarëve (kushdo qofshin ata). Mendimi ku duhet të bazohemi është mendimi i shumicës së dijetarëve të Islamit.

Imam Ahmedi [Allahu e mëshiroftë] tregon se në një rast i erdhën dy vetë dhe i folën keq për Imam Shafiun. Por ai i refuzoi ata dhe ua ktheu ashpërsisht duke mbrojtur vlerat dhe nderin e Imam Shafiut. Pastaj u kthye nga nxënësit e tij dhe iu tha: Ka raste kur Allahu i Madhëruar i jep një njeriu shumë dituri dhe vlera. Të tilla që nuk ua ka dhënë kolegëve të tij. Ajo që ndodh është se këta (kolegët) e kanë zili dhe flasin me inat ndaj vlerave të këtij dijetari. Ky është një tipar i keq tek disa njerëz të ditur.<sup>(266)</sup>

Në mbrojtje të Imam Shafiut [Allahu e mëshiroftë] (nga akuzat kundër tij për shiizëm) Imam Edh-Dhehebi [Allahu e mëshiroftë] shton: Nëse do të ishte Imam Shafiu shi'it, atëherë ai nuk do të fliste me konsideratat më të larta për Halifët e Drejtë duke filluar me Ebu Bekrin, Umerin, Othmanin, Aliun dhe duke përfunduar me të pestin, Umer Ibën Abdul Azizin. (Shi'itët nuk e pranojnë, madje e ofendojnë rëndë Ebu Bekrin dhe Omerin).<sup>(267)</sup>

I dytë: Është e ndaluar për këdo, i cili nuk është në nivelin e subjektit, që ta gjykojë atë. Imam Esh- Shatibi [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Nuk duhet të përzihet askush në kritikën apo gjykimin ndaj dijetarëve. Këtë të drejtë e kanë vetëm njerëzit e nivelit të tyre. Pasi janë vetëm ata që mund t'i kuptojnë

<sup>(265)</sup> - Imam El-Bukhariu, vëllimi: 3, faqja: 221. Në kapitullin e dëshmimeve, paragrafi i dëshmitarëve të drejtë. Gjithashtu edhe Ahmedi në 'Musned', vëllimi: 1, faqja: 14.

<sup>(266)</sup> - Imam El-Bejhaki në "Menakib", vëllimi: 2, faqja: 259. Imam Edh-Dhehebi, "Sijer Ealam en-Nubela", vëllimi: 10, faqja: 58.

<sup>(267)</sup> - Imam Edh-Dhehebi, "Sijer Ealam en-Nubela", vëllimi: 10, faqja: 58-59.



analizat e diturisë, janë ata që kanë edhe moralin e duhur për ta bërë kritikën, nëse është vendi për të.<sup>(268)</sup>

Mund të ndodhë që një dijetar të ketë një mendim, që nuk përkon me mendimin e shumicës së dijetarëve. Kjo nuk e bën atë më të ulët në vlera se kolegët e tij dijetarë. Nga ana tjetër për të gjithë njerëzit e thjeshtë, duke përfshirë edhe nxënësit e diturisë duhet t'i përmbahen mendimit të shumicës së dijetarëve. Por atyre nuk u takon të flasin asnjë fjalë për dijetarin, i cili ka këtë mendim ndryshe nga shumica e dijetarëve.

Shembulli më i mirë për këtë është rasti i diturisë së Hidrit (*paqja qoftë mbi të*) dhe nxënësit të tij Musait (*paqja qoftë mbi të*).<sup>(269)</sup>

Tregohet se disa nxënës i kishin shkuar një dijetari dhe i ishin ankuar për realitetin e rënduar në të cilin jetonin në vendin e tyre prej Haxhaxh bin Jusuf Thekafiut (41-95 Hixhri). Dijetari i këshilloi ata të bënin durim dhe t'i përmbaheshin Islamit, sepse kohët që do të vijnë janë më të këqija, se ato që kanë shkuar. Mirëpo kjo përgjigje nuk iu pëlqeu atyre. Ata prisnin që dijetari t'i orientonte drejt veprimeve vandale, refuzuese të realitetit. Pasi kjo gjë nuk ndodhi këta nxënës u kthyen turivarur, duke thënë se ky dijetar nuk bën.

E njëjta histori ka ndodhur edhe në kohën e sahabëve, kur Enes Ibën Malikun e vizituan disa njerëz, të cilët iu ankuan për realitetin në të cilin ndodheshin. Enesi i këshilloi me durim pasi kohët që do të vinin do të ishin më të vështira, se ato që kishin kaluar. Ai thoshte se këtë e kishte mësuar nga Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*).<sup>(270)</sup>

Është shumë e rrezikshme, që çështjet e gjykimit ndaj njerëzve sidomos dijetarëve, të kalojnë në duart e nxënësve të dijes. Pasi ata kanë një horizont të ngushtë të gjykimit dhe diturisë. Kështu ata për një çështje të panjohur gjykojnë se ajo është bidat (risi) në fe. Mirëpo ajo mund të jetë prej çështjeve të fesë, thjesht dituria e tyre e kufizuar nuk ka arritur deri në njohjen e saj.

<sup>(268)</sup> - Imam Esh-Shatibi, "El Meuefekat", vëllimi: 4, faqja: 173.

<sup>(269)</sup> - Referoju Kuranit në suren El-Kehf, ajetet: 60-82. (sh.p).

<sup>(270)</sup> - Imam El-Bukhariu, vëllimi: 13, faqja: 22 në kapitullin e sprovave, paragrafi i kohëve që sa vijnë e prishen.



Shembuj për këtë kemi rastin e ndodhisë së Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) gjatë takimit me Allahun e Madhëruar në Miraxh <sup>(271)</sup>. Tema që diskutohej ishte nëse e ka parë ose jo Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) Allahun e Madhëruar.

Gjithashtu edhe çështja tjetër nëse besimtarët do ta shikojnë Allahun e Madhëruar në Xhenet apo jo?

Për këto dy çështje Imam Edh-Dhehebi [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Çështja nëse e ka parë apo jo Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) Allahun e Madhëruar është diçka që vetë Sahabët kanë patur diskutim në të. Disa e mohonin shikimin e disa e pohonin atë. Për ne do të ishte më mirë që në këtë çështje të mos prononcohem, pasi çështja nuk është e përkufizuar prej tyre. Ne nuk mund të quajmë si të gabuar, as atë që e pohon, se kjo ka ndodhur, dhe as atë që e mohon këtë. Për ne do të ishte më e drejtë të mos merreshim fare me këtë çështje dhe të themi: Allahu i Madhëruar dhe Pejgamberi i Tij (*paqja qoftë mbi të*) e dinë më mirë.

Por nga ana tjetër ne nuk duhet të pranojmë nga askush, që do ta mohonte shikimin e Allahut të Madhëruar nga besimtarët në Ditën e Gjykimit, sepse kjo është e vërtetuar qartazi me argumenta të sakta. <sup>(272)</sup>

Një shembull tjetër është edhe keqkuptimi që pati imam Muhamed bin Jahja Ed-Dhuhelij (173-258 Hixhri) ndaj fjalëve të Imam Bukhariut në çështjen e Kuranit. Ai kuptoi nga fjalët e Imam Bukhariut, se Kurani është i krijuar (debati i mirënjohur tashmë), mirëpo Imam Bukhariu jo vetëm që nuk e besonte këtë gjë, por ai ishte ndër dijetarët, që e vërtetonin se Kurani është fjalë e Allahut të Madhëruar. Në fakt imam Bukhariu kur fliste për krijim të Allahut të Madhëruar e kishte fjalën për zërat e kënduesve të Kuranit. Sigurisht që ato janë produkt i kordave të njeriut, të cilin e ka krijuar Allahu i Madhëruar. <sup>(273)</sup>

<sup>(271)</sup> - *Miraxh*, Udhëtimi që bëri Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) brenda natës nga Meka deri në Xhaminë Aksa (Palestinë) e më pas nga aty deri përtej qiejve, ku u takua me Allahun e Madhëruar. Aty ai mori edhe udhëzimet për kohët dhe mënyrat e Namazit (faljeve, pesë herë në ditë), për më shumë referohu në Kuran, suren El-Isra dhe komentet e saj. (sh.p).

<sup>(272)</sup> - Imam Edh-Dhehebi, "Sijer Ealam en-Nubela", vëllimi: 10, faqja: 114. Imam Ibën Kajim në "Zad el Mead", vëllimi: 3, faqja: 36-38.

<sup>(273)</sup> - Shejkh El-Islam Ibën Tejmije, "El Fetava" vëllimi: 12, faqja: 364 - 365.



Edhe pse më e mira do të ishte të mos futeshin fare në të tilla debate, duke ndjekur porosinë e Imam Ahmed Ibën Hambelit, përsëri na duhet të kuptojmë, se ka dallim ndërmjet fjalëve të Imam Bukhariut dhe kuptimit që Imam Muhamed bin Jahja Ed-Dhuhelij e kishte marrë.<sup>(274)</sup>

Të tilla raste ka patur shpesh në praktikën e dijetarëve, aq sa dijetari Bekir bin Abdullah Ebu Zejd (1365-1429 Hixhri) [Allahu e mëshiroftë] do të shkruante një studim, ku do të përmblihdte shumë prej këtyre keqkuptimeve, që ose kanë ardhur nga keqkuptimi, ose nga keqinterpretimi i atyre që i kanë lexuar këto. Ndër to mund të përmendim :

- Fetvanë se gruaja mund të jetë gjykatëse, e cila gabimisht i është ngjitur Ebu Hanifes [Allahu e mëshiroftë] dhe medhhebit të tij. Ndërkohë që këtë çështje Ai vetë dhe Medhhebi Hanefi e ka ndaluar rreptësisht.<sup>(275)</sup>
- Fetvanë që Nijeti duhet thënë me zë, të cilën ia referojnë Imam Shafiut [Allahu e mëshiroftë]. Nxënësit e tij mendojnë, se ai nuk e ka patur për këtë qëllimin kur ka thënë: Në namaz njeriu duhet të futet me Dhikër (Përmendje të Zotit).- Mirëpo ai këtu e kishte fjalën për Tekbirin fillestar (Allahu Ekber).<sup>(276)</sup>

---

<sup>(274)</sup> - Imam Edh-Dhehebi, "Sijer Ealam en-Nubela", vëllimi: 12, faqja: 456.

<sup>(275)</sup> - "Et-tealumu ue etheruhu ala el-fikri uel Kitab", faqja: 102.

<sup>(276)</sup> - Po aty, faqja: 102.

## Kapitulli i shtatë: Domsdoshmëria e justifikimit të dijetarëve.

Dijetarët, siç përmendëm më lart janë kategoria më e nderuar e umetit musliman. Për këtë arsye nderi dhe personalitetit i tyre duhet trajtuar me kujdes të veçantë. Duke qenë njerëz ata mund të gabojnë. Por gabimet e tyre nuk duhet të trajtohen me të njëjtën peshore, si të njerëzve të tjerë. Gabimet e tyre duhet të justifikohen fillimisht përpara se të gjykohen. Muslimanët nuk duhet të bien pre' e keqdashësve të Islamit dhe dijetarëve të tij dhe të bëhen bartës të akuzave dhe shpifjeve të këtyre njerëzve. Përkundrazi ata duhet të mos i pranojnë ato dhe të kenë një gjykim pozitiv për dijetarët.

Allahu i Madhëruar thotë në Kuran:

لَوْلَا إِذْ سَمِعْتُمُوهُ ظَنَّ الْمُؤْمِنُونَ وَالْمُؤْمِنَاتُ بِأَنْفُسِهِمْ خَيْرًا وَقَالُوا هَذَا إِفْكٌ مُّبِينٌ ﴿١٢﴾

“Kur e dëgjuat këtë përgojim, përse besimtarët dhe besimtares (mes jush) nuk menduan mirë për njëri-tjetrin dhe të thoshin: “Kjo është shpifje e qartë?!...”

*Kuran: En-Nur, 12.*

Umer Ibën Khatabi [Allahu qoftë i kënaqur prej tij] do të thoshte në komentimin e këtij ajeti: Mos e merr një fjalë të vëllait tënd për të keqe, nëse ke mundësi ta justifikosh atë.<sup>(277)</sup>

Imam Muhamed Ibën Sirini [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Nëse merr vesh diçka të keqe për vëllanë tënd, justifikoje atë. E nëse nuk gjen ndonjë justifikim, atëherë thuaj: Ndoshta mund të ketë ndonjë justifikim që unë nuk e di.<sup>(278)</sup>

<sup>(277)</sup> - Imam Ibën Kethir, “Tefsiri El-Kuran El-Adhim”, vëlimi: 4, faqja: 213.

<sup>(278)</sup> - Transmetuar nga Imam El-Asfahani, faqja: 97.



Edhe Ebu Kalabe (ndërroi jetë në vitin 104 Hixhri) [Allahu e mëshiroftë] është shprehur ngjashëm me Ibën Sirinin kur thoshte: Duhet të përpiqesh ta marrësh për mirë fjalën e vëllait tënd, të gjesh justifikime sa të mundesh. Dhe nëse nuk gjen diçka, atëherë thuaj: Ndoshta ka patur diçka që unë nuk e di.<sup>(279)</sup> Nëse duhet të sillemi kështu me njëri-tjetrin, atëherë si do të duhej të ishte sjella me më të diturin?

Imam Sebeki (683-755 Hixhri) [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Nëse njeriu njihet si i besueshëm, me moral të lartë dhe i ditur, atëherë çdo fjalë që dëgjon prej tij, ose për të, apo ndonjë nga shkrimet e tij duhet ta mirëkuptojmë dhe të mos nxitohemi në gjykimin e tij.<sup>(280)</sup>

Dijetari i nderuar Abdul Kadir Arnauti [Allahu e mëshiroftë] i njohur tashmë për thellimin e tij në dituri dhe për devotshmërinë e tij, gjithmonë kur e pyesnin për fetvatë e tij, ai mendohej të shmangte pyetjet me karakter politik. Kjo për faktin se ai jetonte në një sistem diktatorial, që u ndërtua në Siri në kohën e Hafiz El-Esedit<sup>(281)</sup> dhe djalit të tij Beshar El Esedit<sup>(282)</sup>. Në fakt dijetari i nderuar nuk kishte frikë të fliste fjalën e tij për regjimin, por ai mendonte se dobia më e madhe ishte në mësimin e njerëzve për Islamin dhe edukimin e tyre. Kështu nuk mund të gjykojmë mbi qëndrimet e tij të heshtura ndaj politikës diktatoriale, se ai pajtohej me të. Përkundrazi ai shikonte në këtë regjim zullumin dhe padrejtësitë, por ai i dha më tepër përparësi edukimit të njerëzve dhe mësimin e tyre, sesa kundërshtimit të hapur të sistemit. Ai kishte llogaritur dëmin dhe dobitë e çështjes së rezistencës ndaj diktaturës dhe e kishte parë me vend se dobia e tij do të ishte më e madhe në mësimin e njerëzve sesa në dhënien e jetës.<sup>(283)</sup>

Dijetari është njeri dhe si i tillë ai nuk mund të dalë nga natyra e tij njerëzore. Krahas shembullit të mësipërm kemi edhe raste të tjera në historinë islame,

<sup>(279)</sup> - Transmeton Imam Ebu Nueim në "el-Hulje", vëllimi: 2, faqja: 285.

<sup>(280)</sup> - Imam Es-Sebkij "Kaidetu el-Xherhi ue et-Teadiil", faqja: 93.

<sup>(281)</sup> - *Hafiz El-Esed*, Ish-president i Republikës së Sirisë. Diktator që sundoi me dhunë mbi popullin e tij nga viti 1970 deri në vitin 2000, kur edhe vdiq. (sh.p).

<sup>(282)</sup> - *Bashar El-Esed*, Presidenti aktual i Sirisë, i cili ndoqi gjurmët e babait të tij në shtypjen e popullit me dhunë. Aktualisht ai njihet si diktatori që numëron mbi 80,000 viktima mbi civilët e pafajshëm në popullin sirian. (sh.p).

<sup>(283)</sup> - Kjo ishte nga përvoja ime me Shejkhun e nderuar Abdul Kadir në Damask në vitin 1999. (sh.p).

kur dijetarët kanë qenë të detyruar të heqin dorë nga parimet e tyre për shkak të presionit, që kanë patur nga sistemet e ndryshme politike. Kështu në çështjen e përkufizimit të Kuranit (nëse është Fjala e Zotit apo krijuar prej Zotit) shumë dijetarë të mëdhenj u detyruan të hiqnin dorë nga e vërteta, prej dhunës që ushtronte në atë kohë pushteti politik i halifit Memun (siç e cituam më lart). Ndër këta vetëm njëri qëndroi i palëkundur dhe ai ishte Imam Ahmed Ibën Hambeli [Allahu e mëshiroftë], i cili pranoi burgjet dhe torturat, madje edhe internimet, duke mos toleruar një përkufizim të gabuar ndaj Kuranit. Mirëpo shumë prej dijetarëve të tjerë u dorëzuan dhe u detyruan të ulin kokën. Por edhe këta dijetarë, edhe pse duhej të rezistonin, si Imam Ahmed [Allahu e mëshiroftë] gjithsesi justifikohen, për faktin se kanë qenë të dhunuar.

Imam El-Meruedhi (200-275 Hixhri) [Allahu e mëshiroftë] thotë: Më vonë dëgjova se dikush i thoshte një dijetari: Nuk do ta marrim më fjalën tënde, vetëm Imam Ahmed [Allahu e mëshiroftë] është i denjë për t'ia marrë fjalën, sepse rezistoi. Ky dijetar iu kthye: Jeni i lirë të zgjidhni, por duhet ta dini, se Imam Ahmedi kishte fuqi ta mbante torturën dhe unë nuk kisha fuqi ta përballoja atë.<sup>(284)</sup>

Ibrahim Ibën Abdullah El-Xhenid (ndërroi jetë në vitin 270 Hixhri) [Allahu e mëshiroftë] thoshte: Kam dëgjuar Jahja Ibën Meinin të thoshte, se Ibën El-Medeni ka devijuar nga feja pasi u dorëzua në sprovën e përkufizimit të Kuranit. Mos fol kështu i thashë, përkundrazi ai është dijetar i ndershëm dhe besimtar i devotshëm. Ai thjesht nuk mundi të rezistonte në torturat që i bëheshin dhe u dorëzua duke deklaruar diçka jo të vërtetë.<sup>(285)</sup>

Ali Ibën El-Medeni [Allahu e mëshiroftë] do t'i shkruante një shokut të vet: Asgjë nga ato që kam thënë nën tortura nuk është e vërtetë. Thjesht unë kisha frikë, se do të më vrisnin. Dhe ju e dini, miku im, se unë mjafton një e rënë e dajakut dhe bie i vdekur.<sup>(286)</sup>

(284) - Imam Edh-Dheheb, "Sijer Ealam en-Nubela", vëllimi: 11, faqja: 55.

(285) - Imam Edh-Dhehebi, "Sijer Ealam en-Nubela", vëllimi: 11, faqja: 57.

(286) - Imam Edh-Dhehebi, "Sijer Ealam en-Nubela", vëllimi: 11, faqja: 57.



Imam Ebu Zura Er-Razi [Allahu e mëshiroftë] do të thoshte: Imam Ahmedi nuk merrte më asnjë hadith nga Jahja Ibn Medini dhe nga askush tjetër që ishte dorëzuar në sprovën e përkufizimit të Kuranit.<sup>(287)</sup>

Imam Edh-Dhehebi [Allahu e mëshiroftë] do të thoshte për këtë çështje: Gjithsesi dobësia e atyre dijetarëve, që u dorëzuan ndaj dhunës shtetërore të kësaj kohe, janë të justifikuar para Zotit, sepse vetë Zoti e ka toleruar diçka të tillë, kur njeriu detyrohet të mohojë të vërtetën nga presioni dhe jo nga besimi. Jahja ibn Meini është ndër dijetarët e nderuar të Islamit dhe Sunetit të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*).<sup>(288)</sup>

Ajo që kritikohen më shumë dijetarët është varësia e tyre ndaj pushtetit. Shumë prej tyre paguhen nga politika, ndoshta sepse nuk kanë me se të jetojnë. Por ka prej tyre që edhe pse janë të pavarur ekonomikisht vazhdojnë të paguhen nga shteti. Sigurisht një dijetari i takon të jetë i drejtë dhe objektiv në gjykimet e tij. Por jo pak herë ka ndodhur që varësia e tyre nga politika të ketë shtrembëruar qëndrimet e tyre, që duhet të ishin objektive.

Imam Edh-Dhehebi [Allahu e mëshiroftë] tregon, se një dijetar e kishin akuzuar, që ai kërkonte para për punën e tij. Mirëpo asnjëri prej tyre nuk e dinte, se ky dijetar kishte trembëdhjetë frymë në shtëpi për të mbajtur dhe asnjë të ardhur.<sup>(289)</sup>

Ka raste kur dijetarët në auditorin e tyre pranojnë njerëz të ndryshëm. Kjo ndodh zakonisht, sepse ata janë zemërgjerë dhe të dashur me të gjithë. Mirëpo ndër njerëzit që dëgjojnë prej tij mund të ketë prej tyre njerëz dashakeqës dhe me qëllime të këqija. Ai nuk i dëbon ata, edhe pse mund të njohi shturjen e tyre. Në raste të tilla ka patur prej njerëzve, që i kanë paragjykuar këta dijetarë për zemërgjerësinë e tyre.

Imam Edh-Dhehebi [Allahu e mëshiroftë] për dijetarë të tillë thoshte: Ata dijetarë duhej t'i kritikonin dhe të mos i afronin pranë tyre këta njerëz të prishur. Mirëpo shumica e tyre ecin me dëshirën e mirë, që këta njerëz do të rikthehen në të drejtë.<sup>(290)</sup>

---

(287) - Po aty.

(288) - Imam Edh-Dhehebi, "Sijer Ealam en-Nubela", vëllimi: 11, faqja: 87.

(289) - Po aty, vëllimi: 10, faqja: 152.

(290) - Imam Edh-Dhehebi, "Sijer Ealam en-Nubela", vëllimi: 7, faqja: 140-141.



## Kapitulli i tetë: Referimi i dijetarëve në çdo moment, sidomos në kohë të turbullta.

Kur në shoqëri ka trazira dhe rrëmuja çështjet bëhen të paqarta dhe nuk mund të kuptohen qartë qëndrimet e njerëzve. Në këtë kohë mbrojtja e vetme është në një bashkësi që drejtohet nga dijetarët. Njerëzit detyrohen që t'i qëndrojnë afër dhe të mbështeten në mendimin e dijetarëve. Të jesh larg tyre në ato momente do të thotë më shumë rrëmuja dhe trazirat të përhapen. Allahu i Madhëruar na këshillon që për çdo çështje duhet të referohemi tek dijetarët, qoftë në kohë paqeje, po ashtu edhe në kohë trazirash apo lufte. Allahu i Madhëruar thotë në Kuran:

وَإِذَا جَاءَهُمْ أَمْرٌ مِّنَ الْأَمْنِ أَوْ الْخَوْفِ أَدَاعُوا بِهِ ۖ وَلَوْ رَدُّوهُ إِلَى الرَّسُولِ وَإِلَىٰ أُولِي الْأَمْرِ  
مِنْهُمْ لَعَلِمَهُ الَّذِينَ يَسْتَنْبِطُونَهُ مِنْهُمْ ۗ وَلَوْلَا فَضْلُ اللَّهِ عَلَيْكُمْ وَرَحْمَتُهُ لَاتَّبَعْتُمُ الشَّيْطَانَ  
إِلَّا قَلِيلًا ﴿٨٧﴾

"Kur atyre u vjen ndonjë lajm i rëndësishëm që ka të bëjë me sigurinë, ose frikën, ata e përhapin (pa e vërtetuar mirë). Por në qoftë se këtë lajm do t'ia përcillnin (për shqyrtim) të Dërguarit dhe parisë, hulumtuesit do ta merrnin vesh prej tyre (se çfarë lajmi duhet përhapur e çfarë jo). Sikur të mos ishte mirësia e Allahut dhe mëshira e Tij, ju të gjithë do të ndiqnit djallin, përveç një numri të vogël."

Kuran: En-Nisa, 83.

Dijetari Abdurrahman Ibën Seadi [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Duhet që njerëzit t'i referohen dijetarëve në kohë gëzimesh apo trazirash. Ata nuk duhet të nxitohen në shfrenim, qoftë ai gëzim apo frikë. Njerëzit duhet të rikthehen



tek porositi e Allahut të Madhëruar dhe dijetarëve, të cilët kanë mundësi të japin zgjidhje të dobishme në menaxhimin e krizave. Nga këtu ka lindur parimi juridik që thotë: Çdo çështje e re që ndodh, duhet pikësëpari të dërgohet për shqyrtim tek dijetarët përpara se të publikohet.

Kur ndodh diçka e papritur apo një çështje e re në shoqërinë islame, nuk duhet të nxitojmë menjëherë në gjykimin dhe përhapjen e saj. Fillimisht iu duhet lënë dijetarëve që të japin mendimin e tyre në lidhje me këtë çështje, sepse janë ata që kanë mundësi në mënyrë të drejtë të nxjerrin përfundimet e duhura për këto çështje, dobitë e tyre dhe reagimet që duhet të ketë shoqëria ndaj tyre.<sup>(291)</sup>

Arsyet e referimit tek dijetarët:

**Arsyeja e parë:**

Dijetarët kanë mundësi ta shqyrtojnë çështjen duke përdorur metodat e nevojshme për to, siç janë:

- 1- Referimi në argumentet e jurisprudencës islame dhe parimeve të saj.
- 2- Peshohet çështja me qëllimet e Jurisprudencës Islame.
- 3- Peshohet çështja ndërmjet dobive dhe dëmeve.
- 4- Referohen argumentet shpjeguese.

Këto metoda nuk mund të përdoren nga njerëzit e rëndomtë, por as nga studentët e diturisë, pasi këto janë çështje që kërkojnë thellim në dituri dhe përvojë të gjatë.

Nuk mundet që çdokush të bëjë analizën e jurisprudencës dhe metodës së arritjes së qëllimeve dhe zgjidhjes së problemeve shoqërore. Këtë nuk mund ta arrijë askush, që nuk është i thelluar në dituri, i rrahur me përvojën në shoqëri dhe analist i hipotezave të ndryshme për zgjidhje.

Marrja e vendimeve duke peshuar mirë dobitë dhe dëmet, kërkon një kuptim të thellë të Jurisprudencës Islame dhe qëllimeve të saj. Kërkon gjithashtu edhe njohjen e thellë të ngjarjeve që kanë ndodhur dhe ato që mund të ndodhin apo pasojat e tyre.

Hidri (*paqja qoftë mbi të*) kishte njohuri më të thella për pasojat e disa ngjarjeve, të cilat Musai (*paqja qoftë mbi të*) nuk i dinte.

---

<sup>(291)</sup> - Shejkh Abdurahman Es-Sadij, "Tejsir El-Kerijm Er-Rrahman", vëllimi: 2, faqja: 54-55.

Nga historia e tyre dijetarët kanë nxjerrë parimin e artë të Jurisprudencës “Lejohet shmangja e të keqes më të madhe me një të keqe më të vogël” .

Shembull për këtë është rasti kur Hidri dëmtoi anijen e peshkatarëve. Sigurisht në pamje të parë, Musai (*paqja qoftë mbi të*) e pa këtë si një veprim të gabuar. Mirëpo ai nuk e dinte atë që Hidri (*paqja qoftë mbi të*) dinte. Ai nuk e dinte, që mbreti i atij vendi po konfiskonte çdo anije të përshtatshme për luftën e tij. Ndërkohë që ky konfiskim do t'i dëmtonte më shumë peshkatarët e varfër, pasi do t'i linte ata pa mjetin e tyre të jetesës. Me dëmtimin e anijes mbreti e pa që ky nuk ishte një mjet i përshtatshëm për luftën e tij. Nga ana tjetër riparimet që i bënë peshkatarët asaj bëri që kjo anije të qëndronte në duart e tyre, si mjet për të siguruar jetesën.

Kështu Musai (*paqja qoftë mbi të*) dhe historia e tij me mësuesin e tij (Hidrin) na jep të kuptojmë se çështjet mund të kenë prapavijat e tyre dhe ndonjëherë zgjidhjet permanente mund të mos jenë aq të mira në dukje, por gjithsesi ato janë më të mira, nëse do të arrinim të kuptojmë dëmet e mëdha që këto zgjidhje kanë mënjanuar.

Imam Neueuiu (631-676 Hixhri) [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Disa çështje të dukshme mund të jenë shumë të lehta për të marrë vendime për to. Kështu gjithkush mund të dijë gjykimin për Abdesin dhe Namazin, Alkolin apo Imoralitetin. Ndërsa çështje të tjera, më të vështira, të cilat janë shumë më tepër konfuze për shoqërinë, siç janë Lufta, Xhiahadi, Trazirat, apo çështje të tjera, kërkojnë analiza të thelluara. Atëherë këtu duhet t'iu referohemi dijetarëve, pasi vetëm ata munden të japin gjykimin e duhur.<sup>(292)</sup>

#### Arsyeja e dytë:

Zakonisht problemet më të mëdha në zbatimin e ligjeve vijnë nga vetë pushtetarët, për këtë arsye qytetarët e thjeshtë nuk kanë fuqinë e duhur ta bëjnë përmirësimin e tyre. Ata që me të vërtetë mund të ndikojnë në përmirësimin e pushtetarëve dhe zbatueshmërinë e ligjeve janë dijetarët. Janë ata që arrijnë të bëjnë ndryshimin me këshillat e nevojshme ndaj pushtetarëve dhe pastaj edhe me orientimin e masave në ndryshimin e nevojshëm. Nëse masat veprojnë të paorientuara, atëherë dëmi i reagimit të tyre mund të jetë më i madh sesa dobia.

<sup>(292)</sup> - Imam En-Neueui "Sherhu Sahih Muslim", vëllimi: 2, faqja: 23.



**Arsyeja e tretë:**

Nëse masat e njerëzve do të merrnin përsipër vetë zgjidhjet e problemeve do të krijohesh një kaos i madh në marrëdhëniet shoqërore. Patjetër, sidomos në raste krizash duhet të jenë liderë të ditur ata që duhet të marrin frenat e drejtimit të shoqërisë në dorë dhe t'i japin drejtim asaj në ruajtjen e qetësisë dhe zgjidhjeve të problemeve. E kush më mirë se dijetarët mund ta bëjnë këtë gjë?... Dijetari Salih Ibën Feuzan (lindi 1354 Hixhri), [Allahu e ruajtë] thotë: Është detyrë e dijetarëve, që të jenë të qëndrueshëm dhe të mos nxitohen. Allahu i Madhëruar na ka urdhëruar, që të jemi të matur dhe të mos nxitohemi me popullin. Çështjet e drejtimit të shoqërisë duhet të lihen në dorë të dijetarëve dhe liderëve politikë, që bashkëpunojnë me dijetarët në dobi të popullit. Nuk lejohet që njerëz të rëndomtë të marrin në dorë çështjet e drejtimit të shoqërisë, pasi kjo do të krijonte kaos dhe do t'i hapte rrugë armiqve të vendit të realizonin planet e tyre ndaj kombit tonë.<sup>(293)</sup>

**Arsyeja e katërt:**

Arsye tjetër pse duhet t'iu referohemi dijetarëve në moment krizash, por edhe në kohë paqeje, është edhe fakti se janë ata që i dinë metodat e pengimit të së keqes dhe nxitjes së të mirës. Janë ata që e dinë, kur është e dobishme të ndërmerret ky veprim ose jo. Janë ata që e analizojnë një veprim të caktuar, nëse ai sjell apo nuk sjell pasoja më të mëdha në shoqëri. Këtë rol nuk mund ta ketë çdo individ në shoqëri. Ata që mundën ta bëjnë këtë janë vetëm dijetarët, që njohin ligjin e Allahut të Madhëruar dhe realitetin e shoqërisë në të cilin jetojnë.

**Arsyeja e pestë:**

Njerëzit që mund të përfaqësojnë një shoqëri janë dijetarët e saj. Nëse ata nderohen, edhe ajo shoqëri është e nderuar. Nëse ata përfillen nga shoqëria, edhe ajo shoqëri përfilllet nga pjesa tjetër e njerëzimit. Nëse dijetarët nuk merren për referencë dhe nuk respektohen nga një shoqëri e caktuar, as atë shoqëri nuk e respekton kush në mesin e kombeve të botës.

---

<sup>(293)</sup> - Shejkh Salih El-Feuzan, "Uuxhubu et-tethebuti fi el-Ehbari ue bejan mekeneh el-Ulema", faqja: 21.

## Kapitulli i nëntë: Askush nga dijetarët nuk ka shpëtuar nga shpifjet

Nëse hulumtojmë historinë islame, madje edhe nëse shohim në historinë njerëzore do të vërejmë se cilido që është shquar në shoqëri ka patur patjetër edhe kundërshtarët e tij, që kanë folur kundër. Edhe në umetin musliman, sa herë që ka patur një dijetar të shquar, ai ka qenë i rrethuar me njerëz që kanë folur për të ose kundër tij. Shumë e kanë lavdëruar, por edhe shumë e kanë kritikuar, madje dhe ofenduar.

Imam Edh-Dhehebi [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Njerëzit i gjykon vetëm Allahu i Madhëruar për të qartat dhe të fshehtat e tyre. Mirëpo duke qenë se Allahu i Madhëruar e ka vendosur Umetin Musliman si dëshmuar mbi të gjitha kombet njerëzore, atëherë gjykimi ndaj një personi është në varësi të gjykimit, që shoqëria islame ka për të. Nëse e tërë shoqëria Islame e njeh dikë, si një njeri të devotshëm dhe të mirë, atëherë çdo fjalë kundër tij nuk mund të ndikojë në jetëshkrimin e tij. Nga ana tjetër nëse një njeri njihet si jobesimtar dhe i pamoralshëm nga shoqëria islame, atëherë çdo fjalë pro tij nuk merret për bazë.

Ndërsa për njerëz, për të cilët mendimet e Umetit Musliman janë të ndryshme, ne duhet të mbajmë një qëndrim neutral. Jo duke i ofenduar, as duke i lavdëruar ata. Duhet t'ia lejmë Allahut të Madhëruar çështjen e tij për gjykim. Në këtë mënyrë zemra na qetësohet dhe nuk kemi pse fusim veten në çështje që nuk na përkasin.

Duhet të dimë se Umeti musliman (duke mos përfshirë këtu Sahabët) asnjëherë nuk ka qenë unanimisht pro ose kundër një njeriu të caktuar. Pavarësisht vlerave të tyre të dëshmuara nga Allahu i Madhëruar dhe Pejgamberi (paqja qoftë mbi të), njerëzit kanë përfolur edhe Ebu Bekrin,



Umerin, Othmanin, Aliun, Ibën Zubejrin<sup>(294)</sup> (Allahu qoftë i kënaqur prej tyre). Kanë folur edhe për Haxhaxhin, Memunin (170-218 Hixhri), Bishr El Merisiun (138-218 Hixhri), Ahmed Ibën Hambelin, Shafiun, Bukhariun, Nesaiun, e të tjerë në kohë të hershme e në kohë të vona. Edhe sot nuk gjen një njeri me vlera, e që të mos ketë injorantë nga mesi i muslimanëve, që të zhyten në ofeza ndaj tij. Këta janë kategori e njeriut ekstrem. Ashtu sikurse ka edhe ekstremistë të tjerë nga ana tjetër, që në injorancë janë ndjekës të verbër. Mirëpo fjala përfundimtare i mbetet Dijetarëve të Umetit. Janë ata që arrijnë të vlerësojnë figurat e Umetit Musliman dhe liderët e tyre.

Dituria është një dritë që Allahu i Madhëruar e hedh në zemrën e kujtdo që Ai dëshiron. Kështu do të ishte më mirë për individët të qëndrojnë larg gjykimit të njerëzve. Nëse je larg këtyre gjykimeve të jesh i sigurtë, që Allahu i Madhëruar nuk ka për të të pyetur ty për këtë.<sup>(295)</sup>

Kënaqësia e të gjithë njerëzve është një mision i pamundur. Nuk është e mundur asnjëherë të shpëtosh nga fjalët e njerëzve.

Imam Shafiun [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Asnjëherë nuk ka shpëtuar kush nga fjalët e njerëzve. Prandaj mos humb kohë, por shiko çfarë të bën dobi dhe futju punës.<sup>(296)</sup>

Nëse personi i përfolur është njeri i keq, atëherë Allahu i Madhëruar ka për ta demaskuar atë dhe të vërtetën e tij dhe do ta bëjë mësim për shoqërinë. Edhe e kundërta vlen. Nëse personi i përfolur është një njeri i mirë, Allahu i Madhëruar asnjëherë nuk e ka lënë pa e nderuar atë në shoqërinë e tij. Nëse një njeri përpiket të jetë i devotshëm me Allahun e Madhëruar, atë e nderon vetë Allahu. E nëse Allahu i Madhëruar e nderon dikë, çdo fjalë që flitet kundër tij, nuk ndikon në personalitetin e tij.

---

<sup>(294)</sup> - *Abdullah Ibën Zubejri*, Sahab [shok] i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) lindi në vitin e parë të Hixhretit. Madje u quajt përgëzimi i muslimanëve, pas fjalëve që ishin përhapur se muslimanët nuk mund të lindin fëmijë prej një mallkimi të idhujve kurejshitë. Ai bëri një jetë aktive islame. Mori pjesë në disa beteja të muslimanëve. Ai u caktua Khalif [prijës] i muslimanëve pas vdekjes së Muauije Ibën Jezid Ibën Muauijes. U vra nga Haxhaxh Ibën Jusuf Et-Thekafiu në vitin 73 Hixhri pas një rrethimi të tij në Mekë. (sh.p).

<sup>(295)</sup> - Imam Edh-Dhehebi, "Sijer Ealam en- Nubela", vëllimi: 14, faqja: 343-345.

<sup>(296)</sup> - Imam El-Bejhaki, "Edeb es- Shafij", faqja: 278-279. Imam Edh-Dhehebi, "Sijer Ealam en-Nubela", vëllimi: 10, faqja: 42 dhe vëllimi: 10, faqja: 89.



Imam Husejn El-Kerabisiu (ndërroi jetë në vitin 245 Hixhri) [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Ata që flasin kundër Imam Ahmed Ibën Hambelit iu ngjajnë atyre, që duan të shembin malin Ebu Kubejs me pandoflat e veta.<sup>(297)</sup>

Imam Edh-Dhehebi [Allahu e mëshiroftë] ka thënë për Imam Shafiun: Disa njerëz e kanë përfolur Imam Shafiun me mllef dhe inat. Mirëpo Allahu i Madhëruar e ka nderuar imam Shafiun, duke bërë që mbrojtjen e nderit të tij ta bënin shumë dijetarë të tjerë. Ata i kanë rrëzuar të gjitha kritikatat e pabaza ndaj Imamit të nderuar. Kështu Allahu i Madhëruar vepron duke mbrojtur të dashurin e Tij dhe duke rrëzuar të gjithë ata që mundohen të hedhin baltë mbi të.<sup>(298)</sup>

Ai gjithashtu ka folur edhe për Imam Fudejl Ibën Ajadin [Allahu e mëshiroftë] duke thënë: Nëse njerëzit kanë përfolur personalitete të mëdha të Islamit, si Fudejl Ibën Ajadi, atëherë kush mbeti pa u përfolur? E kush mund të shpëtojë nga gjuhët e njerëzve? Por ai njeri, i cili është i njohur për vlerat dhe diturinë që ka, nuk i bëjnë dëm përgojimet e njerëzve ndaj tij. Asnjëherë përgojimi i dijetarëve nuk ka qenë serioz dhe i përfillshëm nga njerëzit me logjikë dhe ndërgjegje të shëndoshë.<sup>(299)</sup>

Zakonisht qëndrimi më i drejtë ndaj përgojimit të dijetarëve është verifikimi i këtyre akuzave. Çdokush mund të përhapë fjalë ndaj dikujt tjetër. Mirëpo në Islam ekziston një parim dhe një vlerë, që secili musliman duhet ta ketë gjithmonë parasysh 'Vërtetimi'. Çdo musliman i devotshëm duhet të mos nxitohet në përhapjen e akuzave apo në gjykimin ndaj dikujt tjetër, sidomos ndaj një dijetari. Ai më përpara duhet t' i verifikojë ato akuza të ngritura dhe për këtë duhet të kthehet tek dijetarët.

Në të gjitha rastet është më mirë të mos përzihemi në çështje të gjyqimit të dijetarëve, duke qëndruar larg edhe përhapjes dhe verifikimit. Vetëm në dy raste verifikimi është i domosdoshëm :

**Rasti i parë:** Kur përhapet një fjalë kundër një dijetari, atëherë i bie që ajo patjetër të jetë e shoqëruar ose me moralin e prishur të thënësit të saj, ose me pavërtetësinë e saj në raport me realitetin.

(297) - Imam Edh-Dhehebi, "Sijer Ealam en-Nubela", vëllimi: 11, faqja: 204.

(298) - Imam Edh-Dhehebi, "Sijer Ealam en-Nubela", vëllimi: 10, faqja: 8-9.

(299) - Po aty, vëllimi: 8, faqja: 448.



Në origjinë dijetarët janë të besueshëm dhe të ndershëm, për këtë dëshmon i gjithë umeti musliman. Ai që e kundërshton këtë duhet të ketë argumente të forta. Ndryshe akuza e tij llogaritet si njollë në personalitetin e akuzuesit.

Allahui i Madhëruar thotë në Kuran:

يَتَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا إِن جَاءَكُمْ فَاسِقٌ بِنَبَأٍ فَتَبَيَّنُوا أَن تُصِيبُوا قَوْمًا بِجَهَالَةٍ فَتُصْبِحُوا عَلَىٰ مَا  
فَعَلْتُمْ نَادِمِينَ ﴿٦١﴾

"O. ju që keni besuar! Nëse ndonjë njeri i pandershëm ju sjell ndonjë lajm, sigurohuni mirë (në është i vërtetë), për të mos i bërë dëm ndokujt padashje, e të pendoheni pastaj për atë që keni bërë."

Kuran: *El-Huxhurat*, 6.

Imam Ibën Xherir Et-Taberiu (224-310 Hixhri) [Allahu e mëshiroftë] në komentin e tij për këtë ajet, ka thënë: Mos nxitoni. Sigurohuni më parë për vërtetësinë e lajmit dhe mos shpejtoni në përhapjen e tij dhe as mos merrni qëndrime pa i vërtetuar ato lajme, sepse ndodh që ju të dëmtoni njerëz pa të drejtë. Ndoshta lajmi ka qenë i pavërtetë dhe ju do të pendoheni për veprimin tuaj të nxituar kundër njerëzve të pafajshëm.<sup>(300)</sup>

Rasti i dytë: Në kohë trazirash dhe krizash, kur çështjet janë të paqarta, kur shpifjet dhe gënjeshttrat janë diskutimi i ditës, atëherë muslimanët nuk duhet të nxitohen në përcjelljen e fjalëve që dëgjojnë.

Allahu i Madhëruar thotë në Kuran:

وَإِذَا جَاءَهُمْ أَمْرٌ مِّنَ الْأَمْنِ أَوْ الْخَوْفِ أَذَاعُوا بِهِ ۗ وَلَوْ رَدُّوهُ إِلَى الرَّسُولِ وَإِلَىٰ أُولِي الْأَمْرِ  
مِنْهُمْ لَعَلِمَهُ الَّذِينَ يَسْتَنْبِطُونَهُ مِنْهُمْ ۗ وَلَوْلَا فَضْلُ اللَّهِ عَلَيْكُمْ وَرَحْمَتُهُ لَاتَّبَعْتُمُ الشَّيْطَانَ  
إِلَّا قَلِيلًا ﴿٨٢﴾

<sup>(300)</sup> - Imam Et-Tabariu, "Xhemiu el-Bejan", vëllimi: 26, faqja: 123-125.

"Kur atyre u vjen ndonjë lajm i rëndësishëm që ka të bëjë me sigurinë ose frikën, ata e përhapin (pa e vërtetuar mirë). Por në qoftë se këtë lajm do t'ia përcillnin (për shqyrtim) të Dërguarit dhe parisë, hulumtuesit do ta merrnin vesh prej tyre (se çfarë lajmi duhet përhapur e çfarë jo). Sikur të mos ishte mirësia e Allahut dhe mëshira e Tij, ju të gjithë do të ndiqnit djallin, përveç një numri të vogël."

*Kuran: En-Nisa, 83.*

Ky ajet ka zbritur për shkak se kishte prej muslimanëve, që kur merrnin vesh lajmin se ushtria muslimane po vinte si fitimtare, menjëherë fillonin të përhapnin lajmin. Pa pritur që komandanti i ushtrisë të raportonte tek Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) dhe pa pritur prononcimin e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) për këtë ngjarje. Në fakt duhej të bënin të kundërtën. Ata duhej të prisnin që Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) të dilte dhe të jepte lajmin.<sup>(301)</sup>

Në kohë trazirash ato që përhapen më shumë janë gënjeshtret dhe shpifjet. Madje këto shpifje përqendrohen më shumë tek liderët e shoqërisë, tek dijetarët e saj dhe tek ata njerëz që janë burim frymëzimi për shoqërinë. Shembull për këtë kemi trazirat në kohën e Sahabëve 35-73 Hixhri [Allahu qoftë i kënaqur me ta], kur persona përçarës shpifën ndaj personaliteteve më të larta të Sahabëve. Ishin këto shpifje që çuan në trazira shumë të mëdha, dhe si rezultat i të cilave shumë prej Sahabëve u sakrifkuan padrejtësisht.<sup>(302)</sup>

Dr. Mustafa Es-Sibai (1330-1384 Hixhri) [Allahu e mëshiroftë] ka thënë në librin e tij "Moralet tona shoqërore": Masat e njerëzve gjithmonë janë më të nxitueshëm në lajmet e këqija, se me lajmet e mira. Kështu nëse dëgjon një fjalë të keqe të flitet mos e beso atë, edhe nëse sheh njëmijë njerëz të flasin me to, derisa të bindesh se e kanë parë me sy. Edhe nëse e kanë parë me sy, mos u bind për të derisa të vërtetosh objektivitetin e njeriut që akuzon. Për këtë arsye është më mirë për ty, që të mos i ndjekësh këto fjalë. Sidomos kur ato janë

<sup>(301)</sup> - Imam Ibën Abd El-Berr, "Xhemiu el-Bejan", vëllimi: 5, faqja: 180.

<sup>(302)</sup> - Për më shumë rreth kësaj teme referohu librit "Islami në kohë trazirash", Eduart Thartori. (sh.p).



thjesht hipoteza, pasi Allahu i Madhëruar i ka cilësuar hipotezat të pavlefshme për t'u argumentuar.<sup>(303)</sup>

Mosnxitimi deri në vërtetimin e lajmeve është argument i devotshmërisë së njeriut dhe pastërtisë së tij. Ai kështu e ruan veten e tij dhe nderin në futjen në rrugë të mjegullta, për të cilat Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) na ka porositur të qëndrojmë larg.

Vërtetim do të thotë, që të shqyrtohet mirë transmetuesi i lajmeve sidomos atyre lajmeve të këqija. Nëse përcjellësi i ka kuptuar si duhet ato lajme? Ose nëse ka qenë me të vërtetë objektiv në transmetimin e tyre? Ose nuk ka patur qëllime të këqija, inate dhe zili etj.

Shejkh El-Islam Ibën Tejmije [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Shumë njerëz që na sjellin lajme, nuk kanë qëllim të na gënjejnë. Mirëpo ndodh në shumë raste, që njerëzit nuk i kuptojnë si duhet ato lajme dhe për këtë arsye, ato që vijnë tek ne janë ndryshe nga realiteti i tyre.<sup>(304)</sup>

Imam Es-Sebeki [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Shpesh ndodh edhe me nxënësit e diturisë. Jo gjithmonë ata e kuptojnë si duhet fjalën e profesorëve të tyre. Për këtë arsye ata gabojnë në shpjegimin e drejtë të mësimëve që marrin nga profesorët e tyre, madje edhe në gjykimin e tyre ndaj librave, apo shkrimtarëve të tyre. Ka prej tyre që duke komentuar një temë të caktuar, gabojnë në botëkuptimin e tyre të asaj teme dhe e ndryshojnë krejtësisht nga ajo çfarë ka dashur të thotë autori.<sup>(305)</sup>

---

<sup>(303)</sup> - Mustafa Es-Sibai "Ahlakuna el-Ixhtimaije", faqja: 60.

<sup>(304)</sup> - Shejkh El-Islam Ibën Tejmije "El-Fetauea", vëllimi: 6, faqja: 303.

<sup>(305)</sup> - Imam Es-Sebkij "Kaidetu fi el-Xherhi ue et-Teadil", faqja: 93.

## Kapitulli i dhjetë: Marrja në referencë e mirësive të dijetarëve para gjykimit ndaj tyre

Gabimi është në natyrën njerëzore. Është e pranueshme nga logjika, nga legjislacioni dhe nga historia se njerëzit janë gabimtarë, përveç Pejgamberëve (*paqja qoftë mbi ta*) në mesazhet hyjnore. Kështu gabimi është në natyrën njerëzore. Ama njerëzit ndahen në dy kategori përse i përket gabueshmërisë së tyre.

Kategoria e Parë: Njerëzit që gabojnë, por që në krahasim me saktësinë e tyre, gabimet janë shumë pak dhe të papërfillshme. Në këtë rast ata konsiderohen të saktë dhe të besueshëm.

Kategoria e dytë: Njerëzit që gabimet e tyre janë shumë më të mëdha se saktësia e tyre. Në këtë rast ata konsiderohen të pasaktë dhe të pabesueshëm. Dijetarët bëjnë pjesë në kategorinë e parë të njerëzve përse i përket besueshmërisë së tyre. Dijetarët janë njerëzit më të zgjedhur të umetit musliman dhe ajka e tij.

Shejkh El-Islam Ibën Tejmije [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Dijetarët e popujve të mëparshëm kanë qenë njerëzit më të korruptuar të shoqërisë, ndërsa në Umetin Musliman dijetarët janë njerëzit më të zgjedhur dhe më të devoshëm. Ata janë që e përcollën ndershmërisht traditën e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) në ditët tona. Për ta ka folur Kurani dhe ata kanë folur për Kuranin.<sup>(306)</sup>

Meqë dijetarët kanë këtë pozicion të nderuar, në lidhje me Allahun e Madhëruar, pastaj edhe me Umetin Musliman, atëherë gabimet e tyre janë të papërfillshme dhe nuk duhet të llogariten përpara mirësive dhe shërbimeve të tyre ndaj Umetit.

<sup>(306)</sup> - Shejkh El-Islam Ibën Tejmije, "Refau el-Melam", faqja: 11-12.



Sejid Ibën Musejibi (19-94 Hixhri) [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Nuk mund të përjashtohet asnjë dijetar nga gabimi, por gjithmonë në gjykimin ndaj njeriut vihen në peshore të mirat dhe të këqijat e tij. Nëse të mirat e tij janë më të shumta se të këqijat, atëherë këto të këqija fshihen nga të mirat e tij. Edhe e kundërta vlen. Nëse të këqijat janë më të shumta se të mirat, atëherë mirësitë e këtij njeriu humbasin.<sup>(307)</sup>

Në të njëjtin kontekst dijetari Ibën Abd El-Berri (368-463 Hixhri) [Allahu e mëshiroftë] ka transmetuar thënien e dijetarëve të hershëm: Askush nuk mund të jetë i mbrojtur nga gabimet. Por ai që në pjesën më të madhe të mësimeve të tij është i saktë, atëherë konsiderohet i ditur. Nëse gabueshmëria e tij është më e madhe se saktësia, atëherë ky njeri nuk konsiderohet dijetar.<sup>(308)</sup>

Imam Sufjan Eth-Theuri [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Dijetari nuk mund të shpëtojë nga gabimet, por nëse ai njihet si një njeri që mban mend mirë dhe ka dituri, atëherë ai quhet dijetar. E nëse njihet si një njeri që ka probleme me kujtesën, atëherë fjalët e tij nuk duhet të merren për bazë.<sup>(309)</sup>

Imam Ibën Hibani [Allahu e mëshiroftë] thoshte: Nuk është e drejtë, që të mos përfillen dituria e dikujt, që është shquar për vlerat dhe mundin e tij dhënë në dobi të diturisë Islame dhe shoqërisë. Nëse do të ecnim me këtë logjikë, atëherë do të linim pas dore Zukhriun, Ibën Xhurejxin, Theuriun dhe Shuaben. Pasi këta ishin njerëz që e kishin të gjithë diturinë e tyre përmendësh. Relativisht ata nuk është e thënë, se në transmetimet e tyre të mos kenë gabuar asnjëherë, por kjo nuk ua ul aspak vlerat atyre. Në rast gabimi mund të lejmë këtë transmetim të gabuar dhe të marrim të saktat, por nuk mund të lejmë aspak pas dore dijetarin në fjalë.<sup>(310)</sup>

Ibën Kajim El-Xheuzije [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: ... Kush e di thelbin e Sheriatit dhe diturisë Islame e kupton fare mirë, se Njeriu dijetar në Islam ka vlerën dhe pozitën e tij të nderuar. Mirëpo kjo nuk do të thotë, se ai në gjykimin e tij mund të mos gabojë asnjëherë. Përkundrazi çdo njeri gabon, por ndryshe nga të tjerët për dijetarin e Islamit ka tjetër gjykim. Nëse ai gabon ai

(307) - Imam Ibën Abd El-Berr, "Xhemiu Bejani el-Ilmi ue Fadlihi", vëllimi: 2, faqja: 48.

(308) - Po aty, vëllimi: 2, faqja: 48.

(309) - Imam Khatib El-Bagdadi, "El-Kifaje", faqja: 174.

(310) - Imam Ibën Ibad, "Et-Thikat", vëllimi: 7, faqja: 97-98.



përsëri është i shpërblyer nga Allahu i Madhëruar për përpjekjen e tij, që të jetë i saktë me të vërtetën, edhe pse në gjykimin e tij ai nuk duhet të ndiqet. Ama kjo nuk ia ul aspak vlerën e dijetarit dhe respektin e tij në sytë e muslimanëve.<sup>(311)</sup> Ai gjithashtu shton: Sikur prej gabimit në një çështje të mënjanoheshin dituritë e njerëzve, atëherë të gjitha shkencat do të shkatërroheshin dhe çdo dituri do të shpërbëhej.<sup>(312)</sup>

Imam Ibën Rexhebi thotë: Është e drejtë që njeriut me vlera të mëdha t'i falen disa gabime të vogla.<sup>(313)</sup>

Imam Edh-Dhehebi [Allahu e mëshiroftë] thoshte: E duam Sunetin e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) dhe këdo që e praktikon atë. I duam dijetarët dhe i respektojmë për vlerat që kanë. Sigurisht secili mund të ketë të metat e tij, por vlera e njeriut fitohet nga mirësitë e shumta që ka.<sup>(314)</sup>

Në biografinë e Imam Muhamed Ibën Nasir El-Meruzit (202-294 Hixhri), Imam Edh-Dhehebi thotë: Sikur ne ta hidhnim poshtë çdo dijetar për një gabim në gjykimin e çështjeve, ta akuzonim atë për bidate apo ta ofendonim, nuk kishte për të shpëtuar as Ibën Nasiri, as Ibën Mundihu, as shumë të tjerë më të njohur se ata. Mirëpo Allahu i Madhëruar është Ai që udhëzon njerëzit në rrugë të drejtë dhe është më i Mëshirshmi. Pra, Allahu na ruajtë nga devijime të tilla dhe nga ashpërsia.<sup>(315)</sup>

Në biografinë e Imam Ibën Huzejmes<sup>(316)</sup> [Allahu e mëshiroftë] do të thoshte: Nëse do të hidhnim poshtë vlerat e tij, por edhe të secilit që mund të ketë

<sup>(311)</sup> - Imam Ibën Kajim, "Talam el-Muvekiine", vëllimi: 3, faqja: 283.

<sup>(312)</sup> - Imam Ibën Kajim, "Medarixhu es-salikin", vëllimi: 2, faqja: 39.

<sup>(313)</sup> - Imam Shemsudijn El-Asfahani, "El-Kauaid", faqja: 3.

<sup>(314)</sup> - Imam Edh-Dhehebi, "Sijer Alam en-Nubela", vëllimi: 20, faqja: 46.

<sup>(315)</sup> - Imam Edh-Dhehebi, "Sijer Alam en-Nubela", vëllimi: 14, faqja: 40.

<sup>(316)</sup> - *Ibën Khuzejme*, lindi në vitin 223 Hixhri (838 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin e 311 Hixhri (923 Diellor). Emri i tij është Muhamed ibën Is'hak ibën Khuzejme, Ebu Bekri, hafëz, argument, dijetar i madh i fikhut dhe hadithit, njohës shumë i mirë i transmetuesve të haditheve, i titulluar shejku (dijetari i madh) i Islamit, imam (lider) i imamëve (i liderëve), nga Nejséburi. Ai është autor i shumë përpilimeve dhe një prej dijetarëve më të shquar të hadithit. Që në vegjëli u preokupua me hadithin dhe fikhun, aq sa shërbeu si model me të cilin jepej shembull sa i përket diturisë së gjerë dhe perfeksionimit. Ai udhëtoi në Sham, Irak, Egjipt dhe Gadishullin Arabik. Hafëz Ebu Ali En-Nejséburi ka thënë për të: "Nuk kam parë askënd sikurse Ibën Khuzejme". Edh-Dhehebiu ka thënë: "Ai (Hafëz Ebu Ali En-Nejséburi) e thotë këtë gjë, porse ai ka parë En-Nesaiun". Ed-Derakutni ka thënë: "Ishte imam (lider) konsekuent dhe nuk kishte



ndonjë gabim në gjykimet e tij, atëherë do të hidhnim poshtë shumë dijetarë dhe shumë dituri. Allahu i Madhëruar i mëshiroftë të gjithë dijetarët tanë dhe ua faltë gabimet atyre.<sup>(317)</sup>

Ndërsa për Katade Ibën Deamen [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Allahu i Madhëruar ndoshta ua ka falur disave si puna e tij, edhe nëse kanë bërë ndonjë gabim në gjykim, Sepse qëllimi i tyre ka qenë dashuria dhe respekti i Allahut të Madhëruar. Nuk duhet të harrojmë që Allahu i Madhëruar është Mëkatfalës, Mëshirues, dhe i Butë me robërit e Tij të devotshëm. Në rastin e Katade Ibën Deames, një kolosi të tillë të diturisë, të cilit i njihen vlerat dhe munda në shkencë, i njihet devotshmëria, i njihen ndikimet që ka patur. Një njeri i tillë nuk mund të hidhet poshtë thjesht për një gabim të rastit. Sigurisht nuk mund ta ndjekim atë në gabimet e tij, por edhe vlerat e tij nuk mund të anashkalohen.<sup>(318)</sup>

Në biografinë e Imam Bishr Ibën El-Uelid El-Kindit (150-238 Hixhri) [Allahu e mëshiroftë] Imam Edh-Dhehebi ka thënë: Ai ishte njeri me emër të mirë në shoqëri, edhe pse kishte aty këtu ndonjë të metë, ai prapë konsiderohet nga vlerat e dijetarëve të umetit.<sup>(319)</sup>

Ndodh që punët e mira të njeriut që ka bërë në të kaluarën mund të jenë të tilla, që e mbrojnë atë nga pasojat e liga të një pune të keqe, që ai bën në të ardhmen. Shembull për këtë kemi rastin e Khatib Ibën Belteas [Allahu qoftë i kënaqur pre tij]<sup>(320)</sup>, njërit prej sahabëve [shokë] të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*).

---

shembull". Ibën Hibani ka thënë: "Nuk kam parë në fytyrën e tokës dikë të memorizoj produksionin e suneteve (të traditës profetike), të memorizoj artikulumet e haditheve autentike dhe shtojcat e tyre, aq sa sunetet sikur ishin midis dy syve të tij, përveçse Ibën Khuzejmes". Përpilimet e tij kanë arritur në 140, prej të cilave përmendim: "Et-Teuhid ue Ithbetu Sifati er-Rabi", "Mukhtesar el-Mukhtesar" si dhe "Sahih ibën Khuzejme". Ibën Khuzejme [Allahu e mëshiroftë!] jetoi tetëdhjetenëntë vite [Shih: "El Ea'lem" me autor Ez-Zirikliu (i cili ndërroi jetë në vitin 1396 Hixhri) dhe "Sijaru Ealemi en Nuebelei" me autor Edh-Dhehebiu (ndërroi jetë në vitin 748 Hixhri). (sh.p.).

<sup>(317)</sup> - Imam Edh-Dhehebi, "Sijer Alam en-Nubela", vëllimi: 14, faqja: 374.

<sup>(318)</sup> - Imam Edh-Dhehebi, "Sijer Alam en-Nubela", vëllimi: 5, faqja: 271.

<sup>(319)</sup> - Imam Edh-Dhehebi, "Sijer Alam en-Nubela", vëllimi: 10, faqja: 674.

<sup>(320)</sup> - *Hatib Ibën Belteas*, Sahab [shok] i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Mori pjesë në luftën e Bedrit dhe në disa luftime të tjera. Ndërroi jetë në vitin 30 Hixhri. (sh.p).

Ali Ibën Ebi Talibi [Allahu qoftë i kënaqur prej tij] tregon, se u urdhërua nga Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*), që të shkante bashkë me dy shokë të tij në ndjekje të një gruaje, e cila mbarte me vete një letër porosi për Kurejshët. Ajo ishte dërguar nga Khatib Ibën Beltea, i cili paralajmëronte kurejshët për një sulm të mundshëm nga muslimanët kundër tyre, çështje kjo që kishte të bënte me sekret shtetëror për muslimanët dhe sigurinë e tyre.

Ata arritën ta gjenin këtë grua duke udhëtuar drejt Mekës dhe e ndaluan. Menjëherë e urdhëruan t'ua dorëzonte letrën që mbante. Mirëpo ajo e mohoi të kishte ndonjë letër me vete. Atëherë Aliu i tha: Nëse ti, nuk do të na e dorëzosh atë letër me dëshirë, atëherë ne do të ta marrim me pahir. E frikësuar gruaja ia dorëzoi letrën Aliut, në të cilën lexohej mesazhi i paralajmërimit për kurejshët, i firmosur nga Khatib Ibën Beltea. Menjëherë Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) e thirri Khatibin për këtë çështje. Umer Ibën Khatabi [Allahu qoftë i kënaqur me të], i cili ishte i pranishëm kërkoi leje ta vriste Khatibin, për shkak të tradhtisë së tij. Mirëpo Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) e pyeti Khatibin, përse e kishte bërë këtë veprim. Ai u justifikua duke thënë, se nuk kishte asnjë mungesë besimi ndaj Allahut të Madhëruar apo Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*), por atje në Mekë kishte familjen dhe nuk donte që kurejshët t'i dëmtonin ata. Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) e pranoi justifikimin e tij, edhe pse veprimi ishte i pajustificueshëm. Arsyeja përse Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) e fali atë ishte, se Khatib Ibën Beltea kishte marrë pjesë në Luftën e Bedrit. Të gjithë ata që kishin marrë pjesë në Luftën e Bedrit<sup>(321)</sup> kanë vlera shumë të mëdha, aq sa Allahu i Madhëruar ua ka falur çdo gjynah atyre, që kishin bërë në të shkuarën, por edhe ato që do të bënin në të ardhmen. Allahu i Madhëruar i ka përgëzuar ata me Xhenet, sa ishin gjallë në këtë botë. Pas këtij momenti kur Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) tregoi për vlerat e luftëtarëve të Bedrit, Umerit i lotuan sytë nga mallëngjimi.<sup>(322)</sup>

<sup>(321)</sup> - Bedër, beteja e parë e muslimanëve me mosbesimtarët kurejshitë. Ata u përballën në zonën e quajtur burimet e Bedrit. Në këtë përballje muslimanët fituan ndaj kurejshëve dhe aty mbetën të vrarë pothuajse të gjithë liderët e tyre, të cilët ishin edhe nxitësit e kësaj lufte kundër Islamit dhe muslimanëve. Ndodhi në vitin e dytë Hixhri. (sh.p).

<sup>(322)</sup> - Këtë histori e ka transmetuar Imam El-Bukhari, vëllimi: 4, faqja: 19 në kapitullin e Xhihadit, Paragrafi i Spiunimit. Bukhariu e përmend edhe në vëllimi: 5, faqja: 89 në kapitullin e mirësive të luftëtarëve të Bedrit. Muslimi, numri i hadithit 1941 dhe 2494,



Po kështu kemi shembullin e Othman Ibën Afanit <sup>(323)</sup> (Allahu qoftë i kënaqur prej tij), i cili përgatiti Ushtrinë e Usres. Ai dhuroi njëmijë dinarë floriri për përgatitjen e bazës materiale të ushtrisë. Kjo bëri që Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) të thoshte për Othmanin: “{Asgjë e keqe që Othmani mund të bëjë në të ardhmen nuk ka për të ndikuar në mirësitë e tij}”.<sup>(324)</sup>

Imam Ibën Kajim El-Xheuzije [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Ndër parimet e Jurisprudencës Islame dhe urtësisë është edhe parimi i peshores ndaj të mirave dhe të këqijave. Atij, të cilit të mirat i peshojnë shumë më tepër, se sa të këqijat dhe ka një kontribut të njohur në Islam mund t' i falen disa pasaktësi, gjëra të cilat nuk mund t' i falen të tjerëve. Përfundimisht i falen të metat më shumë, se mund t' i falen dikujt tjetri që nuk i ka vlerat e tij. Sepse edhe uji nëse arrin nivelin e dy Kiletejn (njësi matëse e barabartë me 203.125 litra ujë), atëherë nuk mund të ndikohet nga pak ndyrësi. Ndryshe nga uji që është më i pakët. Ai nuk mund të pranojë asnjë ndyrësi mbi të, pasi menjëherë do të ndryshohej. Historia e Khatib Ibën Beltas, që përmendëm më sipër është referencë për këtë parim.

Njësoj me këtë mund të përmendim edhe historinë e Musait (*paqja qoftë mbi të*), i cili në zemërim e sipër hodhi në tokë pllakat e urdhresave të Allahut të Madhëruar. Shkak për zemërimin e tij ishte devijimi i popullit të Izraelit në paganizëm, pasi iu kishte ardhur udhëzimi nga Allahu i Madhëruar. Të gjitha mirësitë që ai kishte, të gjitha përpjekjet dhe sakrificat e tij për të përcjellë mesazhin e Allahut të Madhëruar tek Faraoni apo dhe peripecitë që iu desh të

në kapitullin e mirësive të sahabëve. Paragrafi i Luftëtarëve të Bedrit. Ebu Daudi vëllimi: 3, faqja: 47, numri i hadithit: 2650 dhe 2651, në kapitullin e gjykimit të tradhtarit. Tirmidhiu, vëllimi: 5, faqja: 82 numri i hadithit: 3360, në kapitullin e Tefsirit të sures Mumtehine.

<sup>(323)</sup> - Othman Ibën Afani ishte Sahab [shok] i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Ai u martua me dy vajzat e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*), njëra pas tjetrës. Ishte Khalifi [prijësi] i tretë i drejtë. Ndër sahabët më të afërt të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*), ndër dhjetë të përgëzuarit me Xhenet. Ai mbeti i vrarë në trazirat që u zhvilluan në Medine, nga pushtimi i rebelëve që vinin nga Iraku dhe Egjipti. Ndërroi jetë në vitin 36 Hixhri. (sh.p).

<sup>(324)</sup> - Imam Ahmedi në “Musned”, vëllimi: 5, faqja: 63. Tirmidhiu, vëllimi: 5, faqja: 289 numri i hadithit: 3785 në kapitullin Menakib Othman Ibën Afan. Hakimi, vëllimi: 3, faqja: 102, kapitulli njohja e sahabëve, paragrafi i ushtrisë së Usres që ishte përgatitur nga Othmani. Tirmidhiu e konsideron këtë hadith si Hasen Garib (I mirë por i panjohur), ndërsa Hakimi dhe Dhehebiu mendojnë se ai është sahih (i saktë).

kapërcente, i fshinin atij edhe këtë mëkat, ndaj Allahut të Madhëruar me hedhjen në tokë dhe thyerjen e pllakave të urdhëresave.

Një poet do të shkruante:

*Nëse i dashuri do më vinte me një gabim*

*Do të vinin një mijë të mirat e tij si ndërmjetës.*

Një tjetër thoshte:

*Nëse një herë ai të dëshpëroi*

*Mos harro një mijë herët kur të ka gëzuar.*

Allahu i Madhëruar në Ditën e Gjykimit do të caktojë për çdo kënd një peshore, ku do të vihen në peshë të mirat dhe të këqijat e secilit. Atyre që u peshojnë më shumë të mirat do të jenë të shpëtuar, ndërsa atyre që të këqijat do t' u peshojnë më shumë do të jenë të humbur. Mirëpo ndërmjet tyre do të ketë edhe prej atyre njerëzve, që një vepër e mirë, edhe pse e paktë mund të bëhet shkak, që të përfitojë prej Allahut të Madhëruar falje dhe mëshirë.<sup>(325)</sup>

Kjo pra është peshore më të cilën mund të peshojmë drejt. Njeriu nuk mund të braktiset thjesht për një gabim të tij. Sidomos kur ai ka një kontribut të madh në Islam dhe në shoqëri. Kështu kur të vejmë në dukje të metat e dikujt që njihet si dijetar, kushtëzohet patjetër që të përmenden edhe mirësitë e tij. Ky kusht është edhe më i domosdoshëm, nëse kemi një ambjent të paformuar njerëzish, që mund të mos i kuptojnë drejt thelbin e diskutimit rreth dijetarit të përmendur.

<sup>(325)</sup> - Imam Ibën Kajim, "Miftar Dar es-Seadeh", vëllimi: 1, faqja: 176 - 177.





## Kapitulli i njëmbëdhjetë: Kujdesi në gjykimin e gabimeve të dijetarëve

Siç e cituam më lart dijetarët nuk janë njerëz të pagabueshëm. Si kushdo tjetër mund të gabojnë në gjykimet e tyre, ose edhe mund të harrojnë, të neglizhojnë e kështu me radhë. Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) ka thënë: “Çdo bir i Ademit<sup>(326)</sup> është gabimtar, por më i miri prej gabimtarëve është ai që pendohet”.<sup>(327)</sup>

Në komentin e këtij hadithi Imam Ibën Tejmije [Allahu e mëshiroftë] thotë: As besimtarët e drejtë, as dëshmorët në Rrugë të Allahut të Madhëruar, dhe as njerëzit e mirë nuk janë të pagabueshëm. E kemi fjalën që mund të bëjnë gabime të qarta. Ndërsa për çështje për të cilat ata përpiqen të japin gjykimin e tyre, ndodh që ata mund të jenë të saktë, por edhe mund të jenë të gabuar. Në rast se janë të saktë në gjykimin e tyre, atëherë ata marrin dy sevape. Për shkak të përpjekjes së tyre dhe për shkak të saktësisë së arritur. Mirëpo nëse nuk janë të saktë në gjykimin e tyre, atëherë ata marrin vetëm një sevap. Kjo si shpërblim i përpjekjes së tyre. Ndërsa gabimi i tyre në këtë rast nuk llogaritet i dënueshëm.<sup>(328)</sup>

---

<sup>(326)</sup> - Ademi, është njeriu i parë i racës njerëzore. Ai u krijua në Xhenet nga materië dheut, që ishte marrë nga planeti Tokë. Pas këtij krijimi Allahu i Madhëruar e vendosi në Xhenet dhe i mësoi të gjitha njohuritë që do të dijnë njerëzit pas tij. Kjo bëri që ai të ishte më i vlerësuar sesa engjëjt dhe xhindet, madje edhe çdo lloj krijese tjetër. U caktua nga Allahu i Madhëruar, si kujdestar i Tokës. Ai është babai i tërë njerëzimit dhe gruaja e tij Havaja, që u krijua nga brinja e tij është nëna e tërë racës njerëzore. (sh.p).

<sup>(327)</sup> - Transmeton Imam Ahmedi, vëllimi: 3, faqja: 198. Darimiu “Sunen”, vëllimi: 2, faqja: 213, numri i hadithit: 273, kapitulli i spiritualitetit, paragrafi i Teubes. Tirmidhiu, vëllimi: 4, faqja: 70, kapitulli i Kijametit. Ibën Maxhe, vëllimi: 2, faqja: 1420 numri i hadithit: 4251, kapitulli i Zuhdit, paragrafi i Teubes. Hakimi, vëllimi: 4, faqja: 244, kapitulli i Teubes. Imam Hakimi e ka përcaktuar si të saktë këtë hadith bashkë me Imam Dhehebiun etj.

<sup>(328)</sup> - Shejkh El-islam Ibën Tejmije “El-fetaua”, vëllimi: 35, faqja: 69.



Në lidhje me gabimin në gjykueshmërinë e dijetarit për një çështje të caktuar ka dy mënyra për ta trajtuar këtë problem.

*E Para:* Mospërfillja e këtij gabimi në këtë çështje duke qenë se është në kundërshtim me vetë Jurisprudencën e Islamit. Kështu në këtë pikë ndalohej ndjekja e dijetarit në gjykimin e tij për këtë çështje.

Imam Esh-Shatibi [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Sidoqoftë nuk lejohet ndjekja e asnjë dijetari, nëse ai bie në kundërshtim me Sheriatin e Islamit. Patjetër që ndjekja e dijetarit bëhet vetëm në rast të korrektësisë së tij me jurisprudencën islame.<sup>(329)</sup>

Njerëzve kur u bëhet e qartë, që filan dijetar ka gabuar në një çështje të caktuar, nuk duhet ta ndjekin mendimin e tij për këtë çështje. Madje edhe disa mendime, të cilat janë në kundërshtim me mendimin e shumicës së dijetarëve nuk duhet të ndiqen.

Imam El-Euzaiu [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Nëse njeriu ndjek vazhdimisht mendimet e një dijetari, edhe nëse ato janë në kundërshtim me mendimin e shumicës së dijetarëve, kjo mund të çojë në humbjen e rrugës së drejtë.<sup>(330)</sup>

*E Dyta:* Gjykimi i gabuar nuk duhet të influencojë në konsideratën dhe respektin ndaj dijetarit. Edhe pse ai mund të ketë gabuar në një mendim të caktuar, ai nuk duhet të konsierohet si shkak për mosrespektim ndaj dijetarit dhe punës së tij të gjatë ndaj Islamit.

Imam Ibën Kajim El-Xheuzije [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Ai njeri, që njihet si dijetar i Islamit, i njihen edhe vlerat e tij në shërbim të diturisë Islame dhe shoqërisë. Ky person edhe pse në një rast të veçantë mund të ketë gabuar në gjykimin e tij, kjo nuk duhet të jetë shkak për mosrespektimin ndaj tij. Përkundrazi në këtë rast duhet thjesht të braktiset vetëm mendimi i tij i gabuar në këtë çështje, por jo të tregohet mungesë respekti për dijetarin dhe veprën e tij.<sup>(331)</sup>

Imam Esh-Shatibi [Allahu e mëshiroftë] ka thënë në lidhje me gabimin e dijetarit: Nuk duhet të ofendohet dijetari për gabimin e tij. Përkundrazi ai tek Allahu i Madhëruar është i shpërblyer. Nuk duhet të hidhet poshtë e tërë vepra

<sup>(329)</sup> - Imam Esh-Shatibi, "El-I'atizam", vëllimi: 2, faqja: 862.

<sup>(330)</sup> - Imam Esh-Dhehebi "Sijer Alam en-Nubela", vëllimi: 7, faqja: 125.

<sup>(331)</sup> - Imam Ibën Kajim "T'alam el-Muvekiine, vëllimi: 3, faqja: 295.



e tij vetëm për një mendim të ndryshëm. Mosrespekti i tij bie në kundërshtim me rregullat e fesë.<sup>(332)</sup>

Nëse gabimi i dijetarit është i padëmshëm për shoqërinë, ne detyrohemi që ta mbulojmë atë, të mos lejojmë fyerjen dhe ofendimin e tij, pasi personaliteti i tij është më i rëndësishëm.

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) ka thënë: "Mbulojani njerëzve vepërmirë gabimet e tyre, veç në raste të shkeljeve që përbëjnë dënime".<sup>(333)</sup>

Gjithashtu Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) ka thënë: "Kush i mbulon muslimanit të metat, Allahu i Madhëruar do t'ia mbulojë të metat atij".<sup>(334)</sup>

Duke i mbuluar muslimanit të metën e tij, kjo bëhet shkak edhe për korigjimin e tij, për këtë arsye është e këshilluar edhe mbulimi i të metave ndaj muslimanëve. E nëse është kështu ndaj dijetarëve është më parësore.

Në fakt gabimet e dijetarëve nëse përhapen bëhen shkak për probleme në dy kategori njerëzish:

- Përkrahësve të verbër, të cilëve çdo fjalë e dijetarit iu ngjan e drejtë.
- Kundërshtarëve të këtij dijetari, të cilëve çdo fjalë të tij e shohin si të gabuar.

Por e vërteta qëndron tek qëndrimi mesatar. Respekti dhe mirënjohja për liderët e Umetit Musliman; dijetarët, udhëheqësit shoqërorë dhe personat që ndërtojnë opinionin në shoqëri. Kështu duhet të vlerësohen qëndrimet e drejta të tyre dhe duhet të lihen mënjanë ato të gabuarat. Por duke mos hedhur poshtë personin dhe kontributin e tij të vazhdueshëm në dobi të Islamit.

Shejkh El-Islam Ibën Tejmije [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Në lidhje me këtë çështje duhet të dihet, se çdo njeri i madh në dituri dhe në Islam, qoftë ai prej sahabëve, Tabiinëve, ndjekësve të tyre deri në Ditën e Gjykimit, qofshin

---

<sup>(332)</sup> - Imam Esh-Shatibi "El-Muvefekat", vëllimi: 4, faqja: 170-171.

<sup>(333)</sup> - Imam Ahmedi në "Musned", vëllimi: 6, faqja: 181. Ebu Daudi, vëllimi: 4, faqja 133, numri i hadithit: 4375, kapitulli i qënimeve penale, paragrafi i ndërmjetësimeve në dënime.

<sup>(334)</sup> - Imam Ahmedi në "Musned", vëllimi: 2, faqja: 252. Ebu Daudi, vëllimi :3, faqja: 274, numri i hadithit: 3460, kapitulli i shitblerjeve, paragrafi i faljes dhe tolerimit. Ibën Maxhe, vëllimi: 2, faqja: 741 numri i hadithit: 2199, kapitulli i tregtisë, paragrafi i tolerimit.

ata edhe prej Familjes së Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*), prej të gjithëve mund të pritet që ata të gabojnë në një moment në gjykimin e tyre. Kështu ata nuk mund të ndiqen në gabimin e tyre, por duhet të nderohen për vlerat e tyre. Nëse ndodh kështu, atëherë problemi fillon të trajtohet nga dy grupe njerëzish në forma krejt të ndryshme.

Grupi i parë, janë ata të cilët e madhërojnë atë aq shumë, sa nuk mund ta pranojnë prej dijetarit gabimin. Kështu ata përpiqen që t'i mbulojnë ato gabime ose t'i komentojnë ato.

Ndërsa Grupi i dytë mundohet ta poshtërojë edhe më shumë figurën e dijetarit. Kjo ndodh, për faktin se ata e paragjykojnë dhe gabimi i tij thjesht bëhet shkak që ata ta sulmojnë edhe më shumë figurën e tij. Ata mundohen ta komentojnë gabimin e tij, si problem në besimin e tij. Këta u ngjajnë Khauarixhëve dhe Rafidinjtë, të cilët e konsiderojnë çdo gabim të vogël, si mungesë besimi.

Ai që ndjek rrugën mesatare në gjykimin tij, e madhëron dijetarin, e nderon atë dhe e ndjek rrugën e tij. Ai i jep hakun të gjitha çështjeve, i mëshiron krijesat e Allahut të Madhëruar dhe e di se njeriu ka mirësitë dhe të metat e tij. Kështu ai i vlerëson mirësitë që ka dijetari dhe i anashkalon gabimet dhe të metat e tij. Kjo është metodologjia e gjyimit të Ehli Sunetit, e ndryshme nga khauarixhët dhe rafidinjtë.<sup>(335)</sup>

Kështu të cenosh nderin e figurave të shquara të Umetit musliman, qoftë duke i ofenduar ato, apo edhe duke i shenjtëruar janë këto probleme, që sjellin përçarje në Umetin Musliman.

Ka qenë ky shkak që bëri historinë e trazirave në fillimet e këtij Umeti, kur njerëzit filluan të mbanin anën e disa sahabëve, duke lënë disa të tjerë. Disa i konsideronin si të pagabueshëm, e disa të tjerë si jobesimtarë. Të gjitha këto vetëm duke ndjekur paragjykimet e tyre dhe aspak argumentet e Islamit.

Rafidinjtë kaluan në ekstrem, kur ofenduan Ebu Bekrin dhe shenjtëruan Aliun (Allahu qoftë i kënaqur prej të gjithë Sahabëve). Nauasibët ofendonin Aliun dhe lavdëronin Sahabët e tjerë. Këto përçarje dhe probleme i shkaktuan Umetit Musliman shumë trazira dhe humbje.

<sup>(335)</sup> - Shejkh El-Islam Ibën Tejmije "Minhaxhu es-Suneh", vëllimi: 4, faqja: 543-544.



Të gjykosh njerëzit duhet të jetë me dituri dhe argumente dhe kjo në fakt duhet të bëhet me masën e caktuar, aq sa ndikimi i gabimit të tyre është i dëmshëm për shoqërinë dhe jo më shumë, duke e ulur figurën e tyre. Njësoj është lavdërimi i njerëzve. Duhet të bëhet në masën e caktuar dhe jo të kalohet në shenjtërim.

Është e drejta e dijetarit, që kur gabon të ketë njerëz që ta këshillojnë pasi kjo është porosia e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*), i cili ka thënë se: “*Feja është këshillë (tre herë) - E pyetën për kë, o Pejgamber i Zotit? - Ai tha: - Për raportet me Allahun, për raportet me të (Pejgamberin), për raportet me Prijësat e Umetit musliman dhe për raportet me të qeverisurit në Umetin Musliman*”.<sup>(336)</sup>

Këshilla për liderët e Umetit musliman duhet të jetë në mënyrë sa më të kujdesshme pa cenuar nderin dhe personalitetin e tyre. Nëse kjo etikë nuk ruhet, atëherë nuk kemi të bëjmë më me këshillë, por me ofendim dhe cenim të personalitetit të dijetarit.

Mund të jenë në të drejtë kritikuesit ndaj kritikës që i bëjnë dijetarit, por kjo e drejtë nuk i jep atyre dorë të lirë, që të cenojnë personalitetin e tij. Kjo madje do të shkaktonte acarime të padrejta dhe ndoshta edhe moskorigjim nga gabimi i mëparshëm. Kritikuesi duhet që para se të japë këshillën e tij të ketë parasysh disa çështje etike:

- 1- Qëllimi i kritikës të jetë përmirësimi, bazuar në fjalën e Allahut të Madhëruar ku thotë:

قَالَ يَقَوْمِ أَرَأَيْتُمْ إِنْ كُنْتُ عَلَى بَيْنَةٍ مِّن رَّبِّي وَرَزَقَنِي مِنْهُ رِزْقًا حَسَنًا وَمَا أُرِيدُ أَنْ  
أُحَالِفَكُم إِلَىٰ مَا أَنهَكُم عَنْهُ إِنْ أُرِيدُ إِلَّا الْإِصْلَاحَ مَا اسْتَطَعْتُ وَمَا تَوْفِيقِي إِلَّا بِاللَّهِ  
عَلَيْهِ تَوَكَّلْتُ وَإِلَيْهِ أُنِيبُ ﴿٥٥﴾

<sup>(336)</sup> - Transmeton Imam Muslim, vëllimi: 1, faqja: 74, numri i hadithit: 55, kapitulli i Besimit, paragrafi “Feja është këshillë”. Ebu Daudi, numri i hadithit: 4944, kapitulli i Moralit, paragrafi i këshillës. Nesaiu, vëllimi: 7, faqja: 156 kapitulli i Betimit, paragrafi i këshillës së Imamatit. Tirmidhiu numri i hadithit: 1927, kapitulli i respektit familjar, paragrafi i Këshillës.

"Unë dëshiroj vetëm të përmirësoj atë që mundem. Ndërsa suksesi im varet vetëm nga Allahu. Tek Ai mbështetem dhe Atij i drejtohem."

*Kuran: Hud, 88.*

Nisur nga kjo personi kritikues duhet që çdo kritikë apo veprim lidhur me këtë ta ketë konform këtë ajeti.

- 2- Kritikuesi duhet të shmangë çdo metodë, e cila aludon në cenimin e personalitetit. Të jetë i butë dhe jo abuziv. Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) gjithmonë kur kritikonte iu drejtohej në shumës dhe jo duke përcaktuar individin apo popullin, Ai thoshte: "Ata njerëz..."<sup>(337)</sup>
- 3- Shmangia sa më shumë e rolit të akuzatorit, i cili me çdo mënyrë përpiqet të gjejë në faj të akuzuarin.
- 4- Kujdesi që kritika të ngrihet mbi fakte dhe argumente dhe të drejtohet vetëm ndaj veprimeve të gabuara dhe jo personalitetit të individit.

Për mendimin tim, personi që dëshiron të këshillojë dikë që ka vlera duhet të ndjekë njërën prej këtyre dy rrugëve:

**E para:** Të kërkojë fakte nga dijetarët e tjerë, që me të vërtetë thënia e këtij dijetari është e gabuar.

**E dyta:** Këshillimi i dijetarit në mënyrë indirekte, në formën e pyetjes, shkrimit të këshillës me anë të një letre drejtuar atij etj.

<sup>(337)</sup> - Kjo shprehje është përdorur në shumë hadithe kritikuese të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Njëri prej tyre si shembull është edhe hadithi, ku ai thotë "Si është puna me disa njerëz, që kur falen ngrejnë kokën në qiell?" Imam El-Bukhariu, vëllimi: 2, faqja: 233.



## Kapitulli i dhjetë: Mospërfillja e kritikave nga bashkëkohësit

Dijetarët shpeshherë mund të kenë mendime të ndryshme për njëri-tjetrin. Kështu kjo çështje mbetet e diskutueshme dhe nuk mund të bazohet mbi të asnjë lloj gjykimi. Kushdo prej dijetarëve përpiket të arrijë në gjykimin e drejtë rreth një çështjeje të caktuar, apo individi të caktuar. Disa prej tyre mund të arrijnë në një gjykim të saktë dhe disa të tjerë jo. Mirëpo duke marrë parasysh përpjekjen e tyre ata të gjithë janë të shpërblyer. Të parët janë dyfish të shpërblyer për përpjekjen dhe gjetjen e së drejtës. Ndërsa të dytët janë të shpërblyer vetëm për përpjekjen e tyre në gjetjen e së drejtës.

Edhe dijetarët ashtu sikurse çdo njeri kanë dobësitë e tyre dhe pritet prej tyre, që të shfaqin ndjenja zilie, xhelozie, inati e të tjera të këtij lloji, qoftë edhe në doza të vogla. Ata ndoshta mund t'i shprehin këto ndjenja ndaj kolegëve të tyre prej sukseseve të arrira nga këta të fundit. Kështu nëse ata pyeten për mendimin e tyre rreth vlerave të një kolegu të tyre, nuk është e thënë se vlerësimi i tyre mund të jetë objektiv. Mendimi i tyre nuk është i mbrojtur nga përzierja edhe me këto ndjenja. Për këtë arsye zakonisht nuk merret mendimi i dijetarit kundër një kolegu të tij bashkëkohës.

Ibën Abasi [Allahu qoftë i kënaqur prej tij] ka thënë: Prej dijetarëve merrni diturinë dhe jo gjykimet e tyre ndaj njëri-tjetrit.<sup>(338)</sup>

Edhe Malik Ibën Dinari [Allahu e mëshiroftë] është i të njëjtit mendim, kur thotë: Fjala e dijetarëve merret në çdo drejtim të jetës, por ajo nuk pranohet nëse flasin për njëri-tjetrin.<sup>(339)</sup>

Imam Ibën Abd El-Berri [Allahu e mëshiroftë] do ta sqaronte edhe më tej këtë çështje: Personi i njohur për devotshmërinë e tij, diturinë dhe kontributet që ka dhënë në dobi të shoqërisë, nuk mund të cenohet me gjykimin e askujt prej

<sup>(338)</sup> - Imam Ibën Abd El-Berr, "Xhemi u Bejani el Ilmi ue Fadlihi", vëllimi: 2, faqja: 151.

<sup>(339)</sup> - Po aty, vëllimi: 2, faqja: 152.



bashkëkohësve të tij. Vetëm nëse personi që e kritikon atë sjell argumente të vërtetueshme. Pasi në origjinë çdo njeri, sidomos dijetarët e Umetit janë të pastër nga akuzat, derisa t`u vërtetohet e kundërta.<sup>(340)</sup>

Imam Esh-Dhehebi [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Akuzat e dijetarëve për kolegët e tyre bashkëkohës nuk përfillen fare për t`u shënuar. Ato thjesht duhet të lihen në harresë, në mënyrë që të mos trazohen zemrat e njerëzve, që i lexojnë ato. Është më mirë të themi atë që Allahu i Madhëruar na ka porositur në Kuran:

وَالَّذِينَ جَاءُوا مِنْ بَعْدِهِمْ يَقُولُونَ رَبَّنَا اغْفِرْ لَنَا وَلِإِخْوَانِنَا الَّذِينَ سَبَقُونَا بِالْإِيمَانِ وَلَا تَجْعَلْ فِي قُلُوبِنَا غِلًّا لِلَّذِينَ ءَامَنُوا رَبَّنَا إِنَّكَ رَءُوفٌ رَحِيمٌ ﴿١٠﴾

"Edhe ata që erdhën pas tyre thonë: "O Zoti ynë, falna neve dhe vëllezërit tanë, të cilët kanë besuar para nesh dhe mos lejo, që në zemrat tona të ketë asnjë të keqe ndaj besimtarëve! O Zoti ynë, Ti je vërtet i Butë dhe Mëshirëplotë!"

*Kuran: El-Hashr, 10.*

Sidomos dijetarët, por në fakt të gjithë muslimanët kanë vepra të mira të mëparshme, që mund t`ua mbulojnë gabimet e tyre. Nuk duhet të jemi prej atyre, që i shenjtërojmë dijetarët, por as nga ata që i hedhin poshtë kontributet e tyre thjesht për një gabim të bërë. Ne nuk presim që dijetarët tanë të jenë të pagabueshëm. Ne pranojmë se disa janë me vlera më shumë se të tjerët. Ne e pranojmë se Ebu Bekri dhe Umeri janë më të mirët e Umetit, pastaj dhjetë të përgëzuarit me Xhenet, pastaj Hamzai<sup>(341)</sup>, Xheafferri<sup>(342)</sup>, Muadhi<sup>(343)</sup>,

<sup>(340)</sup> - Po aty, vëllimi :2, faqe: 152.

<sup>(341)</sup> - Hamza, Xhaxhai i Pejgamberit (paqja qoftë mbi të). Ishte ndër personalitetet më me influencë të Mekës në kohën para Islame. Ai pranoi Islamit për arsye fisnore, por me konvertimin e tij, muslimanët filluan të merrnin frymë më lirshëm, pasi ishin të mbrojtur nga shtypja dhe presioni i kurejshëve. Vdiq dëshmor në vitin e tretë Hixhri në betejën e Uhudit. (lindi në vitin 55 para Hixhretit dhe ndërroi jetë në vitin e tretë të Hixhretit).

<sup>(342)</sup> - Xheafferri Ibën Ebi Talib, lindi në vitin 33 para Hixhretit (590 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 8 Hixhri (629 Diellor). Xheaffer Ibën Ebi Talibi, ishte nga trimat e fisit Benu Hashim të Pejgamberit [paqja qoftë mbi të!], djali i Abdul Mutalibit, pra djali i



Zejd<sup>(344)</sup>, Nënati e Besimtarëve<sup>(345)</sup>, vajzat e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi to*), Luftëtarët e Bedrit, Ebu Derdai, Selman El-Faresiu, Ibën Umeri, sahabët e Besës së Ridvanit, pastaj muhaxhirët dhe ensarët në përgjithësi, Khalid Ibën Velidi<sup>(346)</sup>, Abasi<sup>(347)</sup>, Abdullah Ibën Umeri<sup>(348)</sup>, e të gjithë sahabët me radhë.

xhaxhait të Pejgamberit [*paqja qoftë mbi të!*], vëllai i prijësit të besimtarëve Ali ibën Ebi Talibit [Allahu qoftë i kënaqur me të!] dhe më i madh se ai me dhjetë vite. Xhefer Ibën Ebi Talibi [Allahu qoftë i kënaqur me të!] i ngjante shumë Muhamedit [*paqja qoftë mbi të!*]. Pseudonimi i tij është "Et-Tajar-Fluturuesi". Xhefer Ibën Ebi Talibi së bashku me bashkëshorten e tij, Esmā binti Umejsin e përqafuan Islamin nëpërmjet Ebu Bekrit [Allahu qoftë i kënaqur me të!], para se të hynte i Dërguari i Allahut në shtëpinë e Erkamit. Ata të dy shpërngulen në Abisini (Etiopia e sotme) që në emigrimin e parë që bënë muslimanët. Xheferi është personazh i fjalimit të bukur të mbajtur prej tij me rastin e delegacionit kurejshit që shkoi tek Nexhashiu, mbreti i Abisinisë, me qëllim që t'i kthenin në Mekë muslimanët e parë që kishin emigruar atje., fjalë në të cilën ai ndër të tjera lexoi edhe një pjesë nga surja Merjem. Xha'fer Ibnu Ebi Talibi së bashku me bashkëshorten e tij qëndruan në mikpritjen e Nexhashiut dhjetë vjetë të sigurtë, në preheje dhe qetësi. Ai mbi në Abisini derisa Pejgamberi [*paqja qoftë mbi të!*] emigroi në Medinë, për t'iu bashkangjitur Pejgamberit [*paqja qoftë mbi të!*] në Medinë teksa Pejgamberi ishte në Khajber (në vitin 7 Hixhri). Në fillim të vitit të tetë Hixhri, kur ushtria myslimane u ndesh me ushtrinë armike bizantine në Betejën e Mu'tes, Xhefer Ibnu Ebi Talibi depërtoi ndër radhët e armikut me shpatën e tij duke luftuar me një heroizëm të rrallë, derisa e goditën dhe ia këputën krahun e djathtë. Mirëpo ai menjëherë e mori flamurin në dorën e majtë por nuk vonoi shumë e ia këputën edhe krahun e majtë. Pas kësaj e mori flamurin dhe e shtrëngoi me krahërorin dhe dy krahët e tij të gjymtuara, derisa ai herën e tretë goditet për vdekje. Pejgamberi [*paqja qoftë mbi të!*] "E kam parë Xheferin në Xhenet. Dy krahët e tij të përgjakur i kishte të stolitur me pendë shumëngjyrëshe." Vetëm rreth një vit pasi sapo kishte ardhur nga Abisinia, Xheferi bie dëshmor në këtë betejë dhe në trupin e tij prej heroi numëroheshin rreth nëntëdhjetë goditje shpatash dhe shigjetash [Shih: "El Ea'lem" me autor Ez-Zirikliu (i cili ndërroi në vitin 1396 Hixhri) dhe dhe "Sueru min Hajati es-Sahabe" me autor Abdurrahman Rafet El-Basha]. (sh.p.).

<sup>(343)</sup> - Muadh Ibën Xhebeli, edhe ky sahab i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) lindi 25 para hixhretit. E pranoi Islamin në moshë fare të re 13 vjeçare. Është ndër dhjetë të përgëzuarit me Xhenet. Ndërroi jetë në moshën 38 vjeçare nga epidemia e kolerës, që ra në Jordani në vitin 18 Hixhri, ku kishte shkuar të përhapte Islamin. (sh.p).

<sup>(344)</sup> - Zejd bin Thabit, sahab i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Është ndër personat që u morën me mbledhjen e Kuranit. Gjatë kohës së Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*), por edhe gjatë kohës së Ebu Bekrit ishte personi, i cili u ngarkua me shkrimin e kopjes së parë të kompletuar të Kuranit. (sh.p).

<sup>(345)</sup> - Kështu konsiderohen të gjitha gratë e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*).

<sup>(346)</sup> - Khalid Ibën Uelidi, Sahab i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Ishte ndër figurat kryesore të elitës së Mekës. Ai luftoi kundër muslimanëve në betejën e Uhudit dhe

Të gjithë ata që jetuan, u munduan, luftuan, mësuan prej Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) [Allahu i Madhëruar qoftë i kënaqur me ata të gjithë].

Ndërsa shpifjeve të rafidinjeve dhe khauarixhëve, ne nuk u kushtojmë asnjë farë rëndësie, sepse shumica e shkrimeve të tyre janë gënjeshtër, të tjerat janë shtrembërime prej inateve dhe paragjyqimeve.

Edhe Tabi'inët (nxënësit e sahabëve) kanë folur ndaj njëri-tjetrit, por të gjitha thëniet e tyre respektive mbeten nën hije dhe për njeriun besimtar duhet që të mos merret me çështje, që nuk kanë lidhje me të. Le ta dijnë që mishri (d.m.th. nderi) i dijetarëve është i helmuar.<sup>(349)</sup>

Sigurisht që fjala e dijetarëve për kolegët e tyre bashkëkohës nuk është e pranuar. Por ky parim nuk është gjithmonë i vlefshëm. Që të jetë i tillë parimi duhet që për dijetarin e përfolur të ketë dëshmi nga një numër i madh kolegësh, që vërtetojnë vlerat e tij. Ndër shkaqet që e bëjnë të hidhet poshtë fjala e dijetarit kundër kolegut të tij dijetar janë si më poshtë:

1. Prania e konkurrencës ndërmjet tyre.<sup>(350)</sup> Duke qenë dijetarë të së njëjtës fushë apo të të njëjtit vend. Konkurenca zakonisht shkakton xhelozë dhe keqgjykim ndërmjet kolegëve.<sup>(351)</sup>

---

strategjisë dhe mprehtësisë së tij i dedikohet fitorja e kurejshëve në këtë luftë. Pranoi Islamin në vitin e shtatë të hixhretit. Menjëherë pas konvertimit të tij ai filloi të kompensojë kohën e humbur. Në komandën e tij ushtrinë muslimane asnjë moment nuk dështuan (ai u quajt nga Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) si Shpata e Allahut). Ai dha një kontribut të madh në shtypjen e kryengritjeve të fiseve dezertore në kohën e Khalifit Ebu Bekr. Ndërroi jetë në vitin 21 Hixhri. (sh.p).

<sup>(347)</sup> - Abasi, Xhaxhai i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Para Islamit ai ishte figurë e shquar në elitën kurejshite. Kryesonte këshillin që merrej me kujdesin ndaj Qabes. Ai kishte pranuar Islamin, mirëpo e mbajti të fshehtë atë dhe i dërgonte lajme Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) për lëvizjet e kurejshëve. Emigron në Medine para çlirimit të Mekës dhe me të mbyllet edhe kapitulli i emigracionit të muslimanëve nga Meka në Medine. Ndërroi jetë në vitin 32 Hixhri. (sh.p).

<sup>(348)</sup> - Abdullah Ibën Umer, Sahab i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Pranoi Islamin që në fëmijëri para babait të tij Umer Ibën Khatabit. Për arsye të moshës së vogël, ai nuk mori pjesë në betejat e Bedrit dhe të Uhudit. Por më pas ai ishte aktiv në çdo çështje të Islamit. Konsiderohet si njëri ndër dijetarët më të mëdhenj të Islamit. E ndiqte Pejgamberin (*paqja qoftë mbi të*) në çdo hap të tij. Ndërroi jetë në vitin në Mekë në vitin 74 Hixhri. (sh.p).

<sup>(349)</sup> - Imam Edh-Dhehebi "Sijer Alam en-Nubela", vëllimi: 10, faqja: 92-94.

<sup>(350)</sup> - Imam Edh-Dhehebi "Sijer Alam en-Nubela", vëllimi: 7, faqja: 143.

<sup>(351)</sup> - Imam Ibën Abd El- Berri "Xhemiu Bejani el Ilmi ue Fadlihi", vëllimi: 2, faqja: 156.



2. Gjykimi në zemërim e sipër. Sigurisht që çdo njeri e ka të pamundur të ruajë objektivitetin e tij në të gjykuar. Në këtë rast ky lloj gjykimi nuk mund të merret për bazë.<sup>(352)</sup>
3. Ndryshimi medhhebor ndërmjet dijetarëve. Mund të ketë ndryshime medhhebore (juridike) [por edhe ideore ndërmjet shkollash të ndryshme ideologjike, të cilat janë përhapur shekullin e fundit në botën islame]<sup>(353)</sup> Në raste të tilla mundet që ndryshimi medhhebor apo ai ideologjik të ndikojë në një gjykim jo objektiv të dijetarit.<sup>(354)</sup>
4. Prania e konflikteve të mëparshme ndërmjet kolegëve. Edhe ky mund të jetë shkak për një gjykim jo objektiv ndërmjet dijetarëve për kolegët e tyre.<sup>(355)</sup>

Imami Taxh Es-Sebekiu (723-771 Hixhri) [Allahu e mëshiroftë] thotë: Duhet bërë shumë kujdes. Nuk mund të marrim për bazë fjalët e dikujt, kundër një dijetari përpara fjalëve që janë thënë për vlerat e tij. Sidomos kur është i njohur me këto vlera në një masë të madhe muslimanësh. Në këtë rast çdo fjalë e thënë kundër tij, thjesht neglizhohet dhe nuk shkruhet në biografinë e tij. Madje kjo përforcohet më shumë, nëse akuzuesit e tij kanë patur më parë konflikte me këtë dijetar, apo kanë ndryshime medhhebore ndërmjet tyre.<sup>(356)</sup> Për të qenë të drejtë me dijetarët dhe diturinë, ajo që gjithmonë ka karakterizuar dijetarët e Islamit ka qenë respekti ndërmjet tyre, fjalët e mira dhe vlerësimi i kontributeve të njëri-tjetrit.

Imam Ahmedi [Allahu e mëshiroftë] e lavdëronte punën e Is'hak Ibën Rahauejhit duke thënë: Nga ata që kanë ardhur në Horasan<sup>(357)</sup> askush nuk ka qenë më i mirë se Is'hak Ibën Rahauejhi (161-238 Hixhri). Edhe pse ne kishim disa mospajttime me njëri-tjetrin, por kjo është normale për njerëzit.<sup>(358)</sup>

---

<sup>(352)</sup> - Po aty, vëllimi: 2, faqja: 155.

<sup>(353)</sup> - Shënim i Përkthyesit.

<sup>(354)</sup> - Imam Edh-Dhehebi "Sijer Alam en-Nubela", vëllimi: 14, faqja: 310.

<sup>(355)</sup> - Imam Edh-Dhehebi "Sijer Alam en-Nubela", vëllimi: 10, faqja: 658.

<sup>(356)</sup> - Imam Es-Sebkiu "Tabakat esh-shafiije", vëllimi: 1, faqja: 188.

<sup>(357)</sup> - Zonë në Iran.

<sup>(358)</sup> - Imam Edh-Dhehebi "Sijer Alam en-Nubela", vëllimi: 11, faqja: 371.

Imam Ibën Rexhepi [Allahu e mëshiroftë] do të thoshte për Imam Ahmedin: Imam Ahmedi edhe pse kishte kundërshtime mendimesh me Ibën Rahavejhin, ai përsëri e respektonte atë dhe fliste fjalë të mira ndaj tij.<sup>(359)</sup>

Në kuadër të këtyre shembujve të shkëlqyer të sjelljes së dijetarëve është edhe rasti i transmetuar nga Muhamed Ibën Ahmed El-Finxhari (i cili ndërroi jetë në vitin 598 Hixhri) [Allahu e mëshiroftë], i cili thotë: Ibën Selami ka qenë një dijetar shumë i njohur dhe ka kontribut të madh në shumë fusha të shkencës islame. Ai ka patur miqësi të madhe me kolegun e tij Ahmed Ibën Hafsin. Ata e ruanin miqësinë e tyre, edhe pse ndërmjet tyre kishte herë pas here ndryshime mendimesh në çështje të caktuara juridike.<sup>(360)</sup>

E sa shumë shembuj të kësaj natyre ka ndërmjet dijetarëve. Ata edhe pse mund të flisnin kundër njëri-tjetrit, përsëri e kanë ruajtur nderin e tyre dhe kur vinte puna për të folur për vlerat e njëri-tjetrit ata dinin t'ua jepnin hakun kontributeve të secilit prej tyre.

<sup>(359)</sup> - "El-Ferku Bejne Nasihati ue Tabair", faqe: 31-32.

<sup>(360)</sup> - Imam Edh-Dhehebi "Sijer Alam en-Nubela", vëllimi: 10, faqja: 630.



## Kapitulli i trembëdhjetë: Dijetarët fillimisht gjykohen si të drejtë

Këtë kapitull po e organizoj në një numër parimesh:

**Parimi i parë:** Dijetari Muxhtehid (Specialist) është i shpërblyer për punën e tij kërkimore, si në suksesin e saj, ashtu edhe në dështimin e saj.

Dijetari i njohur nga Umeti Musliman si specialist i një fushe të caktuar, në çdo punë shkencore që bën në gjetjen e argumenteve fetaro-juridike është i shpërblyer në të dyja rastet. Si në rastin kur arrin t' i gjejë ato argumente dhe të nxjerrë një gjykim të saktë, po ashtu edhe në rastin kur megjithë përpjekjen e tij, ai nuk arrin dot në një gjykim të drejtë të çështjes.

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) ka thënë: "Nëse gjykatësi jep gjykimin e tij, pas një shqyrtimi të çështjes nga ana e tij ai është i shpërblyer gjithsesi. Nëse pas përpjekjes së tij ai ka qenë i saktë, atëherë ka dy shpërblime. Nëse nuk ka qenë i saktë ai do të ketë veç shpërblimin e përpjekjes së tij".<sup>(361)</sup>

Nga ky hadith kuptohet, se ajo që kërkohet nga dijetari është që të punojë në nxjerrjen e gjykimit të drejtë, por nuk është e thënë se ai patjetër do t' ia arrijë gjykimit të saktë.

Në komentin e këtij hadithi Shejkh El-Islam Ibën Tejmije [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Dijetarët e Ehli Sunetit mendojnë se dijetarët specialistë të fesë nuk mund të kenë dënim për punën e tyre kërkimore. Shpeshherë ata arrijnë të gjejnë gjykime të sakta për çështjet që hulumtojnë. Por ka raste që

---

<sup>(361)</sup> - Imam El-Bukhari, vëllimi: 8, faqja: 157, kapitulli "T'atizam" paragrafi, shpërblimi i specialistit në gjykimin e tij. Imam Muslim, vëllimi: 3, faqja: 1346 numri i hadithit: 1716, kapitulli i çështjeve gjyqësore, paragrafi shpërblimi i gjykatësit në gjykimin e tij. Ebu Daudi, vëllimi: 3, faqja: 299, numri i hadithit: 3574, kapitulli i çështjeve gjyqësore, paragrafi i gabimeve të gjykatësit në gjykim. Ibën Maxhe, vëllimi: 2, faqja: 776, numri i hadithit: 2914, kapitulli i çështjeve gjyqësore, paragrafi shpërblimi i gjykatësit në gjykimin e tij.



ata edhe nuk arrijnë deri tek gjykimi i saktë. Në të dyja rastet ata janë të shpërblyer. Në rastin kur e gjejnë saktësisht gjykimin për çështjen, atëherë kanë dy shpërblime. Në rastin se nuk arrijnë deri tek gjykimi i saktë ata janë të shpërblyer për mundin e tyre. Ndërsa njerëzit e padrejtë janë të njëanshëm në qëndrimin e tyre me dijetarët. Disa prej tyre i konsiderojnë të pagabueshëm dhe disa të tjerë gabimin e tyre e konsiderojnë si shkak, që të mos përfillin mundin dhe djersën e dijetarit. Ndërsa njerëzit besimtarë janë të ekuilibruar. Ata nuk hedhin poshtë dijetarin për gabimin e tij. Nga ana tjetër ata nuk e marrin këtë gabim në zbatueshmëri.<sup>(362)</sup> Ai vazhdon: Dijetari Muxhtehid (specialist) mund të jetë në shumë fusha. Mund të jetë gjykatës, mund të jetë kryetar shteti, por mund të jetë edhe dijetar mësimdhënës, apo Myfti. Mjafton që ai në kërkimin e tij t'i përmbahet devotshmërisë ndaj Allahut të Madhëruar dhe rregullave të kërkimit shkencor. Ndryshe nga sektet e devijuara, të cilat janë të padrejta me diturinë dhe dijetarët.<sup>(363)</sup>

Në një vend tjetër ai përsëri e citon këtë çështje duke thënë: Sigurisht që nuk është në dorën e askujt ta gjejë të drejtën në gjykimet e tij. Por përgjegjësia e dijetarit qëndron në korrektësinë e tij në zbatimin e standarteve shkencore që kërkohet për çështjen në fjalë. Sigurisht që mbi dijetarin nuk bie asnjë penalitet, nëse ai nuk ka neglizhuar asgjë në metodikën e tij shkencore. Të këtij mendimi janë të gjithë juristët e Islamit, si në kohët e hershme, po ashtu edhe në kohët e sotme.<sup>(364)</sup>

Çështjet në të cilat dijetarët mundet edhe të gabojnë janë në bazë argumenteve që u paraqiten. Ata mund të mos jenë të njohur me argumentin ndryshe, ose mund të ndryshojnë në interpretimin e tij.

Shejkh El-Islam Ibën Tejmije [Allahu e mëshiroftë] edhe për këtë çështje prononcohet duke thënë: Pranohet gabimi nëse një dijetar kur e merr të analizojë argumentin, nuk e di nëse ky argument është i saktë ose jo, apo ndoshta interpretimi që ai i bën nuk është në përputhje me interpretimin unanimit të tij. Shembuj për këtë kemi rastin e atyre që pretendojnë, se ishte Is'haku ai që do të flijohej nga Ibrahim dhe jo Ismaili. Duke marrë si argument për këtë një hadith, i cili nuk është vërtetuar saktësia e tij. Apo

<sup>(362)</sup> - Shejkh El-Islam Ibën Tejmije "Mexhmua el-Fetava", vëllimi: 19, faqja: 123.

<sup>(363)</sup> - Shejkh El-Islam Ibën Tejmije "Minhaxhu es-Suneh", vëllimi: 5, faqja: 111.

<sup>(364)</sup> - Shejkh El-Islam Ibën Tejmije "Mexhmua el-Fetaua", vëllimi: 19, faqja: 213.



shembulli i dikujt, i cili pretendon se Allahu i Madhëruar nuk shikohet në këtë botë bazuar në ajetin e Kuranit:

لَا تُدْرِكُهُ الْأَبْصَارُ وَهُوَ يُدْرِكُ الْأَبْصَارَ وَهُوَ اللَّطِيفُ الْخَبِيرُ ﴿١٠٣﴾

"Shikimet njerëzore nuk mund ta arrijnë Atë."

Kuran, El-E'nam, 103.

Apo bazuar në ajetin tjetër të Kuranit:

إِنَّا نَطْمَعُ أَنْ يَغْفِرَ لَنَا رَبُّنَا خَطِيئَاتِنَا أَنْ كُنَّا أَوَّلَ الْمُؤْمِنِينَ ﴿٥١﴾

"Asnjë njeriu nuk i është dhënë që Allahu t'i flasë atij, përveçse me anë të Frymëzimit ose pas perdes..."

Kuran, Esh-Shura, 51.

Me këto dy ajete u bazua Aishja <sup>(365)</sup> (Allahu qoftë i kënaqur prej saj), kur pretendonte se Pejgamberi (Paqja qoftë mbi të) nuk e ka parë Allahun e

---

(365) - Aishja, lindi në vitin 9 para Hixhretit (58 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 58 Hixhri (678 Diellor).

Emri i saj është Aishe bintu (e bija e) Ebu Bekër es-Sidikut (të sinqertit), nga Kurejshët, e cila u lindi dhe u rrit në një shtëpi besimtare, për më tepër besimtarësh të tillë si i ati i saj Ebu Bekri dhe nëna e saj Umu Rumanë [Allahu qoftë i kënaqur me të dy!]. Ajo është bashkëshortja e tretë e Pejgamberit [paqja qoftë mbi të!], nëna e besimtarëve dhe më e ditura në fe, fikh dhe letërsi ndër gratë e Pejgamberit. Ajo u martua me Pejgamberin [paqja qoftë mbi të!] në një moshë të re, e cila përlllogaritet që më sa paku të ketë qenë 14 vjeçare. Ajo ishte një grua bardhoshe, shumë e bukur dhe e vetmja grua e virgjër me të cilën është martuar Pejgamberi [paqja qoftë mbi të!]. Ajo jetoi me Pejgamberin [paqja qoftë mbi të!] tetë vjet e pesë muaj dhe pati rastin ta njihje atë [paqja qoftë mbi të!] më afër se çdokush tjetër dhe të përfitonte prej diturisë së tij. Për këtë arsye ajo ishte edhe dijetarja më e madhe në Medinë dhe më e mira grua, përveç Hadixhes [Allahu qoftë i kënaqur me të!]. Pseudonimin e kishte Umu Abdullah. Vetë Engjëlli Xhibrili [paqja qoftë mbi të!] erdhi tek Pejgamberi [paqja qoftë mbi të!] duke bartur imazhin e Aishes [Allahu qoftë i kënaqur me të!] në një copë mëndafshi jeshil dhe i tha atij: "Kjo është bashkëshortja jote në dynja dhe Amshim" [Transmetim nga Et-Tirmidhi, i gradës hasen-i mirë]. Pejgamberi [paqja qoftë mbi të!] u martua me të në

Madhëruar në takimin që kishte me Të. Të njëjtin mendim kanë patur edhe disa nga Tabiinët, të cilët e interpretonin ajetin e Kuranit:

وَجُوهٌ يَوْمَئِذٍ نَّاصِرَةٌ ﴿٢٢﴾ إِلَىٰ رَبِّهَا نَاظِرَةٌ ﴿٢٣﴾

"Atë ditë, disa fytyra do të shkëlqejnë dhe Zotin e tyre do të shohin".

Kuran, El-Kijame, 22-23.

Se këto janë fytyrat e besimtarëve që presin prej Allahut të Madhëruar shpërblimin e Tij. Kështu mendonte Muxhahidi dhe Ebi Salihu.

Apo shembull tjetër, personat që mendojnë se i vdekuri nuk dënohet nga të qarat e të gjallëve për të bazuar në ajetin e Kuranit:

vitin e dytë Hixhri. Ajo ishte gruaja më e dashur për të ndër bashkëshortet e tij dhe njëkohësisht transmetuesja që transmetoi më shumë hadithe ndër to. Ajo ka transmetuar nga Pejgamberi [paqja qoftë mbi të!] një varg të sajin transmetimesh që arrin në 2210 hadithe, 147 prej të cilëve gëzojnë autenticitet sipas konsensusit të El-Bukhariut dhe Muslimit, teksa me 45 është veçuar Bukhariu dhe 69 Muslimi. Ajo është personazh i disa kumtimeve dhe qëndrimeve. Për çdo gjë që i ndodhte, ajo ishte e aftë të recitonte poezi. Sahabët e mëdhenj e pyesnin atë mbi çështjet e porcioneve të trashëgimisë dhe ajo u përgjigjej. Allahu i Madhëruar e pafajësoi atë për shpifjen që ju bë, duke zbritur për të një numër të konsiderueshëm thëniesh kuranore. Njihet qëndrimi i saj i rreptë kundrejt punës së Uthmanit gjatë jetës së tij dhe më pas zemërimi që e kaploi atë për shkak të vrasjes së tij, gjë për të cilën dihet pozicionimi i saj në ngrehinën mbi devenë e saj, në Ndodhinë "El-Xhemel". Aishja [Allahu qoftë i kënaqur me të!] ndërroi jetë në Medine [Shih: "El-Ea'lem" me autor Ez-Zirikliu (i cili ndërroi jetë në vitin 1396 Hixhri) dhe "Sijaru Ealemi en-Nuebelei" me autor Edh-Dhehebi (i cili ndërroi jetë në vitin 748 Hixhri)]. Aishja është gruaja e dytë e Pejgamberit (paqja qoftë mbi të). Ajo ishte vajza e Ebu Bekrit dhe u martua me Pejgamberin (paqja qoftë mbi të) pas vdekjes së gruas së tij të parë, Hatixhes (Allahu qoftë i kënaqur prej saj). Ajo jetoi disa vjet pas Pejgamberit (paqja qoftë mbi të) dhe duke qenë me afër tij kishte marrë prej tij dituri, të cilën jo të gjithë kishin patur rastin ta merrnin, për këtë arsye konsiderohet ndër dijetaret më të mëdha të Islamit. Të gjitha gratë e Pejgamberit (paqja qoftë mbi të) konsiderohen, si Nëna të Besimtarëve dhe respektohen si të tilla. Aishja ndërroi jetë në vitin 58 Hixhri.



قُلْ أَغْيَرَ اللَّهُ آبِغِي رَبًّا وَهُوَ رَبُّ كُلِّ شَيْءٍ ۚ وَلَا تَكْسِبُ كُلُّ نَفْسٍ إِلَّا عَلَيْهَا ۚ وَلَا تَزِرُ وَازِرَةٌ  
وِزْرَ أُخْرَى ۚ ثُمَّ إِلَىٰ رَبِّكُم مَّرْجِعُكُمْ فَيُنَبِّئُكُم بِمَا كُنتُمْ فِيهِ تَخْتَلِفُونَ ﴿١٧٤﴾

"Kushdo që bën diçka, punon për vete dhe askush nuk ngarkohet me barrën e tjetrit".

Kuran, EL-En`ame, 164.

Duke mos pranuar transmetimin e hadithit me pretekstin, se ky ajet është më i sigurtë se aftësia transmetuese e atyre që e transmetojnë.

Apo shembulli i atyre që nuk besojnë se i vdekuri dëgjon zërin e të gjallëve, duke u bazuar në ajetin e Kuranit:

إِنَّكَ لَا تَسْمَعُ الْمَوْتَىٰ وَلَا تَسْمَعُ الْأُدْعَاءَ إِذَا وَلَّوْا مُدْبِرِينَ ﴿٨٠﴾

"Sigurisht që ti (Muhamed), nuk mund t'i bësh të vdekurit të dëgjojnë".

Kuran, En- Nemb, 80.

Apo dikush që mendon, se Allahu i Madhëruar nuk çuditet, siç pretendonte Kadi Shurejhi, duke argumentuar se çuditja vjen nga mungesa e diturisë, të cilën Allahu i Madhëruar nuk e ka. Apo si dikush që pretendon se Aliu (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) është sahabi më me vlerë, duke u bazuar në hadithin e Pejgamberit (Paqja qoftë mbi të), që u lut në një ditë: "O Allah sille këtu në tryezën time, krijesën më të dashur për Ty, që të hajë me mua këtë zog".<sup>(366)</sup>

(366) - Imam El-Bukhariu në "Tarikh", vëllimi: 1, faqja: 358. Imam El-Akili në "Duafa el-Kebir", vëllimi: 1, faqja: 82. Tirmidhiu në "Sunen", vëllimi: 5, faqja: 300 numri i hadithit: 3805. Ebu Neim në "Dhikr Ehbar Asbahan", vëllimi: 1, faqja: 205. Hakimi në "Mustedrek", vëllimi: 3, faqja: 13. Imam El-Khatibi "Tarikh", vëllimi: 9, faqja: 369. Imam Ibën Xheuzi në "El-Ilel", vëllimi: 1, faqja: 226. Ky hadith ka edhe transmetime të tjera, të cilat janë cilësuar që të gjitha të dobëta. Dijetari El-Akili thotë: Nuk është i njohur prej nesh ky hadith. Ibën Tahiri thotë: Është shpifje. Kështu e ka shënuar edhe Ibën Xheuziu në "El-Ilel", vëllimi: 1, faqja: 233.

Kjo dua u plotësua me ardhjen e Ali Ibën Ebi Talibit në ato momente. Kjo ngjarje është marrë për të pretenduar një gjë të tillë, ndërkohë që para Aliut, ishin Ebu Bekri, Umeri dhe Othmani (Allahu qoftë i kënaqur prej të gjithëve). Apo gjithashtu historia e mësipërme me Khatib Ibën Beltan, që Umeri e quajti munafik (hipokrit) pa vlerësuar aspak arsyet dhe vllrat e tij të mëparshme. Apo historia e Esid bin Hadirit, që e akuzoi Sead bin Ubaden si munafik pasi ky i fundit mbronte disa njerëz të akuzuar. Apo rasti i Umer Ibën Khatabit, i cili kritikoi Hisham Ibën El-Hakimin për mënyrën sesi ai e këndonte Kuranin, pasi nuk e këndonte ashtu si e kishte kënduar Umeri.<sup>(367)</sup>

Nga sa kuptojmë nga fjalët e Ibën Tejmijes dhe shembujve që ai sjell, të gjitha këto gabime të dijetarëve kanë qenë për faktin se ata nuk e kanë njohur argumentin kundër, që ka qenë më i fortë se i pari, mbi të cilin edhe janë bazuar mendimet e sakta të shumicës së dijetarëve. Dijetari i vërtetë, që mund të ketë bërë të tilla gabime, e ka në natyrën e tij, që të rikthehet nga mendimi i mëparshëm, menjëherë sapo të gjejë argumentin e vërtetë. Në fakt ky është realiteti i pothuajse të gjithë këtyre dijetarëve.

Mirëpo kjo nëse është e tolerueshme tek dijetarët, nuk është e tillë edhe tek njerëzit e thjeshtë, që nuk janë të specializuar në fushat e diturisë. Kështu nëse dikush prej tyre mendon ndryshe nga mendimi i dijetarëve, ai patjetër që merr gjynahe dhe penalizohet për faktin se nuk është i specializuar në këto fusha.

Imam Esh-Shatibi thotë: [Allahu e mëshiroftë] thotë: Gabimi në jurisprudencën islame është dy llojesh:

*I Pari:* Gjykimi që vjen pas një pune të vërtetë shkencore dhe profesionale dhe të devotshme. Në këtë rast çdo gabim është i falshëm dhe nuk e prek personalitetin e dijetarit.

*I dyti:* Gjykimi që vjen nga një punë amatore dhe ordinere të pabazuar në standarde shkencore dhe aspak objektive. Në këtë rast ky gjykim nuk përfillet dhe është plotësisht i gabueshëm, madje edhe sikur të jetë i saktë. Allahu i Madhëruar thotë në Kuran:

وَأَنْ أَحْكَمَ بَيْنَهُمْ بِمَا أَنْزَلَ اللَّهُ وَلَا تَتَّبِعْ أَهْوَاءَهُمْ ... ﴿١٦٠﴾

<sup>(367)</sup> - Shejkh El-Islam Ibën Tejmije "Mexhmua el-Fetaua", vëllimi: 20, faqja: 33-36.



"Prandaj gjykoji sipas asaj që të ka shpallur Allahu e mos ndiq dëshirat e tyre të kota!"

Kuran, El-Maide, 49.

apo:

يٰۤاٰدُودُ اِنَّا جَعَلْنَاكَ خَلِيْفَةً فِى الْاَرْضِ فَاَحْكُم بَيْنَ النَّاسِ بِالْحَقِّ وَلَا تَتَّبِعِ الْهَوٰى فَيُضِلَّكَ

عَنْ سَبِيْلِ اللّٰهِ ... ﴿٦٨﴾

"O Daud, Ne të kemi bërë mëkëmbës në Tokë, prandaj gjyko ndërmjet njerëzve me drejtësi dhe mos shko pas dëshirave dhe tekave, se ato të largojnë nga rruga e Allahut!"

Kuran, Sad, 26.

Kështu gjithçka tjetër përveç argumentit nuk pranohet, por që gjykimi i argumentuar të pranohet, duhet të vijë nga një dijetar i specializuar.<sup>(368)</sup>

Shembulli i gjykimit nga persona jokompetentë ka ndodhur që në kohën e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Rast për këtë është historia e përcjellur nga Xhabir Ibën Abdullahu,<sup>(369)</sup> i cili na rrëfen: Ishim në udhëtim së bashku me

<sup>(368)</sup> - Imam Esh-Shatibi "El Muuefekat", vëllimi: 4, faqja: 167.

<sup>(369)</sup> - Xhabir Ibën Abdullahi, lindi në vitin 16 para Hixhretit (607 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 78 Hixhri (697 Diellor). Emri i tij është Xhabir Ibën Abdullah Ibën Amër Ibën Harami, Ebu Abdullahu dhe Ebu Abdurahmani, nga Ensarët që i përkasin fisit Khazrekh, sahabi që ka transmetuar shumë transmetime në adresë të Pejgamberit [*paqja qoftë mbi të!*], teksa prej tij kanë transmetuar një grup sahabësh. Edhe Xhabiri edhe i ati i tij Abdullahu, ishin prej sahabëve (shokëve) të Pejgamberit [*paqja qoftë mbi të!*]. Xhabiri ishte lider i madh, dijetar i madh në fikh, muxhtehid, hafëz dhe ka qenë personi i fundit që ndërroi prej atyre që morën pjesë në natën e Besëlidhjes së dytë të Akabesë ku ai mori pjesë krahas të atit të tij Abdullahut [Allahu qoftë i kënaqur me të!]. Do donim që në këtë kontekst të përmendnim një histori shumë mbresëlënëse që i përket babai të Xhabirit, Abdullah Ibën Haramit [Allahu qoftë i kënaqur me të!]: "Ai ishte prej krerëve pjesëmarrës në Betejën e Bedrit. Xhabiri [Allahu qoftë i kënaqur me të!] iu bind babait të tij Abdullahut [Allahu qoftë i kënaqur me të!] ditën e Betejës së Uhudit, ndaj dhe nuk doli në Betejë por qëndroi të kujdesej për motrat e tij që ishin të shumta në numër. Abdullahu ra dëshmor në Betejën e Uhudit dhe pasi ai ra dëshmor, Allahu i Madhëruar i dha jetë dhe i foli ballë për ballë, pa ndërmjetës. Kur Muauija



disa miqtë tanë. Njëri prej tyre u aksidentua keqazi me një gur që i çau kokën. Ai ra pa ndjenja. Kur u zgjua ai pa se nga organi i tij kishte rrjedhur lëng, që i prishte pastërtinë dhe e bënte të nevojshëm për të marrë Gusul<sup>(370)</sup>. Ai kishte pyetur, nëse mundej të mos merrte Gusul, për shkak se uji mund ta dëmtonte. Mirëpo shokët e tij i thanë, se e vetmja mënyrë për të qenë i pastër ishte Gusuli. Me vështirësi ai mori gusul, por uji e kishte dëmtuar plagën e tij në kokë nga e cila nuk vonoi shumë dhe ai vdiq.

Kur mbërritën në Medinë këtë çështje ia treguan Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*), ndërsa ai u dëshpërua shumë për vdekjen e panevojshme dhe tha: *"E vranë, i vraftë Zoti, pse nuk pyetën, kur nuk dinin? Ilaçi i injorancës është pyetja"*.<sup>(371)</sup>

[Allahu qoftë i kënaqur me të!] bëri një kanalizim uji nëpër varrezat e dëshmorëve të Uhudit, Xhabiri nxitoi tek varri i të atit, dhe pasi kishte kaluar një kohë relativisht e gjatë, e gjeti trupin e të atit të freskët dhe të padekompozuar." Xhabiri [Allahu qoftë i kënaqur me të!] ka marrë pjesë në nëntëmbëdhjetë beteja, ndër të cilat edhe në Betejën e Ahzabit. Gjithashtu ai mori pjesë në Besëlidhjen e Raduanit, derisa arriti pleqërinë dhe e la shikimi, pasi iu afrua të nëntëdhjetave. Ai ishte myftiu i Medinës në kohën e tij dhe në ditët e tij të fundit ai kishte në xhaminë e Profetit [Paqja qoftë mbi të!] në Medinë një qarkim nxënësish që merrnin dituri islame prej tij. Ai jetoi disa vite pas Ibën Umarit [Allahu qoftë i kënaqur me të!], duke mbetur kësisoj unik ndër të pranishmit e kohës së tij. Ai ka transmetuar dituri të bollshme nga Prejgamberi [*paqja qoftë mbi të!*], Ebu Bekri, Umari, Aliu, Ebu Ubejde, Muadh Ibën Xhebeli, etj [Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë ata!]. El-Bukhariu, Muslimi dhe transmetuesit e tjerë të hadithit kanë transmetuar prej tij 1540 hadithe. Xhabirit i takon përpilimi me hadithet e transmetuara prej tij që titullohet "Musnedu Xhabir", i cili është prej transmetimeve të Ebu Abdurahmanit, Abdullahut të birit të iman Ahmed Ibën Muhamed ibën Hanbelit. Xhabiri [Allahu qoftë i kënaqur me të!] ndërroi jetë në moshën nëntëdhjetekatër vjeç dhe namazin e xhenazes së tij e fali Ebenu ibën Uthmani i cili ishte asokohe guvernatori i Medinës [Shih: "El Ea'lem" me autor Ez-Zirikliu (i cili ndërroi jetë në vitin 1396 Hixhri) dhe "Sijaru Ealemi en Nuebela" me autor Imam Edh-Dhehebi (i cili ndërroi jetë në vitin 748 Hixhri). (sh.p.).

<sup>(370)</sup> - Gusul, është mënyrë e pastrimit të trupit, ku i gjithë trupi pa përjashtim duhet të lahet me ujë. Ai bëhet i detyrueshëm, në rastin kur njeriu bëhet i papastër zakonisht pas marrëdhënieve seksuale, apo kur del sperma në rast ëndërrimi në gjumë. (sh.p).

<sup>(371)</sup> - Transmeton Imam Ebu Daudi, vëllimi: 1, faqja: 93, numri i hadithit: 336, kapitulli i pastërtisë, paragrafi i Tejemumit nga plagët. Imam Ed-Darekutni, vëllimi: 1, faqja: 90. Imam Ahmedi në "Musned", vëllimi: 1, faqja: 370. Imam Ed-Darimiu në "Sunen", vëllimi 1, faqja: 156, numri i hadithit: 758, kapitulli i pastërtisë, paragrafi i të plagosurit të papastër. Ebu Daudi në "Sunen", vëllimi: 1, faqja: 93, numri i hadithit: 337, kapitulli i Pastërtisë, paragrafi i Tejemumit nga plagët. Ibën Maxhe vëllimi: 1, faqja: 189, numri i hadithit: 573, kapitulli i Pastërtisë, paragrafi i të plagosurit të papastër. Imam Ed-Darekutni, vëllimi: 1, faqja: 190, numri i hadithit: 7, kapitulli i



Këta njerëz nuk e patën aftësinë e nevojshme për të dhënë gjykimin e tyre dhe rezultati ishte fatal.

**Parimi i dytë:** Dijetarët jo gjithmonë janë unanimisht dakord në çështje të caktuara. Ndryshimi i mendimeve ndërmjet tyre është i pashmangshëm. Allahu i Madhëruar e ka caktuar qëllimisht, që çështje dytësore të Islamit të jenë të diskutueshme. Kjo është e vërtetuar edhe nga praktika e dijetarëve. Mirëpo gjithë diskutimet janë vetëm në çështjet dytësore dhe jo në parimet bazë të Islamit. Për këtë arsye edhe debatet e shumta ndërmjet dijetarëve janë konstruktive dhe që ta hapin horizontin edhe më shumë.<sup>(372)</sup>

Dijetarët janë të vetëdijshëm, që unanimiteti i tyre nuk mund të arrihet dhe kjo për faktorë objektivë. Shumë prej tyre kanë qenë të shpërndarë nëpër popuj të ndryshëm me kultura të ndryshme, që i detyronte t'i përshtasin dituritë e tyre edhe me natyrën e popujve dhe vendin ku jetonin. Mjafton kjo, që të mos preken bazat e Islamit. Gjithashtu arsye tjetër ka qenë edhe fakti se secili dijetar ndryshon në këndvështrimin dhe interpretimin që ai i jep argumentit. Madje ka prej tyre që referohen në argumente, që disa të tjerëve u mungon dhe anasjelltas. Për këtë arsye ata ishin të vetëdijshëm, që nuk është e mundur unanimiteti i këtij Umeti të madh musliman (gati një miliard e gjysëm) i përbërë nga popuj, gjuhë dhe kultura të ndryshme. Gjithmonë mbetet po ai parim thelbësor, Bazat e Islamit janë të njëjta kudo në auditoret e diturisë islame nëpër të gjithë botën.

Ishte kjo arsyeja që e detyroi Imam Malikun të ndalonte Khalifin Mensur (i cili ndërroi jetë në vitin 185 Hixhri), që librin e tij "El Muueta" ta bënte bazë të kushtetutës të gjithë shtetit Islam, ndër të tjera ai i tha: Mës e bëj këtë, sepse njerëzit e kanë zgjeruar diturinë e tyre. Kanë dëgjuar shumë hadithe dhe

---

lejimit të Tejemumit. Hakimi në "Mustedrek", vëllimi: 1, faqja: 178, kapitulli i Pastërtisë, paragrafi i mënyrave të pastrimit të atij që është Xhunub. Korrektuesi i Darimiut ka thënë: Ky hadith është transmetuar edhe prej Hakimit, i cili shënon se ky hadith është i saktë sipas standarteve të Bukhariut dhe Muslimit. Mirëpo Darekutni dhe Bejhakiu e kanë konsideruar si transmetim të dobët. Gjithsesi duke qenë se ky është transmetuar në versione të ndryshme me të njëjtin kuptim, bëhet i saktë për t'u argumentuar me të. Për këtë arsye edhe Imam Ibën Sekeni e ka cilësuar të saktë. Referohu tek "Suneni" i Darimiut, vëllimi 1, faqja: 157-158.

<sup>(372)</sup> - Imam Esh-Sharibi "El-I'atizam", vëllimi: 2, faqja: 168.

transmetime të ndryshme, çdo popull tashmë e ka konsoliduar mënyrën e vet të juridiksionit islam. Kështu që pas kësaj të përpiqesh t' i mbledhësh ata në një juridiksion të vetëm do të ishte e padrejtë dhe e pamundur. Prandaj lëri njerëzit në lirinë e tyre juridike sipas shkollave (medhhebeve) islame që kanë, sepse çdo popull e di vetë çfarë juridiksioni është i përshtatshëm për të.<sup>(373)</sup>

Ky lloj ndryshimi i mendimeve dhe i interpretimeve ka ndodhur në fakt, që në kohën e Sahabëve (Allahu qoftë i kënaqur prej tyre). Madje këtë gjë e ka lejuar edhe vetë Allahu i Madhëruar, mjafton që kjo të mos sjellë përçarje sektare<sup>(374)</sup> ndërmjet Umetit Musliman. Allahu i Madhëruar na ka lënë hapësirë diskutimesh dhe zgjedhjesh në çështjet që kanë të bëjnë me mënyrat e aplikimit të bazave të Islamit, por jo në vënien në diskutim të tyre. Sahabët kur kanë patur ndryshime në mendime në çështje të aplikimit janë marrë vesh, që secili të qëndronte në interpretimin e tij dhe tjetri ta respektonte, pasi mosrespekti dhe përçarja do të ishin rrezik që prekte vetë unitetin e muslimanëve.

Shembull për këtë kemi rastin e porosisë së Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*), i cili i urdhëroi sahabet që merrnin pjesë në ekspeditën kundër fisit Beni Kurejdha<sup>(375)</sup>. Ai i porositi sahabët e ekspeditës, duke iu thënë: "Të mos e falë askush namazin e Ikindisë, vetëm se kur të arrini në fisin Beni Kurejdha."<sup>(376)</sup> Mirëpo rruga deri tek objektivi ishte e gjatë dhe namazit të Ikindisë po i mbaronte koha. Kështu që disa nga sahabet vendosën ta falin namazin në kohën e vet dhe pastaj të vazhdonin rrugën. Kjo bëri që një grup i sahabëve të debatonin me njëri-tjetrin, ku disa menduan se duhej të zbatonin me

<sup>(373)</sup> - Imam Ibën Asakiri "Keshfu el-Gita", faqja: 47.

<sup>(374)</sup> - Ka patur edhe përçarje sektare në Umetin Musliman. Madje Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) ka paralajmëruar, se do të jenë 73 grupacione. Të gjitha këto kanë ardhur si rezultat kur disa njerëz kanë guxuar të përfshijnë në debat edhe bazat e Islamit (Kuranin dhe Sunetin), të cilat janë të paprekshme dhe janë edhe identiteti themelor i Islamit. Çdo ndryshim nga këto baza do të thotë devijim ndaj Islamit. (sh.p).

<sup>(375)</sup> - Beni Kurejdha, Fisi Hebre që jetonte në periferi të Medinës. Ata e kishin thyer marrëveshjen me Pejgamberin (*paqja qoftë me të*) dhe kishin bërë aleancë me armiqët e muslimanëve, që kishin rrethuar Medinen në betejën e njohur si 'Beteja e Hendekut'. Për këtë arsye Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) u shpalli luftë atyre dhe dërgoi tek ata një ekspeditë ushtarake. (sh.p).

<sup>(376)</sup> - Hadithi, Historia dhe debati është transmetuar nga Imam Esh-Shatibi në "El-Fatisam", vëllimi: 1, faqja: 263 - 266.



përpikmëri porosinë e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*), ndërsa të tjerët e interpretuan këtë porosi duke thënë se: Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) kishte si qëllim që ne të shpejtonim drejt objektivit tonë dhe jo të mos e falim namazin në kohë.

Ky debat u përcoll tek Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*), i cili i miratoi të dy palët për veprimin e tyre. Si ata që e zbatuan me përpikmëri porosinë e tij, ashtu edhe ata që e interpretuan këtë porosi.<sup>(377)</sup>

Shembuj të tillë kanë ndodhur shumë, madje dhe në fusha të ndryshme, siç mund të jenë në adhurime, në marrëdhëniet sociale, martesë, trashëgimi, politikë etj.<sup>(378)</sup> Ata, debatonin me njëri-tjetrin në çështje të ndryshme. Këshilloheshin, kritikoheshin, e megjithatë kjo nuk ndikoi aspak në vëllazërinë e tyre dhe unitetin që kishin.<sup>(379)</sup>

Kështu debati është i lejuar madje edhe i këshilluar për aq kohë sa nuk shkakton përçarje dhe ndasi. Shejkh El-Islam Ibën Tejmije [Allahu e mëshiroftë] thotë: Asnjeherë nuk do të ndodhin dasi apo përçarje, nëse do të kishim debate konstruktive. Gjithmonë ato ndodhin kur ka debate shterp dhe jo objektive. Për këtë arsye Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) ka ndaluar çdo aktivizim të njëanshëm në moment trazirash. Kjo është edhe në parimet e jurisprudencës islame.<sup>(380)</sup>

Në komentin e tij të ajetit të Kuranit:

وَمَا تَفَرَّقُوا إِلَّا مِنْ بَعْدِ مَا جَاءَهُمُ الْعِلْمُ بِنُفُسِهِمْ ... ﴿١٤﴾

"Sidoqoftë, ata u përçanë midis tyre, pasi u erdhi dijenia vetëm prej smirës."

Kuran, *Esh-Shura*, 14.

Shejkh El-Islam Ibën Tejmije [Allahu e mëshiroftë] thotë: Kjo ndodhi tek Pasuesit e Librit, atëherë kur atyre iu erdhi dituria nga Allahu i Madhëruar. Sepse Allahu i Madhëruar nuk i humb njerëzit pa u sjellë më parë diturinë dhe

(377) - Shënim i Përkthyesit.

(378) - Shejkh El-Islam Ibën Tejmije "El-Fetaua", vëllimi: 19, faqja: 122.

(379) - Shejkh El-Islam Ibën Tejmije "El-Fetaua", vëllimi: 24, faqja: 172.

(380) - Imam Ebu Asim En-Nesai, "El-Istikame", vëllimi: 1, faqja: 31-32.



argumentet. Shkakut e përçarjes dhe humbjes së tyre ishte pikërisht sektarizmi dhe inatet e brendshme.

Kjo dallon krejtësisht nga debatet konstruktive ndërmjet dijetarëve, sidomos kur ata variojnë në prezencën e argumenteve. Inati ose të çon në humbjen e arsyes dhe domosdoshmërisht në humbjen e të vërtetës, ose në tejkalimin e normave. Kështu inati ata i çoi, ose në lënien pas dore të detyrimeve, ose në ekstrem, duke u futur në haram.<sup>(381)</sup>

Nëse do të ketë debate, kurrsesi nuk është e lejuar, që ato të kthehen në inate personale.

Imam Shafiu [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Dijetarët e mëhershëm, por edhe në ditët tona kanë patur debatet e tyre. Shumë herë ata kanë replikuar me njëri-tjetrin, por nuk kemi dëgjuar askënd nga ata, që të thonë se filan dijetar nuk duhet të përfillet, edhe pse mund të mos kenë qenë dakord me mendimet e njëri-tjetrit. Parimi kryesor ka qenë të mos preken bazat, pastaj çdo gjë tjetër vazhdonte me lirinë e mendimit dhe respektin reciprok...<sup>(382)</sup>

Hadithet që paralajmërojnë dënime penale zbatohen vetëm në ato çështje, të cilat janë krejtësisht unanime ndërmjet dijetarëve. Ndryshe çdo zbatim i penalitetit ndaj dikujt, që vepron diçka të ndaluar për disa, por që ka edhe interpretim tjetër që e lejon, në këtë rast zbatimi i penalitetit pezullohet në bazë të kushteve të përcaktuara për këto çështje.<sup>(383)</sup>

Shejkh El-Islam Ibën Tejmije [Allahu e mëshiroftë] në këtë çështje thotë: Kjo temë është e gjerë. Në të futen të gjitha ndalesat, që kanë ardhur nga Kurani dhe Suneti. Nëse do të kishte dijetarë që do të lejonin ndonjë prej ndalesave, duke mos u ardhur atyre argumenti ndalues, ose do të bazoheshin në argumente të tjera, që do t'i interpretonin ndryshe, në këtë rast ata do të ishin të justifikuar. Ndalesa ka disa rregulla derisa të japë rezultatin e: Mëkatimit, Turpërimit, Penalitetit dhe Prishjes morale etj. Këto rregulla kanë të bëjnë me qartësinë e këtyre ndalesave. Mund të jetë Ndalesë e qartë, por duke mos qenë plotësisht e përhapur informacioni për të, apo të jetë ushtruar presion mbi

(381) - Shejkh El-Islam Ibën Tejmije "El-Fetaua", vëllimi: 1, faqja: 14.

(382) - Imam Shafiu "El Um", vëllimi: 6, faqja: 205-206.

(383) - Shejkh El-Islam Ibën Tejmije "Refau el-Melam", faqja: 62-63.



shoqërinë, atëherë asnjë nga këto rezultate nuk aplikohet. Ndoshta Ndalesa mund të jetë vetëm për disa njerëz të veçantë dhe jo për të gjithë të tjerët.<sup>(384)</sup>

Çështja është mesatarja në gjykim, anash kësaj ka dy ekstremitete:

**I Pari:** aplikimi i të gjitha atyre rezultateve që shkakton veprimi i Ndalesës, për të gjithë njerëzit, pa marrë parasysh arsyet e tyre, duke pretenduar se ky është zbatim i ligjit të Zotit.

Të këtij mendimi janë Havarixhët, të cilët konsiderojnë mosbesimtar çdo njeri që vepron qoftë edhe një ndalesë të vogël.

**I Dyti:** lënia pas dore e urdhëresave dhe ndalesave, duke i futur të gjitha në kontekstin, se mund të interpretohen dhe të mos dëmtohet askush. Kjo do të thoshte humbje e qartë dhe shfuqizim i ligjit të Allahut të Madhëuar. Kjo ishte në fakt ajo që bënë edhe pasuesit e librave të mëparshëm (të krishterët dhe hebrenjtë).

Ata ndiqnin murgjit dhe priftërinjtë e tyre, duke i adhuruar ata. Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) thoshte se ata nuk i quanin zota, por kur këta u lejonin të ndaluarën, apo ndalonin të lejuarën, njerëzit i pasonin. Kjo do të çonte në bindje ndaj krijesave duke mos iu bindur Krijuesit të Madhëruar, ndërkohë që Allahu i Madhëruar thotë në Kuran:

يٰۤاَيُّهَا الَّذِيْنَ ءَامَنُوْا اطِيعُوْا اللّٰهَ وَاَطِيعُوْا الرَّسُوْلَ وَاُوْلِيْ الْاَمْرِ مِنْكُمْ ؕ فَاِنْ تَنٰزَعْتُمْ فِيْ شَيْءٍ فَرُدُّوْهُ اِلَى اللّٰهِ وَالرَّسُوْلِ اِنْ كُنْتُمْ تُؤْمِنُوْنَ بِاللّٰهِ وَالْيَوْمِ الْاٰخِرِ ۗ ذٰلِكَ خَيْرٌ وَّاَحْسَنُ تَاْوِيْلًا ﴿٥٩﴾

"O besimtarë! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja. Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, drejtojuni Allahut dhe të Dërguarit, nëse besoni Allahun dhe Ditën e Kiametit. Kjo për ju është më e mira dhe shpjegimi më i bukur".

*Kuran: En-Nisa, 59.*

Dijetarët mundet edhe të ndryshojnë në interpretimin e tyre, por askush nuk duhet të guxojë të dalë jashtë kufijve të përcaktuar në këtë ajet. Nëse kjo do të ndodhte dhe njerëzit do të linin pas dore ligjet e Allahut të Madhëruar, atëherë

<sup>(384)</sup> - Shejkh El-Islam Ibën Tejmije "Refau el-Melam", faqja: 71.



kjo do të ishte devijim i plotë ndaj Islamit dhe rrugës që Allahu i Madhëruar kërkon nga besimtarët.<sup>(385)</sup>

Por ndalohet që të cenohet personaliteti i çdo dijetari, i cili përpigjet nën hijen e argumenteve të nxjerrë gjykimin e duhur, por që nuk arrin dot deri aty.

Shejkh El-Islam Ibën Tejmije [Allahu e mëshiroftë] thotë: Dijetari që është i njohur në mbarë botën Islame për veprimtarinë e tij në dobi të Umetit Musliman konsiderohet si pishtar i diturisë dhe i shkencës. Gabueshmëria e tij në raport me saktësinë është e papërfillshme. Në shumicën e rasteve ndodh për arsye krejt objektive. Dijetarët janë ata që e ndërtojnë shkencën islame, janë ata që ndriçojnë me dituri dhe fshijnë injorancën. Ata janë më të ruajturit ndaj veseve dhe inateve.<sup>(386)</sup>

**E treta:** Arsyet e dallimeve juridike ndërmjet dijetarëve nuk janë aspak prej emocioneve, apo interesave. Të gjitha ato ndodhin për arsye krejt objektive. Dijetari i nderuar Shejkh El-Islam Ibën Tejmije në librin e tij "Refau El-Melam" sjell shumë shembuj të këtyre debateve juridike.

Ai i përmbledh këto shembuj me fjalët e tij: -Nuk ka ndodhur dhe nuk ka për të ndodhur asnjëherë, që një dijetar rigoroz dhe i mirëfilltë i Islamit të mohojë Sunetin e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Megjithë ndryshimet e mendimeve të tyre në çështje të caktuara, secili prej tyre qëllim kryesor ka pasur kënaqësinë e Allahut të Madhëruar dhe respektin e Sunetit të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Të gjithë janë unanimisht dakord, që duhet të ndjekin me korrektësi Sunetin e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Askush nuk është plotësisht i mbrojtur nga gabimi, me përjashtim të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*).

Nëse dikush nga dijetarët ka ndjekur një çështje të caktuar në bazë të gjykimit të tij, që e ka parë më të drejtë ai në fakt duhet justifikuar, nëse ajo nuk ka qenë bazuar në një hadith më të fortë, që ndoshta ai nuk e ka ditur.

Në fakt justifikimet janë njëri nga këto tre lloje:

- 1-Mosdituria e tij për Hadithin e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*).
- 2-Interpretimi i ndryshëm i Hadithit të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*).
- 3-Besimi, që gjykimi me atë hadith mund të jetë abroguar.

<sup>(385)</sup> - Shejkh El-Islam Ibën Tejmije "Refau el Melam", faqja: 104-106.

<sup>(386)</sup> - Shejkh El-Islam Ibën Tejmije "El Fetaua", vëllimi: 11 faqja: 43.



Pastaj nga këto tre lloje degëzohen një sërë justifikimesh të tjera.<sup>(387)</sup>

Në librin e tij Shejkh El-Islam Ibën Tejmije [Allahu e mëshiroftë] i sqaron me shembuj konkretë dhe është e domosdoshme nga çdo nxënës i diturisë, që këtë libër ta studiojë me kujdes.

E Katërta: Nuk është e thënë, që çdo debat ndërmjet dijetarëve është esencial. Ai mund të jetë edhe terminologjik, ku dijetarët debatojnë rreth termave të caktuar.

Abdullah Ibën Mesudi [Allahu qoftë i kënaqur prej tij] na përcjell një ngjarje që ndodhi me të në kohën e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Ai dëgjoi një njeri që e këndonte Kuranin me një dialekt<sup>(388)</sup> tjetër (të gjuhës arabe). Kjo ishte ndryshe nga ajo që e kisha dëgjuar Pejgamberin (*paqja qoftë mbi të*). Bashkë me të shkua tek Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) dhe i tregova. Në fytyrën e tij pashë irritim (prej veprimit tim) dhe na tha: "Të dy ju e këndonin mirë, prandaj mos u përçani, sepse ata që ishin para jush nga këto përçarje u shkatërruan".<sup>(389)</sup>

Shejkh El-Islam Ibën Tejmije [Allahu e mëshiroftë] në komentin e këtij hadithi thotë: Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) e ka ndaluar debatin, me qëllim mohimin e të drejtës dhe mendimit ndryshe. Sidomos kur edhe mendimi ndryshe është pjesë e së vërtetës. Në rastin e mësipërm të dy kënduesit ishin me të drejtë. Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) nuk e lë pa përmendur edhe arsyen e shkatërrimit të popujve të mëparshëm, që ishte debati aspak objektiv dhe konstruktiv.<sup>(390)</sup> Ai shton: Dijeni se shumica e debateve që shkaktojnë përçarje dhe sektarizëm në Umetin Musliman është i këtij lloji, d.m.th. jo konstruktiv dhe jo objektiv. Pra duke pretenduar secila palë, që është me të

---

<sup>(387)</sup> - Shejkh El-Islam Ibën Tejmije "Refau el Melam", faqja: 12.

<sup>(388)</sup> - *Kurani*, ka zbritur në disa dialekte të gjuhës arabe. Ata që njihen më shumë janë shtatë prej tyre. Për më tepër referohu në librin Mena`a El-Katan "Ulumu el- Kuran", (shkencat e Kuranit). (sh.p).

<sup>(389)</sup> - Trasmeton Imam El-Bukhari, vëllimi: 3, faqja: 88, kapitulli i Debateve, paragrafi i biografisë së njerëzve. Gjithashtu ai e transmeton edhe në librin e Pejgamberëve vëllimi: 6, faqja: 116, kapitulli i mirësive të Kuranit, paragrafi i leximit të Kuranit. Imam Ahmedi në 'Musned', vëllimi: 1, faqja: 412 dhe në faqen 456.

<sup>(390)</sup> - Shejkh El-Islam Ibën Tejmija "Iktidau Sirati el-Mustekim", vëllimi: 1, faqja: 123.

drejtën dhe duke mohuar mundësinë, që edhe pala tjetër mund të jetë në të drejtë.<sup>(391)</sup>

**E Pesta:** Në çdo debat duhet të shquhen mirë qëllimet e tij, që të jetë e vërteta dhe baza e saj, që është Kurani dhe Suneti. Allahu i Madhëruar thotë në Kuran:

يٰٓأَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا أَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ وَأُولِي الْأَمْرِ مِنْكُمْ ۗ فَإِن تَنَزَعْتُمْ فِي شَيْءٍ  
فَرُدُّوهُ إِلَى اللَّهِ وَالرَّسُولِ إِن كُنتُمْ تُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ ۚ ذَٰلِكَ خَيْرٌ وَأَحْسَنُ تَأْوِيلًا ﴿٥٩﴾

"O besimtarë! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja. Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, drejtojuni Allahut dhe të Dërguarit<sup>75</sup>, nëse besoni Allahun dhe Ditën e Kiametit. Kjo për ju është më e mira dhe shpjegimi më i bukur."

*Kuran: En-Nisa, 59.*

Referimi tek Allahu i Madhëruar d.m.th. referim ndaj Kuranit. Ndërsa Referimi tek Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) d.m.th. referim ndaj Sunetit të tij. Si rezultat i këtij parimi del, se nuk lejohet asnjë debat në çështje që janë vërtetuar qartazi me argumente të qarta dhe të sakta. Çdo tejkalim i kësaj norme është dalje jashtë rrugës së drejtë. Allahu i Madhëruar thotë në Kuran:

وَمَنْ يُشَاقِقِ الرَّسُولَ مِنْ بَعْدِ مَا تَبَيَّنَ لَهُ الْهُدَىٰ وَيَتَّبِعْ غَيْرَ سَبِيلِ الْمُؤْمِنِينَ نُوَلِّهِ مَا تَوَلَّىٰ  
وَنُصَلِّهِ ۖ جَهَنَّمَ ۖ وَسَاءَتْ مَصِيرًا ﴿١١٥﴾

"Këdo që e kundërshton të Dërguarin, pasi i është dhënë udhëzimi dhe ndjek rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve, Ne e lëmë të ecë andej nga është nisur dhe do ta përcëllojmë në zjarrin e Xhehenemit; eh, sa vendbanim i keq që është ai!"

*Kuran: En-Nisa, 115.*

<sup>(391)</sup> - Po aty, vëllimi: 1, faqja: 124.



**E Gjashta:** Pagabueshmëria nuk mund të jetë cilësi e askujt prej krijesave, veç Pejgamberëve (*paqja qoftë mbi ta*). Kështu, pavarësisht diturisë së tyre askush nga dijetarët nuk është i mbrojtur nga gabimi.

Imam Maliku [Allahu e mëshiroftë] thoshte: Çdokujt mund t`i merren fjalët dhe mund t`i lihen veç personit që është në këtë varr, duke drejtuar gishtin tregues tek varri i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*).<sup>(392)</sup>

Mirëpo Umeti Musliman nëse do të ketë unanimitet në një çështje, atëherë ajo kurrsesi nuk mund të jetë e gabuar. Kështu thotë Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) në hadithin e tij: "Allahu, asnjëherë nuk e lejon që Umeti im të ketë unanimitet në një çështje të gabuar".<sup>(393)</sup>

---

<sup>(392)</sup> - Imam Ibën Abd El-Hadi "Irshadu es-Salik", vëllimi: 1, faqja: 227. Imam Edh-Dhehebi në "Sijer Ealam en-Nubela", vëllimi: 8, faqja: 93.

<sup>(393)</sup> - Transmetimi është qartësuar në faqet e mësipërme.

## Kapitulli i katërbëdhjetë: Ndalesa në kundërshtimin e dijetarëve

Të mos kundërshtosh dijetarët, sidomos ata që janë të njohur në Umetin Musliman për mirësitë dhe diturinë e tyre është çështje e domosdoshme. Duhet që nxënësi i diturisë të rishikojë edhe një herë mendimin e tij, nëse ai bie në kundërshtim me mendimin e një dijetari apo disa dijetarëve të njohur tashmë në Umet.

Imam Esh-Shatibi [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: -Nuk duhet të kundërshtohet dijetari, nëse ai pyetet për një çështje dhe jep përgjigjen e tij, dhe nëse për një problem jep zgjidhjen e tij, e cila mund të jetë e panjohur nga njerëzit, apo ata nuk mund ta arrijnë ta kuptojnë atë. Njerëzit nuk e kanë tagrin ta kundërshtojnë atë. Në kesi rastesh është më e mirë për nxënësit e dijes apo njerëzit e thjeshtë të heshtin. Kështu ata do të jenë më të pastër para Allahut të Madhëruar.<sup>(394)</sup>

Për këtë arsye të mos e kundërshtosh dijetarin, edhe pse mund të mos e pranosh mendimin e tij, kur dihet shumë mirë vlera e tij në Islam, kjo është një çështje shumë e domosdoshme dhe e lavdëruar. Ai që nuk mundet ta përmbajë veten në raste të tilla, nuk është i aftë të vazhdojë të marrë diturinë. Kush nuk ka durimin e nevojshëm nuk mund të mësojë. Ndërsa ai që e ka durimin pikën e tij më të fortë, ka për të arritur në qëllimin e tij.<sup>(395)</sup>

Historia e Musait (*paqja qoftë mbi të*) bashkë me Hidrin është tregues i qartë i kësaj që po themi. Hidri (siç e kemi cituar më lart) e kushtëzoi Musain, që të bënte durim për çështjet që Hidri i dinte, ndërsa Musai jo. Allahu i Madhëruar thotë në Kuran:

<sup>(394)</sup> - Imam Esh-Shatibi "El Muuefekat", faqja. 324.

<sup>(395)</sup> - Shejkh Abdurahman Es-Sadij, "Tejsiru el- Kerijmi er-Rrahman", vëllimi: 5, faqja: 68.



قَالَ لَهُ مُوسَىٰ هَلْ أَتَّبِعُكَ عَلَىٰ أَنْ تُعَلِّمَنِي مِمَّا عَلَّمْتَ رُشْدًا ﴿٦٦﴾ قَالَ إِنَّكَ لَنْ تَسْتَطِيعَ  
 مَعِيَ صَبْرًا ﴿٦٧﴾ وَكَيْفَ تَصْبِرُ عَلَىٰ مَا لَمْ تُحِطْ بِهِ خُبْرًا ﴿٦٨﴾ قَالَ سَتَجِدُنِي إِن شَاءَ اللَّهُ  
 صَابِرًا وَلَا أَعْصِي لَكَ أَمْرًا ﴿٦٩﴾ قَالَ فَإِنِ اتَّبَعْتَنِي فَلَا تَسْأَلْنِي عَن شَيْءٍ حَتَّىٰ أُحَدِّثَ لَكَ  
 مِنْهُ ذِكْرًا ﴿٧٠﴾

"Musai i tha atij: "A mund të të pasoj ty, që të më mësosh edhe mua diçka prej diturisë së drejtë, që të është dhënë ty?" (Hidri) i tha: "Nëse vjen pas meje, mos më pyet për asgjë, derisa të ta shpjegoj unë!" E si mund të durosh (pa pyetur) para diçkaje për të cilën nuk di asgjë?" (Musai) tha: "Do të më gjesh të durueshëm, në dashtë Allahu e nuk do të të kundërshtoj për asgjë". (Hidri) i tha: "Nëse vjen pas meje, mos më pyet për asgjë, derisa të ta shpjegoj unë!"  
*Kuran: El-Kehf, 66 - 70.*

Ndoshta në pamje të parë mund të duket, që gjykimi i drejtë mund të jetë ndryshe nga ajo çfarë thotë dijetari. Por nxënësi, nuk e di se arsyet që ky i ka dijetar për mendimin e tij ndryshe, mund të jenë argumente edhe më të thella, që ky nxënës nuk i di.

Dijetari Abdurrahman Ibën Seadi [Allahu e mëshiroftë] në komentin e tij për historinë e Musait dhe Hidrit, ka thënë: -Mund të jenë çështje të ndryshme në jetën e përditshme për të cilat qartazi duken se janë të ndaluara. Siç është çarja e anijes, apo më e rëndë se kaq vrasja e një fëmije. Nuk ka asnjë dyshim, që janë çështje të ndaluara dhe Musai në çdo rast tjetër nuk mund të qëndronte pa folur dhe ndaluar këto. Mirëpo në rastin e Hidrit çështja ndryshonte. Çdo reagim i Musait në këtë histori, konsiderohej nxitim (sidomos pasi ishte paralajmëruar) dhe mungesë durimi.<sup>(396)</sup>

(396) - Shejkh Abdurrahman Es-Sadij "Tejsiru el-Kerijmi er-Rrahman", vëllimi: 5, faqja: 69 - 70.



Ndër shembujt më të qëlluar në këtë çështje është rasti me Sahabët në Marrëveshjen e Hudejbijes<sup>(397)</sup>, kur ajo u nënshkrua. Këtu po paraqesim disa nga kushtet e saj:

- 1- Arritja e armëpushimit ndërmjet muslimanëve dhe kurejshëve për një periudhë dhjetë vjeçare.
- 2- Muslimanët të kthehen atë vit (viti i gjashtë Hixhri) pa e bërë Umren dhe mundësinë për ta bërë Umren do ta kishin vitin që vjen. Por mundësia e qëndrimit në Mekë, nuk do të zgjaste më shumë se tre ditë.
- 3- Muslimanët dhe Kurejshët janë të lirë të bëjnë aleanca me fise të tjera.
- 4- Muslimanët janë të detyruar, që të kthejnë mbrapsht këdo, që do të emigronte në Medine, pa lejen e Kujdestarit<sup>(398)</sup> të tij. Nëse kjo do të ndodhte, atëherë çdo person duhej të kthehej përsëri nga kishte ardhur.
- 5- Kurejshët nuk janë të detyruar të kthejnë mbrapsht asnjë person, i cili ikën nga Medina drejt Mekës, qoftë edhe pa lejen e Kujdestarit të tij.

Sahabët [Allahu qoftë i kënaqur me to] në fakt e kundërshtuan këtë marrëveshje dhe iu ankuan Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) për kushtet e saj. Mirëpo Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) iu përgjigj atyre: "Po, do ta nënshkruaj këtë marrëveshje, sepse ai që ikën nga ne drejt Mekës, Allahu i Madhëruar e largoftë nga mëshira e Tij. Ndërsa personat besimtarë që emigrojnë drejt nesh, edhe pse do t' i kthejmë përsëri, Allahu i Madhëruar ka për t' u dhënë atyre zgjidhje dhe sukses".<sup>(399)</sup>

Ndër sahabët [Allahu qoftë i kënaqur me to] më shumë që kundërshtonin ishte Umer Ibën Khatabi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij). Ai më vonë do të thoshte: Atë ditë shkova tek Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) dhe i thashë: A nuk je ti i Dërguari i Allahut?!... Ai më tha "Sigurisht që po!"- i thashë: A nuk

<sup>(397)</sup> - Hudejbija, Kjo marrëveshje u arrit në vitin e gjashtë të Hixhretit ndërmjet Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) dhe Kurejshëve. Thelbi i kësaj marrëveshjeje ishte paqja ndërmjet muslimanëve dhe fiseve që ishin në armiçësi me ta. (sh.p).

<sup>(398)</sup> - Kujdestaria, në jurisprudencën islame (por edhe nga sa njihet nga kurejshët e asaj kohe) ishte përgjegjësi që ka babai, vëllai, apo bashkëshorti në lidhje me djemtë, vajzat, ose gratë e martuara.

<sup>(399)</sup> - Transmeton Muslimi, vëllimi: 3, faqja: 1411 numri i hadithit: 1784 në kapitullin e Xhihadit, paragrafi i Marrëveshjes së Hudejbijes. (sh.p).



jemi ne me të drejtën, ndërsa armiku ynë me padrejtësinë? Ai përsëri më tha "Sigurisht që po!" i thashë: Pse atëherë duhet të tolerojmë kaq shumë dhe ta ulim fenë kështu?- Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) më tha: "Unë jam i Dërguari i Allahut dhe nuk kam ndërmend ta kundërshtoj Atë!"- vazhdova: A nuk na pate thënë, se do të bëjmë Tavaf<sup>(400)</sup> në Qabe?- Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) më tha: -"Po është e vërtetë. Por, a jua pata caktuar që do ta bëjmë këtë vit?- I thashë: -JO.- Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) më tha: (Omer) *Ti do ta vizitosh dhe do të bësh tavafin në Qabe.*<sup>(401)</sup>

Pastaj shkova tek Ebu Bekri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) dhe bëra me të të njëjtin diskutim. Ai më tha: More burrë, ai është i Dërguari i Allahut dhe nuk e kundërshton urdhrin e Tij. Sigurisht që Allahu ka për ta ndihmuar. Prandaj bindju atij, sepse ai është në të drejtë. I thashë: -A nuk na pati thënë, se do të bëjmë Tavaf në Qabe? Ebu Bekri tha: -"Po është e vërtetë, por a e pati caktuar, që do ta bëjmë këtë vit?- I thashë: JO. Ebu Bekri më tha: (Umer) *Ti do ta vizitosh dhe do të bësh tavafin në Qabe.*<sup>(402)</sup>

Imam Ibën Haxheri [Allahu e mëshiroftë] thotë: Nga ky hadith kuptojmë, se lejohet tolerimi në çështje strategjike, nëse këto tolerime nuk prekin bazat e Islamit. Edhe tolerimi vlerësohet në masën e caktuar dhe në nevojën e caktuar, qoftë ajo mbrojtje e jetës dhe pasurisë, qoftë edhe në mbrojtje të shoqërisë. Kjo mund të ndodhë edhe në rast se muslimanët janë të dobët, apo në rast se janë të fuqishëm. Kurse nuk duhet të kundërshtohen këto vendime strategjike nga masa thjesht prej pamjes së jashtme. Ata duhet të binden pasi dijetarët janë më të thelluar në çështje, që shumica mund të mos i dijë. Sidomos në rastin e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*), që ishte i ndihmuar edhe nga shpallja hyjnore.<sup>(403)</sup>

---

<sup>(400)</sup> - *Tavaf*, quhet rrotullimi rreth Qabes, kjo është mënyra më e preferuar e adhurimit, që duhet të bëhet në Qabe. Tavafi duhet të bëhet shtatë herë me radhë. Aplikohet nga Haxhinjtë, ose nga ata që bëjnë vizitë (Umre) në Qabe.

<sup>(401)</sup> - Transmeton Imam El-Bukhariu, vëllimi: 3, faqja: 182. Imam Muslim, vëllimi: 3, faqja: 1422, numri i hadithit 1785.

<sup>(402)</sup> - Transmeton Imam El-Bukhari, vëllimi: 3, faqja: 182, kapitulli i Kushteve, paragrafi i kushteve të xhihadit. Imam Muslim, vëllimi: 3, faqja: 142, numri i hadithit: 1785 në kapitullin e Xhihadit, paragrafi i Marrëveshjes së Hudejbijes.

<sup>(403)</sup> - Imam Ibën Haxher El-Askalanij "Fet`h el-Bari", vëllimi: 5, faqja: 352.

Ashtu siç do të vërtetohej më vonë Marrëveshja e Hudejbijes solli një sukses shumë të madh për muslimanët.

Imam Ez-Zuhejri [Allahu e mëshiroftë] thotë: Asnjëherë nuk ishte arritur sukses më i madh për muslimanët, sesa ai në Hudejbije. Më parë kishte vetëm luftime, ku përballeshin njerëzit. Mirëpo në kohë paqeje, ku gjakrat qetësohen, kushdo e ka mundësinë të takohet dhe të bisedojë i qetë. Atëherë edhe ftesa islame u përhap më shumë dhe kushdo që dëgjonte për Islamin e pranonte atë. Vetëm në ato dy vite (marrëveshja zgjati vetëm dy vjet dhe u thye nga Kurejshët) paqeje pranuan Islamin aq shumë njerëz, sa ishin bërë muslimanë për të gjitha vitet e mëparshme. Ndoshta edhe më shumë.<sup>(404)</sup>

Imam Ibën Hishami<sup>(405)</sup> [Allahu e mëshiroftë] shkruan: Si argument për thënien e Imam El Zuherit është fakti se Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) në ditën kur bënte këtë marrëveshje kishte me vete vetëm një mijë e katërqind muslimanë. Ndërsa pas dy vjetësh, kur do të çlironte Mekën do të ishin dhjetë mijë muslimanë.<sup>(406)</sup>

Imam Ibën Haxher El-Askalanij<sup>(407)</sup> [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: -Ndër sukseset e arritura në Hudejbije ishte se njerëzit hynin në Islam në turma.

<sup>(404)</sup> - Marrë nga Ibën Hishami në "Siretu en-Nebij", vëllimi: 3, faqja: 425.

<sup>(405)</sup> - *Ibën Hishami*, Ndërroi jetë në vitin 213 Hixhri (828 Diellor).

Kronist i afirmuar (i gradës eminent) në shkencën e gjenalogjisë, gjuhës dhe rrëfimeve të arabëve. Ai ka lindur dhe është rritur në Basra, ndërsa ka vdekur në Egjipt. Libri i tij më i famshëm është "Es-Siratu en Nebeuie" i njohur me "Siratu Ibën Hisham", që e ka transmetuar nga Ibën Is'haku (duke e koleksionuar dhe përpunuar nga përpilimi i tij "El-Magazi ue Sijer"). Prej veprave të tij është "El-Kasaid el-Himjarie" që sjell rrëfimet e Jemenit dhe mbretërve të tij përgjatë periudhës paraislame. Po në këtë kontekst ka shkruar "Et-Tijxhan fi Muluki Himjar", që e ka transmetuar nga Esed ibën Musa, nga Ibën Sinani, nga Ueheb Ibën Munebihi si dhe veprën e tij "Sherhu ma Uekaa' fi Esha'ri es-Sijer min el-Garib" etj... [Shiko: "El-Ea'lem" me autor Ez-Zirikliu (i cili ndërroi jetë në vitin 1396 Hixhri)]. Es-Suhejliu, shpjeguesi i jetëshkrimin të Pejgamberit [*paqja qoftë mbi të!*], thotë për të në librin e tij "Er Raudu el-Unuf": "Ai njihet për mbartjen e diturisë dhe si i avancuar në diturinë e gjenealogjisë dhe gramatikës..." (sh.p.).

<sup>(406)</sup> - Marrë nga Imam Ibën Hishami në "Siretu en-Nebij", vëllimi: 3, faqja: 426.

<sup>(407)</sup> - *Ibën Haxheri*, lindi në vitin 168 Hixhri (784 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 230 Hixhri (845 Diellor).

I njohur me emrin Ibën Haxher El-Askalani, Shihebudin Ebu E- Fadli, el-Keneni. Ai është autori i interpretimit më të shquar të "Sahihu El-Bukhari". Origjina e tij është nga Askalani i Palestinës, teksa për të lindur ai lindi në Kajro, ku edhe ndërroi jetë. Ai është dijetar, muhadith, fakih, fillimisht përpilues i arrirë në zhanrin e letërsisë dhe poezisë,



Marrëveshja e Hudejbijes ishte çelësi i saj. Dhe duke qenë se Marrëveshja e Hudejbijes ishte çelësi i çlirimit të Mekës, kjo marrëveshje u quajt Çlirimi i Hudejbijes.

Kurejshët me këtë marrëveshje donin të zmbrapsnin muslimanët nga vizita e Qabes. Në pamje të jashtme ky ishte një poshtërim për muslimanët. Mirëpo në thelb ky ishte vetëm sukses për ta, pasi njerëzit në kohë armëpushimi patën mundësi të takoheshin me njëri-tjetrin dhe të bisedonin për Islamin haptazi pa i penguar askush. Muslimanët iu lexonin mosbesimtarëve ajetet e Kuranit dhe diskutonin me ta në mënyrë të hapur pa asnjë lloj pengese. Më parë ata bisedonin me njëri-tjetrin vetëm fshehtas. Ndërsa tani muslimanët mund të deklaroheshin publikisht për besimin e tyre dhe askush të mos i ndalonte. Mosbesimtarët u poshtëruan me të njëjtën marrëveshje, që kërkonin të korrnin sukses. U dorëzuan prej të njëjtës armë, që donin të arrinin fitoren.<sup>(408)</sup> Madje edhe muslimanët e kuptuan këtë sukses dhe shprehën pendesën e tyre. Omer ibn Hatabi [Allahu qoftë i kënaqur prej tij] duke kuptuar gabimin e bërë, i kishte shpeshtuar edhe më tepër punët e mira, në mënyrë që Allahu t'ia falte atij gabimin e bërë atë ditë. Ai do të thoshte për atë ditë: - Akoma vazhdoj të agjëroj, të jap lëmoshë dhe të liroj skllëvër, për shkak të asaj që

---

paskëtaj u dha pas hadithit, dëgjoi shumë dijetarë, udhëtoi dhe iu qep pas profesorit të tij Hafëzit Ebu El Fadl El-Irakiut. Ai udhëtoi në Jemen, në Hixhaz dhe gjetkë, që të dëgjonte dijetarët. Fama e tij u përhap anembanë. Njerëzit merrnin rrugën për tek ai për nxënien e diturisë që ai posedonte. Ai u bë Hafëzi i Islamit në kohën e tij. Kur El-Irakiu po përjetonte agoninë e vdekjes, atij i thanë: Kë ke lënë pas teje? Ai u përgjigj: "Ibën Haxherin, pastaj dy djemtë e Ebu Zer'as, pastaj El-Hajthemium". Ibën Haxheri ishte shumë elokuent, vjershëtor dhe recitues i afirmuar dhe njohës i kronikave të gjeneratave të mëhershme dhe mëvonshme. Ai u emërua në kryesinë e gjykatës së Egjiptit disa herë dhe më pas dha dorëheqjen. Sa i përket përpilimeve të tij ato janë vërtetë të shumta, prej të cilave përmendim: "Fet'hul Bari fi Sherhi Sahihi el-Bukhari", "El I'sabe fi Temjizi Esmei es-Sahabe", "Tehdhibu et Tehdhib", "Tekribu et-Tehdhib fi Esmei Rixhali el-Hadith", "Lisenu el-Mizan", "Esbebu en-Nuzuli", "Tea'xhilu el Menfea bi Rixhali el-Eimeti el-Arbea", "Bulugul Muram min Edileti el-Ehkami", "Teb siru el-Muntebih fi Tehrimi el Mushtebih", "It'hafu el-Mehera bi Etrafi el-Ashra", "Tabakatu el-Mudelisin", "El-Kaul el-Museded fi edh Dhebbi an Musnedi el -Imami Ahmed", etj... (sh.p.).

<sup>(408)</sup> - Imam Ibën Haxher El-Askalanij "Fet'h el-Bari", vëllimi: 5, faqja: 348.



kundërshtova atë ditë. E do të vazhdoj derisa të mendoj, se me këto do ta kem mbuluar atë gabim.<sup>(409)</sup>

Sahabi Sehël bin Hunejfi<sup>(410)</sup> [Allahu qoftë i kënaqur prej tij] gjithmonë i ndalonte njerëzit të kundërshtonin mendimet e dijetarëve të sahabëve. Gjithmonë i këshillonte në të tilla raste, që të rishikonin edhe një herë mendimet e tyre (nxënësve). Në Marrëveshjen e Hudejbijes ndryshe nga të tjerët ai thoshte: O njerëz, mendohuni mirë, çfarë po bëni? Si e kundërshtoni Pejgamberin (*paqja qoftë mbi të*)? Ju nuk e kundërshtuat Pejgamberin (*paqja qoftë mbi të*), kur ishim në Dumetul Xhendel<sup>(411)</sup>, e pse sot po e kundërshtoni?<sup>(412)</sup>

Këtu vihet në pah palëkundshmëria e Ebu Bekrit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij), që në momentet më të vështira i është gjendur pranë Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Në përgjigjen e Ebu Bekrit vërejmë, se ai ishte Sahabi më i plotësuar, njeriu më i njohur me çështjet e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*), njohësi më i mirë i çështjeve të Islamit dhe padyshim sahabi që ishte më korrekt me urdhrat e Allahut të Madhëruar [Allahu qoftë i kënaqur prej tij].<sup>(413)</sup>

<sup>(409)</sup> - Imam Ahmedi në "Musned", vëllimi: 4, faqja: 325 me Sened të mirë (transmetuesit janë të njohur dhe të besueshëm).

<sup>(410)</sup> - Sehël bin Hunejfi, Sahab [shok] i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Ndër ensarët më të njohur për diturinë e tij. Në fillimet e tij islame ai shkante natën dhe thyente idhujt e Medinës fshehurazi, pastaj i përdorte për dru zjarri. Në Betejën e Uhudit ai i dha besën Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) për të qenë ndër luftëtarët e vdekjes. Ka marrë pjesë në të gjitha betejat. Ndërroi jetë në vitin 37 Hixhri. (sh.p).

<sup>(411)</sup> - Dumetul Xhendel, kjo është një zonë tregtare e njohur në kohën për të cilën bëhet fjalë. Ishte një kryqëzim rrugësh ndërmjet Irakut, Sirisë dhe Gadishullit Arabik. Aktualisht gjendet në veri të Mbretërisë së Arabisë Saudite. Shkaku i kësaj beteje ishte kërcënimi që vinte nga fiset e kësaj zone, që ishin mbledhur për të sulmuar Medinen. Mirëpo reagimi i shpejtë dhe i papritur i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) bëri që armiqtë e dislokuar aty të shpërndaheshin të tmerruar dhe të befasuar njëkohësisht, pasi nuk pritnin një reagim të tillë kaq të shpejtë të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Aty muslimanët nuk bënë luftime, por fituan shumë plaçkë lufte. Sehël bin Hunejfi në ditën e Hudejbijes ua përmend Muslimanëve këtë rast (që ndodhi vetëm një vit më parë) për t'iu thënë, se ju erdhi mirë kur fituat plaçkë lufte në Dumetul Xhendel, por përkrahja nuk duhet vetëm në momente fitoreje.

<sup>(412)</sup> - Transmeton Imam El-Bukhari në disa pjesë të librit të tij "Es-Sahih" ndër to: vëllimi: 5, faqja: 331, kapitulli i Kushteve, paragrafi i kushteve të Xhihadit.

<sup>(413)</sup> - Imam Ibën Haxher El-Askalanij "Fet`h el-Bari", vëllimi: 5, faqja: 346.



Rreziku i kundërshtimit të dijetarëve bëhet edhe më i madh, nëse njerëzit synojnë me këtë ta ulin vlerën e tyre. Guvernatori i Kufes Zijad Ibën Ebi Sufjani (i cili ndërroi jetë në vitin 53 Hixhri) në një ligjëratë të tij foli për këtë çështje. Ai tha: O njerëz, mbrëmë nuk më ka zënë gjumi gjatë natës, për tre arsye. E ndjej veten përgjegjës për t'ju këshilluar për tre kategori njerëzish. E shoh të nevojshme t'ju këshilloj për respekt ndaj njerëzve të nderuar, ndaj njerëzve të ditur dhe ndaj njerëzve të moshuar. Këdo person që tregon mungesë respekti ndaj këtyre njerëzve do ta dënoj ashpër. Ju duhet ta dini, se shoqëria vlerësohet aq sa vlerëson ajo dijetarët, të nderuarit dhe të moshuarit e saj.<sup>(414)</sup>

Njerëzit e mençur gjithmonë e quanin për turp të kundërshtoheshin dijetarët. Lukmani e këshillon birin e tij duke thënë: Biri im, mos debato me të diturit, se do të poshtërohesh para tyre dhe do të të urrejnë njerëzit. Mos debato as me injorantët, se do të të poshtërojnë dhe do të të ofendojnë.<sup>(415)</sup>

Dijetari Mejmun Ibën Mehrani [Allahu e mëshiroftë] ka thënë: Mos sfido asnjë dijetar, por as edhe një injorant, sepse nëse sfidon një dijetar ka për të të burgosur dituria e tij, e nëse sfidon një injorant ai do të të poshtërojë me injorancën e tij.<sup>(416)</sup>

Nxënësi i diturisë duhet të jetë i kujdesshëm në bindjen ndaj dijetarëve dhe të ruhet nga diskutimi në praninë e tyre. Të mençurit kanë thënë: Nëse ulesh me të diturit dëgjo me vëmendje dhe mos hap gojën.<sup>(417)</sup>

Hasan Ibën Ali Ebi Talibi [Allahu qoftë i kënaqur prej tij]<sup>(418)</sup> e këshilloi birin e tij, duke i thënë: Biri im, kur të ulesh me dijetarët kujdesu të jesh i heshtur

---

(414) - Përmendur nga Imam Ibën Abdul El-Berri "Xhamiu Bejan el-Ilm ue Fadlihi", vëllimi: 1, faqja : 35.

(415) - Po aty, vëllimi: 1, faqja: 107.

(416) - Po aty, vëllimi: 1, faqja: 129.

(417) - Po aty, vëllimi: 1, faqja: 130.

(418) - *Hasan Ibën Ali Ebi Talib*, nipi i dashur i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Ai bashkë me vëllain e tij Husejnin ishin dy djemtë e Ali Ibën Ebi Talibit dhe gjyshi i tyre nga nëna ishte Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*). Ishin pika e tij e dobët dhe gjithmonë lutej për ta. Pas vrasjes së babait të tij, Hasani u bë Khalif i Muslimanëve për një periudhë gjashtë mujore pastaj dha dorëheqjen nga ky post duke ia lënë atë Muauije Ibën Ebi Sufjanit, për të bashkuar kështu Umetin Musliman, i cili sapo kishte kaluar disa sfida të përgjakshme. Ndërroi jetë në vitin në vitin 50 Hixhri.



dhe i vëmendshëm. Ushtroje veten bir, që të jesh i vëmendshëm dhe i heshtur para dijetarit.<sup>(419)</sup>

Gjithsesi kundërshtimi i dijetarëve nuk është për çdo gjë. Por kundërshtimi i urryer është ai, kur bëhet për një çështje, që është diskutueshme dhe ka ndryshim mendimesh. Është i urryer kundërshtimi sidomos kur vjen nga mungesa e fakteve dhe paaftësia për gjetjen e tyre. Sepse ka njerëz që e kanë mani t'i kundërshtojnë dijetarët dhe të gjejnë gabimet e tyre dhe nuk kanë ndërmend të marrin mësim dhe dituri prej tyre.

Ndërsa të lihet kritika e dijetarëve për çdo gjë, edhe kjo është e ndaluar dhe siç e kemi përsëritur vazhdimisht askush nuk është i pagabueshëm përveç Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*).

Imam Edh-Dhehebi [Allahu e mëshiroftë] citon në librin e tij një thënie të Ebu Abdurrahman Es-Sulemit (325-412 Hixhri) [Allahu e mëshiroftë] në të cilën thuhet: Ai që i thotë mësuesit të vet: Përse kjo?- Nuk ka për të patur sukses asnjëherë. Pastaj shton po aty: E këshilloj nxënësin e diturisë, që të mos i thotë mësuesit të tij: Pse kështu? Këta njerëz nuk mund të kenë sukses në diturinë e tyre.

Allahu i Madhëruar thotë në Kuran:

... وَتَعَاوَنُوا عَلَى الْبِرِّ وَالتَّقْوَىٰ ... ﴿٢١٧﴾

"Ndihmojeni njëri-tjetrin në punë të mira dhe në të ruajturit nga të këqijat."

Kuran: El-Maide, 2.

إِلَّا الَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَتَوَّصَوْا بِالْحَقِّ وَتَوَّصَوْا بِالصَّبْرِ ﴿٢١٨﴾

"... i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën."

Kuran: El-Asr, 3.

ثُمَّ كَانَ مِنَ الَّذِينَ ءَامَنُوا وَتَوَّصَوْا بِالصَّبْرِ وَتَوَّصَوْا بِالْمَرْحَمَةِ ﴿٢١٩﴾

(419) - Përmendur nga Imam Ibën Abdul El-Berri "Xhamiu Bejan el-Ilm ue Fadlihi", vëllimi: 1, faqja : 130. (sh.p).



"e këshillojnë për mëshirë."

*Kuran: El-Beled, 17.*

E pra, kush nuk u përmbahet këtyre ajeteve të Kuranit, ata vetëm se flasin dhe aspak nuk punojnë dhe në fund do të jenë të dështuar.<sup>(420)</sup>

---

<sup>(420)</sup> - Imam Edh-Dhehebi "Sijer Alam En-Nubela, vëllimi: 17, faqja: 251.

## Kapitulli i pesëmbëdhjetë: Statusi i besueshmërisë për dijetarin.

Ka disa njerëz që habiten pse dijetarët ndalojnë gjëra që në fakt janë të lejuara. Por dijetarët duke parë edhe rezultatet negative nga këto lejime mund të këshillojnë për ndalesën e tyre. Disa lejime mund të bëhen shkak për fenomene negative në shoqëri. Duke qenë kështu Islami i peshon gjërat dhe nuk neglizhon në lejimin e disa veprave që në vetvete janë të lejuara, nëse ato sjellin pasoja që mund të jenë të dëmshme për shoqërinë.

Le të marrim disa shembuj: Dihet që në Islam konsiderohet si mosbesimtar dhe njeri që dënohet me vdekje<sup>(421)</sup> nga Gjykata Islame, nëse dikush vërtetohet që ofendon simbolet e Islamit, ofendon Emrin e Allahut të Madhëruar, apo ofendon besimtarët. Në kohën e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) ka ndodhur, që disa njerëz kanë ofenduar haptazi besimtarët dhe ironizuan Islamin. Në një rën prej betejave të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) gjatë kthimit ndodhi që ndërmjet dy personave të kishte një mosmarrëveshje. Njëri prej tyre thirri në ndihmë fisin e vet, që ishte prej Ensarëve të Medines duke thirrur: Ku janë Ensarët?- Ndërsa tjetri duke parë veten ngushtë thirri emigrantët e Mekës, që kishin ardhur në Medine, duke thirrur:- Ku janë Muhaxhirët. Mirëpo Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) ndjeu rrezikun e sektarizmave fisnore dhe menjëherë ndërhyri: Ç'janë këto thirrje të kohës së injorancës? Njëri nga të pranishmit e sqaroi Pejgamberin (*paqja qoftë mbi të*), se si ishte puna. Mirëpo Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) tha: "Lërin këto thirrje (sektare) pasi janë të

(421) - Dënimi me vdekje, është dënimi kapital në këtë botë. Në Islam këtë dënim nuk mund ta japë askush tjetër vetëm se gjykatës islame dhe ekzekutimin e tij e ka obligim vetëm organet ekzekutive të shtetit Islam. Zakonisht para se të jepet dënimi me vdekje, personi duhet të hetohet për rrethanat në të cilat e ka kryer veprën penale, që i përgjigjet këtij dënimi. (sh.p).



*qelbura.*" Njëri prej të pranishmëve që ishte Abdu'lah Ibën Ubej Seluli <sup>(422)</sup> i ngarkuar me mlllef tha: Epo e mbus'ën kupën këta të ardhurit, kur të kthehemi në Medine, (Ne) elita e Medines do t'i nxjerrë jashtë ata (muslimanët) fundërrinat. Kjo shprehje e tij shkaktoi një zemërim të madh tek muslimanët dhe Umer Ibën Khatabi [Allahu qoftë i kënaqur prej tij] kërkoi leje nga Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*), që ta vriste këtë njeri. Mirëpo Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) e ndaloi atë duke thënë: "Jo, Umer, nuk duam që njerëzit të mendojnë se Muhamedi (*Paqja qoftë mbi të*) po vret shokët e tij."<sup>(423)</sup> Në këtë ngjarje ne kuptojmë, se Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) tashmë po menaxhonte një krizë të panevojshme bazuar në dasitë fisnore. Veprimi i parë që bëri ishte të shuante zjarrin e ndezur ndërmjet fiseve medinase dhe emigrantëve të Mekës. Pas kësaj ai e kuptoi, se dënimi i këtij njeriu jobesimtar dhe hipokrit do të shkaktonte një tjetër vatër zjarri të panevojshme, ndërkohë që sapo ishte shuar e para. Për këtë arsye Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) e ndaloi Umer Ibën Khatabin ta vriste këtë njeri, edhe pse dënimi i tij përputhej me legjislacionin e Islamit.

Për të njëjtën ngjarje shtohet, se djali i Abdullah Ibën Ubejit, edhe ai quhej Abdullah, i cili ishte besimtar i sinqertë shkon tek Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) dhe i thotë: O i Dërguari i Allahut, kam marrë vesh se ti ke ndërmend të vrasësh babain tim Abdullahun, për fjalët që ka thënë. Nëse të duhet ta bësh patjetër, të lutem më urdhëro mua për këtë ekzekutim. Unë ta sjell kokën e tij

---

<sup>(422)</sup> - Abdullah Ibën Ubej Seluli, ky ishte kandidati për kryetar i qytetit të Medines në kohën kur Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) sapo kishte emigruar në të. Me ardhjen e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*), planet dhe ambicjet e tij u shkatërruan. Tashmë lidershipi i Medines i takoi të Dërguarit të Allahut, kjo për shkak të popullaritetit të tij të menjëhershëm, që kishte fituar me Mesazhin e tij. Kjo shkaktoi tek Abdullah Ibën Ubej Selul një mlllef të madh. Mirëpo duke parë rrethanat ai u detyrua të heshtte dhe të pranonte, se ishte konvertuar në Islam. Por herë pas here ai gjente momente për të shfryrë inatin e tij ndaj Islamit dhe Pejgamberit Muhamed (*paqja qoftë mbi të*). Ky që po përmendim ishte njëri nga rastet. Për të zbritën edhe ajetet e Kuranit, ku Allahu i Madhëruar e ndalonte Pejgamberin (*paqja qoftë mbi të*) të kërkonte falje për të, sepse Allahu i Madhëruar nuk do t'ia falte. (sh.p).

<sup>(423)</sup> - Transmeton Imam El-Bukhari në "Es-Sahih", vëllimi: 6, faqja: 66, në kapitullin e Tefsirit, paragrafi i komentit të sures Munafikun. Imam Muslim në "Es-Sahih", vëllimi: 4, faqja: 1998-1999 numri i hadithit: 2584, në kapitullin e respektit, paragrafi, ndihmesa e vëllait në çdo rast. Imam Tirmidhi "Es-Sunen", vëllimi: 5, faqja: 90, numri i hadithit: 3370, në kapitullin e Tefsirit, paragrafi i Komentit të sures Munafikun.

para teje. E gjithë Medina e di se sa e kam dashur unë babain tim. Prandaj kam frikë se po të urdhërosh dikë tjetër për vrasjen e tij, unë nuk do duroj dot që vrasësi i babait tim të eci nëpër Medine dhe do të detyrohem të vras një musliman për shkak të një mosbesimtari dhe do të dënohem me zjarrin e Xhehenemit. Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) i tha: “Jo Abdullah, nuk kemi ndërmend ta bëjmë këtë gjë. Përkundrazi do ta nderojmë atë sa të jetë mes nesh.” Pas këtij reagimi të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*), nuk do të ishte më e nevojshme të vinin të tjera reagime nga ana e tij, pasi do të ishin njerëzit e tij, që do t’ia mbyllnin gojën këtij hipokriti, sa herë që ai do të fliste diçka të padrejtë ndaj Islamit dhe muslimanëve. Kur ndodhte kjo Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) i thotë Umer Ibën Khatabit [Allahu qoftë i kënaqur prej tij]: -“E shikon, Umer? Sikur të të kisha lejuar atëherë ta vrisje do të kishim reagime të ashpra. Por sot nëse do të urdhëroja vrasjen e tij do ta bënin po vetë njerëzit e vet.” Umeri i tha: Pasha Allahun e Madhëruar, mendimi yt, o i Dërguari i Allahut është më i drejtë sesa mendimi im.<sup>(424)</sup>

Megjithëse gjendja ishte e rënduar Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) u detyrua të mos e zbatonte këtë dënim, edhe pse nuk e mohoi që personi e meritonte këtë dënim. Në këtë veprim Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) i peshoi me kujdes dëmet dhe dobitë që do të sillte ky veprim dhe pa se dëmet do të ishin më të mëdha se sa dobitë.

Shembull tjetër:

Ndërtimi i Qabes në themelet e Ibrahimit (*paqja qoftë mbi të*) është çështje me shumë rëndësi, por Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) na ka treguar, se rëndësi parësore kishte uniteti dhe paqja në shoqëri. Aishja (Allahu qoftë i kënaqur prej saj) e kishte pyetur Pejgamberin (*paqja qoftë mbi të*) në lidhje me muret e Qabes. Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) i kishte thënë: “Populli yt (*kurejshët*) e zvogëluan ndërtesën e Qabes, për shkak se u mungonin fondet.” Ajo e pyeti edhe për derën e Qabes, e cila ishte e ngritur në një nivel mbi kokat e njerëzve. Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) tha: Populli yt e bëri këtë, sepse nuk donte që gjithkush të hynte brenda në Qabe, por të lejonin vetëm ata që dëshironin. Sikur të

<sup>(424)</sup> - Cituar nga Sira e Imam Ibën Hishamit, vëllimi: 3, faqja: 374. Imam Taberi, vëllimi: 28, faqja: 116. Gjithashtu në "Xhemiu el-Bejan" vëllimi: 2, faqja: 608, edhe në "Tarikhu el-Umem ue el-Muluk", Imam Ibën Kethiri, "El-Bidaje ue en-Nihaje: vëllimi: 4, faqja: 158.



mos ishte fakti që populli yt ka hyrë rishtazi në Islam dhe mund të ndodhi ndonjë përçarje ndërmjet tyre kisha për ta zgjeruar Qaben në themelet e saj dhe do ta ulja derën e saj në nivel me tokën.”<sup>(425)</sup>

Me këtë shembull kuptojmë, se Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) e ndaloi rindërtimin e Qabes në themelet e asaj që kishte ndërtuar më parë Ibrahim, duke shmangur çdo debat të njerëzve, që sapo ishin bërë muslimanë.

Prandaj i nderuar vëlla, ki kujdes dhe besoji gjykimeve të dijetarëve. Duhet të kesh besim në vendimet e tyre, edhe pse në pamje të parë ato të ngjajnë jo të drejta, duhet të jesh i bindur se shkak i vendimeve të tyre ka qenë shmangia e një të keqeje më të madhe, ose arritja e një të mire më të madhe, se sa ajo e pritshmja.

Ka disa njerëz që u kërkojnë llogari dijetarëve për gjykimet e tyre, që sipas tyre (njerëzve) mund të jenë të padrejta. Por kjo është një çështje e ndaluar në Islam dhe me logjikën e shëndoshë njerëzore. Në fakt jo çdo çështje është e përshtatshme për t'u bërë publike. Ali Ibën Ebi Talib [Allahu qoftë i kënaqur prej tij] na këshillon: Tregojuni njerëzve aq sa mund të mbajnë logjika e tyre. A dëshironi që të mohojnë Allahun dhe Pejgamberin e Tij.<sup>(426)</sup>

Ndërsa Abdullah Ibën Mesudi [Allahu qoftë i kënaqur prej tij] vëren se: Nëse do t'u flasësh njerëzve me gjëra që ata nuk arrijnë t'i kuptojnë, thjesht ke shkaktuar probleme në një pjesë të tyre.<sup>(427)</sup> Për këtë arsye dijetarët e quajnë të pakëshillueshme të tregohen detaje të gjykimeve të tyre për çdo njeri, në mënyrë që të mos bëhet një dëm edhe më i madh. Kjo nuk konsiderohet si fshehje e diturisë, e cila është e ndaluar. Kjo futet në dituritë e panevojshme dhe të dëmshme për t'u përcjellë.

Imam Esh-Shatibi [Allahu e mëshiroftë] thotë: Le të dihet, se jo çdo çështje që kemi në kokë duhet edhe të thuhet. Edhe pse prej diturisë Islame pjesa më e

---

<sup>(425)</sup> - Transmeton Imam El-Bukhari, vëllimi: 2, faqja: 156-157, në kapitullin e Haxhit, paragrafi i mirësive të Mekës dhe ndërtesave të saj. Imam Muslim, në vëllimi: 2, faqja: 973, numri i hadithit: 1333, në kapitullin e Haxhit, paragrafi Muret e Qabes dhe dera e saj. Imam Darimiu, vëllimi: 1, faqja: 382 numri i hadithit: 1876 në kapitullin e Menasik, paragrafi "Hixhr min el-Bejt".

<sup>(426)</sup> - Imam El-Bukhari, vëllimi: 1, faqja: 41, në kapitullin e diturive dhe personave të përshtatshëm për të.

<sup>(427)</sup> - E përcjell Imam Muslim në parathënien e librit të tij "Es-Sahih", vëllimi: 1, faqja: 11, kapitulli i përgënjeshtimit të personit, që flet gjithçka që dëgjon.



madhe e saj sigurisht që është e obligueshme të thuhet. Por ka prej tyre që në momente të caktuara, në vende të caktuara apo edhe në persona të caktuar nuk duhet të thuhet.<sup>(428)</sup> Por kjo ka edhe kushtin e vet, të cilin na e sqaron përsëri imam Esh-Shatibi: Çështja duhet të peshohet sipas jurisprudencës islame, nëse sipas saj mund të jetë e dobishme në raport me shoqërinë, atëherë ajo duhet të publikohet. Në të kundërt ajo mund të konsiderohet prej diturive që jepen në kohë të veçanta dhe në nivele të veçanta të përgatitjes shkencore. Kështu në plan të parë vihet interesi i shoqërisë, nëse është në dëm apo në dobi të saj, rrjedhimisht merr edhe gjykimin përkatës.<sup>(429)</sup>

Njerëzit duhet të kenë besim tek dijetarët e tyre. Gjykimet e tyre nuk duhet të keqkuptohen, por duhet të ndiqen me besueshmëri, sepse ata e dinë më mirë, se ku është interesi i përgjithshëm i shoqërisë dhe ku mund të jetë dëmi i saj. Prandaj ata që i besojnë dijetarëve duhet të dinë se: Dijetarët [Allahu i mëshiroftë dhe i ruajtë] dinë më shumë se nxënësit e tyre: çfarë është e dobishme dhe çfarë jo. Sepse ata krahas mësimdhënies japin edhe edukimin që përmban dituria Islame. Ata janë edukatorë të shoqërisë. Ata i japin shoqërisë dozën e diturisë në masën e caktuar, në fazën e caktuar. Dinë të dallojnë çështjet parësore nga ato dytësore.

Në komentin e tij të ajetit të Kuranit:

مَا كَانَ لِبَشَرٍ أَنْ يُؤْتِيَهُ اللَّهُ الْكِتَابَ وَالْحُكْمَ وَالنُّبُوَّةَ ثُمَّ يَقُولَ لِلنَّاسِ كُونُوا عِبَادًا لِي مِنْ دُونِ اللَّهِ وَلَكِنْ كُونُوا رَبَّانِيِّنَ بِمَا كُنْتُمْ تُعَلِّمُونَ الْكِتَابَ وَبِمَا كُنْتُمْ تَدْرُسُونَ ﴿٧١﴾

"Bëhuni edukatorë, me çfarë u keni mësuar (nxënësve) nga Libri dhe diturinë që keni marrë!"

Kuran: Ali Imran, 79.

Abdullah Ibën Abasi [Allahu qoftë i kënaqur prej tij] thotë: Bëhuni edukatorë të urtë dhe të mençur.<sup>(430)</sup>

(428) - Imam Esh-Shatibi "El Muuefekat", vëllimi: 4, faqja: 189.

(429) - Imam Esh-Shatibi, "El-Muuefekat", vëllimi: 4, faqja: 191.

(430) - Transmeton Imam El-Bukhari, vëllimi: 1, faqja 160.



Imam El-Bukhari [Allahu e mëshiroftë] thotë: -Edukator është ai mësues që i mëson nxënësit e vet me gjërat e vogla para gjërave të mëdha.<sup>(431)</sup> Në komentin e kësaj thënieje të Imam El-Bukhariut, Ibën Haxher El-Askelani [Allahu e mëshiroftë] thotë: Gjëra të vogla quhen gjërat e përgjithshme, ndërsa gjëra të mëdha janë detajet e çështjeve. Disa dijetarë i mësojnë nxënësve të tyre, degët para se të mësojnë trungun e pemës, u mësojnë tekstin pa u mësuar mesazhin e tekstit.<sup>(432)</sup>

Imam Ibën Gajathi (117-196 Hixhri) [Allahu e mëshiroftë] na rrëfen historinë e tij me mësuesin e Jurisprudencës, Eameshin (61-148 Hixhri). Shkova tek ai për të mësuar jurisprudencën islame, mirëpo ai më pyeti: A e ke mësuar Kuranin? Unë i thashë: Jo. Ai më tha: Atëherë, shko dhe mëso Kuranin pastaj eja tek unë të të mësoj Jurisprudencën. Edhe unë shkova të mësoj Kuranin dhe arrita ta mësoj atë të gjithin përmendësh. Pastaj shkova tek mësuesi im dhe ai pranoi të më mësonte Jurisprudencën Islame.<sup>(433)</sup>

Më kanë treguar shumë persona që kanë mësuar tek profesori im Muhamed Ibën Ibrahim Ali Shejkh<sup>(434)</sup> [Allahu e mëshiroftë], se kushdo që i vinte për të mësuar tek ai, e porosiste të mësonte një herë Kuranin të gjithin përmendësh. Pastaj fillonte t' i mësonte atij tekste të lehta, derisa e ngjiste atë në dituri edhe më të zgjeruara. Mësimet e këtij dijetari ishin të përshkallëzuara. Kushdo që donte të mësonte nga Profesor Ali Shejkh duhej fillimisht të mësonte Kuranin përmendësh.

---

<sup>(431)</sup> - Imam El-Bukhari "Sahih el-Bukhari" dhe "Fet'h el-Bari", vëllimi: 1, faqja: 162.

<sup>(432)</sup> - Po aty.

<sup>(433)</sup> - Transmeton Imam RamHurmuzi në "El-Muhadith el-Fasil", faqja: 203.

<sup>(434)</sup> - Ish-Myftiu i përgjithshëm i Mbretërisë së Arabisë Saudite (lindi në vitin 1311 Hixhri dhe ndërroi jetë në vitin 1389 Hixhri). (sh.p).

## Përfundimi

Në përfundim të këtij studimi, për të cilin i lutem Allahut të Madhëruar, që ta bëjë këtë të dobishëm për njerëzit po i përmbledh në disa pika të gjitha rezultatet në të cilat kam arritur këtu, në formën e një epilogu.

1. Dijetarët [Allahu i mëshiroftë] kanë cilësi të veçanta, që i dallojnë ata nga njerëzit e tjerë, ndër to është dituria e tyre, mençuria dhe devotshmëria që ata kanë me Allahun e Madhëruar. Për këtë arsye ata shquhen në shoqëri dhe respektohen prej saj dhe janë dëshmuar të saj përpara Allahut të Madhëruar.

2. Gjithsesi dijetarët kanë dallim edhe prej atyre që konsiderohen leximtarë, mendimtarë, ligjërues, apo intelektualë. Ata janë diçka më shumë se kaq. Edhe pse secili prej tyre ka vlerat e veta, ata janë të specializuar në çështje të ndryshme dhe mund të jenë të aftë në profesionet e tyre. Por në çështje të diturisë, për këtë flasin dijetarët.

3. Dijtarët kanë një vend të veçantë në Islam dhe në Shoqëri, që nuk mund ta arrijnë të tjerët, që nuk janë në nivelin e tyre. Argumentet për këtë i kemi shtjelluar më lart, por vlen të theksohen disa vërejtje:

- Dijetarët me këtë rast nuk shenjtërohen. Respekti i tyre është në varësi të respektit që ata kanë ndaj Allahut të Madhëruar, pasi ata janë udhëzuesit drejt rrugës së Tij.
- Dijetarët nuk duhet të merren si referencë vetëm për çështje të Islamit, por për të gjitha çështjet shoqërore, sepse edhe vetë Islami nuk është vetëm për adhurimet, por i përfshin të gjitha këto çështje të shoqërisë, thënë ndryshe Feja Islame është sistem jetese.



- Vlera e dijetarëve vjen vetëm nga dituria e tyre. Ky vlerësim nuk mund të hiqet për çështje të tjera, qofshin ato çështje sociale, shkarkime nga detyra, krime kolegjesh apo mospajtime në gjykim.
- Vlera e tij shtohet edhe më shumë nëse gjykimi i tij i bashkohet gjykimin të pjesës tjetër të dijetarëve, ose një pjese të madhe të tyre.

4. Është detyrë e shoqërisë t'i nderojë dhe t'i dojë dijetarët, pasi ata janë njerëzit më meritore për këtë respekt, duke qenë se vetë Allahu i Madhëruar i nderon. Dashuria ndaj tyre është tregues i devotshmërisë së njeriut ndaj Allahut të Madhëruar.

5. Nderimi i dijetarëve është porosi e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) dhe e të gjithë dijetarëve të hershëm dhe të mëvonshëm të këtij Umeti.

6. Mënyra e marrjes së diturisë është ndjekja dhe pasimi i dijetarëve dhe munda e sakrifica që duhet nxënësi të bëjë për diturinë e tij. Duhet që nxënësi të shkojë tek mësuesi i tij dhe jo e kundërta.

7. Dituria është në grada dhe specialitete të ndryshme, dhe dijetarët ndryshojnë në këto grada dhe specialitete. Nxënësit duhet të respektojnë hierarkinë e nevojshme të diturisë dhe dijetarëve.

8. Ofendimi apo mungesa e respektit ndaj dijetarëve është sjellje e njerëzve të shkatërruar, pasi mosrespekti apo ofezat ndaj tyre në të vërtetë janë ofeza ndaj vetë Islamit, sepse ata janë bartësit e fesë.

9. Dijetarët duke qenë njerëz janë edhe të gabueshëm, por akuzat ndaj gabimeve të tyre sjellin dy rreziqe shumë të mëdha:

- Akuza mund të mos jetë e bazuar në fakte. Pra, mund të mos jetë dijetari në gabim, por keqkuptimi i akuzuesve.
- Akuzuesi mund të mos jetë fare në nivelin e dijetarit. Madje ai mund të mos jetë i aftë të zbulojë gabimet e veta, e jo më të jetë i aftë të gjykojë një dijetar.

10. Dijetarët janë vlerat e shoqërisë. Për këtë arsye çdo gabim i tyre duhet të mirëkuptohet dhe të justifikohet. Në fakt kështu duhet vepruar për çdo musliman. Mirëpo për dijetarët kjo është edhe më e domosdoshme.

11. Sfidat e shoqërisë janë të shumta. Shpeshherë ato janë shkak për konfuzion në shoqëri. Krijohen keqkuptime dhe keqinterpretime të ndryshme. Në ato momente mbrojtja më e mirë është duke qenë të bashkuar dhe jo të ndarë. Në bashkësi kryesuesit e saj duhet të jenë dijetarët. Duke qenë kështu njerëzit duhet që të ndjekin vazhdimisht mendimet e dijetarëve dhe t'u referohen atyre në të gjitha çështjet. Sidomos kur kemi të bëjmë me kohën e sfidave shoqërore.

12. Gjithmonë sa herë që do të ketë dijetarë, do të ketë edhe njerëz që do t'i përflasin ata. Do të ketë prej tyre që do t'i shenjtërojnë, por edhe prej tyre që do t'i poshtërojnë. Mirëpo qëndrimi mesatar dhe i drejtë është që, as të mos i shenjtërojmë dijetarët, as t'i përgënjeshtrojmë ata. Por në rast se ka çështje të përfolura ndaj tyre, duhet të sigurohemi mirë për vërtetësinë e tyre, siç thotë Allahu i Madhëruar.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا إِن جَاءَكُمْ فَاسِقٌ بِنَبَأٍ فَتَبَيَّنُوا أَن تُصِيبُوا قَوْمًا بِجَهَالَةٍ فَتُصْحَبُوا عَلَىٰ مَا  
فَعَلْتُمْ نَدِيمِينَ ﴿٦﴾

"O ju që keni besuar! Nëse ndonjë njeri i pandershëm ju sjell ndonjë lajm, sigurohuni mirë (në është i vërtetë), për të mos i bërë dëm ndokujt padashje, e të pendoheni pastaj për atë që keni bërë."

*Kuran: El-Huxhuratë, 6.*

13. Siç është e konfirmuar edhe në Islam, por edhe me logjikën e shëndoshë, dijetarët nuk janë të mbrojtur nga gabimet. Por për njerëzit që njihen për vlerat dhe mundin e tyre në dituri dhe në Islam gabimet e tyre janë të pallogaritshme në krahasim me vlerat dhe kontributet e tyre. Për këtë arsye përpara se të gjykojmë gabimet e dijetarëve, duhet më parë të fusim në



peshore vlerat dhe kontributin e tyre. Ky është një parim i Sunetit dhe i dijetarëve të hershëm, dhe nuk është një shpikje apo devijim prej tyre.

14. Qëndrimi i drejtë në raport me vlerësimet e dijetarëve është i bazuar në dy parime:

- Mospranimi i mendimit të gabuar të dijetarit, nëse ai bie ndesh me Jurisprudencën Islame.
- Drejtësia në konsideratën ndaj dijetarit. Duke mos i mohuar atij kontributet dhe vlerat e tij, për shkak të mendimit të tij të gabuar.

15. Dijetarët janë liderët e shoqërisë islame. Është e drejta e tyre, që kur ata gabojnë të këshillohen me metoda sa më të respektueshme për ata dhe vlerat që kanë.

16. Kur dijetarët gjykojnë njëri-tjetrin nuk është e thënë se gjithmonë kanë të drejtë. Arsyet që i bëjnë ata të kritikojnë njëri-tjetrin mund të jenë të drejta, por mund të jenë edhe për arsye njerëzore, siç janë inati, zilia apo të tjera. Për këtë arsye zakonisht nuk merret për bazë fjala e një dijetari për kolegun e tij, sidomos kur ai është bashkëkohës.

17. Në përgjithësi njeriu duhet të jetë i drejtë dhe objektiv, por më shumë ai duhet të jetë me dijetarët dhe mendimet e tyre. E gjithë kjo mund të përmbliidhet në këto pika:

- Dijetari në çdo rast është i shpërblyer nga Allahu i Madhëruar, qoftë kur është i saktë, qoftë kur është në gabim. Mjafton që ai të përdorë të gjitha mjetet shkencore për gjetjen e gjykimit të drejtë dhe të jetë i devotshëm me Allahun e Madhëruar.
- Debatimet dhe ndryshimet e mendimeve ndërmjet dijetarëve janë të lejuara dhe konstruktive për aq kohë sa ato nuk shkaktojnë ndasi dhe inate.
- Shkaqet pse dijetarët mund të mos jenë plotësisht dakord me njëri-tjetrin, në mendimet e tyre janë të shumta. Për to janë shkruar shumë libra dhe studime.



- Gjithsesi baza e fesë nuk përbëjnë objekt diskutimi. Ndërsa për çdo debat referenca duhet të jetë Kurani dhe Suneti i Pejgamberit (Paqja qoftë mbi të).
- Askush, cilido qoftë ai nuk është i pagabueshëm dhe fjalët e tij mund të merren, por edhe mund të lihen, përveç Pejgamberit (Paqja qoftë mbi të).

18. Dijetarët nuk duhet të kundërshtohen, kjo është një çështje e domosdoshme dhe e lavdërueshme për shoqërinë. Përpara se kjo të bëhet duhet të rishikohet mendimi i kritikuesit të dijetarit. Pasi në shumicën e rasteve ai është i gabuari. Sidomos kjo porosi është e domosdoshme për nxënësit e diturisë. Duke mos kundërshtuar dijetarët, por duke rishikuar dhe korrigjuar mendimet e tyre.

19. Njerëzit më të merituar, që duhet t'u besojmë janë dijetarët. Prandaj vendimet e tyre duhet të përcillen nga masat dhe duhet të pranohen prej tyre.

Falënderimet i takojnë Allahut të Madhëruar, me përkrahjen e të Cilit arrihen edhe veprat e mira. Paqja dhe bekimi qofshin mbi Pejgamberin Muhamed, mbi familjen e tij dhe mbi shokët e tij dhe të gjithë ata që ndjekin rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit.

FUND



## Fjalori Terminologjik

### A

**Allah:** është emri i Zotit, Krijuesit të gjithësisë. Termi 'i Madhëruar' përdoret në shenjë nderimi për Krijuesin e gjithësisë. Vetëm Atij i takon merita për ekzistencën e gjithçkaje në gjithësi. Adhurimi duhet ti dedikohet vetëm Atij dhe askujt tjetër, për faktin se Ai është Sunduesi i vërtetë i gjithçkaje. Emri madhështor "Allah" përmendet edhe në librat e mëparshëm sipas dialektikave të gjuhëve respektive. Në Bibël është përmendur 'Eloha' nga hebraishtja. Në Kuran emri "Allah" përmendet rreth 2153 herë.

**Ademi:** Është njeriu i parë i racës njerëzore. Ai u krijua në Xhenet nga dheu i marrë nga planeti Tokë. Pasi këtij krijimi Allahu i Madhëruar e vendosi në Xhenet dhe i mësoi të gjitha njohuritë që do të dijnë njerëzit pas tij. Kjo bëri që ai të ishte më i vlerësuar sesa engjëjt, xhindët, madje edhe çdo lloj krijese tjetër. Ai u caktua nga Allahu i Madhëruar, si kujdestar i Tokës. Ai është babai i tërë njerëzimit dhe gruaja e tij Havaja, që u krijua nga brinja e tij është nëna e tërë racës njerëzore.

**Asketizëm:** është animi i njeriut në një jetesë shpirtërore, duke lënë pas dore anën materiale të kësaj bote. Në Islam duhet të ketë patjetër një balancim ndërmjet anës shpirtërore dhe asaj materiale. Gjithsesi në kontekst bëhet fjalë për ata njerëz dijetarë që e njohin mirë këtë balancë të Islamit. Këtu është përdorur për të vënë në pah refuzimin e tyre në kompromentimin material të fjalës.

### B

**Bedër:** Beteja e parë mes muslimanëve me mosbesimtarët kurejshitë. Ata u

përballën në zonën e quajtur burimet e Bedrit. Në këtë përballje muslimanët fituan ndaj kurejshëve dhe aty mbetën të vrarë pothuajse të gjithë liderët e tyre, të cilët ishin edhe nxitësit e kësaj lufte kundër Islamit dhe muslimanëve. Ndodhi në vitin e dytë të Hixhrit.

**Beni Kurejdha:** Fis Hebre që jetonte në periferi të Medinës. Ata e kishin thyer marrëveshjen me Pejgamberin (*paqja qoftë me të*) dhe kishin bërë aleancë me armiqtë e muslimanëve, që kishin rrethuar Medinen në betejën e njohur si 'Beteja e Hendekut'. Për këtë arsye Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) u shpalli luftë atyre dhe dërgoi tek ata një ekspeditë ushtarake.

## C

**Civilizim:** Civilizimet janë mënyra jetese të shoqërisë njerëzore. Aty përfshihen kulturat, traditat mënyrat e jetesës dhe religjionet e shoqërisë njerëzore. Ndër më të shquarat në historinë njerëzore njihen civilizimi grek, romak, egjiptian, ai Islam dhe civilizimi i sotëm Perëndimor.

## D

**Dëshmia: La ilahe il-Allah Muhamed Resulullah:** Kjo është dëshmia, e cila e njuh zyrtarisht secilin që do ta deklarojë, si besimtar musliman. Sipas një hadithi të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) është edhe çelësi për t'u futur në Xhenet. Kjo përkthehet në shqip: Nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut të Madhëruar, i Cili është i denjë për adhurim dhe se Muhamedi është i Dërguar i Tij. Allahu Krijuesi dhe Poseduesi i gjithçkaje që ekziston është i Vetmi që meriton të adhurohet. Madje kjo është arsyeja e vetme për të cilën Allahu i Madhëruar e ka krijuar racën njerëzore dhe racën e xhindeve. Ndërsa Muhamedi (*paqja qoftë mbi të*) është i dërguari i Tij i fundit.

**Dëshmor:** Dëshmor në Islam konsiderohet çdo musliman, që lufton dhe jep jetën e tij në beteja kundër mosbesimtarëve, ose në mbrojtje të nderit, pasurisë dhe jetës së tij apo familjes së tij, madje i tillë konsiderohet edhe ai që mbron



atdheun e tij, duke qenë besimtar dhe me nijetin që këtë sakrificë t'ia dedikojë vetëm Allahut të Madhëruar, që të jetë fjala e Allahut të Madhëruar ajo triumfuesja.

**Dijetarët e Hadithit:** Hadith është e barazvlefshme edhe me fjalën Sunet. Bëhet fjalë për porosinë e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*), qofshin ato pohime, ndalesa dhe heshtje të tij. Shkenca e mbledhjes së Hadithit është një ndër shkencat e rralla të diturisë njerëzore. Për t'u kujdesur për autenticitetin e përcjelljes së Hadithit, dijetarët e Islamit kanë krijuar shkencën e biografisë së transmetuesve të Hadithit. Në bazë të transmetuesve mund të vlerësohet edhe vetë autenticiteti i Hadithit. Përmbledhjet më autentike janë Sahihu i Buhariut dhe Sahihu i Muslimit, kjo për faktin se standartet e vendosura nga këta dy dijetarë të hadithit janë shumë strikte dhe shumë korrekte në përcjelljen e një Hadithi të transmetuar nga Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*). Gjithsesi ky është një profilizim i diturisë. Ashtu sikurse ka Dijetarë specialistë të Komentit të Kuranit, Dijetarë specialistë të Jurisprudencës e kështu me radhë. Jo gjithmonë dijetari specialist i Hadithit është edhe në Jurisprudencë po aq specialist sa në Hadith. Jo gjithmonë Dijetari specialist i Komentit të Kuranit është edhe dijetar specialist i Jurisprudencës, megjithëse të gjithë dinë shumë edhe nga fushat e tjera. Kështu mbetet parimi: Çdo shkencë ka njerëzit e saj.

**Dita e Gjykimit:** Quhet dita e madhe në të cilën do të vendoset drejtësia absolute hyjnore. Ajo ditë do të jetë pas Kijametit dhe ringjalljes së krijesave. Do të jetë e gjatë sa njëmijë vjet me ato të tokës. Në të njerëzit do të llogariten për çdo veprim të jetës së tyre në këtë botë dhe do të shpërblehen sipas veprave që kanë kryer. Të gjitha veprat e tyre do të vihen në peshore dhe nëse ajo do të anojë nga punët e mira, personi do të shpërblehet me Xhenet. Ndërsa nëse peshorja do të anojë nga veprat e këqija, atëherë personi do të dënohet në zjarrin e Xhehenemit. Aty do të ketë edhe dëshmitarë të cilët do të dëshmojnë për veprat që ka kryer njeriu, prej të cilave do të jenë edhe vetë gjymtyrët dhe shqisat e tij. Prej dëshmitarëve të kësaj dite gjithashtu mund të jenë edhe engjëjt, njerëzit, kafësht dhe sendet. Vetë Kurani do të dëshmojë mbi sjelljen e njeriut në raport me të.

**Dita e Kijametit:** Është dita në të cilën do të mbarojë kjo botë dhe jeta në të. Gjithçka në këtë gjithësi do të shkatërrohet. Ajo do të ndodhë vetëm me një të fryrë të bririt nga Engjëlli Israfil dhe gjithçka do të fillojë të shkatërrohet. Sipas dëshmimeve të shkencëtarëve i gjithë kozmosi ka qenë i ngjeshur në një masë shumë të vogël dhe e ka origjinën nga ajo që quhet shpërthimi i madh 'Big Beng'. Sipas tyre, shkatërrimi i gjithësisë do të ndodhë kur e gjithë kjo të mblidhet edhe një herë në masën që ishte. Madje kjo vërtetohet edhe në ajetin e Kuranit, ku Allahu thotë: "Ashtu si e nisëm fillimin e krijimit ashtu edhe do ta rikthejmë atë." Kurani: El-Enbija, ajeti: 104. Pas një kohe të caktuar, ku gjithçka përveç Allahut të Madhëruar do të jetë shkatërruar dhe vdekur. E kështu do të fillojë ringjallja e madhe për të vazhduar më pas me ditën e Gjykimit.

**Dumetul Xhendel:** Kjo është një zonë tregtare e njohur për kohën për të cilën bëhet fjalë. Ishte një kryqëzim rrugësh ndërmjet Irakut, Sirisë dhe Gadishullit Arabik. Aktualisht gjendet në veri të Mbretërisë së Arabisë Saudite. Shkaku i kësaj beteje ishte kërcënimi, që vinte nga fiset e kësaj zone, që ishin mbledhur për të sulmuar Medinen. Mirëpo reagimi i shpejtë dhe i papritur i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) bëri që armiqet e dislokuar aty të shpërndaheshin të tmerruar dhe të befasuar njëkohësisht, pasi nuk e pritnin një reagim të tillë kaq të shpejtë të Pejgamberit (*Paqja qoftë mbi të*). Aty muslimanët nuk bënë luftime, por fituan shumë plaçkë lufte. Sehl ibn Hunejfi në ditën e Hudejbijes ua përmend Muslimanëve këtë rast (që ndodhi vetëm një vit më parë), për t'iu thënë se ju erdhi mirë kur fituat plaçkë lufte në Dumetul Xhendel, por përkrahja nuk duhet vetëm në momente fitoreje.

E

**Ensarët:** quhen kështu të gjithë ata që ndihmuan Pejgamberin (*paqja qoftë mbi të*) dhe i dolën në krah atij. Ata ishin nga populli i Medines dhe përbënin dy fiset më të mëdha të qytetit, fisin Eus dhe Hazrexh. Origjina e këtyre dy fiseve ishte nga Jemeni. Në atë kohë ata jetonin në luftëra fisnore ndërmjet tyre. Kjo do të vazhdonte kështu për vite me radhë deri sa erdhi Pejgamberi Muhamed (*paqja qoftë mbi të*) në Medine dhe i pajtoi, madje dhe i vëllazëroi



të gjithë njerëzit e saj me njëri-tjetrin dhe emigrantët mekas, që kishin ardhur bashkë me të.

## F

**Farisenjtë:** Farisenjtë janë klerikë në religjionin hebraik.

**Fetva:** Është gjykimi për një çështje të caktuar dhe duhet të bëhet nga një person i specializuar në këto çështje dhe që quhet Myfti.

## G

**Gusul:** Është mënyra e pastrimit të trupit (i gjithë trupi pa përjashtim, duhet të lahet me ujë). Ai bëhet i detyrueshëm në rastet kur njeriu bëhet i papastër, zakonisht pas marrëdhënieve seksuale, apo kur del sperma në rast endërrimi në gjumë.

## H

**Hadith:** Është ekuivalente edhe me fjalën Sunet. Bëhet fjalë për porositë e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*), qofshin ato pohime, ndalesa, dhe heshtje të tij. Shkenca e mbledhjes së Hadithit është një ndër shkencat e rralla të diturisë njerëzore. Për t'u kujdesur për autenticitetin e përcjelljes së Hadithit, dijetarët e Islamit kanë krijuar shkencën e biografisë së transmetuesve të Hadithit. Në bazë të transmetuesve mund të vlerësohet edhe vetë autenticiteti i Hadithit. Përmbledhjet më autentike janë Sahihu i Bukhariut dhe Sahihu i Muslimit, kjo për faktin se standartet e vendosura nga këta dy dijetarë të hadithit janë shumë strikte dhe shumë korrekte në përcjelljen e një Hadithi të transmetuar nga Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*).

**Hallall:** Përkthehet në shqip, i lejuar. Në fakt në Islam në origjinë të gjitha gjërat janë Hallall, përveç disave prej tyre, për të cilat kanë ardhur ndalesat përkatëse, nga Kurani dhe Suneti.



**Haram:** Është e kundërta e Hallallit. Natyrisht edhe përkthimi do të ishte, të ndaluara. Në Islam të gjitha adhurimet konsiderohen të ndaluara (d.m.th., nuk mund të shpiken vetvetiu), derisa të kemi argument për urdhërimin dhe mënyrat e praktikimit të tyre, nga Kurani dhe Suneti.

**Hixhri:** Hixhri, është mënyra e llogaritjes së kohës sipas historisë Islame. Kalendarit që bazohet në llogaritjet hënore dhe fillon me kohën kur Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) emigroi nga Meka në Medine (më 24 shtator të vitit 622 e.s.). I pari që e caktoi këtë Kalendar ishte Umer Ibën Khatabi, Khalifi [prijësi] i dytë i shtetit Islam. Ka 12 muaj me nga 29 deri në 30 ditë. Dita e parë fillon më datë: 16 Qershor të vitit 622 e.s. Aktualisht ndër shtetet që e aplikojnë zyrtarisht këtë Kalendar është Arabia Saudite.

**Horasan:** Zonë në Iranin lindor, sot ndahet në tre lokalitete të ndryshme.

## I

**Islam:** Është i vetmi religjion dhe besim i pranuar tek Allahu i Madhëruar. Është ai i vërteti. Të gjitha religjionet e tjera kanë dalë si shkak i devijimit nga religjioni i vërtetë, që është Islami. Në fakt Islami është shumë më tepër se sa religjion, ai është program jete për njeriun në misionin e tij si mëkëmbës i Allahut të Madhëruar, në Tokë dhe krijesave që ka në të. Përkthehet në shqip (paqe, harmoni) në këtë rast në harmoni me Allahun e Madhëruar dhe me krijesat e Tij. Islami është besimi i të gjithë Pejgamberëve (paqja qoftë mbi ta).

**Ixhma:** Unanimiteti i mendimit të dijetarëve të Jurisprudencës Islame ose i shumicës së tyre.

## K

**Khalif:** Quhet mëkëmbësi i Allahut të Madhëruar në tokë. Kështu është quajtur njeriu për shkak të misionit të tij në kujdestarinë e tokës. Halif quhet



edhe kryetari i shtetit Islam. Prej tyre katër të parët quhen Halifët e drejtë, për shkak të drejtësisë dhe korrektësisë që patën në ndjekjen e porosive të Kuranit dhe Sunetit të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*).

**Khavarixhët:** Janë një sekt ekstrem i dalë pas trazirash të mëdha që u shkaktuan në brezin e parë të Historisë islame. Sipas tyre njeriu konsiderohet mosbesimtar dhe del nga Islami, qoftë edhe për një gabim të vogël që mund të bëjë. Rrjedhimisht duke dalë nga Islami, lejohet edhe vrasja e këtyre mëkatarëve. Një pjesë e madhe e sjelljeve ekstreme në ditët e sotme i faturohen këtij secti të devijuar.

**Kujdestari:** Kujdestaria, në Jurisprudencën Islame (por edhe nga sa njihej nga kurejshët e asaj kohe) ishte përgjegjësia që ka babai, vëllai, apo bashkëshorti, në lidhje me djemtë, vajzat, ose gratë e martuara. Femrës muslimane dhe fëmijëve nuk iu lejohet të udhëtojnë apo të përfaqësohen si palë në marrëveshje të ndryshme, pa praninë e Kujdestarit, që mund të jetë babai i saj, vëllai, ose bashkëshorti.

**Kurani:** Kurani është mesazhi i fundit hyjnor i zbritur nga Allahu i Madhëruar. I zbriti Pejgamberit Muhamed (*paqja qoftë mbi të*). Përbëhet nga 114 kapituj (Sure), i ndarë në 30 pjesë (Xhuze). Ai konsiderohet mrekulli, për faktin se në të ka vazhdimisht argumente të rigjenerueshme për të gjitha kohët dhe vendet. Është i mbrojtur nga çdo deformim nga vetë Allahu i Madhëruar, i cili thotë: “Sigurisht, Ne e kemi shpallur Kurantin dhe sigurisht, Ne do ta ruajmë atë.” sure El-Hixhër, ajeti: 9. Kurani konsiderohet si shtylla e parë e legjislacionit Islam.

## L

**La ilahe il Allah, Muhamedun Resul Allah:** Kjo është dëshmia e cila e njeh zyrtarisht secilin që do ta deklarojë, si besimtar musliman. Sipas një hadithi të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*), është edhe çelësi për tu futur në Xhenet. Kjo përkthehet në shqip: Nuk ka të adhuruar me të drejtë askënd veç Allahut të

Madhëruar dhe se Muhamedi është i Dërguar i Tij. Ai si Krijuesi dhe Poseduesi i gjithçkaje që ekziston është i Vetmi që meriton të adhurohet. Madje kjo është arsyeja e vetme për të cilën Allahu i Madhëruar e ka krijuar racën njerëzore dhe racën e xhindeve. Ndërsa Muhamedi (*paqja qoftë mbi të*) ishte i Dërguari i Tij i fundit.

**Laicizmi:** Laicizmi, është mënyra e qeverisjes duke mos pranuar legjislacionet fetare, por edhe duke mos i mohuar fetë dhe besimet në ushtrimin e funksionit të tyre shpirtëror.

**Lufta e Bedrit:** Beteja e parë e muslimanëve me mosbesimtarët kurejshitë. Ata u përballën në zonën e quajtur burimet e Bedrit. Në këtë përballje muslimanët fituan ndaj kurejshëve dhe aty mbetën të vrarë pothuajse të gjithë liderët e tyre, të cilët ishin edhe nxitësit e kësaj lufte kundër Islamit dhe muslimanëve. Ndodhi në vitin e dytë Hixhri.

**Luftëtarët e Bedrit:** Me këtë term njihen luftëtarët muslimanë, që dolën në këtë përballje me kurejshët. Ata në fakt dolën jo për të luftuar, por thjesht për të marrë karvanin tregtar, që dërgonte pasurinë e tyre të konfiskuar nga kurejshët, drejt Shamit. Mirëpo kurejshët sapo morën vesh për këtë lëvizje të muslimanëve dërguan në mbrojtje të karvanit një ushtri të përbërë prej 1000 ushtarësh të armatosur, ndërsa muslimanët ishin vetëm 300 burra. Të gjithë muslimanët që morën pjesë në këtë luftë të parë, u quajtën të përgëzuar me Xhenet dhe asnjë mëkat i tyre i mëvonshëm nuk do të ndikonte në vlerat e tyre. Ko luftë u fitua nga muslimanët, ndërsa kurejshët humbën aty pothuajse të gjithë elitën e tyre, e cila në fakt ishte ajo që e kishte munduar më shumë Pejgamberin (*paqja qoftë mbi të*) dhe muslimanët gjatë kohës së qëndrimit të tyre në Mekë.

M

**Marrëveshja e Hudejbijes:** Kjo marrëveshje u arrit në vitin e gjashtë të hixhretit, ndërmjet Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) dhe Kurejshëve. Thelbi i kësaj marrëveshjeje ishte paqja ndërmjet muslimanëve dhe fiseve, që ishin në



armiqësi me ta.

**Materializmi:** Filozofia që bazohet vetëm në anën materiale në mënyrën e jetesës.

**Medina:** Quhej ndryshe qyteti i Jethribit. Ishte vendi ku emigroi Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*). Ajo konsiderohet edhe baza ku për herë të parë lindi dhe u konsolidua shteti Islam. Aty ndodhet edhe xhamia e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Aktualisht gjendet në Mbretërinë e Arabisë Saudite.

**Medh`heb:** Shkollë juridike islame. Më të njohurat prej tyre janë katër medhhebe 1-Medhhebi Hanefi nga themeluesi i saj Imam Ebu Hanife. 2-Medhhebi Shafii nga themeluesi i saj Imam Shafiu, 3-Medhhebi Hambeli, nga themeluesi i saj Imam Ahmed Ibën Hambeli. 4-Medhhebi Maliki nga themeluesi i saj imam Malik Ibën Enesi.

**Mes`h:** Është mënyrë pastrimi, e cila përdoret në vend të larjes së këmbëve. Në këtë rast bëhet fjalë për fërkimin e këmbës mbi çorape me dorë të lagur. E zëvendëson pastrimin me ujë në raste kur lagia e këmbëve mund t'i dëmtojë ato, dhe kur çorapet janë të trasha, që nuk e lejojnë futjen e ujit në to. Lejohet aplikimi i Mes`hit për udhëtarin deri në 72 orë, ndërsa për vendasin deri në 24 orë.

**Mexhlis:** Ulje. Në ato kohë nuk kishte klasa të rregullta me banka, por nxënësit uleshin në formë rrethi dhe mësonin nga dijetari atë që u ligjëronte. Kjo ulje quhej Mexhlis. Gjithsesi kjo fjalë përdoret edhe sot duke nënkuptuar takime mes miqsh.

**Miraxh:** Udhëtimi që bëri Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) brenda natës nga Meka deri në Xhaminë Aksa në Palestinë e më pas nga aty deri përtej qiejve, ku u takua me Allahun e Madhëruar. Aty ai mori edhe udhëzimet për kohët dhe mënyrat e Namazit (faljeve, pesë herë në ditë) për më shumë referohu në Kuran, suren Isra dhe komentet e dijetarëve për këtë çështje.

**Muhaxhirët:** Janë sahabët [shokët] e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*), që emigruan bashkë me të nga Meka në Medine, ku i fundit prej tyre ka qenë xhaxhai i tij Abas Ibën Abdul Mutalibi.

**Musliman:** D.m.th. i nënshtuar. Përdoret për të gjithë ata që pranojnë Islamin dhe i nënshtrohen Allahut të Madhëruar. I pari që i ka quajtur kështu besimtarët ishte Pejgamberi Ibrahim (*paqja qoftë mbi të*).

**Muxhtehid:** Është dijetari Specialist në një fushë të caktuar të diturisë islame. Ai mund të jetë i tillë pasi të jetë i thelluar në këto dituri. Atëherë ai ka mundësi që të bëjë kërkime të pavarura dhe të dalë në gjykime të tilla, të cilat të respektohen nga dijetarët e tjerë dhe i tërë Umeti Musliman.

**Myfti:** Edhe ky është term në gjuhën arabe dhe përkthehet, si njeriu, i cili nxjerr gjykimin ndaj një çështjeje të caktuar. Sigurisht personi që ka tagrin ta nxjerrë gjykimin dhe ta bëjë atë publik, duhet patjetër të jetë i specializuar në fushat përkatëse. Zakonisht ky term përdoret për juristët e Sheriatit Islam. Myfti është dijetari i Islamit, që është i autorizuar për të dhënë gjykimin e tij për çështje të ndryshme, që kanë të bëjnë me publikun. Gjykimi i dhënë prej tij quhet Fetva.

**El-Muveta:** Është libri i Imam Malik Ibën Enesit në fushën e Jurisprudencës Islame. Ai është konsideruar si libri më i madh dhe më i organizuar deri në kohën e tij rreth viteve 150 Hixhri. Ai është i ndarë në 61 pjesë, me 803 kapituj. Juridikisht ai njihet si libër i Shkollës (Medhhebin) Maliki.

P

**Pejgamber:** Termi Pejgamber përkthehet ndryshe, si i Dërguar i Zotit për të përcjellë mesazhet e Tij. Në Kuran përmenden rreth 28 Pejgamberë, por numri i tyre i kalon të 120 mijët. Ata kanë qenë dërguar kohë pas kohe tek popuj të ndryshëm për të përcjellë këtë mesazh. Pejgamberi i fundit dhe vula e Mesazhit hyjnor është Muhamedi (*paqja qoftë mbi të*).



## R

**Rafidinjtë:** Sekt shiit, refuzues i respektit ndaj Sahabëve sidomos ndaj dy Khalifëve të parë të drejtë (Ebu Bekrit dhe Umer Ibën Khatabit). Shenjtërojnë padrejtësisht Ali Ibën Ebi Talibin dhe pasardhësit e tjerë të tij. Ndër ta bëjnë pjesë edhe Ismailinjtë, edhe Ithneasherije.

## S

**Sahabët:** Sahabët janë shokët dhe shoqëruesit e Pejgamberit Muhamed (*paqja qoftë mbi të*). Në fakt konsiderohet i tillë çdo bashkëkohës i tij, të cilët e kanë parë, ose jetuar me të, duke qenë muslimanë.

**Sahabët e Besës së Ridvanit:** Kjo ngjarje ndodhi në vitin e gjashtë Hixhri pak para marrëveshjes së Hudejbijes. Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) ishte nisur me 1500 muslimanë për të bërë Umre në Mekë, mirëpo kurejshët i penguan ata. Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) dërgoi Othman Ibën Afanin në Mekë për t'u bërë të ditur kurejshëve, se muslimanët vinin në paqe dhe kishin si qëllim vetëm vizitën e Qabes (Umre). Mirëpo gjatë takimeve me kurejshët Othmani u vonua, ndërsa në kampin e muslimanëve u përhapën fjalë, se Othmani ishte ekzekutuar nga kurejshët. Menjëherë të gjithë muslimanët u mbledhën dhe i dhanë besën Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*), se do të futeshin në Mekë dhe do të merrnin hakun e Othmanit. Vendi ku u dha besa ishte nën hijen e një peme. Të gjithë sahabët që dhanë besën u bekuan nga Allahu i Madhëruar, i cili deklaroi në Kuran, se është i kënaqur me të gjithë ata.

**Shejkh:** Termi 'Shejkh' është në gjuhën arabe dhe përdoret zakonisht për njerëzit e ditur, për njerëzit me reputacion shoqëror dhe për njerëzit e shtyrë në moshë.

**Shejtan:** Shejtan, d.m.th. i mallkuar dhe i përzënë. Ky epitete i është vendosur xhindit me emrin Iblis, i cili u mallkua nga Allahu i Madhëruar, si pasojë e mosbindjes së tij, kryeneçe ndaj urdhrit të Allahut të Madhëruar.



**Sheriat:** Kështu quhet sistemi i ligjeve të Islamit njohur ndryshe, si Jurisprudenca Islame. Islami duke qenë fe dhe shtet, rregullon jetën e njeriut në këtë botë materiale, por edhe në botën e tij shpirtërore. Islami përmban ligje dhe rregulla që e organizojnë jetën e njeriut në të dyja anët e saj. Atë shpirtërore dhe atë materiale. Të gjitha këto janë të organizuara në kapituj të ndryshëm në Jurisprudencën Islame.

**Sulltan:** I Plotfuqishmi, i Pushtetshmi. Është kreu i shtetit Musliman. Sipas sistemeve të ndryshme është quajtur Khalif, Sulltan ose Emir.

**Sunet:** Quhet e tërë vepra, porositë, pohimet, ndalesat, dhe heshtjet e Pejgamberit Muhamed (*paqja qoftë mbi të*). Është shtylla e dytë e Legjislacionit Islam.

## T

**Tavaf:** Quhet rrotullimi rreth Qabes, kjo është mënyra më e preferuar e adhurimit, që duhet të bëhet në Qabe. Zakonisht duhet të bëhet shtatë herë me radhë. Aplikohet nga Haxhilerët ose nga ata që bëjnë vizitën e thjeshtë (Umre) në Qabe.

**Tabi'inët:** Tabi'inët ishin nxënësit e Sahabëve, ata që lindën pas largimit të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) nga kjo jetë. Konsiderohen të tillë të gjithë ata që kanë takuar së paku një herë, njërin prej sahabëve të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*).

## U

**Umeti musliman:** Në gjuhën arabe përkthehet si Bashkësi dhe përdoret zakonisht për bashkësinë islame. Është nocion më i gjerë sesa termi komb, pasi në bashkësinë islame futen kombe të ndryshme. Umeti musliman, është nocioni i përdorur për kombin apo popullin musliman. Ai nuk është i ndërtuar mbi baza etnike apo raciale, porse baza e tij është përkatësia në Islam. Në fakt



në Umetin musliman, futen edhe ato pakica jo muslimane, të cilat janë të mbrojtura me kontratë nga Shteti Islam.

**Umre:** Quhet vizita e Qabes, në kohë të Haxhit ose jo. Ajo është prej adhurimeve të këshillueshme për t'u bërë për secilin që shkon në Mekë, në kohën e Haxhit, ose jashtë kësaj kohe.

**Ushtria e Usres:** Bëhet fjalë për betejën e Tebukut, ku ushtria muslimane u detyrua të përballej me ushtrinë bizantine. Ndodhi në vitin e nëntë të hixhretit, menjëherë pas çlirimit të Mekës. Koha kur do të niseshin për në luftë ishte e nxehtë dhe njerëzit jo të gjithë i kishin mundësitë financiare për ta përballuar këtë udhëtim. Për këtë arsye Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) dërgoi lajm nëpër të gjitha fiset arabe, që ishin bërë muslimane në Mekë, Medinë dhe rrethinat e tyre. Të gjithë iu përgjigjën thirrjes, ku vetëm Othman Ibën Afani dhuroi një të tretën e shpenzimeve të luftës. Ai dhuroi 1500 deve, 50 Kuaj dhe 1000 dinarë (që konvertohen me rreth 30 mijë euro). Ky ishte donacioni më i madh, që është dhuruar prej dikujt deri në atë kohë. Ky veprim i Othmanit e bëri Pejgamberin (*paqja qoftë mbi të*) të thotë: *Kjo që bëri Othmani do t'i mbulojë atij të gjitha të këqijat, që ka bërë dhe do të bëjë.*

## V

**Vaiz:** Ligjërues, konsiderohen si të tillë të gjithë ata dijetarë, hoxhallarë (mësues), që mbajnë ligjërata në një publik të gjerë, ose në mjedis të ngushtë mes nxënësish.

## X

**Xhehenemi:** Është vendi i dënimit për të gjithë jobesimtarët, mëkatarët dhe të gjithë ata që nuk janë penduar nga mëkatet e tyre. Dënimi më i vogël në të është kur njeriut do t'i vendoset diçka në mes të gishtërinjve të këmbëve dhe nga kjo do t'i ziejnë trutë në kokë.

**Xhenet:** Apo Parajsa, antonim i Xhehenemit apo Ferrit: Kuptimi gjuhësor është kopsht apo lulishte. Xheneti është vendi i shpërblimit për besimtarët e devotshëm ndaj Allahut të Madhëruar. Aty do të jenë pa kufi në të gjitha kënaqësitë e mundshme. Aty nuk ka vdekje, pleqëri, skamje, mjerim dhe as sëmundje. Banori i Xhenetit jeton përjetësisht në rini dhe lumturi. Sigurisht kënaqësia më e madhë që do t'u jepet besimtarëve në Xhenet është pamja e Allahut të Madhëruar, të Cilin ata e besojnë dhe adhurojnë në këtë botë paçka se nuk e kanë parë, por kanë parë gjurmët e Tij të pamohueshme kudo në ekzistencë.



## Biografi

**Sahabët:** Ata janë shoqëruesit e Pejgamberit Muhamed (*paqja qoftë mbi të*). Në fakt konsiderohen si të tillë çdo bashkëkohës i tij, të cilët e kanë parë, ose jetuar me të, duke qenë muslimanë.

### A

**Abas Ibën Abdul Mutalib:** Xhaxhai i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Para Islamit ai ishte figurë e shquar në elitën kurejshite. Kryesonte këshillin që merrej me kujdesin ndaj Qabes. Ai e kishte pranuar Islamin, mirëpo e mbajti të fshehtë atë dhe i dërgonte lajme Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) për lëvizjet e kurejshëve. Emigroi në Medine para çlirimit të Mekës dhe me të mbyllet edhe kapitulli i emigracionit të muslimanëve nga Meka në Medine. Nderroi jetë në vitin 32 Hixhri.

**Abdullah Ibën Abasi:** Është ndër sahabët [shokët] e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Konsiderohet si erudit i shquar. Është transmetues i shumë haditheve dhe njihet më shumë si komentator i Kuranit. Lindi 3 vjet para Hixhretit (shpërnguljes) të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) dhe ndërroi jetë në vitin 68 Hixhri.

**Abdullah Ibën Mesudi:** Lindi në vitin 28 para Hixhretit (593 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 32 Hixhri (653 Diellor). Ebu Abdurahmani: pena e diturisë, fakihu i kombi islam, pjesëmarrës në Betejën e Bedrit, emigroi në të dy rastet, prej më të sojshmëve të njerëzve, prej sahabëve më të mëdhenj, në meritë, inteligjencë si dhe në afrimin që gëzonte tek i Dërguari i Allahut [*paqja qoftë mbi të!*]. Ai është prej banorëve të Mekës, prej të parëve që pranuan

Islamin, para se Pejgamberi të strehohej në Shtëpinë e Erkamit, si dhe i pari që e lexoi haptazi Kuranin në Mekë. Gradët dhe meritat e tij janë të bollshme. Ai ishte asistent i të Dërguarit të Allahut [*paqja qoftë mbi të!*], besniku dhe mbajtësi i sekretit të tij, shoqëruesi i tij në qëndrim, udhëtim dhe beteja, i pandashëm nga ai. Një ditë Umari [Allahu qoftë i kënaqur me të!] e pa atë dhe tha: "Një enë e mbushur përplot dituri". Pas vdekjes së Pejgamberit [*paqja qoftë mbi të!*] ai e emërua në krye të Thesarit Publik të Kufes. Pastaj në kohën e Khalifatit (qeverisjes) së Uthmanit [Allahu qoftë i kënaqur me të!] ai erdhi në Medinë, ku edhe ndërroi jetë rreth moshës gjashtëdhjetë vjeçare. Ai ishte shumë i shkurtër sa që thujse mund të mbulohej edhe prej një njeriu të ulur. Ai pëlqente shumë të parfumohej, sa që kur dilte nga shtëpia, fqinjët për shkak të erës së parfumit të tij, e kuptonin se ai ka kaluar. Ai ka transmetuar 848 hadithe. El-Xhahidhu në "El-Bejanu ue et-Tibjenu" ka sjellë ligjërime dhe pjesë të zgjedhur të Ibën Mes'udit [Shih: "El Ea'lem" me autor Ez-Zirikliu (i cili ndërroi jetë në vitin 1396 Hixhri) dhe "Sijaru Ealemi en Nubela" me autor Edh-Dhehebi (i cili ndërroi jetë në vitin 748 Hixhri)]

**Abdullah Ibën Selami:** Sahab i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Ishte ndër dijetarët e njohur të izraelitëve, që jetonin në Medinë dhe më i respektuari prej tyre. Në historinë më sipër bëhet fjalë për reagimin e izraelitëve ndaj konvertimit të tij në Islam. Ndërroi jetë në vitin 43 Hixhri.

**Abdullah Ibën Umer:** Sahab i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Pranoi Islamin që në fëmijëri para babait të tij, Umer Ibën Khatabit. Për arsye të moshës së vogël ai nuk mori pjesë në betejat e Bedrit dhe të Uhudit, por më pas ai ka qenë shumë aktiv në çdo çështje të Islamit. Konsiderohet si njëri ndër dijetarët më të mëdhenj të Islamit. E ndiqte Pejgamberin (*paqja qoftë mbi të*) në çdo hap të tij. Ndërroi jetë në Mekë në vitin 74 Hixhri.

**Abdullah Ibën Ubej Selul:** Ky ishte kandidati për kryetar i qytetit të Medines në kohën kur Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) sapo kishte emigruar në të. Me ardhjen e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*), planet dhe ambicjet e tij u shkatërruan. Tashmë lidërshipi i Medines i takoi të Dërguarit të Allahut, kjo për shkak të popullaritetit të tij të menjëhershëm, që kishte fituar me



Mesazhin e tij. Kjo shkaktoi tek Abdullah Ibën Ubej Selul një mllef të madh, mirëpo duke parë rrethanat ai u detyrua të heshtte dhe të pranonte, se ishte konvertuar në Islam. Por herë pas here ai gjente momente për të shfryrë inatin e tij ndaj Islamit dhe Pejgamberit Muhamed (*paqja qoftë mbi të*). Për të zbritën edhe ajetet e Kuranit, ku Allahu i Madhëruar e ndalonte Pejgamberin (*paqja qoftë mbi të*), që të kërkonte falje për të, sepse Allahu i Madhëruar nuk do t'ia falte.

**Abdullah Ibën Abdullah Ibën Ubej Selul:** I biri i personit të lartpërmendur. Ky ishte ndër besimtarët më të devotshëm. Mori pjesë në luftën e Bedrit dhe të gjitha betejat e tjera të Islamit. Ra dëshmor në betejën e Jemames në vitin 12 Hixhri.

**Abdullah Ibën Zubejr:** Sahab i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) lindi në vitin e parë të Hixhretit. Madje u quajt përgëzimi i muslimanëve, pas fjalëve që ishin përhapur se muslimanët nuk mund të lindin fëmijë prej një mallkimi të idhujve kurejshë. Ai bëri një jetë aktive islame. Mori pjesë në disa beteja të muslimanëve. Ai u caktua Khalif i muslimanëve pas vdekjes së Muauije Ibën Jezid Ibën Muauijes. U vra nga Haxhaxh Ibën Jusuf et-Thekafu në vitin 73 Hixhri pas një rrethimi të tij në Mekë.

**Abdullah Ibën Amru El-A's:** Lindi në vitin 7 para Hixhretit (616 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 65 Hixhri (684 Diellor). Ishte prej Kurejshëve, prej banorëve të Mekes, sahabi, imami, pena e diturisë, adhuruesi i madh, e lexonte Kuranin në tre ditë dhe agjëronte një ditë po dhe një jo. Ai ishte aq i përkushtuar në adhurim saqë Pejgamberi [*paqja qoftë mbi të!*] i tha: "*Në të vërtetë ti i detyrohesh trupit tënd, i detyrohesh bashkëshortes tënde dhe i detyrohesh syrit tënd*". Ai ka shumë grada, merita dhe një pozitë solide në dituri, duke qenë se ai barti një dituri të madhe nga Pejgamberi [*paqja qoftë mbi të!*]. Ai ka transmetuar gjithashtu nga Ebu Bekri, Umeri, Muadhi, Suraka Ibën Maliku, i ati i tij Amri, nga Abdurahman ibën Aufi, Ebu Ed-Darda dhe shumë të tjerë [Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë ata!]. Ai pati marrë pjesë nëpër betejat e luftime dhe godiste me dy shpata njëkohësisht. Në ditën e Betejës së Jermukut, ai e barti flamurin e të atit. Gjithashtu ai qe prezent edhe në



ndodhinë e Sifinit, në kampin e Muauijes [Allahu qoftë i kënaqur me të!], i cili e emëroi atë guvernator në Kufa për një periudhë të shkurtër kohore. Kur qeverisja i kaloi Jezidit, Abullahu nuk ia dha atij besëlidhjen dhe u mbyll në një qoshe në anën e Askalanit, duke iu përkushtuar adhurimit. Ai ka transmetuar edhe nga Ehlu Kitabi, i ka pasur vazhdimisht nën mbikëqyrje librat e tyre dhe është preokupuar me to. Ai në kohën paraislame ishte prej atyre që shkruanin dhe e njihnte shumë mirë Sirjanishten. Ai i kërkoi leje të Dërguarit të Allahut [paqja qoftë mbi të!] që të shkruante atë që dëgjonte prej tij dhe Pejgamberi [paqja qoftë mbi të!] ia dha lejen për këtë. Ai përcolli nga i Dërguari i Allahut [paqja qoftë mbi të!] 700 hadithe. Për fizionominë e tij është thënë se ai ishte i gjatë dhe i shëndoshë. Në fundin e jetës së tij ai u prek nga verbimi. Thuhet se ai ndërroi jetë në Taif (qytet në Arabinë Saudite). [Shih: “El-Ea’lem” me autor Ez-Zirikliu (i cili ndërroi jetë në vitin 1396 Hixhri) dhe “Sijaru Ealemi en-Nubela” me autor Edh-Dhehebi (i cili ndërroi jetë në vitin 748 Hixhri).

**Aishja:** Lindi në vitin 9 para Hixhretit (58 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 58 Hixhri (678 Diellor). Emri i saj është Aishe bintu (e bija e) Ebu Bekër es-Sidikut (të sinqertit), nga Kurejshët, e cila u lind dhe u rrit në një shtëpi besimtare, për më tepër besimtarësh të tillë si i ati i saj Ebu Bekri dhe nëna e saj Umu Rumane [Allahu qoftë i kënaqur me të dy!]. Ajo është bashkëshortja e tretë e Pejgamberit [paqja qoftë mbi të!], nëna e besimtarëve dhe më e ditura në fe, fikh dhe letërsi ndër gratë e Pejgamberit. Ajo u martua me Pejgamberin [paqja qoftë mbi të!] në një moshë të re, e cila përlllogaritet që më sa paku të ketë qenë 14 vjeçare. Ajo ishte një grua bardhoshe, shumë e bukur dhe e vetmja grua e virgjër me të cilën është martuar Pejgamberi [paqja qoftë mbi të!]. Ajo jetoi me Pejgamberin [paqja qoftë mbi të!] tetë vjet e pesë muaj dhe pati rastin ta njihnte atë [paqja qoftë mbi të!] më afër se çdokush tjetër dhe të përfitonte prej diturisë së tij. Për këtë arsye ajo ishte edhe dijetarja më e madhe në Medinë dhe më e mira grua, përveç Hadixhes [Allahu qoftë i kënaqur me të!]. Pseudonimin e kishte Umu Abdullah. Vetë Engjëlli Xhibrili [paqja qoftë mbi të!] erdhi tek Pejgamberi [paqja qoftë mbi të!] duke bartur imazhin e Aishes [Allahu qoftë i kënaqur me të!] në një copë mëndafshi jeshil dhe i tha atij: “Kjo është bashkëshortja jote në dynja dhe Amshim” [Transmetim nga Et-Tirmidhi, i gradës hasen-i mirë]. Pejgamberi [paqja qoftë



*mbi të!*] u martua me të në vitin e dytë Hixhri. Ajo ishte gruaja më e dashur për të ndër bashkëshortet e tij dhe njëkohësisht transmetuesja që transmetoi më shumë hadithe ndër to. Ajo ka transmetuar nga Pejgamberi [*paqja qoftë mbi të!*] një varg të saj in transmetimesh që arrin në 2210 hadithe, 147 prej të cilëve gëzojnë autenticitet sipas konsensusit të El-Bukhariut dhe Muslimit, teksa me 45 është veçuar Bukhariu dhe 69 Muslimi. Ajo është personazh i disa kumtimeve dhe qëndrimeve. Për çdo gjë që i ndodhte, ajo ishte e aftë të recitonte poezi. Sahabët e mëdhenj e pyesnin atë mbi çështjet e porcioneve të trashëgimisë dhe ajo u përgjigjej. Allahu i Madhëruar e pafajësoi atë për shpifjen që ju bë, duke zbritur për të një numër të konsiderueshëm thëniesh kuranore. Njihet qëndrimi i saj i rreptë kundrejt punës së Uthmanit gjatë jetës së tij dhe më pas zemërimi që e kaploi atë për shkak të vrasjes së tij, gjë për të cilën dihet pozicionimi i saj në ngrehinën mbi devenë e saj, në Ndodhinë “El-Xhemel”. Aishja [Allahu qoftë i kënaqur me të!] ndërroi jetë në Medine [Shih: “El-Ea’lem” me autor Ez-Zirikliu (i cili ndërroi jetë në vitin 1396 Hixhri) dhe “Sijaru Ealemi en-Nubela” me autor Edh-Dhehebi (i cili ndërroi jetë në vitin 748 Hixhri)]. Aishja është gruaja e dytë e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Ajo ishte vajza e Ebu Bekrit dhe u martua me Pejgamberin (*paqja qoftë mbi të*) pas vdekjes së gruas së tij të parë, Hatixhes (Allahu qoftë i kënaqur prej saj). Ajo jetoi disa vjet pas Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) dhe duke qenë me afër tij kishte marrë prej tij dituri, të cilën jo të gjithë kishin patur rastin ta merrnin, për këtë arsye konsiderohet ndër dijetaret më të mëdha të Islamit. Të gjitha gratë e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) konsiderohen, si Nëna të Besimtarëve dhe respektohen si të tilla. Aishja ndërroi jetë në vitin 58 Hixhri.

**Ali Ibën Ebi Talib:** Ishte Khalifi [prijësi] i katërt i drejtë, djali xhaxhait të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*), fëmija i parë, që pranoi Islamin dhe jetoi me të deri në momentin kur ndërroi jetë. E vranë në një atentat në vitin 40 Hixhri. Konsiderohet gjithashtu edhe si dëshmor në rrugë të Allahut të Madhëruar.

E

**Ebu Bekri:** Lindi në vitin 51 para Hixhretit (573 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin e 13 Hixhri (634 Diellor). Ebu Bekër es-Sidiku, Khalifi (prijësi) i parë i

drejtë dhe i pari prej burrave që besuan tek i Dërguari i Allahut [*paqja qoftë mbi të!*]. Ai ishte një prej njerëzve të mëdhenj ndër arabët. U lind në Mekë dhe u rrit aty si një prej krerëve të Kurejshëve, të kamurve të tyre, dijetar sa i përket gjenealogjisë së fiseve, rrëfimeve dhe politikave të arabëve. Arabët e quanin atë dijetari i Kurejshëve. Ebu Bekri [Allahu qoftë i kënaqur me të!] ia kish ndaluar vetes alkoolin që në kohën paraislame dhe nuk e kishte pirë atë. Në epokën e Pejgamberit Muhamed [*paqja qoftë mbi të!*], Ebu Bekri [Allahu qoftë i kënaqur me të!] njihet për qëndrime të mëdha. Ai i dëshmoi betejat e bëra, duroi vështirësitë dhe kontribuoi me pasurinë e tij. Besëlidhja e tij si halif (qeveritar i muslimanëve) u bë në ditën e vdekjes së Pejgamberit [*Paqja qoftë mbi të!*], në vitin 11 hixhri. Ai i luftoi dezertorët dhe këdo që refuzoi të jepte zekatin. Në ditët e tij u çliruan territoret e Shamit [Siria, Jordania, Libani dhe Palestina] dhe një pjesë e madhe e Irakut. Ai gjeti konsensusin e komandantëve të mëdhenj sikurse Khalid ibën Uelidit, Amër ibën el-A'sit, Ebu Ubejde ibën el Xherahut, El-A'le ibën el-Hadramiut, Jezid ibën Ebi Sufjanit dhe El-Muthene Ibën Harithes [Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë ata!]. Ebu Bekri [Allahu qoftë i kënaqur me të!] atribuohet me maturi dhe butësi kundrejt masës së gjerë të popullit. Ai ishte ligjërues elokuent dhe guximtar heroik. Koha e qeverisjes së tij zgjati dy vjet e tre muaj e gjysmë. Ai ndërroi jetë në Medine. Ebu Bekrit [Allahu qoftë i kënaqur me të!] në librat e hadithit i takon përçimi i 142 haditheve. Thuhet se pseudonim i tij ka qenë "Es-Sidiku, "I sinqerti" që në kohën paraislame, por thuhet edhe se këtë pseudonim ai e fitoi në Islam, nisur nga vërtetimi që i bëri lajmit të Israsë dhe Mia'raxhit, që i ndodhi Pejgamberit Muhamed [*Paqja qoftë mbi të!*]. Dosja e ngjarjeve të Ebu Bekër es-Sidikut [Allahu qoftë i kënaqur me të!] është e dendur dhe autori i veprës "Eshher Meshehiri el-Islam" i ka dedikuar ai rreth njëqindëpesëdhjetë faqe material. Gjithashtu për personalitetin unik të Ebu Bekrit [Allahu qoftë i kënaqur me të!] janë shkruar edhe shumë vepra të tjera, ndër të cilat përmendim librin "Ebu Bekër es-Sidiku" me autor dijetarin Ali Et-Tantau [Shih: "El Ea'lem" me autor Ez-Zirikliu (i cili ndërroi jetë në vitin 1396 Hixhri)].

**Ebu Darda:** Amir Ibën Malik, Sahab i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Nga fisi Hazreth në Medine. Konsiderohej si njeri i urtë ndërmjet sahabeve. Ka



qenë gjykatës i Damaskut. Ndërroi jetë në vitin 32 Hixhri.

**Ebu Dherri:** Xhundeb bin Seken El-Gafari, sahab i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Pranoi Islamin ndër pesë të parët. Jetoj në fisin e tij Gafar jashtë Mekës derisa Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) emigroi në Medine, ku edhe iu bashkua atij. Ishte një njeri i nderuar në mesin e Sahabëve. Në Khilafetin e Ebu Bekrit, Umerit dhe Othmanit pati postin e Myftiut. Mori pjesë në çlirimin e xhamisë Aksa me Umerin. Në pjesën e fundit të jetës u tërhoq nga jeta publike dhe jetoj në një zonë jashtë Medines, ku edhe ndërroi jetë, në vitin 32 Hixhri.

**Ebu Umame:** *Ebu Umame*, Ndërroi jetë në vitin 86 Hixhri (706 Diellor). Ai është prej sahabëve të shquar dhe një prej atyre që i dhanë besën Pejgamberit [*paqja qoftë mbi të!*] në Marrëveshjen e Hudejbijes, që ndodhi në vendin me të njëjtin emër. Në Betejën e Sifinit ai ishte në krahun e Aliut [Allahu qoftë i kënaqur me të!]. Ai banoi në Egjipt dhe pastaj në Hums të Shamit, [Siri] ku edhe ndërroi jetë në moshën nëntëdhjetenjë vjeçare. Ai është sahabiu i fundit që vdiq në tokën e Shamit, në kohën e Khalifatit të Abdulmalik Ibën Maruanit. Në dy autentikët e haditheve ("Sahihu el-Bukhari" dhe "Sahihu Muslim") prej tij janë përcjellë 250 hadithe. Ai shquhej për devotshmërinë e tij, sidomos për agjërimin e dendur të tij, gjë për të cilën thuhej: "Nuk është parë Ebu Umame, as e shoqja dhe as asistenti i tyre, veçse agjërueshëm". Nëse në shtëpinë e tij shihje zjarr ose tym gjatë ditës, dihej se atyre u kishin shkuar miq [Shih: "El-Ea'lem" me autor Ez-Zirikliu (i cili ndërroi jetë në vitin 1396 Hixhri)].

**Enes Ibën Malik:** Lindi në vitin 10 para Hixhretit (612 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 93 Hixhri (712 Diellor), në Basra (qytet në Irak). Njihet dhe me nofkën Ebu Hamza. Ai është sahabi [shok] i të Dërguarit të Allahut [*paqja qoftë mbi të!*] dhe asistenti i tij. Transmetuesit e hadithit kanë transmetuar nga ai 2286 hadithe. Është i lindur në Medinë, e pranoi Islamin në vegjëli dhe i shërbeu të Dërguarit të Allahut [*paqja qoftë mbi të!*] derisa ai [*paqja qoftë mbi të!*] ndërroi jetë. Pastaj udhëtoi për në Damask dhe prej aty për në Basra, ku edhe vdiq. Ai është sahabiu [shoku] i fundit që vdiq në Basra [Shiko: "El-Ea'lem" me autor Ez-Zirikliu (i cili ndërroi jetë në vitin 1396 Hixhri)]. Ai



është imami i madh, myftiu, kënduesi i Kuranit, muhadithi, transmetuesi i Islamit, i afërm i Pejgamberit (nga ana e nënës së Pejgamberit [paqja qoftë mbi të!]), nxënës i tij dhe pasues i tij. Ai mori pjesë në betejat e Pejgamberit [paqja qoftë mbi të!] më se një herë, si dhe ishte prej atyre që ia dhanë Pejgamberit [paqja qoftë mbi të!] besën nën pemë. Ebu Hurejra [Allahu qoftë i kënaqur me të!] ka thënë: “Nuk kam parë asnjë të falë namaz më të përngjashëm me namazin e të Dërguarit të Allahut [paqja qoftë mbi të!], sesa i biri i Umu Sulejmit (Enesi [Allahu qoftë i kënaqur me të!])” [Shih: “Sijaru Ealemi en-Nubala” me autor Imam Edh-Dhehebi (i cili ndërroi jetë në vitin 748 Hixhri)]. Enesi thotë për veten e tij: “Kur erdhi i Dërguari i Allahut [paqja qoftë mbi të!] në Medine unë isha dhjetë vjeç dhe kur ai ndërroi jetë isha njëzet dhe nëna më nxiste t’i shërbeja të Dërguarit të Allahut [paqja qoftë mbi të!]. Umu Sulejmi, nëna e tij, ia solli atë Pejgamberit [paqja qoftë mbi të!] kur erdhi në Medine, duke i thënë: “Ky është Enesi, një djalosh që të të shërbejë ty”, gjë të cilën Pejgamberi [paqja qoftë mbi të!] e pranoi. Ai i shërbeu Pejgamberit [paqja qoftë mbi të!] dhjetë vjet dhe Pejgamberi [paqja qoftë mbi të!] u lut për të [Shih: “El-Isabe fi Temjizi es-Sahabe” me autor Ibën Haxher el-A’skalani (i cili ndërroi jetë në vitin 852 Hixhri)].

**Esid bin Hadiri:** Sahab i Pejgamberit (paqja qoftë mbi të), nga fisi Eus. Në luftën e Uhudit ndodhi që Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) po drejtonte rreshtat e ushtrisë dhe e goditi Esidin me shkop lehtë në bark, duke i thënë të futej në rresht. Ai i tha: Më vrave o i Dërguari i Allahut, prandaj dua hakun tim.- Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) zbuloi barkun e tij ndërsa Esidi e puthi Pejgamberin (paqja qoftë mbi të) në bark. Kur e pyetën pse e bëre, tha: Doja që të ishte e gjëja e fundit që mund të bëja në këtë botë, të prekja lëkurën e Pejgamberit (paqja qoftë mbi të). Ndërroi jetë në vitin 20 Hixhri.

**Ebu Hurejra:** Lindi në vitin 21 para Hixhretit (602 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin e 59 Hixhri (679 Diellor). Emri i tij është Abdurrahman Ibën Sakhri nga Deusi, me pseudonimin Ebu Hurejra. Ai ishte prej sahabëve që kishin memorizuar dhe transmetuar hadithet më të shumta. Në kohën paraislame ai u rrit i dobët dhe jetim. Kur ai erdhi në Medinë, Pejgamberi [paqja qoftë mbi të] ishte në Khajber [qytet në Arabinë Saudite]. Ai e pranoi Islamin në vitin 7



Hixhri. Ai e ndoqi Pejgamberit [*paqja qoftë mbi të!*] dhe transmetoi prej tij 5374 hadithe, të cilat më pas i transmetuan prej tij më se 800 transmetues prej sahabëve dhe tebi'inëve. Ebu Hurejra [Allahu qoftë i kënaqur me të!] i ka mësuar përmendsh më shumë se 1600 hadithe të Pejgamberit [*paqja qoftë mbi të!*] dhe i ka ruajtur ato për popullin islam. Ai gëzonte autoritetin e myftiut dhe dijetar i Islamit Tekiju ed-Din es-Sebki ka koleksionuar një përpilim të cilin e ka titulluar “Fetuat Ebi Hurjera”. Në kohën e injorancës, ai thirrej “Abdu Shems-rob i diellit. Kur atë e udhëzoi Allahu në Islam ai u takua me Pejgamberin [*paqja qoftë mbi të!*], i cili e pyeti: “Si quhesh?” Ai iu përgjigj: - *Quhem Abdu Shems (rob i diellit)*. Pejgamberi i tha: - *Le të quhesh “Abdurrahman- rob i të Gjithëmëshirshmit”*. Shkaku pse është quajtur “Ebu Hurejra-baba i koteles” është sepse ai në fëmijëri kishte një mace të vogël me të cilën luante dhe qysh atëherë moshatarët e tij e thirrën kështu. Pejgamberi i Zotit [*paqja qoftë mbi të!*] shpeshherë e thërriste “Ebu Hirr-baba i maçokut”, ndaj dhe ai e pëlqeu më shumë të quhej “Ebu Hir”. Ebu Hurejra [Allahu qoftë i kënaqur me të!] e pranoi Islamit nëpërmjet Tufejl Ibnu Amrit Ed-Dejlemiut dhe mbeti në tokën e fisit të tij “Deus” edhe gjashtë vjet pas Hixhretit, kur shkoi në Medinë me një grup nga fisi i tij te Pejgamberii [*paqja qoftë mbi të!*]. Djaloshi nga Deus i u vu në shërbim dhe shoqërim të Pejgamberit [*paqja qoftë mbi të!*]. Xhamia ishte vendqëndrimi i tij kurse Pejgamberi [*paqja qoftë mbi të!*] ishte mësuesi dhe imami i tij. Ebu Hurejra [Allahu qoftë i kënaqur me të!] sa ishte gjallë Muhamedi [*paqja qoftë mbi të!*] nuk pati as grua dhe as fëmijë (nuk vendosi të martohet që t’i përkushtohet shërbimit të Pejgamberit [*paqja qoftë mbi të!*] dhe mesazhit të tij). Pas një kohe jo të gjatë të mirat vërshuan tek muslimanët dhe Ebu Hurejra [Allahu qoftë i kënaqur me të!] bëri pasuri, shtëpi, katandi, u martua dhe lindi një djalë... Ai të shumtën e jetës së tij e kaloi në Medinë, ku u emërua për një periudhë kohore guvernator, por ky post nuk ndikoi asnjëherë në shpirtbutësinë dhe zemërgjerësinë e tij. Ai agjëronte gjatë ditës dhe falej gjatë një të tretës së natës. Umari [Allahu qoftë i kënaqur me të!] e pati emëruar Ebu Hurejrën guvernator të Bahrejnit, por kur pa se ai ishte me karakter të brishtë dhe i preokupuar me adhurim, e hoqi prej kësaj përgjegjësie. Ai ndërroi jetë në fundin e Khalifatit (qeverisjes) së Muauijes [Allahu qoftë i kënaqur me të!] [Shih: “El Ea’lem” me autor Ez-Zirikliu (ndërroi jetë në vitin 1396 Hixhri) dhe “Sueru min Hajati es-Sahabe” me



autor Abdurrahman Rafet El-Basha.

## H

**Hamza Ibën Abdul Mutalib:** Xhaxhai i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Ishte ndër personalitetet më me influencë të Mekës në kohën para Islame. Ai e pranoi Islamit për arsye fisnore, por me konvertimin e tij, muslimanët filluan të merrnin frymë më lirshëm, pasi ishin të mbrojtur nga shtypja dhe presioni i kurejshëve. Vdiq dëshmor në vitin e tretë hixhri në betejën e Uhudit. Lindi në vitin 55 para hixhretit dhe ndërroi jetë në vitin e tretë të Hixhretit.

**Hasan Ibën Ali Ebi Talib:** Nipi i dashur i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Ai bashkë me vëllain e tij Husejnin ishin dy djemtë e Ali Ibën Ebi Talibit dhe gjyshi i tyre nga nëna ishte Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*). Ishin pika e tij e dobët dhe gjithmonë lutej për ta. Pas vrasjes së babait të tij, Hasani u bë Khalif i Muslimanëve për një periudhë gjashtë mujore pastaj dha dorëheqjen nga ky post, duke ia lënë atë Muauije Ibën Ebi Sufjanit, për të bashkuar kështu Umetin Musliman, i cili sapo kishte kaluar sfida të përgjakshme. Ndërroi jetë në vitin 50 Hixhri.

**Hidri:** Hidri konsiderohet si Pejgamber, por ka mendime, se ai ka qenë thjesht një njeri besimtar i devotshëm dhe shumë i ditur. Historia e tij me Musain përmendet në Kuran në suren Kehf. Rreth tij ekzistojnë gojëdhëna se është akoma gjallë. Por e vërteta e tij është se ai duhet të ketë vdekur brenda shekullit kur jetoi edhe Pejgamberi (Paqja qoftë mbi të), sepse në një hadith të tij përmendet se askush nga njerëzit që jetonin në atë kohë nuk do të ishin gjallë pas njëqind vjetësh nga ai moment. Ky është edhe mendimi i Ibn Tejmijes.

## KH

**Khatib Ibën Beltea:** Sahab i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Mori pjesë në luftën e Bedrit dhe në disa luftime të tjera. Ndërroi jetë në vitin 30 Hixhri.



**Khalid Ibën Uelid:** Sahab i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Ishte ndër figurat kryesore të elitës së Mekës. Ai lufoi kundër muslimanëve në betejën e Uhudit dhe strategjisë dhe mprehtësisë së tij dedikohet fitorja e kurejshëve në këtë luftë. Pranoi Islamin në vitin e shtatë të Hixhretit. Menjëherë pas konvertimit të tij ai filloi të kompensojë kohën e humbur. Nën komandën e tij ushtritë muslimane nuk dështuan për asnjë moment. Ai u quajt nga Pejgamberi (*paqja qoftë mbi të*) si Shpata e Allahut. Ai dha një kontribut të madh në shtypjen e kryengritjeve të fiseve dezertore, në kohën e Khalifit Ebu Bekr. Ndërroi jetë në vitin 21 Hixhri.

## I

**Ibën Abasi:** Lindi në vitin 3 para Hixhretit (68 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 68 Hixhri (687 Diellor). Ai ishte (djali i xhaxhait të Pejgamberit [*paqja qoftë mbi të!*]), pena e kombit islam, dijetari i madh i fikhut, interpretuesi i Kuranit. Lindi në Mekë dhe u rrit në fillimin e epokës profetike. E shoqëroi hap pas hapi të Dërguarin e Allahut [*paqja qoftë mbi të!*] dhe i transmetoi prej tij hadithet e tij të sakta. Në dy autentikët (“Sahiu el-Bukhari” dhe “Sahihu el-Muslim”) dhe jashtë tyre, vijnë prej tij 1660 hadithe. Ibën Mesu’di [Allahu qoftë i kënaqur me të!] ka thënë: “Abasi (Ebu el-Abasi) është më i miri interpretues (i Kuranit)”. Amër Ibën Dinari ka thënë: “Nuk kam parë kuvend në të cilin të tubohet tërë mirësia, sikurse ai i Ibën Abasit, (në kuvendin e të cilit koleksionohej) hallalli, harami, arabishtja, gjenealogjia dhe poezia”. A’tau ka thënë: “Kishte prej individëve që e frekuentonin Ibën Abasin për poezinë dhe gjenealogjinë, kishte që e frekuentonin për ditarin e arabëve dhe ngjarjet e tyre dhe kishte që e frekuentonin për fikhun dhe diturinë. Secilës kategori ai i qasej me atë që deshte. Në të shumtën e rasteve ai i ndante ditët e tij, një ditë për fikhun, një për interpretimin, një për betejat, një për poezinë dhe një për ngjarjet e arabëve”. Umeri [Allahu qoftë i kënaqur me të!] kur kishte për të zgjidhur ndonjë çështje të ndërlikuar, thërriste Ibën Abasin dhe i thoshte: “Ti je për këtë dhe për gjëra të sojit të saj. Pastaj ai e merrte në konsideratë fjalën e tij dhe nuk thërriste kënd tjetër veç tij”. Ai ishte argument në memorizim. Ai e mësoi me një të dëgjuar një poezi prej tetëdhjetë vargjesh që e recitoi Ibën Ebi Rabia’. Kur dëgjonte këndimet lavdëruese që gratë bënin për të vdekurin, ai i

mbyllte veshët me gishtat e tij, nga frika se mos i memorizonte fjalët e tyre. Vepra “Tefsiru el-Kuran” i është atribuuar pikërisht Ibën Abasit [Allahu qoftë i kënaqur me të!]. Kjo vepër përbën atë që disa nga dijetarët kanë koleksionuar prej transmetimet që komentuesit e Kuranit kanë përcjellë në adresë të tij, për çdo thënie Kuranore që ai ka komentuar. Dosja e të dhënave që flasin për Ibën Abasin është vërtetë shumë e ngjeshur. Ai i dëshmoi në krahun e Aliut [Allahu qoftë i kënaqur me të!] dy betejat, “Sifin” dhe “El-Xhemel”. Në fundin e moshës së tij ai u prek nga verbimi, jetoi në Taif dhe aty ndërroi jetë [Shih: “El-Ea’lem” me autor Ez-Zirikliu (i cili ndërroi jetë në vitin 1396 Hixhri).

**Ibën Mesu'di:** Lindi në vitin 28 para Hixhretit (593 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 32 Hixhri (653 Diellor). Ai ishte pena e diturisë, fakihu i kombit islam, pjesëmarrës në Betejën e Bedrit, emigroi në të dy rastet, prej më të sojshmëve të njerëzve, prej sahabëve më të mëdhenj, në meritë, inteligjencë si dhe në afrimin që gëzonte tek i Dërguari i Allahut [paqja qoftë mbi të!]. Ai është prej banorëve të Mekës, prej të parëve që pranuan Islamin, para se Pejgamberi të strehohej në Shtëpinë e Erkamit, si dhe i pari që e lexoi haptazi Kuranin në Mekë. Gradët dhe meritat e tij janë të bollshme. Ai ishte asistent i të Dërguarit të Allahut [paqja qoftë mbi të!], besniku dhe mbajtësi i sekretit të tij, shoqëruesi i tij në qëndrim, udhëtim dhe beteja, i pandashëm nga ai. Një ditë Umeri [Allahu qoftë i kënaqur me të!] e pa atë dhe tha: "Një enë e mbushur përplot dituri". Pas vdekjes së Pejgamberit [paqja qoftë mbi të!] ai e emërua në krye të Thesarit Publik të Kufas. Pastaj në kohën e Khalifatit (qeverisjes) së Uthmanit [Allahu qoftë i kënaqur me të!] ai erdhi në Medinë, ku edhe vdiq rreth moshës gjashtëdhjetë vjeçare. Ai ishte shumë i shkurtër sa që thajse mund të mbulohej edhe prej një njeriu të ulur. Ai pëlqente shumë të parfumohej, sa që kur dilte nga shtëpia, fqinjët për shkak të erës së parfumit të tij, e kuptonin se ai ka kaluar. Ai ka transmetuar 848 hadithe. El-Xhahidhu në "El-Bejanu ue et-Tibjanu" ka sjellë ligjërime dhe pjesë të zgjedhur të Ibën Mes'udit [Shih: “El-Ea’lem” me autor Ez-Zirikliu (i cili ndërroi jetë në vitin 1396 hixhri) dhe “Sijaru Ealem en-Nubala” me autor Edh Dhehebi, (i cili ndërroi jetë në vitin 748 hixhri)].



## L

**Lukmani:** Ishte një njeri i urtë nga Abisinia. Thuhet se ka qenë Pejgamber, por shumica mendojnë se ai nuk ishte i tillë. Ka jetuar në kohën e Pejgamberit Daud (*paqja qoftë mbi të*).

## M

**Muadh Ibën Xhebel:** Muadh Ibën Xhebeli edhe ky sahab i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*), lindi në vitin 25 para Hixhretit. E pranoi Islamin në moshë fare të re 13 vjeçare. Është ndër dhjetë të përgëzuarit me Xhenet. Ndërroi jetë në moshën 38 vjeçare nga epidemia e kolerës, që ra në Jordani në vitin 18 Hixhri, ku ai kishte shkuar të përhapte Islamin.

**Musai:** Musai (*paqja qoftë mbi të*) është një nga Pejgamberët më të njohur, që ka dërguar Allahu i Madhëruar. Ai u dërgua tek izraelitët për t'i nxjerrë ata nga zgjedha e Faraonit të Egjiptit. Atij i zbriti nga Allahu i Madhëruar, libri i Teuratit.

## N

**Nënat e Besimtarëve:** Kështu konsiderohen të gjitha gratë e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Ato ishin 11 zonja. Hadixheja, Seuda, Aishja, Hafsa, Umu Seleme, Umu Habibe, Zejnebi, Xhuuejrije, Zejneb bintu Huzejme, Mejmune dhe Safije.

## O

**Othman Ibën Afani:** Othman Ibën Afani ka qenë Sahab i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Ai u martua me dy vajzat e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*), njëra pas tjetrës. Ishte Khalifi [prijësi] i tretë i drejtë. Ndër sahabët më të afërt të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*), ndër dhjetë të përgëzuarit me Xhenet. Ai mbeti i vrarë në trazirat që u zhvilluan në Medine, nga pushtimi i rebelëve që

vinin nga Iraku dhe Egjipti. Ndërroi jetë në vitin 36 Hixhri.

## S

**Sead bin Ubade:** Sahab i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*), ishte i pari i fisit Hazrexh të Medines. Konsiderohej ndër personalitetet e Medines, burrë i urtë dhe i mençur. Ndërroi jetë në qytetin Haran në vitin 16 Hixhri.

**Sehël Ibën Hunejfi:** Sahab i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Ndër ensarët më të njohur për diturinë e tij. Në fillimet e tij islame ai shkonte natën dhe thyente idhujt e Medinës, fshehurazi, pastaj i përdorte për dru zjarri. Në Betejën e Uhudit ai i dha besën Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) për të qenë ndër luftëtarët e vdekjes. Ka marrë pjesë në të gjitha betejat. Ndërroi jetë në vitin 37 Hixhri.

**Selman El-Faresi:** Sahab i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Pranoi Islamin në Medine në kohën kur muslimanët ishin të rrethuar në luftën e Hendekut. Ai ishte ideatori i teknikës së hapjes së hendekëve. Ndërroi jetë në qytetin Medain në vitin 36 Hixhri.

## U

**Ubej Ibën Keabi:** Sahab i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Ka qenë njëri ndër gjashtë mbledhësit kryesorë të Kuranit në kohën e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Ndërroi jetë në Medine në vitin 22 Hixhri.

**Udej Ibën Hatim:** Sahab i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*). Ndërroi jetë në moshën 120 vjeçare në vitin 66 Hixhri.

**Umer Ibën Khatabi:** Lindi në vitin 40 para Hixhretit (584 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 23 Hixhri (644 Diellor). Khalifi [prijësi] i dytë i drejtë, i pari që u emërtua me titullin Prijësi i Besimtarëve, guximtari, i paepuri, autori i çlirimeve të mëdha, drejtësia e të cilit shërben si model. Në injorancën



paraislame ai ishte prej kreshnikëve të Kurejshëve mekas dhe krerëve të tyre, saqë atij i qe besuar roli i ambasadorit. Ai ishte besnik i tyre, urrente dhe kërcënonte sipas politikës së tyre. Ai është një nga dy Umarët për të cilët Pejgamberi [*paqja qoftë mbi të!*] e luste Allahun e Madhëruar që me njërin prej tyre ta përforconte Islamin. Ai e pranoi Islamin pesë vjet para hixhretit (emigrimit në Medine) dhe ishte dëshmitar i të gjitha betejave. Ibën Mesu'di ka thënë: “Nuk mundeshim të faleshim tek Qabja, derisa u bë musliman Umeri”. Ikrima ka thënë: “Islami mbeti i fshehur derisa pranoi Islamin Umeri”. Umeri [Allahu qoftë i kënaqur me të!] merrej me tregtinë që bëhej në Sham, në Jemen dhe në Hixhaz (Meke dhe Medine). Atij iu dha besëlidhja për kryetar shteti në po atë ditë që vdiq Ebu Bekri [Allahu qoftë i kënaqur me të!] (në vitin 13 hixhri) falë marrëveshjes të implementuar nga Ebu Bekri. Në kohën e qeverisjes së Umerit (e cila zgjati dhjetë vjet) u çlirua Shami. Iraku, Kudi, Medeini, Egjipti dhe Gadishulli Arabik, saqë është thënë se: Në periudhën e tij janë ngrehur dymbëdhjetëmijë podiume pro Islamit. Ai është i pari që u vendosi arabëve Kalendarin hixhri, para të cilit ata referoheshin tek betejat dhe ngjarjet e mëdha të ndodhura. Ai bëri Shtëpinë e Ndihmës Financiare (Bankën Bamirëse) për muslimanët si dhe urdhëroi ndërtimin e Basras dhe Kufës, (qytete në Irak) ndërtim i cili u bë realitet. Ai është i pari që implementoi arshivat në Islam, të cilat i vendosi sipas modelit persian, me qëllim që të bënte bilancin e asistentëve dhe shpërndarjen e rrogave për ta. Ai vërtitej i vetëm nëpër tregje dhe gjykonte në kohë rekord konfliktet midis njerëzve. Ai u shkroi punonjësve të tij: “Nëse më shkruani filloni me shqetësimet tuaja personale”. Zuhriu transmeton: “Kur Umerit i binte të gjykonte për një çështje komplekse, ai thërriste dy të rinj dhe konsultohej me ta, për të shfrytëzuar mprehtësinë e intelektit të tyre”. Umeri [Allahu qoftë i kënaqur me të!] është autor i civateve, ligjëratave dhe kumtimeve jashtëzakonisht të arrira. Thua jse gjithmonë kur i ekspozohej ndonjë çështje, ai recitonte në lidhje me të ndonjë varg poetik. Gjëja e parë që ai bëri kur mori qeverisjen ishte kthimi në familjet e tyre, të robëreshave të zëna në luftën kundër dezertorëve, duke thënë: “Urreva që robëreshat të shndërrohen në turp për arabët”. Monedhat në kohën e tij ishin të shtypura sipas shtypjes persiane dhe ai u shtoi disave prej tyre “El-Hamdu li Lah, Falënderuar qoftë Allahu”, disave “La ilahe il Allah Uahdehu, Nuk ka të adhuruar tjetër me të



drejtë veç Allahut, Një të Vetmit” dhe disave “Muhamed Resulullah, Muhamedi është i Dërguari i Allahut”. Në librat e hadithit vijnë prej tij 537 hadithe. Gdhendja e unazës së tij lexonte: “O Umer, vdekja të mjafton për këshilluese”. Në një hadith profetik vjen: “Frikësojuni zemërimin të Umerit, pasi Allahu zemërohet për shkak të zemërimin të tij.” I Dërguari i Allahut [paqja qoftë mbi të!] e titulloi atë Faruk, Diferencuesi, si dhe i vendosi atij nofkën Ebu Hafs (babai i luanit). Ai bënte gjykatësin teksa Pejgamberi [paqja qoftë mbi të!] ishte ende gjallë. Ai u vra nga atentati me hanxhar, që i bëri Ebu Lulue Fejruz persiani (skllavi i Mugira ibën Shu’bes), atentat në të cilin ai u qëllua në bel, teksa po falte sabahun dhe jetoi vetëm tre netë pas këtij qëllimi. Autori i “Eshher Meshahiri Islam”, Rafik el-Adham, i ka dedikuar Umerit [Allahu qoftë i kënaqur me të!] më se treqind faqe në biografinë që i bën. Ibnul Xheuzi [Allahu e mëshiroftë!] i ka kushtuar atij përpilimin e tij “Umer ibn El-Khatab.

**Utab Ibën Esid:** Sahab i Pejgamberit (paqja qoftë mbi të). Pranoi Islamin në moshë të re dhe Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) e caktoi si guvernator në Mekë. Ndërroi jetë në vitin 23 hixhri.

## Xh

**Xheaferr Ibën Ebi Talib:** Lindi në vitin 33 para Hixhretit (590 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 8 Hixhri (629 Diellor). Xheaferr Ibën Ebi Talibi, ishte nga trimat e fisit Benu Hashim të Pejgamberit [paqja qoftë mbi të!], djali i Abdul Mutalibit, pra djali i xhaxhait të Pejgamberit [paqja qoftë mbi të!], vëllai i prijësit të besimtarëve Ali ibën Ebi Talibit [Allahu qoftë i kënaqur me të!] dhe më i madh se ai me dhjetë vite. Xheaferr Ibën Ebi Talibi [Allahu qoftë i kënaqur me të!] i ngjante shumë Muhamedit [paqja qoftë mbi të!]. Pseudonimi i tij është “Et-Tajar-Fluturuesi”. Xheaferr Ibën Ebi Talibi së bashku me bashkëshorten e tij, Esma binti Umejsin e përqafuan Islamin nëpërmjet Ebu Bekrit [Allahu qoftë i kënaqur me të!], para se të hynte i Dërguari i Allahut në shtëpinë e Erkamit. Ata të dy shpërngulen në Abisini (Etiopia e sotme) që në emigrimin e parë që bënë muslimanët. Xheaferr është personazh i fjalimit të bukur të mbajtur prej tij me rastin e delegacionit kurejshit që shkoi



tek Nexhashiu, mbreti i Abisinisë, me qëllim që t'i kthenin në Mekë muslimanët e parë që kishin emigruar atje., fjalë në të cilën ai ndër të tjera lexoi edhe një pjesë nga surja Merjem. Xha'fer Ibnu Ebi Talibi së bashku me bashkëshorten e tij qëndruan në mikpritjen e Nexhashiut dhjetë vjetë të sigurtë, në prehje dhe qetësi. Ai mbi në Abisini derisa Pejgamberi [*paqja qoftë mbi të!*] emigroi në Medinë, për t'iu bashkangjitur Pejgamberit [*paqja qoftë mbi të!*] në Medinë teksa Pejgamberi ishte në Khajber (në vitin 7 Hixhri). Në fillim të vitit të tetë Hixhri, kur ushtria myslimane u ndesh me ushtrinë armike bizantine në Betejën e Mu'tes, Xheafer Ibnu Ebi Talibi depërtoi ndër radhët e armikut me shpatën e tij duke luftuar me një heroizëm të rrallë, derisa e goditën dhe ia këputën krahun e djathtë. Mirëpo ai menjëherë e mori flamurin në dorën e majtë por nuk vonoi shumë e ia këputën edhe krahun e majtë. Pas kësaj e mori flamurin dhe e shtrëngoi me krahërorin dhe dy krahët e tij të gjymtuara, derisa ai herën e tretë goditet për vdekje. Pejgamberi [*paqja qoftë mbi të!*] "E kam parë Xheaferin në Xhenet. Dy krahët e tij të përgjakur i kishte të stolitur me pendë shumëngjyrëshe." Vetëm rreth një vit pasi sapo kishte ardhur nga Abisinia, Xheaferi bie dëshmor në këtë betejë dhe në trupin e tij prej heroi numëroheshin rreth nëntëdhjetë goditje shpatash dhe shigjetash [Shih: "El Ea'lem" me autor Ez-Zirikliu (i cili ndërroi në vitin 1396 Hixhri) dhe dhe "Sueru min Hajati es-Sahabe" me autor Abdurrahman Rafet El-Basha].

**Xhabir Ibën Abdullah:** Lindi në vitin 16 para Hixhretit (607 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 78 Hixhri (697 Diellor). Emri i tij është Xhabir Ibën Abdullah Ibën Amër Ibën Harami, Ebu Abdullahu dhe Ebu Abdurahmani, nga Ensarët që i përkasin fisit Khazrexh, sahabi që ka transmetuar shumë transmetime në adresë të Pejgamberit [*paqja qoftë mbi të!*], teksa prej tij kanë transmetuar një grup sahabësh. Edhe Xhabiri edhe i ati i tij Abdullahu, ishin prej sahabëve (shokëve) të Pejgamberit [*paqja qoftë mbi të!*]. Xhabiri ishte lider i madh, dijetar i madh në fikh, muxhtehid, hafëz dhe ka qenë personi i fundit që ndërroi prej atyre që morën pjesë në natën e Besëlidhjes së dytë të Akabesë ku ai mori pjesë krahas të atit të tij Abdullahut [Allahu qoftë i kënaqur me të!]. Do donim që në këtë kontekst të përmendnim një histori shumë mbresëlënëse që i përket babai të Xhabirit, Abdullah Ibën Haramit [Allahu qoftë i kënaqur me të!]: "Ai ishte prej krerëve pjesëmarrës në Betejën

e Bedrit. Xhabiri [Allahu qoftë i kënaqur me të!] iu bind babait të tij Abdullahut [Allahu qoftë i kënaqur me të!] ditën e Betejës së Uhudit, ndaj dhe nuk doli në Betejë por qëndroi të kujdesej për motrat e tij që ishin të shumta në numër. Abdullahu ra dëshmor në Betejën e Uhudit dhe pasi ai ra dëshmor, Allahu i Madhëruar i dha jetë dhe i foli ballë për ballë, pa ndërmjetës. Kur Muauija [Allahu qoftë i kënaqur me të!] bëri një kanalizim uji nëpër varrezat e dëshmorëve të Uhudit, Xhabiri nxitoi tek varri i të atit, dhe pasi kishte kaluar një kohë relativisht e gjatë, e gjeti trupin e të atit të freskët dhe të padekompozuar.” Xhabiri [Allahu qoftë i kënaqur me të!] ka marrë pjesë në nëntëmbëdhjetë beteja, ndër të cilat edhe në Betejën e Ahzabit. Gjithashtu ai mori pjesë në Besëlidhjen e Raduanit, derisa arriti pleqërinë dhe e la shikimi, pasi iu afrua të nëntëdhjetave. Ai ishte myftiu i Medinës në kohën e tij dhe në ditët e tij të fundit ai kishte në xhaminë e Profetit [Paqja qoftë mbi të!] në Medinë një qarkim nxënësish që merrnin dituri islame prej tij. Ai jetoi disa vite pas Ibën Umarit [Allahu qoftë i kënaqur me të!], duke mbetur kësisoj unik ndër të pranishmit e kohës së tij. Ai ka transmetuar dituri të bollshme nga Prejgamberi [paqja qoftë mbi të!], Ebu Bekri, Umari, Aliu, Ebu Ubejde, Muadh Ibën Xhebeli, etj [Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë ata!]. El-Bukhariu, Muslimi dhe transmetuesit e tjerë të hadithit kanë transmetuar prej tij 1540 hadithe. Xhabirit i takon përpilimi me hadithet e transmetuara prej tij që titullohet “Musnedu Xhabir”, i cili është prej transmetimeve të Ebu Abdurahmanit, Abdullahut të birit të iman Ahmed Ibën Muhamed ibën Hanbelit. Xhabiri [Allahu qoftë i kënaqur me të!] ndërroi jetë në moshën nëntëdhjetekatër vjeç dhe namazin e xhenazes së tij e fali Ebeu ibën Uthmani i cili ishte asokohe guvernatori i Medinës [Shih: “El Ea’lem” me autor Ez-Zirikliu (i cili ndërroi jetë në vitin 1396 Hixhri) dhe “Sijaru Ealemi en-Nuebela” me autor Imam Edh-Dhehebi (i cili ndërroi jetë në vitin 748 Hixhri)].

## Z

**Zejd Ibën Thabit El-Ensarij:** Sahab i Pejgamberit (paqja qoftë mbi të). Është ndër personat që u morën me mbledhjen e Kuranit. Gjatë kohës së Pejgamberit (paqja qoftë mbi të), por edhe gjatë kohës së Ebu Bekrit ishte



personi, i cili u ngarkua me shkrimin e kopjes së parë të kompletuar të Kuranit.

**Zijad Ibën Lebidi:** Sahab i Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*), i cili ka marrë pjesë në Betejën e Bedrit. Ndërroi jetë në vitin 41 Hixhri.

### *Tabi'inët:*

**Tabi'inët:** Ata kanë qenë nxënësit e Sahabëve, që lindën pas largimit të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) nga kjo jetë. Konsiderohen të tillë të gjithë ata që kanë takuar së paku një herë, njërin prej sahabëve të Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*).

**Ubejd Ibën Umejr:** Ai ka qenë prej Tabiinëve. Edhe pse lindi në kohën e Pejgamberit (*paqja qoftë mbi të*) ai nuk e pa atë, për shkak të moshës së vogël. Gjithsesi ishte nxënës i zellshëm i Umer Ibën Khatabit, Ali Ibën Ebi Talibit dhe Ebu Dherrit. Ndërroi jetë në vitin 74 Hixhri.

**Rabia:** Ishte prej Tabiinëve. Bëri një jetë të pasur me dituri edhe pse ishte i verbër. Shquhej në Medine si ndër dijetarët më të mëdhenj të kohës së tij. Prej tij mësoi edhe imam Maliku.

**Umer Ibën AbdulAziz:** Ishte prej Tabiinëve. Nipi i Meruan Ibn Hakemit Prijësit të Shamit pasardhësit të Abdullah Ibën Zubejrit në Khilafet. Umeri shquhej për devotshmërinë e tij dhe ka qenë nxënës i Enes Ibën Malikut. Umer Ibën Abdulazizi, Khalif i tetë i dinastisë Emevite konsiderohet si i pesti i Khalifëve të drejtë. Vdiq i helmuar në vitin 101 hixhri në moshën 35 vjeçare duke qenë Khalif i drejtë. Ai tashmë e kishte kthyer edhe një herë kohën e Khalifëve të drejtë.

**Seid Ibën Xhubejri:** Është prej Tabiinëve të famshëm, i cili qëndroi trimërisht përballë diktatorit Haxhaxh Ibën Jusuf eth-Thekafiut. Në qëndrimin e tij ai tregoi vendosmëri për të mbrojtur të vërtetën, që në atë kohë nuk i shkonte shumë për shtat Haxhaxhit. Ai u vra nga Haxhaxhi në vitin 95 Hixhri.

**Harun Er-Rashid:** Eshtë një personalitet për të cilin është folur shumë në Perëndim, si njeri i dhënë pas pasioneve. Mirëpo e vërteta e tij është, se ai ishte një njeri i ditur dhe e nderonte diturinë. Në kohën e tij çdo libër që botohej për herë të parë e drejta e autorit blihej në flori me peshën e librit. (Lindi në vitin 147 Hixhri dhe ndërroi jetë në vitin 93 Hixhri).

### *Figura të shquara të jurisprudencës islame*

#### A

**Ahmed Ibën Hambel:** Imam Ahmedi, ashtu si edhe Imam Ebu Hanife, Imam Shafiu, Imam Maliku, themeloi një shkollë juridike shumë të rëndësishme, e cila quhet Medhhebi Hambeli. Ai njihet gjithashtu edhe për rezistencën që i bëri Halifit Memun, në lidhje me çështjen e përkufizimit të Kuranit, nëse ai është Fjala e Zotit apo krijesa e Zotit. Imam Ahmedi mbrojt mendimin që Kurani është Fjala e Zotit, që është edhe e vërteta. Vuajti për 18 muaj tortura dhe disa vite internim, por më në fund u lirua nga Khalifi Muteuekil. (Lindi në vitin 164 Hixhri dhe ndërroi jetë në vitin 241 Hixhri).

**Abdulaziz Bin Baz:** Dijetari i njohur Shejkh Abdullah bin Baz, që në moshë të vogël ka humbur shikimin dhe për këtë arsye ai mbante dikë që ia lexonte atij literaturën për të cilën do të mësonte ose do ta publikonte. Edhe ky rast bën pjesë në praktikën e tij të vazhdueshme për dijen dhe mos lodhjen e tij në këtë rrugë të bekuar. Ai ka ndërruar jetë në vitin 1999.

#### B

**Bukhari:** Lindi në vitin 194 Hixhri (810 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 256 Hixhri (870 Diellor). Ai ishte pena e Islamit, hafëz (memorizues) i hadithit të të Dërguarit të Allahut [paqja qoftë mbi të!]. Ai është autori i "El-Xhemiu es-Sahih", i cili njihet me titullin "Sahihu el-Bukhari". Gjithashtu ai





është autor i një sërë veprash sikurse “Et-Tarikh” që është një vepër voluminoze, “Ed-Dua’feu” që shtjellon autoritetin e transmetuesve të hadithit, “Khalku Efa’li el-I’bad” dhe “El-Edeb el-Mufrad”. Ai është lindur në Bukhara dhe është rritur jetim. Bëri një udhëtim të gjatë (në vitin 210 Hixhri) në gjurmim të hadithit, duke vizituar Khurasenin, Irakun, Egjiptin dhe Shamin. Ai ka dëgjuar prej rreth një mijë dijetarëve si dhe ka koleksionuar rreth 600 000 hadithe, prej të cilave në “Sahihun” e tij përzgjedhi transmetuesit me autorësi të besueshme. Ai është autori i parë që bëri në Islam një përpilim të këtij konteksti. Rezidencën ai e pati në Bukhara. Një grupazh, për shkak të fanatizmit, e akuzuan atë me akuza të paqena, kështu ai doli në Khartenka (një fshat prej fshatrave të Semerkandit) ku edhe ndërroi jetë. Përpilimi i tij në hadith është përpilimi më autentik ndër gjashtë përpilimet e famshme të hadithit që janë: “Sahihu el-Bukhari” (i autorit biografisë e të cilit po bëjmë), “Sahihu el-Muslim” (lindi 201 – ndërroi jetë në vitin 262 Hixhri), “Sunen Ebi Daudi” ((lindi 202 – ndërroi jetë në vitin 275 Hixhri), “Sunen et-Tirmidhi” (lindi 209 – ndërroi jetë në vitin 279 Hixhri), “Sunen Ibën Maxhe” (lindi 209 – ndërroi jetë në vitin 273 Hixhri) dhe “Sunen en-Nesaiu” (lindi 215 – dhe ndërroi jetë në vitin 303 Hixhri). Për zgjerim në biografisë e imam Bukhariut mund të lexoni librin “Hajatu El-Bukhari” të dijetarit Xhemaludin El-Kasimiu.

## DH

**Dhehebi:** Lindi në vitin 673 Hixhri (1275 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 748 Hixhri (1347 Diellor). Ai është rrëfyes, lektor, lider hafëz (memorizues), muhadith (shkencëtar i hadithit) i kohës dhe vulë e hafëzëve (memorizuesve). Ai është kronist islam dhe gjurmues i hadithit përgjatë tetëmbëdhjetë viteve. Ai ka nxënë prej shumë dijetarëve, ka udhëtuar, është preokupuar me këtë çështje, është përpjekur dhe i ka shërbyer asaj derisa u afirmua në të. Es-Sekhauiu në lidhje me të ka thënë: “Muhadithët e tanishëm, në lidhje me transmetuesit dhe profilet e tjera të arteve të hadithit, janë të nevojshëm për katër (personalitete): (Ebu el-Haxhaxh) El-Mizziu, Edh Dhehebiu, El-I’rakiu dhe Ibën Haxher El-Askalani”. Atij i iku shikimi në vitin 741 Hixhri. Përpilimet e tij janë të shumta dhe përafërsisht shkojnë në njëqind vepra, prej të cilave përmendim: “Tarikhu el Islam”, “Sijaru Ealemi en-Nubela”,



“Tabakatu el-Hufadh”, “Tabakatu el-Kura”, “Mukhtesar Tehdhibi el-Kemali”, “El Keshefu” “Et-Texhridu fi Esmai es-Sahabe”, “El-Mizan fid Duafe”, “El-Mugni fid Duafe”, “Telkhisu el-Mustedrak lil Hakim”, “Mukhtesar Suneni el-Bejhaki”, etj. Ai është lindur në Damask.

## E

**Ebu Hanife:** Ai është themeluesi i Medhhebit (Shkollës Juridike) Hanefi. Ai konsiderohet ndër dijetarët më të njohur të shkollës së Mendimit. Imam Shafiu do të thoshte për Ebu Hanifen: Njerëzit janë fëmijë përpara Ebu Hanifes, kur bëhet fjalë për Jurisprudencën Islame. Aktualisht medhhebi hanefi është më i përhapuri në botën Islame. (Lindi në vitin 80 Hixhri dhe ndërroi jetë në vitin 150 Hixhri).

**Ebu Daudi:** Lindi në vitin 202 Hixhri (817 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin e 275 Hixhri (889 Diellor). Ebu Daudi, nga Sixhistani: hadithologu i Basrës [qytet në Irak], imami (lideri), dijetari i madh, lideri i liderëve në hadith, një prej gjashtë autorëve të famshëm të përpilimeve të hadithit. Ai ka transmetuar nga El-Kanabiu, Ahmedi, Jahja, Ibën El-Mediniu dhe shumë të tjerë veç tyre [Allahu i mëshiroftë që të gjithë!]. Kurse prej tij kanë transmetuar: Et-Tirmidhi dhe djali i tij Ebu Bekri, Ebu Auane dhe një grup transmetuesish të tjerë [Allahu i mëshiroftë që të gjithë!]. Ibrahim el-Harbiu [Allahu e mëshiroftë!] ka thënë për të: “Hadithi iu ujdís Ebu Daudit, ashtu siç iu ujdís hekuri Daudit [paqja qoftë mbi të!]. Ibën Hibani [Allahu e mëshiroftë!] ka thënë: “Ebu Daudi është një nga liderët e botës në fikh, dituri, memorizim, rit, devocion dhe perfeksionim.” Ebu Daudi [Allahu e mëshiroftë!] e koleksionoi, përpiloi dhe mbrojte Sunetin. Atij i takojnë një sërë përpilimesh, prej të cilave përpilimi më i shquari është padyshim “Es-Sunen”, që përbën një prej gjashtëshes së përpilimeve më të shquara ndër përpilimet e hadithit, ku Ebu Daudi [Allahu e mëshiroftë!] ka koleksionuar 4800 hadithe, të cilat i ka përzgjedhur nga mesi i 500 000 haditheve. Gjithashtu Ebu Daudit [Allahu e mëshiroftë!] i takojnë përpilimet: “El- Merasil”, “Ez Zuhd”, “El-Beathu” etj [Marrë nga: “El-Meusuatu el-Arabie el-Alemie”]. Në “Ruetu et-Tehdhijbejni: (“Tehdhibu el-Kemali fi Esmai er-Rixhali”, me autor El-Mezziun (i cili ndërroi



jetë në vitin 742 hixhri) dhe “Tehdhibu et-Tehdhib”, me autor Ibën Haxher El-Askalani (i cili ndërroi jetë në vitin 852 Hixhri) vjen: “Ai është shtresa e njëmbëdhjetë, që i takon gjeneratës së mesit të atyre që kanë nxënë prej “tabi-tebi’inëve-gjeneratës pas gjeneratës së sahabëve”.

## I

Ibën Kajim El-Xheuzje: Lindi në vitin 691 Hixhri (1292 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 751 Hixhri (1350 Diellor). Ai është prej famozëve të reformës fetare islame të shekullit 8 Hixhri. U lind në Damask dhe procesin e nxënies së tij e kreu në duart e Ibën Tejmijes [Allahu e mëshiroftë!], prej të cilit u ndikua vërtet shumë. Ishte pikërisht Ibën Kajimi [Allahu e mëshiroftë!] ai që i përpunoi librat e tij dhe e publikoi diturinë e tij. Ai u burgos dhe u ndëshkua disa herë, për tu liruar më pas nga burgimi në Kalanë e Damaskut ku qe burgosur, vetëm pas vdekjes të Ibën Tejmijes [Allahu e mëshiroftë!]. Prej librave më të shquar të Ibën Kajim El-Xheuzijes [Allahu e mëshiroftë!] në lëmin e politikës ishte libri i tij i famshëm “Et-Turuk el-Hukmije fi es Sijaseti esh-Sher’ije”. Gjithashtu atij i takojnë një sërë përpilimesh në tjera në Sheriat, tefsir dhe fikh, prej të cilave përmendim: “Ialemu el-Mueki’in”, “Zedu el-Mead”, “Mederixhu es-Salikin”, “El-Uebil es-Sajib min el-Kelam et-Tajib” dhe “Et-Tibjan fi Eksami el-Kurani”. Muhamed Uejs e- Nedeui ka përpiluar një libër me titull “Tefsiru el-Kajim lil Imam Ibn el-Kajim”, të cilin e ka përfutur prej përpilimeve të tij. Ibën el-Kajimi [Allahu e mëshiroftë!] ka dhënë një rol të shquar në ideologjinë islame bashkëkohore.

Ibën Tejmije: Lindi në vitin 661 Hixhri (1263 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 728 Hixhri (1328 Diellor). U lind në Haran, prej qyteteve të gadishullit arabik, mes Digjlës dhe Euftratit, në vitin 661 Hixhri. Atë, bashkë me familjen, e solli në Damask i jati, në kohën kur zbarkuan ushtritë mongole dhe tatare që zaptuan shumë prej viseve arabe muslimane, në sulmin e tyre barbar të njohur historikisht. Mosha e tij në ditët e emigrimit si kalonte të gjashtë vitet. Në Damask, që asokohe ishte vatra e diturisë dhe fesë, e mori diturinë nga kompetentët e saj. Ai dha fetua (opinionet fetare) ende pa mbushur të njëzetat. U preokupua në Kuran, Hadith dhe Fikh. Ishte mbrojtës solid i besimit të

drejtë, i famshëm për asketizmin, fetarinë, përdëllimin, krahas guximit dhe trimërisë së tij. Ishte mbrojtës i vendit me shpatën e tij ashtu siç ishte edhe mbrojtës i bindjeve të Umetit me gjuhën dhe dorën e tij. Kur tatarët bënë ofensivë kundër Damaskut, në luftën e Shekhabit, ai u ngrit të mbronte Damaskun Jugor, luftë në të cilën Allahu shkroi dhe humbjen e tatarëve. Që kjo luftë ajo që u bë shkak për shpëtimin e viseve të Shamit (Sirisë dhe Jordanisë), Palestinës, Egjiptit dhe Hixhazit (Gadishullit Arabik) nga ofensiva e dytë barbare e tatarëve. Kërkoj nga pushtetarët vazhdimësinë e xhihadit për shfarosjen e armiqve të kombit islam dhe përkrahësve e bashibozukëve të tyre. Kjo gjë ndolli urrejtjen e pushtetarëve e rivalëve të tij dhe stimuloi intrigat e dyfytirëshve dhe të prishurve, gjë që solli keqtrajtimin, burgimin, përzënie dhe internimin e tij; porse ai nuk u dobësua dhe as u nënshtroa. Fjala e tij e famshme ishte: “E çfarë të më punojnë mua armiqtë e mi?! Unë parajsën dhe bahçen time e kam në gjoksin tim, kudo që të shkoj është me mua e nuk më ndahet. Për mua burgu është vetmi me Zotin tim, vrasja martirizim, ndërsa përzënia nga vatani është eksplorim.” Gjatë burgimit të tij, që ishte vërtetë i gjatë, ai thoshte: “I burgosur i vërtetë është ai të cilit i është burgosur zemra larg Zotit të tij, e i robëruar është ai të cilin e ka robëruar epshi i tij.” Veprat e tij në lëmenj të ndryshëm të diturisë i kaluan treqind dhe disa prej tyre janë disa vëllimshe. Vdekja e gjeti atë në burgun e Kalasë së Damaskut, natën e hënë, ditën e njëzetë të Dhul Kides, të vitit 728 Hixhri [Allahut e mëshiroftë me një mëshirë të gjerë!] [Shih biografinë e Ibën Tejmijes, në fillimin e librit “Kitabu el-Iman” me autor Ibën Tejmije].

**Ibën Kethiri:** Lindi në vitin 701 Hixhri (1302 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 774 Hixhri (1373 Diellor). Jetoj në Basra, pastaj në Damask. Hafëz (memorizues), kronist, jurist, lindi në Sham në një fshat të Basras dhe më pas me një vëllain e tij u transferua në Damask në vitin 706 Hixhri, nga ku udhëtoi në kërkim të diturisë. Njerëzit i bartën përpilimet e tij teksa ai ishte ende gjallë. Prej librave të tij përmendim “El-Bidaja ue En-Nihaje” me 14 vëllime në lëmin e historisë, i cili vjen në modelin e Ibn el-Ethirit, “Sherhu Sahihi el-Bukhari” të cilin nuk arriti ta përfundonte, “Tabakatu el-Fukahei esh-Shafi’in”, “Tefsiru el-Kurani el-Kerim” me dhjetë vëllime, “Xhemiu el Mesenid” më tetë vëllime, “Ikhtisar Ulumi el-Hadith” një kumtim në shkencën e terminologjisë së



hadithit, "Ikhtisar es-Sirati en-Nebeuia", "Et-Tekmil fi Mearifeti eth-Thikati ued Duafei ue el-Mexhehil" me pesë vëllime [Shiko: "El-Ea'lem" me autor Ez-Zirikliu (i cili ka ndëruar jetë në vitin 1396 Hixhri)]. Nxënien e diturisë ai e bazoi tek dijetarët e Damaskut sikurse El-Emediu dhe Ibën Tejmija me të cilin kishte një komunikim privat, për shak të të cilit Ibën Kethiri iu ekspozua një persekutimi. Ai i takonte një shtëpie diturie dhe disipline. Ai ishte nxënës i dijetarëve të mëdhenj të kohës së tij. Progresoi si dijetar, ekzaminues, i besueshëm, i përpiktë, det në dituri, hulumtues i arrirë dhe lider në tefsir, hadith dhe histori, duke lënë pas një sërë përpilimesh të çmuara... Para se të vdiste atij ai u verbua. Ndërroi jetë dhe u varros në Damask.

**Ibën Sirini:** Lindi në vitin 33 Hixhri (653 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 110 Hixhri (729 Diellor). Ishte lider i kohës së vet në shkencat e fesë në Basra. I ati i tij pati qenë skllav i Enesit [Allahu qoftë i kënaqur me të!] që e kishte liruar atë me kontratë pagese. Ai është nga Tabi'inët dhe nga autorët më të nderuar të përpilimeve fetare, bartës i titullit dijetar i Islamit. Ai lindi në Basra, në kohën e qeverisjes së Umarit [Allahu qoftë i kënaqur me të!], jetoj rreth tetëdhjetë vite dhe ndërroi jetë po në Basra. Për fizionominë e tij kanë thënë se ai ka qenë me probleme në të dëgjuar, i shkurtër, barkmadh, i ndante flokët, bujar dhe bënte shaka e qeshte shumë në bisedat me njerëzit, por kur fliste për fenë ai vrenjtej dhe rrudhej. Ai përshkruhet se ka qenë unik, mendjemprehtë, i devotshëm dhe i përmbajtur. Pati pësuar disa probleme, ndër të cilat edhe në mallin që tregtonte, gjë e cila e zhyti në borxh dhe bëri që të bjerë dhe në burg. Gjithashtu thuhet se ai merrte gusël për çdo ditë dhe kishte shumë vesvese në abdes. Tregohet se kur në prani të tij përmendej vdekja, çdo gjymtyrë e tij bëhej si e vdekur. Njerëzit e donin shumë atë dhe pamja e tij i kujtonte ata me fenë e Allahut të Madhëruar. Ai vlerësohet se kishte njohuri të gjera në diturinë e trashëgimisë (El-Faraid) dhe në çështjet penale. Ai jetoj me tridhjetë prej sahabëve. Ai u bë dijetar në fikh dhe në transmetimin e hadithit. Ai ishte i shquar për devocionin e tij, agjëronte një ditë po dhe një ditë jo. Gjithashtu ai ishte i shquar edhe për interpretimin e tij të ëndrrave. Atij i përkatësohet libri "Teabiru er Ru'je" sikurse e përmend këtë fakt Ibën Nedimi dhe ky libër nuk ka të bëjë me botimin me titull "Muntekhabu el Kelam fi Tefsiri el Ehlam", që ia kanë përkatësuar Ibën Sirinit, por që s'është i tij [Shih:



“El Ea’lem” me autor Ez Zirikliu (i cili ndërroi jetë në vitin 1396 Hixhri) dhe “Sijaru Ealemi en Nubala” me autor Edh-Dhehebiu (i cili ndërroi jetë në vitin 748 Hixhri)]. Në “Ruetu et-Tehdhijbejni: (“Tehdhibul Kemali fi Esmei er Rixhali”, me autor El-Mezziun (ndërroi jetë në vitin 742 Hixhri) dhe “Tehdhibu et-Tehdhib”, me autor Ibën Haxher el-Askalanin (ndërroi jetë në vitin 852 Hixhri) vjen: “Ai është shtresa e tretë, që i takon gjeneratës së mesit të “Tabi’inëve - gjeneratës pas sahabëve”. Ibën Haxheri në lidhjen me gradën e autoritetit të tij në hadith thotë: Ai është i besueshëm, me shumë vlera dhe nuk ishte pro transmetimit të hadithit me kuptim. Ndërsa Edh-Dhehebiu thotë për të: Ai ishte i besueshëm, argument, një prej krerëve të diturisë, me dituri të madhe.

**Ibën Khuzejme:** Lindi në vitin 223 Hixhri (838 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin e 311 Hixhri (923 Diellor). Emri i tij është Muhamed ibën Is’hak ibën Khuzejme, Ebu Bekri, hafëz, argument, dijetar i madh i fikhut dhe hadithit, njohës shumë i mirë i transmetuesve të haditheve, i titulluar shejkhu (dijetari i madh) i Islamit, imam (lider) i imamëve (i liderëve), nga Nejseburi. Ai është autor i shumë përpilimeve dhe një prej dijetarëve më të shquar të hadithit. Që në vegjëli u preokupua me hadithin dhe fikhun, aq sa shërbeu si model me të cilin jepej shembull sa i përket diturisë së gjerë dhe perfeksionimit. Ai udhëtoi në Sham, Irak, Egjipt dhe Gadishullin Arabik. Hafëz Ebu Ali En-Nejseburi ka thënë për të: “Nuk kam parë askënd sikurse Ibën Khuzejme”. Edh-Dhehebiu ka thënë: “Ai (Hafëz Ebu Ali En-Nejseburi) e thotë këtë gjë, porse ai ka parë En-Nesaiun”. Ed-Derakutniu ka thënë: “Ishte imam (lider) konsekuent dhe nuk kishte shembull”. Ibën Hibani ka thënë: “Nuk kam parë në fytyrën e tokës dikë të memorizoj produksionin e suneteve (të traditës profetike), të memorizoj artikulimet e haditheve autentike dhe shtojcat e tyre, aq sa sunetet sikur ishin midis dy syve të tij, përveçse Ibën Khuzejmes”. Përpilimet e tij kanë arritur në 140, prej të cilave përmendim: “Et-Teuhid ue Ithbetu Sifati er-Rabi”, “Mukhtesar el-Mukhtesar” si dhe “Sahih ibën Khuzejme”. Ibën Khuzejme [Allahu e mëshiroftë!] jetoi tetëdhjetenëntë vite [Shih: “El Ea’lem” me autor Ez-Zirikliu (i cili ndërroi jetë në vitin 1396 Hixhri) dhe “Sijaru Ealemi en Nubala” me autor Edh-Dhehebiu (ndërroi jetë në vitin 748 Hixhri)].



**Ibën Hishami:** Ndërroi jetë në vitin 213 Hixhri (828 Diellor). Kronist i afirmuar (i gradës eminent) në shkencën e gjenalogjisë, gjuhës dhe rrëfimeve të arabëve. Ai ka lindur dhe është rritur në Basra, ndërsa ka vdekur në Egjipt. Libri i tij më i famshëm është “Es-Siratu en Nebeuie” i njohur me “Siratu Ibën Hisham”, që e ka transmetuar nga Ibën Is’haku (duke e koleksionuar dhe përpunuar nga përpilimi i tij “El-Magazi ue Sijer”). Prej veprave të tij është “El-Kasaid el-Himjarie” që sjell rrëfimet e Jemenit dhe mbretërve të tij përgjatë periudhës paraislame. Po në këtë kontekst ka shkruar “Et-Tijxhan fi Muluki Himjar”, që e ka transmetuar nga Esed ibën Musa, nga Ibën Sinani, nga Ueheb Ibën Munebihi si dhe veprën e tij “Sherhu ma Uekaa’ fi Esha’ri es-Sijer min el-Garib” etj... [Shiko: “El-Ea’lem” me autor Ez-Zirikliu (i cili ndërroi jetë në vitin 1396 Hixhri)]. Es-Suhejliu, shpjeguesi i jetëshkrimit të Pejgamberit [*paqja qoftë mbi të!*], thotë për të në librin e tij “Er Raudu el-Unuf”: “Ai njihet për mbartjen e diturisë dhe si i avancuar në diturinë e gjenealogjisë dhe gramatikës...”

**Ibën Haxher:** Lindi në vitin 168 Hixhri (784 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 230 Hixhri (845 Diellor). I njohur me emrin Ibën Haxher El-Askalani, Shihebudin Ebu E- Fadli, el-Keneni. Ai është autori i interpretimit më të shquar të “Sahihu El-Bukhari”. Origjina e tij është nga Askalani i Palestinës, teksa për të lindur ai lindi në Kajro, ku edhe ndërroi jetë. Ai është dijetar, muhadith, fakih, fillimisht përpilues i arrirë në zhanrin e letërsisë dhe poezisë, paskëtaj u dha pas hadithit, dëgjoi shumë dijetarë, udhëtoi dhe iu qep pas profesorit të tij Hafëzit Ebu El Fadl El-Irakiut. Ai udhëtoi në Jemen, në Hixhaz dhe gjetkë, që të dëgjonte dijetarët. Fama e tij u përhap anembanë. Njerëzit merrnin rrugën për tek ai për nxënien e diturisë që ai posedonte. Ai u bë Hafëzi i Islamit në kohën e tij. Kur El-Irakiu po përjetonte agoninë e vdekjes, atij i thanë: Kë ke lënë pas teje? Ai u përgjigj: “Ibën Haxherin, pastaj dy djemtë e Ebu Zer’as, pastaj El-Hajthemiun”. Ibën Haxheri ishte shumë elokuent, vjershëtor dhe recitues i afirmuar dhe njohës i kronikave të gjeneratave të mëhershme dhe mëvonshme. Ai u emërua në kryesinë e gjykatës së Egjiptit disa herë dhe më pas dha dorëheqjen. Sa i përket përpilimeve të tij ato janë vërtetë të shumta, prej të cilave përmendim: “Fet’hul Bari fi Sherhi Sahihi el-Bukhari”, “El I’sabe fi Temjizi Esmei es-Sahabe”, “Tehdhibu et Tehdhib”,



“Tekribu et-Tehdhib fi Esmei Rixhali el-Hadith”, “Lisenu el-Mizan”, “Esbebu en-Nuzuli”, “Tea’xhilu el Menfea bi Rixhali el-Eimeti el-Arbea”, “Bulugul Muram min Edileti el-Ehkami”, “Teb siru el-Muntebih fi Tehrimi el Mushtebih”, “It’hafu el-Mehera bi Etrafi el-Ashra”, “Tabakatu el-Mudelisin”, “El-Kaul el-Museded fi edh Dhebhi an Musnedi el -Imami Ahmed”, etj...

## K

**Kadij Ajad:** Lindi në vitin 476 Hixhri (1083 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 544 Hixhri (1149 Diellor). Dijetar i Marokut, hafëzi unik, i atribuuar me titullin dijetari i Islamit, imam (lider) i hadithit në kohën e tij. Ai ishte prej njerëzve më të ditur mbi artikulimet e gjuhës arabe, gjenealogjinë dhe kronikën e tyre. Ai nuk është se filloi të mësonte që në vegjëlinë e tij, por filloi të mësonte pas të njëzetedytave të moshës së tij, në duart e dijetarëve më me zë numri i të cilëve ka qenë rreth njëqind, derisa u thellua në dituri, koleksionoi dhe përpiloi, për t'i bërë përpilimet e tij kapitëqë synonin dhe bartnin karvanët e nxënësve të dijes dhe për të marrë përfitimet dhe dijen e tij. Ai lindi në Sebte dhe pikërisht në të atij iu besua për një kohë relativisht të gjatë kryesia e gjykatës. Pas kësaj atij iu besua kryesia e gjykatës së Granadës ku nuk qëndroi gjatë dhe u nis për në Kurtube (Kordobë). Kadij Ajadi arriti në vendin e tij një pozitë dhe emërim që askush nga banorët e vendit të tij nuk e pati arritur më parë, porse kjo nuk i shtoi atij përveçse modesti dhe frikë ndaj Allahut të Madhëruar. Ai ndërroi jetë në Marakish i helmuar, teksa thuhet se helmimin ia bëri një hebre. Prej përpilimeve të tij përmendim "Esh-Shifa bi Tearifi Hukuki el Mustafa" që është një ndër përpilimet e tij më të çmuara ku problemi i vetëm është se ai nuk i ka mënjanuar apo identifikuar hadithet e trilluara, paçka se qëllimi i tij ka qenë lavdërimi i Pejgamberit [paqja qoftë mbi të!], teksa hadithet autentik të pasura në këtë zhanër janë të shumta. Prej përpilimeve të tij të tjera është gjithashtu edhe "El-Gunje" ku përmend dijetarët nga të cilët ai e kishte marrë diturinë, "Tertibu el-Mederiki ue Tekribu el-Meseliki fi Mearifeti Ealemi Medhhebi el-Imam Maliki" që është disa vëllimesh, "Et-Tarikhu" një përpilim që dominoi në lëmin e vet, ku ai tuboi informatat mbi mbretërit e Andaluzisë dhe Marokut dhe përfshiu të dhënat e Sebtës dhe dijetarëve të saj. Gjithashtu prej librave të tij janë edhe



"El-Ilmea ile Mearifeti Usuli er-Rauije ue Tekjidi es-Semai" që është një përpilim në terminologjinë e hadithit.

**Khatabi:** Lindi në vitin 319 Hixhri (931 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 388 Hixhri (998 Diellor). Khatabiu, ishte prej krerëve të dijetarëve të arabishtes, pedagogjisë, fikhut dhe hadithit. Ai ishte prej banorëve të Bustes (prej viseve të Kabulit), prej pasardhësve të Zejd Ibën El-Hatabit (vëllait të Umar Ibën El-Khatabit). Jetoi një farë kohe në Nejsebur, pastaj u bart në Buste, ku edhe ndërroi jetë. Atij i takojnë një sërë përpilimesh të çmuara, prej të cilëve "Mealimu es-Suneni", "Garibu el-Hadithi", "Bejenu Ia'xhezi el-Kuran", "Islahu Galati el-Muhadithine", "Tefsir Ehadithi el-Xhami' Es-Sahih lil Bukhariu" etj. Ai ishte shok i Eth-Thealebiut, i cili ka sjellë një pjesë të mirë të poezisë së tij në përpilimin e vet "El-Jetime" [Shih: "El-Ea'lem" me autor Ez-Zirikliu ( i cili ndërroi jetë në vitin 1396 Hixhri).

**Kurtubi:** Lindi në vitin 600 Hixhri (1204 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 671 Hixhri (1273 Diellor). Ai është nga Andaluzia, Ebu Abdullahu, prej Ensarëve të fisit Khazrexh: dijetar i madh i tefsirit, fikhut dhe gjuhës arabe. Ai ishte një njeri i denjë, adhures i flaktë, i devotshëm, e kishte lënë mënjanë ekzagjerimin, vishte një rrobë të vetme dhe mbi kokë mbante një takije. Ai u lind në qytetin e Kurtubes (Kordobës), pas rënies së saj udhëtoi për në Aleksandri dhe më pas për në Said të Egjiptit ku edhe banoi. Imam El-Kurtubi [Allahu e mëshiroftë!] ishte një dijetar i madh që i ishte përkushtuar diturisë dhe e kishte lënë mënjanë dynjanë. Ai la pas vetes një thesar diturie që vlerësohet me trembëdhjetë libra, prej të cilave padyshim që më i shquari është tefsirit i tij i madh dhe tubues i dispozitave të Kuranit fisnik, i cili është një tefsir (komentim) i kompletuar dhe i pasur, që krahas shkencave të tjera bart në të edhe studimin e çështjeve fetare. Ky tefsir titullohet "El-Xhemiu' li Ehkami el-Kurani", i njohur ndryshe me "Tefsiru el-Kurtubi" dhe është i përbërë nga njëzet vëllime. Krahas tij, prej veprave më të njohura të El Kurtubiut [Allahu e mëshiroftë!] mund të përmendim "Et-Tedhkira bi Ehuali el-Meuta", "Ehualu el-Akhira", "Et Tedhekir fi Efdali el-Edhkar" dhe "Et-Takrib li Kitabi et-Temhid" që ka dy vëllime të mëdha. Imam El-Kurtubi ndërroi jetë në një moshë rreth shtatëdhjetë vjeçare dhe u varros në Said të

Egjiptit [Shih: “El-Ea’lem” me autor Ez Zirikliu (i cili ndërroi jetë në vitin 1396 Hixhri).

## M

**Malik Ibën Enes:** Themeluesi i Medhhebit (shkollës Juridike) Maliki. Lindi në Medine në vitin 93 Hixhri dhe ndërroi jetë po aty në vitin 179 Hixhri. Autori i librit të famshëm ‘El Muveta’.

**Muhamed Ibën Abdul Vehab:** Ky dijetar jetoi dhe veprroi në zonën që sot njihet si Arabia Saudite. Ai konsiderohet themeluesi i lëvizjes vehabite (edhe pse këtë emër ia kanë vendosur më vonë studiuesit perëndimorë). Gjithsesi në meritën e punës së tij ishte që pastroi zonën e Hixhazit nga idhujtaria, që e kishte mbuluar shoqërinë muslimane të kohës. Kryesisht kjo lëvizje ka si qëllim purifikimin e besimit të muslimanëve në besimin në një Zot të vetëm (Allahu i Madhëruar), duke mos bërë ndaj Tij idhujtari të asnjëlloj forme. (Lindi në vitin 1115 Hixhri dhe ndërroi jetë në vitin 1206 Hixhri).

**Muhamed Ibën Ibrahim Ali Shejkh:** Ish-Myftiu i përgjithshëm i Mbretërisë së Arabisë Saudite (Lindi në vitin 1311 Hixhri dhe ndërroi jetë në vitin 1389 Hixhri).

**Muslim:** Lindi në vitin 194 Hixhri (810 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 256 Hixhri (870 Diellor). Është imami hafëz (memorizues), argument, përpilues i shquar në hadith dhe shkencat e tij, autor i “El-Xhemi’ es Sahih”. Ka lindur dhe ka vdekur në Nejsebur. Ka përfutuar shumë prej imam Ahmed Ibën Hanbelit dhe El-Bukhariut. Ka udhëtuar në Hixhaz (Arabi), Egjipt, Sham dhe Irak. Është takuar me një sërë dijetarësh prej të cilëve Is’hak Ibën Rahuejhin, Zuhejr Ibën Harbin, Ebu Bekër Ibën Shejben, Ali El-Mediniun dhe Muhamed Ibën Jahja El-Kutaiu. Veç këtyre, Edh-Dhehebiu ka përmendur dhjetëra të tjerë kur ka folur për imam Muslimin në përpilimin e tij “Sijeru Ealemi en Nubelei”. Sa i përket atyre që kanë transmetuar prej tij, numri i tyre është vërtetë i shumtë, prej të cilëve përmendim Et-Tirmidhi, Ibrahim Ibën Sufjanin, Ebu Bekër Ibën Khuzejmen, Muhamed Ibën Makhled El-Atarin, etj.



Ai ishte prej hafëzëve (memorizuesve) më të shquar, aq sa është thënë se memorizuesit në rang bote janë katër: Ebu Zer'a në Raj, Muslimi në Nejsebur, Abdullah Ed-Derimiu në Semarkand dhe Muhamed Ibën Ismaili në Bukhara. Ai ka shumë përpilime, më i shquari i të cilave është "El-Xhemi' es-Sahih", të cilin e ka përpiluar nga 300 000 hadithe të dëgjuar, të tillë që përmban 12 000 hadithe. Ai e shkruajti atë në 15 vjet. Muslimi mbi këtë vepër thotë: "Nuk kam vendosur dhe marrë për bazë në këtë libër timin diçka përveçse me argument dhe nuk kam rrëzuar diçka prej tij përveçse me argument". Ky përpilim është një prej dy autentikëve që janë që të dy ajkë në lëmin e hadithit profetik. Këtë përpilim e kanë shtjelluar shumë autorë. Hafëzi Ebu Ali En-Nejseburi ka thënë për të: "Nuk ka nën rripin e qiellit libër më të saktë sesa libri i Muslimit". Prej përpilimeve të tij është gjithashtu edhe "El-Musned el Kebir ale er-Rixhal", "Et-Temjiz", "El-Ilel uel Esme-e", "Et-Tabakat", "Euhemu el-Muhadithin", "etj...

## N

**Neueui:** Lindi në vitin 631 Hixhri (1234 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 676 Hixhri (1278 Diellor). Ka lindur dhe vdekur në Neue, një fshat të Hauranit në Siri.. Ka qenë një imam novator, hafëz (memorizues) urdhërues në të mirë dhe ndalues nga e keqja, braktisës i pasioneve, vendos të mos martohet. Përsoset në shkenca të ndryshme dhe merr kryesinë e Komunitetit të Hadithit. Biografia e tij shfaqet unike në një sërë kumtesash. Ibën El-A'tari, një prej nxënësve të tij i ka renditur dhe nxënë përpilimet e tij. Prej tyre përmendim: "Tehdhibu el-Esmei uel Lugati", "El-Minhaxhu fi Sherhi Muslim", "Et-Tekribu ue Tejsir fi Mustalahi el-Hadith", "El-Edhkar", "Rijadu es Salihin" i cili është një libër koleksionues shumë i shquar, "El-Mexhmu'u Sherhi el-Muhedheb", "El-Arbeain en Neueuie", "Mukhtesar Esed el-Gabe fi Mearifeti es-Sahabe", etj.

## Sh

**Shafiuu:** Imam Shafiuu edhe ky konsiderohet ndër eruditët e mëdhenj të

Islamit. Ai është themeluesi i Medhhebit Shafii. Lindi në Gaza të Palestinës, por në moshën dy vjeçare familja u transferua për në Mekë, ku edhe jetoi një kohë të gjatë. (Lindi në vitin 150 Hixhri dhe ndërroi jetë në vitin 204).

T

**Tabari:** lindi në vitin 224 Hixhri (839 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 310 Hixhri (923 Diellor). Ai ishte lideri i komentuesve të Kuranit fisnik. Është lindur në Tabaristan, ku ka filluar nxënien e diturisë në moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare. Pastaj udhëtoi për në Bagdad ku u vendos pasi vizitoi një sërë visesh. Dijetarët i kanë bërë lëvdata të shumta Et-Tabariut, duke thënë: Ai është i besueshëm, dijetar i madh, një nga liderët e mëdhenj të Ehlu (Ndjekësve të) Sunetit. Fjala e tij merret në konsideratë dhe ai është referencë falë diturisë së tij të gjerë dhe metodologjisë së tij të saktë. Ai ka lënë pas një sërë përpilimesh me vlerë ku më e shquara është vepra e tij e madhe e tefsirit “Xhemi’u el-Bejeni an Teuili Eji el-Kurani”, i cili në masën e gjerë njihet me titullin “Tefsiri i Et Tabariut”, që është komentimi i parë i plotë i Kuranit që ka arritur tek ne. Prej tij kanë përfituar të gjithë studiuesit e mëpasshëm, prandaj dhe dijetarët e kanë konsideruar Et-Tabariun baba të tefsirit. Gjithashtu ata e kanë konsideruar atë babanë e historisë, pasi ai në lëmin e historisë është autor i përpilimit të një libri të madh të cilit nuk i gjendet shoku, por duhet thënë se ai në këtë vepër nuk është treguar konsekuent në lidhje me dokumentimin. Këtë libër ai e ka quajtur “Tarikhu el-Umemi uel Muluk”. Prej veprave të tij të shquara është gjithashtu edhe “Tehdhibu el-Etheri” etj. Imam Et-Tabariu ndërroi jetë në Bagdad.

**Tahau:** Lindi në vitin 238 Hixhri (852 Diellor) dhe ndërroi jetë në vitin e 321 Hixhri (933 Diellor). Dijetar i madh i hadithit, dijetar i shquar i fikhut, i njohur përmes përpilimit të tij “El-Akide et-Tahauie”. Studioi fikhun Shafi’i përmes dajës së tij El-Muzeniut, kolegut të imam Shafi’iut. Pastaj u kthye në medhhebin e Ebu Hanifes, duke marrë mësimet e fikhut nga dijetar i madh i fikhut hanefi Ahmed ibën Ebi I’mran. Ai udhëtoi në Sham dhe mori leksione hadithi në Bejtul Makdes, Gazë, Askalan dhe Damask, ku e studioi fikhun përmes Ebi Hazmit Abdulhamid Ibën Abdulazizi. Pastaj u kthye në Egjipt, ku



kryesoi kolegjiunin e Ebu Hanifes në Egjipt. Ai ka transmetuar nga Junus ibën Abdu El-Eale, Harun Ibën Seaid El-Ejliu, Muhamed Ibën Abdullah Ibën Abdulhakimi, Ibrahim Ibën Ebi Daudi Ed-Darisiu dhe të tjerë veç tyre. Prej tij ka transmetuar djali i tij Aliu, Sulejman Ibën Ahmed Et-Tabaraniu etj. Përpilimet e tij janë të shumta, prej të cilave përmendim: "Sherhu Meani El-Etheri", "Mushkilu el Etheri", "Ikhtilafu El-Fukahei", "El-Mukhtesar fi el-Fikhi", "El-Akide et-Tahauie", "Ehkemu el-Kurani", "El-Usaja" "El Muhadir ue es-Sexhelet", etj. Ai u varros në Egjipt".





## Referenca

- 1- *Kurani i Madhërishëm dhe kuptimet e tij në gjuhën shqipe*, Prof. Hasan I. Nahi, botim: AIITC, botimi i shtatë, Tiranë: 2010.
- 2- *Imam El-Bukhari*: "Sahih el-Bukhari".
- 3- *Imam Muslim*: "Sahih Muslim".
- 4- *Imam Ebu Daud*: "Sunen ebi Daud".
- 5- *Imam Et-Tirmidhi*: "Sunen Tirmidhi".
- 6- *Imam En-Nesai*: "Sunen en-Nesai".
- 7- *Imam Ibën Maxhe*: "Sunen ibën Maxhe".
- 8- *Abdu Rezaku*: "Musnefi Abdu Rezak".
- 9- *Abdurrahman Es-Sadi*: "Tefsir el-Kerim er-Rrahman".
- 10- *Abdurrahman Rafet El-Basha*: "Sueru min Hajati es-Sahabe".
- 11- *Ahmed Ibën Hanbel*: "Musned Imam Ahmed Ibën Hanbel".
- 12- *Akili*: "Duafa el-Kebir".
- 13- *Albani*: "Sifetu es-Salah".
- 14- *Begaviu*: "Sherh es-Suneh".
- 15- *Bejhakiu*: "Edeb esh-Shafij".
- 16- *Bejhakiu*: "Tabakat el-Kubra".
- 17- *Bejhakiu*: "Menakibu esh-Shafij".
- 18- *Bukhariu*: "Edeb el-Mufred".
- 19- *Darimiu*: "Es-Sunen".
- 20- *Darimiu*: "El-Ilm".
- 21- *Dhehebi*: "Sijer Alam en-Nubela".
- 22- *Ebu Bekr El-Exherij*: "Ahlak el-Ulema".
- 23- *Ebu Naim*: "Dhikr Ehbar Asbahan".
- 24- *Ebu Naim*: "El-Hulje".
- 25- *Emedij*: "Ihkam el-Ehkam".
- 26- *Ez-Zirikliu*: "El Ea'lem".

- 27- Hajthemi: "El-Mexhma".
- 28- Hakimi: "El-Mustedrek".
- 29- Hejthemi: "Kitab el-Ilm".
- 30- Hejthemi: "Mexhmea ez-Zeuaid".
- 31- Ibn Kajim: "Kitab El Rruh".
- 32- Ibn Tejmije: "Sheriati".
- 33- Ibn Xheuzi: "Menakib el-Imam Ahmed".
- 34- Ibnu El-Xheuzi: "Umer Ibën El-Khatab".
- 35- Ibën Abd el Berr: "Xhemiu Bejani el- Ilmi ue Fadlihi"
- 36- Ibën Abd El-Hadij: "Irshadu es-Salik".
- 37- Ibën Abdul Berr: "El-Intika min Fadaail Eth-Thelethe el-Eime el-Fukaha".
- 38- Ibën Abedin: "El-Hashija".
- 39- Ibën Arabij Selefî: "Ehkam el-Kuran".
- 40- Ibën Asakir: "Keshfu el-Gita".
- 41- Ibën Asakir: "Tarikhu".
- 42- Ibën Atijk El-Hanbeli: "Sebil Nexhah ue el-Fekak".
- 43- Ibën Batal: "Transmetim nga Ibn Haxheri," Fet`h el-Bari".
- 44- Ibën Besam: "Adh-Dhekhira".
- 45- Ibën Ebi Hatim: "Edeb esh-Shafij".
- 46- Ibën Ebi Hatim: "El-Xherhu ue et-Teadil".
- 47- Ibën Ebij Iz: "Sherh el-Akide et- Tahavije".
- 48- Ibën Ethir: "Tarikhu Ibën Ethir".
- 49- Ibën Halkani: "Ufejat el-Eajan".
- 50- Ibën Hamdan: "Sifetu el-Fetua ue el-Mustefti".
- 51- Ibën Haxhe: "El Xhamiu fi Ehlak er-Rauï ue Edab es-Semia".
- 52- Ibën Haxher El-Askalani: "El-Isaba".
- 53- Ibën Haxher El-Askelani: "Fet`h el- Bari".
- 54- Ibën Hiban: "Kitab el-Mexhruhin".
- 55- Ibën Hisham: "Siretu en-Nebij".
- 56- Ibën Ibad: "Eth-Thikat".
- 57- Ibën Kajim: "Et-Tefsir el-Kajim".
- 58- Ibën Kajim: "Miftah Daru es-Seadeh".
- 59- Ibën Kajim: "Ialam el-Muekine".



- 60- *Ibën Kajim*: "Medarixhu es-salikin".
- 61- *Ibën Kajim*: "Telbis Iblis".
- 62- *Ibën Kethir*: "Tefsiru el-Kurani el-Adhim".
- 63- *Ibën Kethir*: "El-Bidaje ue en-Nihaje".
- 64- *Ibën Mubarek*: "Ez-Zuhd".
- 65- *Ibën Rexheb*: "Sherh Hadith Ebi Derda`a fi Talebi el-Ilm".
- 66- *Ibën Rexheb*: "Fet'h el-Bari".
- 67- *Ibën Rexheb*: "Bejanu Fadli Ilmu Selef ala Ilm el-Khalef".
- 68- *Ibën Tejmija*: "Refau el-Melam".
- 69- *Ibën Tejmije*: Kitabu el-Iman
- 70- *Ibën Tejmije*: "Mexhmuatu el-Fetava".
- 71- *Ibën Tejmije*: "Minhaxhu es-Suneh".
- 72- *Ibën Tejmije*: "El-Uasijetu el-Kubra".
- 73- *Ibën Xhem'ah*: "Tedhkiretu es-Samij uel- Mutekelim".
- 74- *Ibën Xherir*: "Xhemiu el-Bejan".
- 75- *Ibën Xheuzi*: "El-Ilel".
- 76- *Imam Shafiu*: "El Um".
- 77- *Ibën Farhun*: "Ed-Dijbaxh".
- 78- *Kasimi*: "Musnef".
- 79- *Khatib El-Bagdadi*: "El- Kifaje fi Ulumi er-Riuaje".
- 80- *Khatib El-Bagdadi*: "Er-Rihletu fi Talebi el-Hadith".
- 81- *Khatib El-Bagdadi*: "Sheref As`hab el-Hadith".
- 82- *Khatib El-Bagdadi*: "Tarikh Bagdad".
- 83- *Khatib el-Bagdadi*: "Xhemiu Ehlik er-Raui ue Edab es-Semiu".
- 84- *Kurtubiu*: "El-Xhemiu Li el-Ehkam el-Kuran".
- 85- *Lalakaij*: "Sherhu Usuli I'atikadi Ehli es-Suneti ue el-Xhemah".
- 86- *Muhamed Uejs EN-Nedeuij*: "Tefsiru el-Kajim lil Imam Ibën el-Kajim".
- 87- *Mustafa Es-Sibai*: "Ahlakuna el-Ixhtimaije".
- 88- *Nasir Ibën Abdurrahman El-Akl*: "El Ulemau humu ed-Duatu".
- 89- *Nesai*: "El-Istikame".
- 90- *Neueuij*: "El-Mexhmu".
- 91- *Neueuij*: "Sherhu Sahih Muslim".
- 92- *Ramhurmuzi*: "El-Muhadith el-Fasil".
- 93- *Revista*: "Rabitat el-Alem el-Islami".

- 94- *Salih El-Feuzan*: "Uxhubu et-tethebuti fi el-Ehbari ue bejan mekeneh el-Ulema".
- 95- *Sebkij*: "Kaidetu el-Xherhi ue et- Teadil".
- 96- *Sebkij*: "Tabakat es-Shafiije".
- 97- *Sujuti*: "Ed-Durar el-Menthur".
- 98- *Sulejman El-Gisn*: "Itibau el-Heua".
- 99- *Sharani*: "El-Mijzan".
- 100- *Shatibiu*: "El-Muefekat".
- 101- *Shatibiu*: "El- I'atisam".
- 102- *Shemsudijn El-Asfahani*: "El-Kauaid".
- 103- *Tabariu*: "Xhamiu el-Bejan".
- 104- *Tabariu*: "Tefsiri i Taberiu".
- 105- *Taberani*: "Dhilal el-Xheneh fi tehrixh es-Suneh".
- 106- *Taberiu*: "Tarihu el-Umem uel Muluk".
- 107- *Tuexhrij*: "Itihaf el-Xhemah".
- 108- *Xhemaludin El-Kasimiu*: "Hajatu El-Bukhari"





هذا الكتاب منشور في

سِبْكَرِ الْأَوْكِي

[www.alukah.net](http://www.alukah.net)